

ENVER HOXHA

PËR SHOKËT E MI PIONIERË

(Pjesë të zgjedhura nga Veprat)

I

KUJTIME NGA VEGJËLIA

QYTETI IM I DASHURY*

*(Më 3 tetor 1947, shoku Enver Hoxha shkoi për herë të parë pas Çlirimit në qytetin e Gjirokastrës. Në fjalimin që mbajti para popullit, Ai shprehu dashurinë dhe mallin për vendlindjen.)

Lufta e tmerrshme kundër okupatorëve italianë dhe gjermanë më n-dau për shumë kohë nga qyteti im, ku kam lindur dhe jam rritur, ku kam marrë mësimet e mia të para, ku kam jetuar vegjëlinë time me gëzimet, hidhërimet dhe shpresat e saj, ku janë formuar karakteri dhe ndërgjegjja ime. ku, si të gjithë djemtë e thjeshtë të këtij qyteti heroik, më ishte rrënjësor në zemër dashuria për atdheun dhe për popullin tonë të shumëvujtur.

Lufta më kishte ndarë nga ju, por zemra ime, shpirti im ishte me ju. Qyteti im i dashur, ku kam lindur, ju kalldrëme me gurë dhe ju shtëpi të vjetra me dërrasa, që keni qenë gjithë bota ime dhe gëzimi im i kohës së vegjëlisë, ju mëma plaka, motra dhe vëllezër të Gjirokastrës, që më keni rritur, më keni këshilluar, më keni qortuar dhe më keni gëzuar kur kam qenë i ri, një mall i madh më kishte marrë për ju dhe sot jam thellësisht i emocionuar nga gëzimi që ndiej.

Qyteti im i dashur, ku kam lindur, është e vërtetë se të shoh për herë të parë, pas kaq vjet lufte të madhe, ku luhej e ardhmja dhe fati i popullit tonë, por ti ke qenë në çdo kohë në zemrën dhe në mendjen time. Lufta jote heroike e çlirimit ishte për mua model i shkëlqyer, ishte shembull që duhej të ndiqja deri në vdekje, si djali yt që isha.

Edhe unë, tok me popullin tonë trim, u përpoqa me gjithë fuqinë e mia për çlirimin e atdheut tonë të dashur. Edhe unë, me gjithë popullin tonë heroik, luftova për të fituar lirinë, pavarësinë, sovranitetin e Shqipërisë. Unë s'bëra veçse detyrën time, që më ngarkonin atdheu dhe populli, si çdo qytetari të ndershëm të Shqipërisë, ndër momentet më kritike nga ku kalon te kombi ynë dhe gjithë njerëzimi. Qyteti im i dashur, ku kam lindur, të jam mirënjohës për jetë, pse ti më mite, ti më mësove, ti më dhe forcë të kryej detyrën ndaj atdheut dhe të luftoj për fitoren e atre që shtypeshin, e atyre që vuanin nga mjerimet dhe nga uria.

KALAJA E GJIROKASTRËS

KALAJA E GJIROKASTRËS

Është karakteristike se çdo shtëpi gjirokastrite është ndërtuar me gurë. Me gurë, pra, nuk është ndërtuar vetëm kalaja madhështore e qytetit, me bedena të fortë, me pavdekshmërinë e saj si në ndërtim, ashtu edhe me fuqinë madhështore që i jep pamjes së saj sipër një kodre dominuese gati mbi të gjitha mëhallët e qytetit. Kalaja ndodhet në një pozicion strategjik jashtëzakonisht të fortë kundër sulmeve dhe është ndërtuar në mënyrë që luftëtarët e saj të mund të dilnin fare mirë për të sulmuar armiqtë, në qoftë se këta të fundit do të arrinin të futeshin deri në muret e qytetit.

Kalanë e qytetit shpeshherë e përshkruajnë si një anije ose, siç më duket mua, si një kryqëzor që lundron në një det shtëpish. Them kryqëzor që can valët, pse kalaja, me pjesën e saj të përparme si thikë, merr formën e një kështjelle jo vetëm që mbrohet, por edhe që sulmon përpara. Ilyrja kryesore e kalasë, ajo drejt Pazarit të Vjetër dhe në drejtim të fushës, është ndërtuar në iormë të ngushtë, e rrethuar me bedena të fortë dhe me dy-tre kate nga brenda për manovrime ushtarake. Kurse fundi i kalasë, nga ana e Dunavatit, është më i gjerë, sepse rreziku nuk mund të vinte nga mali.

Një tipar tjetër karakteristik i kësaj kalaje të famshme, që rrallë ia gjen shoqen në mesjetë, me aq sa kam studiuar unë, është pozicioni shumë i lartë mbi kodrën ku është ndërtuar dhe karakteri jobanues, në përgjithësi, nga zotërinjtë feudalë, por mbrojtës e sulmues nga i gjithë populli që do të përballonte sulmin. Po ta imagjinosh për një moment kalanë, pa shtëpitë e lagjeve rreth e rrotull saj, atëherë mund të realizosh honin e madh rreth kalasë, i cili bëhej tmerr për armikun që e sulmon te ose e rrethonte. Edhe pjesa e brendshme e kalasë është ndërtuar me një zotësi të madhe nga ana ushtarake. Daljet nga portat, nëpërmjet tunelesh që nuk gjenden përballë portave, evitojnë goditjet si në sulm, edhe në tërheqje. Qendra e kalasë ishte e zorshme të zaptohej pa sakrificë të mëdha nga sulmuesi. Arkadat, tunelet, portat e brendshme ishin ndërtuar si prita të rrezikshme. Dhe mbi të gjitha, ky monument madhështor i forcës shqiptare ka një elegancë të çuditshme.

Ta shikosh, kalanë nga të katër anët, nga lartësia e Dunavatit, mbetesh me të vërtetë i mahnitur me madhësinë, forcën dhe elegancën e treguar nga projektuesit e ndërtuesit e saj, të cilët këto cilësi i kanë pleksur me anën ushtarake.

Karakteristik është i tërë ky beden i dalë mbrojtës që me bazamentet e tifi në gërxh të jep idenë e forcës. Këtë e shikon kudo, por veçanërisht në hyrje të kalasë, nën kullën e sahatit dhe në kryen e kalasë, që qëndron përballë Dunavatit dhe Malit të Gjerë. Ky beden, mbi vendin që quhet Dullgë, ku mbrojtësit e kalasë së vjetër në themelet e tifi kishin vendosur një top, tytën e të cilit kur ishim të vegjël ngjiteshi-m dhe e shalonim si një kalë, e jep si duhet idenë e forcës së kështjellës.

Brenda kalasë ekziston qendra afër hyrjes. Kjo, aktualisht, por mendoj se edhe më parë, ka qenë një vend i hapët, por i mbrojtur nga të katër anët. Përpara është «mafia» e kalasë si shpatë drejt fushës, anash vazhdojnë të jenë edhe sot vrimat - penxhere të mëdha, nga të cilat qëllonte to-pi, bombardat o kumbaraja mbi armikun që i vinte nga fusha ose nga Përroi i Shamajve. Këto vende e pozicione luftimi më brenda, nëpërmjet mureve të trasha e tuneleve lidheshin me një labirint të madh urash e arkadash, që të çonin edhe në qendrën e poshtme të kalasë, ku ekzistojnë të ndara për luftëtarët, për municionet, burgjet, ashefet etj., por edhe të ngjithin në sheshin e hapur të sipërm të kalasë, nga ku kaloje përsëri në bodrume me arkada të njëllojta, që të nxirrnin deri në fundin e kalasë, në Dullgë. Nga kjo anë ndodhej dhe ujësjellësi ose urat e mëdha, siç i quanim ne, i ndërtuar nga Ali Pasha për të sjellë ujët në kala nga mali i Sopotit. Injorantët e parë dhe ata të kohës së regjimit të Zogut i rrëzuan këto monumente të mrekullueshme.

SOKAKU I TIR MARRËVE*

*(Sot Sokakz i të Marrëzve thirret rrzagica «Pionieri» për nder të gurslculitësvë të vegjël që e shtruan me Kalldrëm në vitin shkollor 1967-1968.)

- Moj nëno, - i thosha gjyshes, - pse i thonë Sokaku i të Marrëve?

Ajo më përgjigjej

- Ku di unë, mor bir, as unë s'e di pse i thonë Sokaku i të Marrëve. Mundet ngaqë ai ka gurë shumë dhe. kur zbr esin njerëzit, bëhet aq shumë zhurmë, sa duket si!..sur kalojnë të marrët. - Kështu më thoshte nënoja.

Por ky Sokak i të Marrëve tash mua më është aq i dashur e më sjell ndër mend vogëlinë. E përfytyroj veten të vogël, me këpucë të zeza m2 proka, me maja të kthyer përpjetë, kur zbritja Sokakun e të Marrëve, nga ana e majtë e të cilit n grihej shtëpia e Skëndulajve, e lartë e lartë, me një mur ovoro, që vinte deri në mes; ne majë të saj shilkoje disa penxhere të dala, me hekura, me çatinë pullaz, që mbahej nga trarë, njëri pranë tjetrit, të rreshtuar si asoerë dhe mbi çati ngriheshin tre-katër oxhakë, të hollë si aneja ime, të bardhë si aneja. Kur vinin «haxhilejlekët» ata bënë atje foletë dhe kërcitnin sqepat.

Më kujtohet dimri, kur, duke u mbledhur nga te ftohtët, zbritja për të vajtur në shllcollë; përpara meje ngriheshin malet e Lunxhër isë vija-vija e qdukeshin sikur në majë kishin një qylaf të bardhë; vijat ishin gërryerjet që kishin bërë ujërat shekullore.

Kam kohë që nuk kam shkuar nga Sokaku i të Marrëve, por, kur mendoj për Gjirokastrën, kujtimet më çojnë sa herë atje. Më thonë se tash pionierët e kanë shtruar me kalldrëm, shkallë-shkallë me mjeshtëri e aq bukur; dritaret e mëdha e të vogla që bien mbi të dhe muret e bardha i japin tani këtij sokaku një hijeshi të veçantë. Në mes shtëpive të thjeshta, anash tij, të ndërtaura me mure me gurë, të cilët janë të radhitur njëri mbi tjetrin pa llaç e me një ustallëk për qejf, sokaku gjarpëron e të çon në rrugën e kako Pinos. Sa herë kam kaluar unë në këtë rrugë.

Kaloja në rrugë nipi përpara dhe ndalesha kurdoherë i habitur përpara shtëpisë së Ficajve, pse ajo ishte me të vërtetë e bukur. Në ato kohë të vogëlisë sime, edhe pse nuk kuptoja nga arkitektura, stili i saj më tërhiqte; ajo ishte një shtëpi e lartë e ljer me bojë në të verdhë të thellë me dy kate e me papafingo. Stili i kësaj shtëpie ishte me të vërtetë i hijshëm.

NËNTORË TË LARGËT

Kemi ardhur në Vlorën heroike, që na tra frymëzuar që në rininë tonë të largët me trimërinë dhe me ngjarjet e saj historike. Këto ditë nëntori në Vlorë më sjellin ndër mend ato kohë të largëta, por sa të dashura nëntorësh, nga të cilat tram aq shumë kujtime.

Në një ditë të caktuar, veçanërisht në nëntor, na vinin në shtëpi burra për vizitë. I prishte aneja poshtë te shkalla dhe i ngjiste sipër në qoshk të odasë së madhe, ku i prishte babai. Kur vinin të gjithë, babai i thosh anesë:

- Nuse, përveç kafesë, na sill edhe nga ato llokumet që prura dje në atë kartën shtupellë që tram vënë në dollap të patit.

- Si urdhëron mulla! - i thosh aneja.

Unë ndiqja anenë kur vinte e vinte për t'u shërbyer mysafirëve, e ndihmoja atë, më në fund rrija afër babait dhe dëgjoja njerëzit që bisedonin.

Duhet të sqaroj që xhaxhanë tonë, Hysen Hoxhën, të gjithë ne, fëmijët, e thërritnim edhe baba, edhe baba Çen, kurse babanë tonë, Halil Hoxhën, të gjithë ne, fëmijët, e thërritnim derisa vdiq, xhaxha.

Në ato ditë nëntori të largët babai me burrat në qoshk flitnin e flitnin, por unë ca i kuptoja, ca jo.

Kur zinte në gojë shpatat baba Ceni, mua fëm më shkonte mendja te sepetet, atje afër mbi dhipato të qoshkut, që ishin plot me shpata të gjyshërve e të babait. Më kujtohet njëherë, kur babai foli për shpatat e grekëve, unë kërceva si gjel i vogël dhe thashë:

- Pse nuk i nxjerrim edhe ne shpatat tona, ja, këtu, në sepet i tremi, doni t'jua tregoj?

Pleqtë qeshën. Xha Hasan Xhiku më vuri dorën në kokë dhe më tha

- Do t'i qitim edhe ne shpatat tona nga sunduqet, mos u merakos, djalë.

Ata burra që mblihdeshin me babanë në ato ditë të nëntorit, flitnin për lirinë, për Flamurin e Vlorës, për Ismail Qemalin, për Cepon e për shumë gjëra. Herë më dëbonin, si duket flitnin gjëra të fshehta, që unë s'duhej t'i dëgjoja, herë dëgjoja babanë që bërtiste:

- Enver, thuaj nuses të na bjerë duhan dhe një tabak me kartë!

Bisedat zgjatëshin. Në mur të qoshkut, afër penxheresë, babai kishte varur një fotografi, ku kishin dalë shumë burra të veshur me të zeza. Në mes tyre ishte edhe një plak me flokë dhe me mjekër të bardhë. Ishte Ismail Qemali.

- Prapa tij, - na thosh babai, - jam edhe unë, ja, ky me sarëk të bardhë. Të gjithë ne jemi mbledhur në kuvend në Vlorë, kur ngritëm Flamurin, shpallëm Pavarësinë dhe formuam Qeverinë e parë të Vlorës, me Ismail Qemalë në krye. Po q'e do, zuzarët e poshtër të jashtëm s'na lënë rehat.

Kjo fotografi ishte nga gjërat më të dashura të shtëpisë sonë të vjetër që na u dogj. Mjerisht, kur na u dogj shtëpia, u dogj edhe sunduku me palla, edhe fotografia. Çdo gjë u dogj, vetëm një sahat i murit na shpëtoi.

Kërkova se mos gjeja ndonjë kopje të asaj fotografie të Vlorës, që varej dikur në shtëpinë që na u dogj, por më kot. Duhej të kalonin kaq dekada dhe më 28 Nëntor 19'72, kur vizituam Muzeun e Pavarësisë ja, në një nga dhomat, unë shoh fotografinë aq të dashur për mua, fotografi e zmadhuar e Kuvendit të Vlorës. Ndenjta i shtangur, e shikoja, e shikoja dhe vazhdoja ta shikoja, saqë ciceroni, i cili kishte kohë që kishte mbaruar shpjegimet, u habit që po rrija aq shumë përpara saj.

- Mos u habit, - i them, - se gjeta një thesar që më kishte humbur.

E dashura .fotografi e rinisë sime! Sa kujtime të ëmbla dhe të hidhura më zgjon ti! Ti më kujtove, veçanërisht, jetën dhe luftën patriotike të baba Çenit, këtij burri të thjeshtë, që vdiq i thjeshtë e i respektuar. Askush nuk ia kujtoi ç'kishte punuar, veç Partisë sonë, e cila, si për gjithë patriotët e tjerë, shkroi edhe për baba Cenin dhe, gjithashtu, e dekoroi për aktivitetin e tij patriotik.

Mua, natyrisht, si i vogël që isha në atë kohë, më bënë përshtypje disa ndodhi, që atëherë ishte e zorshme t'i kuptoja të gjitha, por tash, me kalimin e viteve, ato marrin në thjeshtësinë e tyre dritën e vërtetë. Për mua ato ishin ndodhi familjare, por për të rriturit kishin tjetër kuptim.

Duhej të ishte një natë para 28 Nëntorit, domethënë 27 nëntor. Vendi ishte pushtuar nga grekët. Ishte krizë e madhe për çdo gjë, bukë me zor gjenim dhe atë aneja na e jepte çika-çika. Grekët kishin dashur ta hiqnin babanë nga belediereizi, kryetar i bashkisë së qytetit, por nuk e hoqën dot, pse protestoi populli, gjithë së toku, myslimanë e të krishterë.

Atë ditë, pra, të 27 nëntorit më thirri babai, që rrinte në krye të divanit me një velenxë të bardhë në krahë, dhe më thotë:

- Vis h këpucët, shko te Bido Tushja dhe i thuaj që më tha babai të më japësh një duzinë me qirinj. Në qoftë se të thotë s'kam, ti i thuaj me të qeshur, m'i jep, ndryshe nesër do të ta mbyllë dyqanin, më tha babai.

Unë vasha këpucët dhe ua mbatha këmbëve me të katra. Veja me qejf në dyqanin e xha Bidos, që ndodhej afër xhamisë së pazarit, mu në të hyrë të kubesë, pse atje më ngopej syri, kishte plot gjëra, kishte dhe llokume, edhe sheqerka. Xha Bidoja më fuste nga një sheqerkë në gojë, duke më cimbisur faqen. E gjeta xha Bidon me një burrë tjetër që po bisedonte.

- Ç'do djalë? - më tha xha Bidoja.

I dhashë porosinë e babait. Ai e shikoi atë burrin në sy dhe më tha mua:

- Ku gjenden qirinj në këto kohë te Bido Tushja, thuaj mulla Hysenit. Po të dojë qirinj, le të vejë t'i kërkojë dhespotit, se ai i ka grumbulluar për qishat.

Atëherë unë i lëshova «kërcënimin» e babait, duke e përfunduar me një të qeshur, se nuk dija si mund ta thosha «me të qeshur» që «babai do të të mbyllë dyqanin».

Xha Bidoja ishte njeri i mirë, ai e kishte shumë mik babanë. U ngrit në këmbë, më tërhoqi nga vestii afër bangos së tij plot me defterë gjithë pluhur dhe, duke hapur një sirtar, më tha:

- E shikon ç'është kjo?

Unë u tremba; ishte një pishqollë. Xha Bidoja më tha:

- I thuaj babait se nuk e mbyll dot dyqanin e Bidos, se ia zbraz në bark mulla Hysenit këtë kobure.

Përnjëherë më hipën xhindet. O, si donte xha Bidoja të na vriste babanë, që ne e donim aq shumë?!
I them xha Bidos:

- Ti s'e vret dot baba Çenin, se ai të pret kokën me shpatë. - Bido Tushja dhe burri tjetër qeshën, kurse unë rrija i vrenjtur. Xha Bidoja u fut në qilar, që andej doli me dy pako qirinj, dhe, duke m'i futur nën sqetull, më tha:

- I thuaj mullait që Bidoja është dhelprë plakë dhe e di përse i duhen qirinjtë mullait, prandaj ia ruajta për këto ditë.

Unë u gëzova, mora qirinjtë dhe u nisa të ikja, po xha Bidoja më ndaloi.

- Prit, - dhe, duke dredhur një letër si fishek, mori nga kutia tri llokume, i futi në të dhe më tha: «Një koqe është për ty, një për Sanon dhe një për Balen, po vetëm nesër do t'i hani dhe jo sot».

- Si urdhëron, - i thashë xha Bidos dhe f ryva.

Rrugës, me qirinjtë nën sqetull dhe me llokumet në dorë, po mendoja:

Ama ky, xha Bidoja, është njeri i mirë, po nuk marr vesh pse duhet të jesh dhelprë plakë që të kuptosh përse i do babai qirinjtë për të ndritur natën, kur hamë bukë, kur ai këndon libra, kur aneja qep dhe nënoja na thotë përralla.

Kështu bluante mendja ime e vogël rrugës, dulce u kthyer në shtëpi për t'i dorëzuar babau porosinë. Por nuk do të ishte kështu. Në mbrëmje une do ta merrja vesh përgjysmë dhe të nesërmen e të pasnesërmen tërë kuptimin e vërtetë të blerjes së qirinjve.

Po atë dite, kur u err, babai thirri anenë, i dorëzoi qirinjtë dhe i tha:

- Merri, nuse, këta qirinj, prej përgjysmë me thikë dhe vuri në penxheretë e odasë jashtë, vuri mbi një pjatë filxhani, që të mos na bëjnë pis.

- Si urdhëron, mulla! - i tha aneja dhe mori qirinjtë.

- Dale një çikë, moj nuse! - bërtiti nënoja, pastaj iu kthye babait:

- Hisenj, lëri këto punë, se do të na marrësh në qafë, do të të surgjunosin në Morë.

- Mos u tremb Jeko, - iu drejtua s'emës, - se edhe po të më thërresin, xhevapin ua kam në xhep, as që ua kemi frikën zuzarëve, me nder... (dhe lëshonte nga kucuret e tija që nuk po i shkruaj). Ne bëjmë punën tonë, ata le të bëjnë të tyren.

Unë ndoqa anenë dhe, dulce prerë qirinjtë, duke i vendosur në dritare dhe dulce i ndezur, e pyesja:

- Ane, po pse i vëmë këta qirinj në penxhere?

- Se nesër është festa jonë, djalë, është Dita e Flamurit që u ngrit në Vlorë, ku kishte vajtur dhe mullai nga Gjirokastra. Po mos i thuaj njeriut, se na dogjën pastaj.

- Po pse thua na dogjën, ane, kur ne kemi festën tonë?

- Pse grekun e kemi armik, na ka zaptuar vendin dhe ne që festojmë Flamurin, duam të rrojmë të lire.

Tash e kuptova më qartë historinë e qirinjve. Kishte të drejtë xha Bidoja, «dhelpra plakë»; tash e kuptova pse më tha ai që llokumet t'i hanim vetëm të nesërmen, më 28 Nëntor, Ditën e Flamurit.

- Edhe xha Bidoja, - thosha me vete, - si duket, është si baba Çeni.

Kur u kthyem në dhomën e babait, i vajta afër dhe, pa i thënë asnjë fjalë, e shikoja, e shikoja, sigurisht me një ndjenjë të çuditshme, atë burrë me mjekër e me mustaqe të zeza ndenjtur pajdash, me velenxë në krahë, duke kënduar një libër në dritën e zbehtë të idaresë, siç i thoshim në Gjirokastër, llambës me vajguri. Unë e shikoja dhe më dukej i madh, i fërkoja herë pas here gjunjët me dorën time të vogël. Ai më në fund më tha:

- Ç'më shikon ashtu sikur nuk më ke pare? Shko fli dhe nesër në mëngjes hajde se do të të jap disa grosh të blesh sheqerka, pse kemi feste, pa mos dëgjo ti ç'thonë grate. Armiqtë s'kanë ç'na bëjnë!

Të nesërmen, më 28 Nëntor, në familjen tonë ishin në pritje çfarë do të ngjiste. Vetëm babai dhe ne të vegjlit s'çanim kokën. Unë hëngra llokumen që pa gdhirë, vajta në dhomën e babait dhe bërtita

- Rroftë Flamuri!

Më kujtohet një herë tjetër, kur akoma vazhdonte Lufta e Parë e madhe Botërore. Pasi u shporr ushtria greke, vendin e pushtoi ushtria italiane me ushtarë me pende e me topa, me mushka e me çičibune. Uria mbretëronte. Aneja na thosh se miellit i hidhnin edhe pluhurin e dërrasave që sharronin italianët për ndërtimin e kazermave.

Në mëngjes, pasi hëngrëm trahananë, babai më mori me vete, duke më thënë:

- Hajde këtu djalë, se do të vemi në shtëpinë e Iljazit (Iljaz Hoxhës) t'i bëjmë një vizitë.

Unë u gëzova shumë. Xha Iljazin e doja, megjithëse edhe të bërtiste, po ai më kishte vënë emrin «në vesh», dulce më kënduar në shqip dhe jo arabisht. Kisha qejf të veja te xha Iljazi, pse më jepte nga ndonjë ftua, disa kokrra arra o lajthi, si të ndodhej. Unë nuk u çudita, pse babai më merrte shpeshherë kur vinte për vizita te Selim Bakiri, te Hasan Sinoja e të tjerë.

Kur hymë te xha Iljazi, ndjeva se diçka kishte ngjarë, po nuk e përcaktoja dot. Ki-shte njerëz në dhomën e madhe. E nduk babanë nga xhubja d-he i them:

- Baba, mos i ka vdekur njeri xha Iljazit?

- Jo, djalë, - m'u përgjigj plaku, - përkundrazi, sot kemi festën e Flamurit.

M'u çel fytyra. Në krye të odës ishte një prift me mjekër të bardhë, veshur me një raso të zezë dhe me një kryq të florinjte në gjoks e me gurë me ngjyra. Unë u habita që prifti rrinte në krye dhe në ditën e festës sonë të madhe. I druajtur, u putha dorën të gjithëve me radhë dhe ndenjta në fund të odës, afër derës. Po shihja i habitur ç'do të bëhej këtu sot, më 28 Nëntor, nën pushtimin italian. Pasi u pi kafeja dhe mua më dhanë llokume, u ngrit xha Iljazi hapi dollapin e odasë, nxori andej një flamur me shkabë të zezë dhe e ngriti përjetë, duke thirrur: «Rroftë Shqipëria e lirë!».

Të gjithë u ngritën në këmbë dhe bërtitën njëzëri: «Rroftë Shqipëria e lirë!». Më thirri xha Iljazi dhe më tha:

- Zëre flamurin nga të dy cepat, ngrije lart, siç bëra unë, dhe çojua të tërëve me radhë ta puthin.

Edhe unë ashtu bëra. Natyrisht, të parit ia çova baba Çenit, pse për mua të voglin ai dhe flamuri ishin një. Të gjithë e puthën, edhe prifti e puthi. Unë u çudita që e puthi edhe prifti. Pas kësaj ceremonie pleqtë filluan muhabetin, kurse unë dola në kopsht dhe prisja sa të dilte babai. Kur dolën ishte vonë, burrat kishin hedhur atje brenda nja dy gota. Rrugës e pyeta plakun:

- Po ai prifti kush ishte baba?

- Si, nuk e di, - më tha, - ai është Papapanoja, patriot i flaktë. Sa për të thënë e mban rason dhe kamillafin, se nuk beson në Krishtin, aq sa nuk besoj edhe unë në Muhamedin. Ne kemi një «perëndi», Atdheun, Shqipërinë. Të gjitha të tjerat janë gjepura. Ai, prifti, është babai i mësuesit tënd të shquar, patriotit Thoma Papapano.

- Thomanë unë e dua shumë, baba, - i thashë, se më mëson shqipen, kurse mulla Kamanin nuk e dua, se ai kërkon të na mësojë turqishten.

Që atë ditë të 28 Nëntorit unë u bëra mik me Papa

pano Cuçin. Ai rrinte në Varosh, afër shtëpisë së dajkos tim. E takoja në rrugë priftin, ndalesha, i puthja dorën, më gëzonte kokën dhe më thosh: «Shko rregullisht në shkollë, bir, se ajo do të të hapë sytë».

Më kujtohen 28 Nëntorët e mëvonshëm, pas Luftës heroike të Vlorës, kur vendi u çlirua edhe nga italianët. Unë isha më i rritur atëherë, festën e Flamurit e bënim hapët, venim me shkollë përpara «huqumetit» dhe atje mbaheshin fjalime. Aneja mua më kishte bërë edhe një sharp të kuq me shqiponjë në mes, që e futja nga koka dhe e mbaja në gjoks.

Më kujtohet, që në një nga këto festa, zoti Xhafo Poshi ma dha ta mbaja unë flamurin. Ç'gëzim i papërshkruar! Kur u kthyem nga ceremonia, duke zbritur pazarin me flamurin në sup, takoj baba Çenin, i cili më thotë:

- A të duket i rëndë në sup ai flamur ?

- Jo, baba, - i thashë.

- Ai është i rëndë, djalë, - më tha plaku, - pse mban gjithë historinë e popullit tonë. Sidomos në kohë rreziku ta mbash fort, ta ngresh lart dhe të mos e lësh kurrë të rrëzohet përdhe.

Këto kujtime të largëta të rinisë sime m'u ringjallën në 60-vjetorin e Pavarësisë, kur erdhëm në Vlorë për të festuar këtë ngjarje historike. E ndjeva veten të lumtur, kur u ndodha përpara fotografisë së Kuvendit të Vlorës. ku ndodhej dhe babai.

Ai ishte 60 vjet para meje në Vlorë. Unë atëherë isha 4 vjeç, por jeta e tij, mësimet e tij lanë mbresa të thella në ndërgjegjen time. Ato më rritën me frymën patriotike dhe unë jam kryelartë për baba Çenin e thjeshtë, trim dhe patriot.

SHKOLLAT E MIA

Për herë të parë në shkollë vajta, me sa më kujtohet, në *mejtep*, ku mësonim edhe abëcënë shqip, por edhe *elifbenë* turçe. Mejtepi ishte te xhamia e Palortosë, ku hoxha ishte një plak i kaluar nga moshja, i hollë, me një fytyrë të imët, me disa dhëmbë të rrallë që i kishin mbetur, si dhe me ca qime në mjekrën e tij si të kecit. Atë e quanin mulla Kaman që ne, natyrisht me njëri-tjetrin, e thërritnim mulla Kaman Keci dhe, kur e shihnim që dilte nga xhamia, i këndonim

«*Muda Kaman Keci*
Doli nga koteci».

Këto dy vargje i shoqëronim pastaj me një «blegërimë» keci, zinim me një dorë mjekrën, kurs~e gishtin e madh të dorës tjetër e futnim tek e para, duke krijuar kështu me to formën e mjekrës e, duke i dredhur duart, dridhej edhe zëri ynë si i kecit. Natyrisht, fshiheshim nga mulla Kamani kur i bënim këto djallëzi. Ai herë-herë bënte sikur nuk dëgj-onte, mbyllte derën e xhamisë me një çelës të madh dhe herë-herë bërtiste: «*Habis-ollan*». Nuk e kuptonim ç'donte të thosh me këtë shprehje.

Mulla Kamani gjoja na bënte elifbenë dhe na e mësonte *hezber*. Vetëm elif benë mbaj mend unë që mësova. Atë edhe tash e kujtoj, sidomos geramat e para, por ç'u bë më tej, as që mbaj mend gjë.

Kurse me abëcënë e shqipes ishte ndryshe. Mësues të parë kishim njëfarë Vehip Hoxha, që ishte djali i Asaf efendiut, kadi, njeri i mësuar shumë. Ata rrinin afër shtëpisë sonë, ishim edhe nga një soj. Se ku e kishte mësuar shqipen zoti Vehip, nuk e di, por sigurisht nga abetaret e Stambollit dhe vjedhurazi. Në atë kohë zoti Vehip ishte djalë i shkathët, me iniciativë dhe çapërxihi. Kishte dëshirë të madhe të na mësonte.

Më vonë baba Çeni, që ishte shok, bashkëpunëtor dhe luftëtar me Bajon, Çerçizin dhe me ata të Kongresit të Manastirit, më tregonte se një ditë e kishte thirrur Vehipin dhe i kish thënë:

- Po ti ç'më hin e më del duke ngrënë kot bukën e Asafit? Pse nuk mbledh kalamanët e mëhadhës dhe t'u mësoç të këndojnë e të shkruajnë shqip?

Vehipi i qe përgjigjur fët e fët baba Çenit:

- Jam gati, po më liron divanin e shtëpisë tënde ta bëj shkollë?

Plaku ia ktheu:

- Të gjej unë vend, në xhami.

- Je në të mulla Hysen? - i tha Vehipi. - Ku ta jep xhaminë mulla Kaman Sejdua për këto gjëra, mos do që të rrihem me të?

- Mos ki merak për këtë, - i kishte thënë baba Çeni, - vete rrihem unë me të, ti vetëm për gatitu, bën listat e djemve, u thuaj baballarëve të tyre t'u blejnë nga një pllakë të vogël dhe nga një gurdalem.

Pas disa ditësh çdo gjë ishte gati, mulla Kamani liroi xhaminë, me kusht që ta fshinin vetë, të zhvishnim këpucët në hajat të xhamisë dhe të na mësonte dhe eli f benë. E mori koncesionin e elif besë mulla Kaman Keci! Natyrisht, mulla Kamani i ngriti sixhadetë e xhamisë, se ia prishnim dhe e la bosh, prandaj na pinte të ftohtët. Baba Çeni me Vehipin rregulluan psathët, na dhanë nga shtëpitë edhe nga një jastëk të vogël, që ta vinim përpara në vend të bankës, mbi të cilin vinim pllakën. Kështu filluam mësimin. Vehipi kishte bërë edhe një pllakë të madhe dhe e kishte vënë mu në vendin ku zakonisht falej mulla Kamani.

Në këto kushte filluam ne mësimin e parë me zell të madh. Me Vehipin mësuam mirë abëcënë, por, pas një kohe, u larguam nga xhamia. Gëzim i madh për ne, do të veni, në shkollën «Drita»!* *(

Shkolla «Drita» u hap më 10 shkurt 1917. Në përvjetorin e 65-të të saj, më 10 shkurt 1982, shoku Enver Hoxha i dërgoi një letër drejtorisë së muzeve të Gjirokastrës. ku ndër të tjera shkruan: «Si bir e si nxënës shkollë i atij qyteti, sot kujtoj me respekt të madh themeluesit, mësuesit e talentuar patriotë e të guximshëm, nxënësit e zellshëm të shkollës qendrore shqipe «Drita» dhe të shkollave të tjera që, krahas mësimit e përhapjes së diturisë, në kushte të rënda të pushtimit italian, punuan pa u lodhur e me guxim për të çuar përpara lëvizjet patriotike e demokratike të popullit tonë». Atje nuk kishte më mulla Kaman, as goditje me shufër në duar e në këmbë. Këtij dënimi unë nuk i kisha shpëtuar, jo se nuk mësoja, por një ditë bëra një djallëzi: xhamia, përveç divanit përposh, më sipër kishte një qoshk. Kur një pjesë mësonim shqip poshtë, mulla Kamani lart në qoshk u mësonte të tjerëve syre të Kuranit në arabisht. Një ditë ne më poshtë mbaruam më parë dhe dolëm, por nga qoshku unë pashë të varej nga parmaku bishti i xhybes së hoxhës. Ia nduka nga poshtë dhe u vara tek ajo. Hoxha bërtiste: «*Habis-ollan*, më çore xhubenë. Kush je ti? Po të zura, të vrava!». Mirëpo kë të zinne? Unë ua mbatha «me të katra». Ai e mori vesh kush isha dhe të nesërmen, megjithës. e unë rrija si pulë, si djalë i urtë, nuk i shpëtova dot *fellakasë*.

Më kujtohet një ditë kur zoti Vehip, pasi na mbaroi mësimin, na tha: «Nesër në mëngjes të gjithë do të vini në shkollë me brekë të shkurtra, u thoni në shtëpi t'jua presin. Në qoftë se nuk jua presin, do t'jua pres unë me gërshërë». Dhe nxori gërshërët nga xhepi. Në drekë, kur vajta në shtëpi, i thashë anesë:

- M'i pre këmbët e brekëve mbi gju.

Ajo shqeu sytë, pse kujtoi se isha marrosur.

- Je në të? - më tha. - Ç'janë këto gjëra? Kush t'i mëson këto?

- Zoti Vehip na tha, - iu përgjigja.

Aneja shkoi tek oda e baba Çenit, duke më marrë edhe mua nga dora dhe i tha

- Dëgjo, mor mulla, ç'thotë Enveri, Vehipi i Asafit u ka thënë që t'u shkurtojme brekët.

Mullai mori inat e u ngrit duke bërtitur:

- Maskarai, ia rregulloj unë atij !

Dhe, meqë rrinim afër e afër me shtëpi, doli në penxhere e, me sa zë që kishte, i thirri Vehipit të vinte te ne dhe ai erdhi.

- More ti, - iu drejtua plaku, - të dija djalë të mirë, babanë e ke të mirë, mos të kanë lojtur trutë? Ç'kërkon t'u bëç djelmve?

- Reforma dua të bëj, mulla Hisenji, - i thotë Vehipi.

- Mos kërkon t'i nxjerrç dhe bithë jashtë?! Kush t'i ka mësuar këto reforma? - i tha plaku.

- Ti m'i ke mësuar, - iu përgjigj Vehipi, - kur na flet për historitë që lexon. (Baba Çeni e kishte pasion historinë e popujve dhe në këtë e kam ngjarë dhe unë.) Vehipi mburrej: - Unë jam reformator si Pjetri i Madh. Meqë hoxhallarëve nuk ua pres dot mjekrat, kam vendosur t'u pres brekët shkollarëve, siç bëjnë kudo në Evropë. Ç'turp ka këtu?

Plakut i dridhej mjekra nga inati dhe i tha prerë Vehipit:

- Lëri këto, na u bëre dhe ti! Dëgjo! Po preve këmbët e brekëve të djalit tim, të preva kokën!

Kështu që unë nuk dota kurrë me brekë të shkurtra. Megjithatë, Vehipi s'e hodhi poshtë mendimin e tij dhe lisa prindër i bindi, kurse baba Çenin jo, sido që për gjëra të tjera ky ishte liberal dhe demokrat.

Baba Çeni nuk vente në xhami, as edhe kur u plak e nuk u zgjodh më kryetar i bashkisë dhe punonte në vakëf. Ai s'na fliste kurrë për fenë në shtëpi, kurse babai im, që e thërritnim xhaxha ose xha Halil, qe më ndryshe. Ky vente ngandonjëherë në teqenë e pazarit, por më shumë pasdreke, për muhabet. Gratë në sh lëpi mbanin ramazan dhe plaku nuk i ndalonte. Ai hante veç, me ne fëmijët, kur ishte ramazan. Unë e pyesja:

- Baba Çen, pse nuk mban ramazan dhe ti?

Ai më thosh:

- Hidhi gropës dhe lëri gjëporat, mos u beso atyre që thonë hoxhallarët, dëgjomë ç'të them unë.

Që në vegjëli, pra, baba Çeni më mësoi të mos besoja.

Megjithatë, kur vinte ramazani, ma kish qejfi të hipja në minare dhe në mbrëmje, kur mulla Kamani ngjitej të ndizte kandilet dhe të këndonte ezanin, merrte me vete një nga ne, kalamanët, që i luteshim : «Mulla Kaman, merrmë mua, merrmë mua!». Kur ngjitnim shkallët e minares, që

dridheshin njëra pas tjetrës, hoxha shkonte përpara dhe ne pas tij i mbanim shishen e vajit. Kur arrinim afër grykës, hoxha kthehej nga ne dhe na thosh: «Kini kujdes mos u varni shumë dhe mos i ktheni sitë nga Qorri i Cekës». Ky ishte një mesoburrë, vishej me poture, me xhamadan e me brucë, një sy nuk e kishte, prandaj e thërritnin «Qorri». Ai ishte çoban dhe i guximshëm, të tjerët ia kishin frikën. Vetë nuk besonte, as hoxhët nuk i donte. Shtëpia e tij ishte tamam nën minare dhe, kur dëlnim ne lart të ndiznim kandilet, «Qorri» nga poshtë bërtiste:

- Dole mjekërcjap, rafsh atej dhe thefç kokën!

- Të daltë dhe siri tjetër, kaur, hain, në es f eli sa f ilin do të veç!

Dhe kështu vazhdonin të sharat poshtë e lart e lart e poshtë.

Hoxha e hidhte vetë vajin në kandile me ekonomi të madhe, kurse ne ia sillnim lart kandilet. Ai rrinte në bisht, ne në këmbë. Qorri i Cekës nga poshtë donte të vazhdonte dialogun dhe ma bënte mua me shenjë që t'i flisja hoxhës.

- Hoxhë efendi, - i thosha unë, - të kërkon Qorri i Cekës.

- Mos e shiko shejtanin, të kam thënë.

«Qorri» prapë dhe unë prapë i thosha:

- Hoxhë efendi, Qorri i Cekës të shan. - Dhe kështu vazhonte kjo punë derisa zbritnim. Populli nga poshtë shante «perëndinë» lart.

Nga okupacioni grek i Venizellosit, i Zografos e të tjerëve, nuk mbaj mend në u hapën shkolla greke, se isha i vogël. Vetëm si në ëndërr më kujtohen oficerët grekë me shpata që kalonin edhe nga rruga jonë. Më kujtohet, gjith ashtu, që nën penxhere kalonin të krishterë të varfër nga Varoshi, muratorë, zarzavateshitës, kasapë. fshesaxhinj, që plaku i kishte miq dhe i mbronte nga agallarët e Gjirokastrës. Ata i thërritnin:

- Mulla Hisenji, mos ki frikë nga greku, se na ke ne.

Plaku dilte në penxhere e u thosh:

- Ejvallah, shkoni në punë, se unë nuk kam frikë.

Një ditë kur doli, e ndoqa pas dhe e ndukja nga xhubesja, duke i thënë: «Baba mos dil, më tha nënoja, se do të të therin grekërit».

Në shkollë veja në rregull, asnjëherë nuk mungoja. Në dimër aneja më bënte trahana me një qepë dhe hidhte mbi të shëllirë nga e fuçisë së djathit. Në këtë shëllirë notonin grimca djathi dhe trahanaja bëhej kështu e shijshme. Herët e tjera aneja më jepte ndonjë copë kulaç të misërt në dorë me një copë djathë dhe e haja rrugës. Kur erdhi koha e zisë dhe e urisë, aneja kur më jepte atë çikë bukë, më thosh: «Haje shpejt ose fshihe se gjinah, ka të tjerë që nuk kanë».

Mësimet i përgatitja kurdoherë në rregull dhe merrja nota të mira. Baba Ceni më sillte ngandonjëherë ndonjë kalem, sipër me bojë të verdhë o të kuqe. Gëzohesha shumë kur m'i jepte dhe filloja me zell t'i bëja majën me thikën e bukës. Gjëma ishte kur na thyhej maja, se na zvogëlohej kalemi. Mësimet atëherë i bënim në penxhere ose shtriheshim barkazi në dysheme o në minder. Në këtë pozicion shkruanim dhe këndonim. Defterët në fillim na i qepte aneja me gjilpërë, pastaj në dyqane filluan të dëlnin defterë të shkollës.

Librat i kishim me krëk dhe i ruanim. Më kujtohet se abetaret ishin shtypur me germa latine, por shumë shkronja të saj në atë kohë nuk ishin si këto të tashmet. Librat e leximit ishin të paktë, unë nuk dija ku shtypeshin, por ne vriteshim sa i blinim. Librat me vjersha të Naimit që më pëlqenin shumë, «Baba Tomorin» e Çajupit dhe disa të tjerë në fillim m'i gjente, nuk e di se ku, baba Ceni. Më kujtohet që ata ishin shtypur në Sofje o në Bukuresht, në disa prej tyre shkruhej në fund «Stamboll», në disa «Shtypshkronja Mbrodhësia» etj. Më vonë na erdhën nga Amerika di-sa libra të shtypur nga shoqëria «Vatra».

Në shkollë në gjuhë e në hartime dilja shumë mirë, i kisha qejf. Por edhe në të tjerat nuk mbetsha pas. Babai më vinte të mblidhja sa i kushtonin harxhet e mëngjesit. Kjo ishte një formë e kujdesit të tij për të më ndihmuar që të mësoja dhe për të më kontrolluar se «ç'gatuaja» në shkollë.

Njëherë na ra në dorë një libër këndimi, ku ishte një vjershë e bukur, bërë nga një Shefqet Bajo nga Gjirokastra. E kisha mësuar përmendsh. Atë e mbaj mend edhe tash, kaq shumë më kishte pëlqyer:

*«Ti Adriatik i mjerë, Vlorën e Karaburunë,
Pse s'bën valë këtë herë, Vlora dhe Karaburuni
Valë, dallgë e furtunë, Janë vatanet e mia
Se ti Vlorënë ta zunë, S'na i mban dot Italia».*

Ndjenja patriotike ishte e zjarrtë në popullin e Gjirokastrës. Më kujtohen si në ëndërr turma burrash të veshur me brucë që ngjitnin rrugët e pazarit duke kënduar e bërtitur, që drejtoheshin nga kalaja, nën të cilën te Pasha Kauri ndodhej konsullata greke. Si duket kjo demonstratë duhet të jetë bërë në kohën e okupacionit grek. Më vonë, dhe më kujtohet më mirë, pse duhet të kem qenë më i madh, u bë një mbledhje e madhe e burrave në kala dhe u ngrit flamuri. Ne, djemtë e shkollave, vajtëm me radhë. Kjo ditë ishte e shënuar për ne, veçanërisht për mua, pse tri ditë me radhë aneja më bëri një flamur, që konsistonte në dy copa të gjata atllazi kuq e zi të qepura së toku, në mes të të cilave më qëndisi një shkabë. Aneja i qëndiste shumë bukur këmishët dhe jelekët. Këtë flamur atë ditë feste e lidhëm në gjoks si «sharpë», siç i themi tashti. Natyrisht, unë mburresha për këtë dhe mësuesi më vuri në radhën e parë.

Më kujtohet një ngjarje akoma më me rëndësi, e një kohe më të vonë, kur isha ca më i madh. Vullnetarët gjirokastritë niseshin për në Luftën e Vlorës, kundër Italisë. Me mijëra burra, kalamanë dhe disa plaka, turma-turma dhe burra me dyfekë, me gjerdanë në mes, me bruca dhe me sharkëla në krahë, me qylaf ose me feste të zeza në kokë, me shollë o me opinga në këmbë, me nga një torbë në kr ah, u nisën nga pazari, dulce zbritur nga kisha e Varoshit dhe u ngjitën në bregun e teqesë së baba Manes, sic i thoshim atëherë. Ne, kalamanët, mbanim në dorë flamurët dhe këndonim këngë patriotike. Në breg u bë një miting, pastaj filluan të puthurat e të përqaftuarat dhe vullnetarët u nisën për nga ana tjetër e bregut, drejt Viroit. Ata ishin disa qindra dhe bënë një vijë të gjatë mne njerëz që ne nga bregu, turma e madhe, u thërritnim, u tundnim festet dhe shamitë. Për mua dhe shokët e mi kjo ishte impresionante dhe që atëherë filluam ta kuptonim dhe ca më mirë vjershën që shënova më sipër.

Kur mbaroi Lufta e Vlorës, luftëtarët u kthyen. Kishte nga ata që vinin në shtëpinë tonë, bisedonin me pleqtë dhe ne i mbanim vesh. Më kujtohen vetëm këto gjëra që i rrëfenin plakut: «Gjëmonte topi dhe mitralozi nga kalaja (kjo duhej të ishte kalaja e Kaninës) dhe, kur ia fillonte, ne thoshim «ulu se të pa kalaja». Pale kur na lëshonin dritat në istikame, ditë fare bëhej» (këto duhet të ishin projektorë).

Mësuesit tanë të kohës së vegjëlisë ishin Thoma Papapanoja, Iljaz Hoxha, Xhafo Poshi, Rexho Muçi, Hvsni Babametoja, Arshi Beu, Sadik Çeloja e të tjerë. Mësuesit i donim shumë dhe po aq shumë i respektonim. Disa i thërritnim «zoti mësues» ose «zoti Thoma», «xha Iljaz» ose «xha Rexho».

Zoti Thoma, që na mësonte aq bukur shqipen, ishte një njeri i qeshur, i dashur, me shtat të drejtë dhe me vetulla të zeza. Ne i këndonim një këngë:

*«Thomai një mendjehollë
Mori f lamurin në dorë...».*

Kurse xha Iljazi ishte i rreptë, ai na ndukte edhe veshët kur bënim zhurmë në klasë ose ziheshim në korr idoret para klasave. Xha Iljazi ma kishte vënë mua emrin kur linda. Pleatë e thirrën, sic më ka thënë aneja, dhe i ti,anë të më vinte emrin. Ai bisedoi me ta dhe së toku zgjoc" I hën emrin «Enver». «Iljazi ta këndoi në vesh, pastai e mbajtëm për drekë» më thoshte aneja.

Xha Iljazi vdiq tash vonë, ai tërë jetën ka qenë mësues. Kur shkova njëherë në Gjirokastrë, para se të vdiste, i bëra vizitë në shtëpi; pashë që ishte plakur. Bisedova me të gjerë e gjatë. Ai kishte një admirim të madh për Partinë. « Ah, mor Enver, - më thosh, - ç'mrekullira bëri kjo Parti, si e

ndryshoi faqen e Shqipërisë. U mbush vendi me shkolla e me njerëz të mësuar. Unë gëzohem kur piqem me ish-nxënësit e mi, që sot drejtojnë vendin», - dhe, duke më thënë këto, mësuesi plak u ngrit, hapi dollapin dhe më dha një ftua. «Merce këtë në xhep, se kështu të jepja, kur ishe i vogël». Dolëm tok me të në rrugë, e mbaja nga krahu dhe u ngjitëm sokakut. Kalamanët na ndiqnin nga pas, ashtu siç i ndiqnim ne mësuesit tanë në kohën e vegjëlisë.

Ndërtesat e shkollave, ku kam mësuar në Gjirokastrë, kanë qenë në vende të ndryshme. Në Palorto njëra ishte afër mejtepit të vjetër, që më vonë u bë Liceu Francez i qytetit. Kjo ishte një shtëpi e vjetër njëkatëshe dhe me një hajat poshtë, ku mblidheshim kur binte shi. Ndërtesa (që ekziston akoma) bie mbi rrugë. Dritaret aio i kishte me hekura të dredhur, dhomat ishin të vogla dhe të ftohta në dimër. Por shkolla neve na dukej- vendi më i bukur, e donim çdo qoshe muri të sai, deri te shpella e vogël që ishte në rrugë, rrëzë murit të shkollës.

Një ndërtesë shkollore tjetër ishte shtëpia e Babathanës, siç i thoshim. Kjo ishte një shtëpi e vjetër, e madhe, dykatëshe, shtëpi tipike gjir okastrite. Këtu më duket se vajtëm kur filluam shkollën «qytetëse», siç e quanim atëherë. Ajo i kishte odat të mëdha dhe penxheret po ashtu. Rreth e për qark sai kishte kopshte me kumbulla që, natyrisht, nuk u mbetej kurrë kokërr në degë. Ato ne nuk i linim jo vetëm që të piqeshin, por as edhe të rriteshin.

Një tjetër ndërtesë ka qenë «Klubi», sic e quanim. Ajo ishte mbi një kodër, mu në mes të pazarit, prapa bashkisë së vjetër, për mbi Varosh. Andej tërë Palortonë, Kucullën dhe Bregun e Teqesë i kishte si në pëllëmbë të dorës. Një panoramë e mrekullueshme! Oborri në mes, me pllaka vende-vende dhe me bar midis tyre, ishte i rrethuar me parmakë prej druri nga ana e rrëpirës mbi Varosh. Atje dilnim ne për pushime, dimër e verë. «Klubi» kishte nja katër a pesë dhoma, jo më shumë. pse. siç duket, edhe ne nxënësit ishim pak. Ne e quanim atë me këtë emër «Klub». pse, para se të ishte shkollë, kur u hapën shkollat e klubet e para të «Shqipëtarisë» në kohën e Rilindjes e të Kongresit të Manastirit, ajo u bë Klubi i rilindësve dhe baba Çeni që zgjedhur kryetar i tij, siç më kishte thënë ai vetë. Thoma Papapanoja u mësonte atje burrave abëcënë shqip dhe u këndonte librat e parë në gjuhën ambre. Ky ishte një vend dy herë i shenjtë për ne, pse kishte qenë klub patriotësh dhe shkollë. Këtë ne e dinim që në atë kohë, prandaj mburrehim që mësonim atje.

Nganjëherë xhamet e penxhereve thyheshin atje nga era ose nga ndonjë gur i lodrave tona. Një pjesë e «Klubit» ishte me dërrasa, nga vrimat e të cilave fërshëllente era, që në atë vend, meqenëse ishte në breg, frynte shumë.

Një dita dimri, një shoku ynë u ngrit dhe pyeti mësuesin

- Zoti mësues, është e vërtetë se ka lugat dhe po të vesh natën të ngulësh një thikë në tyrbenë e baba Hasanit vdes?

Ai na u përgjigj

- Agallarët e Gjirokastrës le të bëjnë shaka të vena të vënë ca napolona mbi varrin e baba Hasanit, se una vetë do të shkoj t'i marr ato para dhe, sfida që është një punë jo e mira, do të ngul edhe një thikë mbi tabutin e tyr besë dhe do të shihni se s'do të pësoj gjë, kurse me paratë që do të marr, do të bëj një punë të mira, do t'u vë xhame penxhereve, se këtu po na grin era, do të blej edhe një sobë që ta vë në klasë se u karkallosmë, mbasi s'po na e vë veshin njeri, që të na i bëjnë këto gjëra. lëre qeveria që jo e jo, por as agallarët e Gjirokastrës.

Në regjimin e Zogut çështja e shkollës së mesme në Gjirokastrë ka qenë një plaga e rëndë. Zogu dhe qeveritarët e tij ishin kundër hapjes atje të shkollës së mesme.

Protestat e popullit të Gjirokastrës, të mësuesve dhe të nxënësve gjirokastritë. i detyruan Zogun dhe ministrin e arsimit të asaj kohe që të hapnin atje shkollën qytetëse.

Kështu, kur nxënësit e klasës sonë mbaruan filloren, ata u futën në qytetëse. U qetësua me këtë mënyrë opinioni në Gjirokastrë. kurse gëzimi ynë. i nxënësve. ishte i madh. I~a dukej se fituam çdo gjë dhe shtuam zellin në mësim. :\lësuesit tanë patriotë na nxitnin të mësonim shumë mirë pël, të qenë shembull dhe për të mos u dhënë shkak Zogut dhe njerëzve të tij se gjirokastritët nuk mësojnë. prandaj ua mbvllim shkollat.

Po kur të mbaronim shkollën qytetëse. ç'do të bëheshim : ' Dëshira jonë për të vazhduar shkollën ishte e madhe. Pa shkollë. mendonim ne. ishte vetëvrasje. Prandaj vazhdoi lufta e popullit të

Gjirokastrës me qeverinë në Tiranë. Delegacione pas delegacionesh dërgoheshin nga populli në Tiranë, që kërkonte me këmbëngulje hapjen në Gjirokastrë të një liceu si në Korçë. Pas shumë lufte dhe përpjekjesh dhe duke parë rezistencën e popullit të Jugut, Zogu dhe qeveritarët e tij u detyruan të hapnin shkollë të mesme.

U vendos të hapej lice francez dhe të fillonte nga klasa e 8-të (që ishte klasa e para e liceut) dhe në të të shkrihej edhe shkolla qytetëse. Kështu, ne që mbaronim atë vit qytetësen, do të hynim në klasën e 6-të të liceut. Ç'gëzim kemi ndier në atëherë, këndonim dhe brohoritnim kur na u komunikua vendimi gazmor. Me ne, nxënësit, u gëzua tërë qyteti.

Qytetësen e mbar ova me nota shumë të mira. Erdhi behari, erdhën edhe pushimet, pritnim me padurim ardhjen e drejtorit të liceut francez dhe profesorët francezë.

Më në fund erdhi dita e gëzueshme e vjeshtës. U hap par herë të para liceu në Gjirokastrë. Por una nuk e shijova dot drejtpërdrejt gëzimin e javës së para të hapjes së shkollës së re, mbasi isha i sëmurë, nuk e di nga se dhe nuk më lina nga shtëpia të dilja. Merret me mend ç'mërzi ndieja!

Dita e para imja në shkollën e re ishte jashtëzakonisht e gëzuar. pse do të njihesha me programe krejt të reja, të panjohura nga ne. do të takohesha me profesorët dhe me shokët e vjetër. do të shihja profesorët e rinj francezë. Prandaj. që pa gdhii-Ë u nisa për në shkollë.

Liceu i filloi mësimet në një ish-shkollë fillore në Varosh. një ndërtesë mjaft e madhe dhe me dritare të me dha, me oborr me guro.

Liceu i Gjirokastrës do të kishte nxënës deri në klasën e tretë. Më tej Zogu nuk lejoi që të vazhdonim.

Nxënës e profesorë, shqiptarë dhe francezë, ishin shumë të gëzuar. Drejtori francez quhej Viktor Kutani. Ai ishte një burrë me trup të drejtë, me një fytyrë të pastër, me sy të ndritur, me leshra të zeza, por të thinjura në tëmtha. Hundën e kishte të shtypur dhe fliste ca me hundë. Kutani i qëndronte shumë pastër, si nga trupi, si nga rrobat. Zakonisht vishej me rroba të zeza, me këmbë të bardhë dhe jakë me kollë. Shumë herë ai vishte pantallona me vija (riguë). Që në fillim ne e deshëm dhe e respektonim shumë drejtorin. Ai ishte shumë i rregullt, i përpiktë, kërkonte nga ne rregull, disiplinë, pastërti në çdo gjë, që nga rrobat, trupi, librat, defterët e deri në klasë e në rrugë.

Nëndrejtor i liceut ishte Hysni Babametoja, profesor i vjetër i aritmetikës, i zoti, i drejtë, i sjellshëm dhe i kujdesshëm. Ne e donim dhe e respektonim shumë edhe këtë, s? nuk na bërtiste kurrë, por, kur na qortonte, turpëroheshim shumë dhe gjithë kujdesi ynë ishte që të mos qortoheshim prej tij. Zoti Hysni, thoshim ne, «të vret me pambuk». Mësues e profesorë shqiptarë kishim Vesim e Mumtaz Kokalarin, që dinin frëngjisht, Elmaz Çanin, Hysni Babameton, Ilia Dilo Sheperin, Pano Hidon e të tjerë. Kurse profesorë francezë në fillim kishim Brezhonë, Marshandin dhe më vonë erdhën edhe shumë të tjerë, disa prej të cilëve tash nuk ua mbaj mend emrat. Marshandi dhe Liezeni na mësonin gjuhën dhe literaturën frënge, Brezhoi historinë dhe gjeografinë, kurse matematikë na bënte zoti Hysni, fizikë, gjeologji dhe botanikë na jepnin disa profesorë të tjerë francezë.

Mësonim me zell të madh të gjitha lëndët, veçanërisht frëngjishten, pse ishte diçka e re, e panjohur dhe, pa ditur atë nuk mund të ndiqje dot mësimet. Unë ia fillova me zell frëngjishtes dhe isha nga të parët. Lexoja me kujdes, bëja kujdes në theksin dhe zbatonja me përpikëri metodën që na këshillonin profesorët. Kisha dëshirë të madhe për lexim dhe që në atë kohë profesorët francezë jo vetëm që sollën metodat e frëngjishtes për ne, por edhe librat e tjerë të çdo klase e të çdo lënde, ashtu siç ishin në licetë e Francës dhe në Liceun e Korçës. Kishin ardhur, po ashtu, edhe libra me përralla të tlijeshita në frëngjisht, koleksione të ndryshme e me bojëra, që na tërhiqnin shumë. Ishin libra të bukur, të lidhur mirë, me figura të papara ndonjëherë nga ne, r:)randaj na tërhiqnin shumë dhe, sido që në fillim nuk i kuptonim, ne mbeteshim mbi ta. Profesorët kishin sjellë parta. globe, mjete të tjera mësimi, që ne më parë nuk i rislzim, hishin sjellë edhe trartela me ngjyra me kafshë, me lule. me minerale etj., etj. Të gjitha këto na i bënin mësimet shumë interesante. Kuptohet se edhe profesorët francezë punonin me zell që ne ta mësonim mirë gjuhën, literaturën dhe të përvetësonim gjithë programin. Veçanërisht me ne të klasës së 6-të ata bënin kujdes dhe përpjekje që të fitonim kohën e humbur në gjuhë dhe të arrinim të kuptonim programin në gjuhën frënge, prandaj, me përjashtim të gjuhës shqipe dhe të matematikës që e bënim në shqip, të gjitha mësimet e tjera na i

bënin në frëngjisht. Ne ia arritëm kësaj detyre. Unë e mbarova shumë mirë klasën në të gjitha lëndët. Në frëngjisht dola shumë mirë dhe arrita t'i kuptoja librat në gjuhën frënge, lexoja edhe përrain. edhe poezi të caktuara. Kisha një kujtesë shumë të fortë. Profesorët e frëngjishtes më donin. Çdo vit shtoheshin nxënësit që hynin në lice, shtoheshin edhe profesorët, shqiptarë dhe francezë, prandaj ndërtesa duhej ndërruar. Kështu liceun e transferuan tek ajo ndërtesë që tash është gjimnazi «Aisim Zeneli». Më vonë kësaj iu shtuan dhoma të tjera në krah, pse nuk na mente.

Organizimi i liceut, natyrisht, çdo vit përmirësohej nga çdo pikëpamje. Programet ishin të përcaktuara dhe zbatoheshin me rreptësi. Librat e duhur nga Franca vinin me kohë, kështu që me hapjen e shkollës, ne kishim çdo vit në duar tekstet e nevojshme. Natyrisht, u zgjerua edhe biblioteka e liceut për nxënësit dhe për profesorët. Përveç kësaj, në fund të çdo viti, kur mbaronin mësimet, ndaheshin çmime, të cilat konsistonin në libra të ndryshëm letrarë, sipas klasave dhe lëndëve. Merrnin çmime nxënësit e parë dhe të dytë në çdo lëndë, kurse të tretët merrnin nga një fletënderi. Kur ndaheshin çmimet ishte një ditë feste e madhe për ne dhe ceremonia e veçantë Mhej në divanin e madh të shkollës. Përballë derës së daljes vihej një bango e madhe, që mbushej me libra të bukur, të lidhur me kordele të kuqe. Drejtori dhe rreth tij gjithë profesorët rrinin në këmbë prapa tryezës, kurse nxënësit e liceut qëndronin të ndarë sipas klasave, të radhitur bukur në të dy krahët e divanit. Drejtori Kutani mbante fjalimin e përshëndetjes dhe pastaj fillonte e thërriste njërin pas tjetrit emrat e fituesve të çmimeve të nderit. Ky ishte momenti më emocionues për ne. Unë merrja kurdoherë çmime të para, sidomos në gjuhën shqipe, në frëngjisht, histori, gjeografi etj.

Kutani dhe të tjerët na shtrëngonin dorën, na thoshin: «*Très bien, félicitation*»*. *(Frëngjisht - shumë mirë, përgëzime.) Kur dilnim në të tilla raste nga shkolla, si kurdoherë, po veçanërisht atë ditë, pr itnim edhe profesorët dhe tok me ta kalonim nga pazari. Edhe neve na vinte mirë, edhe profesorëve, por edhe popullit, kur na shihte me togje-togje librash me kordele. Kuptohet se ne mburreshim ca për këtë.

Liceu u bë shumë i dashur për gjithë popullin dhe shpejt u ndie influenca e tij në Gjirokastrë. Profesorët francezë silleshin shumë mirë me popullin, i cili i donte, i respektonte, i përshëndeste dhe, kur hynin në dyqane të blinin gjëra që u nevojiteshin, shitësit u shërbenin me buzëqeshje. Kështu që ata gjetën një ambient shumë të ngrohtë në Gjirokastrë. Profesorët francezë zunë dhoma me qira, atyre u pëlqenin shtëpitë tona piktoreske, romantike, me nga një kopsht të vogël, ku filluan të mbillnin lule, të na jepnin edhe neve farëra.

Rëndësi të madhe kishte për ne dita e provimeve që i bënim me shkrim dhe pritja e rezultateve. Ata që merrnin nota të mira dilnin në tabelën e nderit, e cila varej në murin e korridorit në mes drejtorisë dhe sallës së profesorëve. Gëzimi i madh ishte për ne, kur na dilte emri në tabelë.

Kurdoherë kur do të hynim në klasë, ishte bërë rregull që të radhiteshim jashtë në oborr dhe, duke filluar nga klasat e ulëta, duhej të futeshim në rregull e pa zhurmë në divan e pastaj nëpër klasa. Përballë hyrjes, në divan, ndodhej kurdoherë drejtori ose nëndrejtori në këmbë, të cilin e përshëndetnim dhe na përshëndeste të gjithë. Më kujtohen dy ngjarje në këtë drejtim.

Një ditë, duke luajtur në oborr, Elmaz Konjarit i humbi kopsa e xhakëtës dhe, kur u vu në radhë në klasë, një profesori të tij shqiptar i ra në sy që xhaketa e Elmazit ishte pa kopsë dhe i tha këtij

- Herë tjetër duhet të vish i pastër, në rregull dhe me kopsa të qepura, ndryshe do të të kthej në shtëpi.

Elmazi, për çudi, mbajti një qëndrim mospërfillës ndaj vërejtjes dhe puna vajti majë më majë e në këshillin e profesorëve, i cili e dëboi Elmazin dy ditë nga shkolla. Ishte një gjë shumë e keqe për ne dhe kjo ngjarje na bëri përshtypje.

Një ditë kaloi në oborr profesor Salim Kokalari. Si zakonisht unë e përshëndeta me dorë në ballë. Ai u ndal dhe më tha: «Përshëndetëm edhe një herë!». Dhe unë e përsërita përshëndetjen, po prapë më tha e prapë e përshëndeta. Ai nuk u kënaq dhe e vazhdoi prapë e prapë kërkesën, mbase nja pesëmbëdhjetë herë. Nuk e kuptoja arsyen përse atij nuk i pëlqente kjo lloj përshëndetjeje. Të gjithë më shikonin dhe qeshnin, ndërsa unë isha skuqur. M'u lodh dora dhe, së fundi, kur më tha prapë, fillova ta përshëndes me dorën tjetër. Ai u kënaq dhe nuk vazhdoi më të më kthente. Deri pak më parë unë e kisha përshëndetur me dorën e majtë, që populli e quan dhe «dorë e keqe». Ky ishte një

mësim për mua, prandaj herët e tjera bëja kujdes për përshëndetjen dhe përdorja dorën e djathtë, «dorën e mirë».

Profesori i parë i gjuhës frëngjishte ishte Liezën, që ne e thërritnim plaku, mbasi në atë kohë do të ishte mbi 60 vjeç. Liezëni ishte zviceran francez nga qyteti Vevei. Megjithëse i moshuar ai kishte një trup të drejtë, ecte me shkop me majë të hekurt si të alpinistëve, vishej me qillota të fryra, me çorape dhe me këpucë alpine me gozhdë dhe mbante një pulovër me grykë të kthyer si të atyre që bëjnë ski. Kokën e kishte krejt tullace, rrinte kurdoherë me kasketë, të cilën rrallë e hiqte edhe në klasë, pse «më ngrin koka» thosh. Ishte njeri me zemër shumë të mirë, ne e donim shumë dhe na donte, e ngitnim, por kurrë me të keq, se e respektonim plakun. Liezëni na fliste me dashuri për Zvicrën dhe na jepte kartolina me bojëra të Gjenevës, të Veveit, të kalasë së Shinonit. Ne i shikonim këto kartolina me gëzim dhe më kujtohet se edhe i pikturoja me kalem të zi, në formate të gjera dhe ia tregoja. Ai më thosh: «*Très bien mon garçon*». Kështu thoshte kurdoherë kur i përgjigjeshim mirë në mësim. Ne nga simpatia për të, i imitonim edhe zërin edhe mënvërën se si i shqiptonte shprehjet edhe «*Très bien mon gctrçon*», edhe «*Très mauvais*»*. *(Frëngjisht - shumë keq.) Por për këto do të flas më poshtë.

Liezëni kishte pasion të madh për lulet. Shtëpinë ku rrinte e kishte mbushur me gjithfarë lulesh. Sillte në Gjirokastër lloj-lloj farërash kur kthehej nga pushimet, na jepte edhe neve dhe na mësonte kur t'i mbillnim dhe si t'i mbillnim.

Liezëni mua, Hamit Kokalarin dhe Kiço Karajanin na donte shumë, se ishim të shkëlqyer në frëngjisht. Por në klasë kishim edhe shokë që nuk mësonin, ishin xhore, si Fejzi Selfoja, Mahmut Karagjozi e të tjerë. Kishim edhe ndonjë shok si Nesip Gjebrenë që mësonte mirë, ishte edhe humorist i madh. Kur vinte ora e Liezënit, interesant bëhej kur fillonin pyetjet. Plaku, pasi shpjegonte, fillonte të pyeste nxënësit dhe vinte notat. Mirëpo si plak që ishte, lodhej dhe, gasi i bënte pyetjen nxënësit, kur ky fliste, ai herë dëgjonte, herë dremiste, kështu nota për nxënësin varej më shumë nga ne, sesa nga ai. Kur donim që ndonjë nga shokët tanë të merrte notë të mirë, ne thoshim në kor «*Très bien, mon garçon*», ose në të kundërtën për ndonjë, si Fejzi Selfon, thoshim «*Très mauvais, mon garçon, asseyez vous, vous ne savez rien*»* *(Frëngjisht - shumë keq djali im, uluni, nuk dini asgjë.) etj. Liezëni na shikonte ne të tre dhe si thoshim ne, ashtu e vinte notën. Kur ngrihej Nesipi në pyetje e përgjigjej dhe ia merrte kasketën plakut nga trapeza, ky i thoshte: «Pse e nget kapellën?»

- Ta fshi, - i përgjigjej Nesipi, - dhe bënte sikur ia fshinte, por, duke folur, ia bënte top-top, ia shtrydhte e ne qeshnim, derisa plaku ngrinte kokën dhe ia merrte nga duart.

Një ditë Fejzi Selfoja na u lut që ta ndihmonim të merrte edhe ai një notë të mirë. Ne i premtuarn, por me kusht që të na binte në klasë të gjithëve, edhe plakut, nga një kokërr dardhë për secilin, nga më të mirat e bahçes. Deshi s'deshi «Kopaçja» na i solli. E thërritnim «Kopaçe», se, kur kish qenë i vogël, kishte djegur njëren dorë në zjarr dhe e kishte si kopaçe. Kështu, si hëngrëm mollët dhe dardhët që na solli, Fejziu u ngrit të thosh mësimin. Shkrap! S'kishte mësuar gjë. Mirëpo atë ditë plaku na qëndroi zgjuar, syrin dhe veshin i kishte pishë, kështu që fundi ishte i vajtueshëm për «Kopaçen», me gjithë dardhët që na dha. Profesori e përcolli me shprehjen e tij: «*Oh! très mauvais, mon garçon, asseyez vous, vous ne savez rien*» etj. Të qeshurat tona për këtë ndodhi vazhduan aq shumë dhe tërë ditën, sa e mbaj mend dhe sot. Fejzi Selfoja u bë një ballist i poshtër, Mahmut Karagjozi u bë Ilhandar i Zogut, Nesip Gjebreja la liceun dhe vajti në shkollën e oficerëve në Tiranë dhe atje u vra aksidentalisht nga një shoku i tij. Neve na erdhi shumë keq për Nesipin, pse e kishim shok të mirë, kurse dy të parët nuk i donim që atëherë.

Një ditë zoti Dilo na kishte dhënë për në shtëpi ushtrime gramatikore. Unë i bëra këto në defterin e ushtrimeve. Në shtëpi nuk kishim bankë pune, as karrige, shkruaja dhe mësoja ose duke e vënë defterin mbi minder dhe vetë ulesha në dysHEME, ose shkruaja në këmbë mbi tartaposhin e divanit sipër, siç i thoshim, në shtëpinë e dajkos, në Hazmurat. Në mëngjes ia kthyem fletoret zotit Dilo. Ai i korrigjoi dhe, kur na i solli, pashë me habi të madhe se më kishte vënë zero. I indinjuar i them:

- Zoti Dilo, c'është kjo zero për mua?

Ai më tha:

- Për arsye se ti je tallur me mua, ma ke dhënë defterin të bardhë, pa e bërë fare ushtrimin. Ja, shihe vetë !

Në fakt ushtrime në fletore nuk kishte, por nga ana tjetër isha i bindur se e kisha bërë detyrën. I thashë:

- Zoti Dilo, unë e kam bërë detyrën dhe nuk e pra noj zeron. Do të vete te zoti Hysni të qahem kundër jush.

Zoti Dilo m'u përgjigj

- Shko ku të duash, s'ke vajtur të qahesh në Tiranë?

Unë dola dhe drejt e në drejtori, u ankova te Hysni Babametoja. I tregova atij gjithë historinë.

- Zoti Hysni, - i thashë, - unë jam i sigurt se detyrat i kam bërë.

Ai më pyeti

- Po atëherë ku janë? Unë vazhdova.

- Duhet të ketë cjerrë fletën zoti Dilo që të më vinte zero.

- Jo, mor djalë, - më tha Hysniu, - kjo nuk mund të ngjasë. Pa bjere një herë këtu defterin ta shoh. Dhe, kur mori defterin, në vend që ta hapte nga krei, e hapi nga fundi ose nga mesi, ktheu disa fletë dhe gjeti ushtrimet e mia. Më shikoi me ata sy të mprehtë dhe më tha

- Fajin e ke vetë ti, s'e ka zoti Dilo. Ti ke qenë i pakujdesshëm kur ke bërë ushtrimet, e hape kuturu defterin dhe shkruajte, kurse zoti Dilo s'mund ta merrte me mend se ti shkruan në defter së prapthi ose ku të të teket.

Unë u skuqa si paparunë nga turpi, hyra në klasë, i

kërkova ndjesë zotit Dilo dhe iu luta të m'i shikonte ushtrimet dhe të më korrigjonte notën. Ai ma korrigjoi notën.

Profesorin Marshand, që edhe ai na mësonte frëngjishten, e respektonim shumë. Ai kishte një metodë të mirë në mësim. Ishte një burrë i gjatë, i hollë, i shkathët, fytyrëkuq, me ballë të hapët dhe me leshra të verdha. Marshandi luante mirë tenis, por ishte dhe piktor e portretist i mirë, pikturonte vazhdimisht, sidomos bënte portrete të fshatarëve dhe të shumë njerëzve që mendonte se ishin interesantë. Ai i vizatonte ata me bojëra vaji dhe zakonisht në kartone të trasha të formave të ndryshme, që i sillte nga Franca. Çdo ditë pazari dilte dhe zgjidhte fshatarin që do të pikturonte, i blinte këtij fiqtë o pemët që shiste, i kërkonte leje dhe ia fillonte. Fshatari buzëqeshte dhe nusëronte. Në qoftë se e mbaronte me një pozë, mirë, nc mos e pyeste se kur do të vinte prapë në pazar. Mua më merrte disa herë si përkthyes.

Profesori tjetër, Br ezho, ishte i respektuar nga ne. pse ishte i qeshur. Sido që i ri. kishte bark. Kokën kur ecte e mbante mënjanë sikur ta kishte zverkun të shtrembër ose sikur i rëndonte çanta që kurdoherë e mbante dëng me libra, me fletoret tona dhe me gazeta. Ç'të doje gjeje në çantën e tij. Sidoqoftë atë e dëgjoni me shumë vëmendje kur na shpjegonte historinë, sidomos atë të Francës. Revolucionin Francez, veçanërisht, ne na entuziazmonte dhe krahasonim ngjarjet e tij me ato që duhej të ngjishnin edhe te ne kundër Zogut dhe bejlerëve e agallarëve që bashkë me mbretin shtypnin popullin tonë. Krahasonimet ne i bënim me shoqi-shoqin, me më të besuarit. Asnjë nga ne nuk i donte monarkinë dhe Zogun. Familjen time e kishin edhe në sy si antizogiste, për arsye të lidhjeve tona me Bahri Omarin, i arratisur politik. Urrejtja jonë ishte po ashtu e madhe për xhandarët e Hysni Demës e të Taf Kaziut, që zaptuan Gjirokastrën, sikur kjo të ishte një vend armik dhe i okupuar. Shumë herë gjirokastritët e manifestuan haptazi urrejtjen e tyre kundër këtyre mercenarëve dhe zyrtarëve të Zogut.

Më kujtohet ngjarja përpara prefekturës. Ishte Dita e Flamurit. Ne me shkollat na çuan përpara pr efekturës, ku kishte dhe popull dhe do të bëhej ceremonia e festës. Dolën në shkallë prefekti, komandanti i xhandarmërisë dhe zyrtarë të tjerë. U këndua himni dhe prefekti filloi të mbajë fjalën e rastit, natyrisht, duke mburrur Zogun dhe regjimin e tij. Kur mbaroi prefekti së foluri, nga mesi i popullit u dëgjua një zë i fortë burri që bërtiti: «Poshtë kusarët e regjimit!». U bë një katrahurë e madhe. Ne, nxënësit e liceut, duartrokitem, të tjerë bërtitnin: «Pushoni!», ndërsa prefekti hyri brenda dhe xhandarët filluan të lëviznin. U prish festa, u prishën edhe radhët tona. Ishte kapiten Idriz Guri ai që kishte bërtitur. Ai ishte një burrë patriot, shok i Cerçizit, i Hasan Xhikut dhe i baba

Cenit. Ai ishte veshur atë ditë me uniformë si oficer madhor, me një kordon kuq e zi në gjoks dhe kishte me vete shpatë. Ne, djallëria, e rrethuam dhe ecëm një copë udhë me të, deri te kafeneja e huqumetit. sic i thoshim. Idrizi ishte zverdhur nga fy tyra, mustaqet i ishin ngritur dhe sytë i kishte të zemëruar. Pa u tronditur fare, ai mori nje fron dhe qëndroi jashtë kafenesë. Erdhën xhandarët dhe na larguan. Po kush lar gohej? Ne pritnim të shihnim ç'do t'i ngjiste xha Idrizit, që e donim, sidomos ca më shumë tash që pamë trimërinë e tij përpara gjithë popullit.

Pas një çerek ore erdhi një oficer i gardës së xha Idrizit me tre ushtarë, me kaska në kokë dhe iu afruan xha Idrizit. Qetësi prej varri! Te gjithë pritnim, ç'do të ngjiste. U dëgjuan fjalët e oficerit: «loti kapiten, Idriz Guri, dorëzoni këllëcin, pse jeni i arrestuar». Ç'do të ngjiste? IVIoment dramatik! Xha Idrizi u ngrit në këmbë, beri tre hapa prapa, nxori shpatën dhe i tha kapitenit: «L'argohu, zoti kapiten, se Idriz Guri s'e ka zakon të dorëzojë shpatën. I ti, i unë do të mbetemi këtu të vrarë!». Kapiteni u hutua! «Mbahu Idriz, qëndro!», bërtiti një ze nga kafeneja dhe dolën burrëria jashtë. Ne rinia bërtitem: «Qëndro, xha Idriz, rroftë Idriz Guri». Xhandarët u gjendën të rrethuar, ata nuk mund të vepronin dhe u detyruan të largolleshin me duar bosh.

Xha Idrizin e morën shokët dhe e çuan në shtëpi të tij. Duke parë mbrojtjen e Idriz Gurit nga ana e popullit, Zogu nuk e arrestoi dot, por i zhveshi rrobat e oficerit dhe hapën fjalën që Idriz Guri u marros. Idriz Guri nuk ishte i marrë dhe e vazhdoi luftën kundër Zogut me mënyrat e tij. Ai gdhendte bastune të formave të ndryshme, i lyente me bojë kuq e zi, shkruante gjatë trupit të bastunit shkronja dhe gdhendte figura alegorike. Çdo fjalë e frazës o e parullës përfaqësohej nga shkronja e pare osti nga disa shkronja* *(Për shembull, në një bastun Idriz Guri shkruante: Sh L 23.XI.1912, kurse në anën tjetër: V N 7 prill 1939, që përkatësisht kanë kuptimin: Shqipëri e lirë 28 Nëntor 1912 dhe vdekje nacionale 7 prill 1939.) dhe ai dilte në pazar, në rrugë, në sheshe, nuk i fliste njeriu, po bastuni e ngrinte lart mbi kokë, kurrë s'e ulte poshtë. Kështu bastuni i Idrizit dukej. Të gjitha naruilat ishin kundër regjimit, ai ua shpjegonte ato vetëm njerëzve të besuar të tij, të cilët i përhapnin vesh më vesh. Ne e respektonim shumë xha Idriz patriotin, kurse shërbëtorët e Zogut thoshin : «Doli në pazar Idriz mar r i me bastun».

Kur isha në Liceun e Gjirokastrës nuk kishte as elektrik, as radio, pra nuk kishte as lajme për të ditur se çfarë ngjiste në botti. Gazeta atje dilte nje herë në javë dhe ato që vinin nga Tirana shkruanin ato lajme që i leverdisnin regjimit feudal. Ato shanin revolucionin bolshevik dhe Leninin. Por ç'ishte ky revolucion ne të rinjtë nuk dinim gjë. Profesorët francezë në shkollë nuk na flitnin për këtë revolucion. Kuptohet që asnjë prej tyre nuk e simpatizonte atë, derisa mbanin heshtje të plotë. Por ne, të rinjtë antizogistë, kur këndonim në gazetën e Tiranës se shahej «njëfarë Lenini» dhe Revolucionin i Tetorit, thoshim: «Diçka këtu ka. Ky revolucion duhet të jetë kundër mbretit, ky revolucion duhet të jetë kundër bejlerëve dhe pasanikëve, duhet të jetë i të varfërve, prandaj po e shajmë». Dhe filloi interesimi ynë, gëzhëvimet, pyetjet me zë të ulët dhe diskutimet me shokë.

Më në fund një verë, gjatë pushimeve. u kthyen shokët tanë që mësonin në Liceun e Korçës, Aqifi, Selamiu e të tjerë. Duke biseduar një ditë me ta për këtë punë, Selamiu më foli ëë vesh: «Lëri këto muhabete në rrugë, se do të na dëgjojnë spiunet e Zogut, po hajde nesër në shtëpi të të tregoj diçka». Të nesrmen unë që në mëngjes shkova në shtëpinë e Selamiut.

«Piaka», pse kështu e thërritnim Selamiun, kishte një shtëpi të vjetër, afër sheshit të Mamanit në Palortó. Babai i tij, xha Fejua, një plak i kërrusur, njeri i ëmbël e i ndershëm, ishte fshesaxhi i bashkisë. Ai na donte shumë. Selamiu kishte edhe mëmën dhe një motër më të vogël. Ai mësonte me bursë në Korçë dhe kishte pasion për libra frëngjisht, prandaj kursente dhe bënte ndonjë porosi të vogël. Selamiu kishte porositur kështu edhe disa libra marksistë, edhe disa libra borgjezë që flitnin në mënyrën e tyre për Revolucionin e Tetorit, për Leninin, Stalinin, Voroshilovin dhe Ushtrinë e Kuqe. Librat që më tregoi kishin edhe fotografi. Këto ishin gjërat sekrete të Selamiut, që m'i hapi në mënyrë misterioze atë mëngjes që vajta në shtëpinë e tij. Ai i kishte mbyllur ato në një kuti me çeiës në tavan dhe ne përditë me radhë këndonim në frëngjisht në shtëpinë e tij ç'kishte ngjarë në Rusi dite nuk ngopeshim së shikuari fotografinë e Leninit, të Stalinit, të Voroshilovit që

me kapelën me majë dite me shiritin e trashë në gjoks shkante në paradë Ushtrinë e Kuqe në Sheshin e Kuq.

Një botë e re filloi të agonte në trurin tim të ri. Ishte shkëndija e parë e një zjarri të madh, që më ndriti në shtëpinë e një proletari të varfër, që fshinte rrugët e qytetit të Gjirokastrës, xha Fejo Xhaxhiut. Duhej të ishte viti 1926.

Filloi të piqej dalngadalë kështu edhe truri im, të më zgjerohej horizonti i dijenive. Gjërat tash fillova t'i shihja dite t'i kuptoja më mirë. Shumë prej tyre më bëheshin çdo ditë e më të qarta, më kristalizoheshin.

Në mësim merrja nota të mira, veçanërisht në gjuhën shqipe, në gjuhën frëngjishte, në literaturën shqipe dite franceze, në histori e në gjeografi. Në matematikë kurdoherë isha mirë, po nuk shkëlqoja*, *(Në fjalimin e mbajtur me përfaqësuesit e inteligjencës së kryeqytetit më 25 tetor 1962, shoku Enver Hoxha, ndër të tjera tha: «Tani që po flas me kaq zjarr për shkencën e sidomos për matematikën, ndoshta të rinjtë mund të qeshin, ashtu siç kam qeshur edhe unë vetë kur kam qenë i ri, pasi duhet të pohoj, shokë, se nuk e kisha shumë qejf matematikën dite besoj se orët e mësimin të matematikës në shkollën e mesme më kanë shpejtuar ca daljen e mjekrës. Por e vërteta është se matematika ka poezinë e saj të madhe, ajo është pasionante, ajo s'është aq e «egër» sa kujtohet».) klasën e kaloja në rregull. Profesorët më donin dite unë i doja, ata as edhe një herë nuk u qanë nga unë.

Frëngjishten e mësova ta shkruaja dite ta lexoja mirë, por edhe e flisja lirisht, natyrisht, në lidhje me klasën. Kjo më ndihmoi shumë që të lexoja me lehtësi shumë libra, shkrimtarë, poetë, dramaturgë, komedianë, historianë. Autorët e preferuar të mi që në atë kohë kanë qenë Hygoi, Lamartini, La Fonteni, A. Dymas (babai), Perro, Grim, Kornei, Rasini, Molieri, Bualo, La Bryjer, Verharem, Anatol Fransi, Teofil Gotie e shumë e shumë të tjerë, të cilët më vonë i thellova dite e zgjerova gamën e leximeve të mia, sidomos kur vajta në Liceun e Korçës, ku bibliotekat ishin shumë më të mëdha dite në frëngjisht u perfeksionova shumë më mirë. Unë u jam shumë mirënjohës profeso rëve të mi të parë të shqipes, të gjuhës ambre, por edhe atyre të gjuhës frënge, e cila pas shqipes më ka ndihmuar shumë në jetë.

Kur po vazhdonim klasën e tretë të liceut filluan përsëri qederet tona të nxënësve. Në Tiranë u vu çështja nëse duhet të kompletohet deri në fund Liceu i Gjirokastrës, apo nuk do të ketë më klasë të dytë? Ky ishte një shqetësim i madh për ne dite për popullin arsimdashës të Gjirokastrës. Ç'do të bëheshim ne djemtë që mbaronim klasën e tretë? Do të mbeteshim rrugëve? Punë nuk kishte, regjimi ishte i falimentuar, mësuesit dite profesorët me muaj nuk merrnin rrogat. Në familje ishim keq ekonomikisht. As që mendohej që xhaxhai të më dërgonte dot me të hollat e tij të vazhdoja mësimet në Liceun e Korçës, në shtëpi mezi na dilte të hanim. Ishim shumë të mërzhitur ne dite profesorët tanë. Profesorët francezë dite shqiptarë protestuan në einistrinë e Arsimit në Tiranë, por askush nuk i dëgjo. Filluan protestat nga populli dite nga ne, nxënësit, por askush nuk na e vuri veshin.

Zhurma u bë e madhe, por regjimi obskurantist i Zo gut nuk e ndryshoi vendimin që Liceu Francez i Gjirokastrës hëpërhtë të qëndronte deri në klasën e tretë për ta prishur krejt më vonë. Tirana, për ta ulur ca pakënaqësinë, vendosi që nxënësve të varfër që mbaronin klasën e tretë, t'u jepej bursë për të vazhduar mësimet në Liceun e Korçës. Kështu, një nga ata që morën bursë për në këtë lice isha edhe unë.

Kur na doli bursa për në Korçë, gëzimi im ishte i madh, i papërshtuar. Filluam përgatitjet. Ëndërrimet ecnin, do të shihnim Korçën e bukur, për të cilën na flitnin çdo verë shokët tanë që mësonin atje. Nga bisedat e tyre ne, pa qenë atje, gati e njihnim jetën e Liceut të Korçës, profesorët, zakonet, zotësinë dite dobësitë e tyre.

Xhaxhai mori borxh dite më bëri një pallto të trashë për dimër dite një palë këpucë. Për rroba nuk tepruan, por aneja bëri si bëri e më preu dy palë këmbishë dite dy palë pantallona. Më bëri edhe dy palë çorape të leshta dite dy palë me «dhigari». Të gjitha i vendosa palë-palë në një valixhe të vjetër të të ziut vëlla që e kishte sjellë nga Amerika. Mbetej kasketa, «uniforma» e vetme e liceut. Ia rropa kokën xhaxhait dhe ai porositi babanë e Samuel Cifutit që ma solli nga Janina. Kushtoi 25 lekë. Shiritin e kuq me dy vija të zeza në mes do ta blija në Korçë.

S'na tubante vendi nga gëzimi, i shtynim ditët njëra pas tjetërës. Erdhën edhe shokët nga Korça për pushime dhe gjatë tërë pushimeve bisedonim e bënim plane. Më në fund dita e gëzuar erdhi, por megjithëkëtë zemrën e kisha prapë të trishtuar, pse më vinte keq që do të lija vetëm xhaxhanë, anenë, Sanon, të dashurit e mi, që i doja dhe më donin me gjithë shpirt. Ishte hera e parë që ndahesha prej tyre, më dukej sikur i lija në mes të katër rrugëve. Ata vetëm mua më kishin, nga mua pritnin, tek unë shikonin të ardhmen e tyre. E gjithë bota e tyre isha unë. Ata më rritën me ato që kishin, kaluam kaq brenga e halle së toku dhe kjo ma shtrëngonte akoma më shumë zemrën, sidomos kur shikoja anenë të qederosur, që qante edhe fshehurazi. Para se të nisesha më dhanë një barrë këshilla, të ruhesh se mos ftohesh, t'u shkruaja letra ngaherë, se do t'u mbetej mendja tek unë, të mësoja, të sillesha mirë, që të mos turpërohesh për vete, të mos turpëroja edhe familjen. Xhaxhai nuk mungoi të më thosh: «Shih, Enver, ti e di që ne jemi të varfër, pare nuk kemi të të dërgojmë, prandaj nuk ke ç'kërkon nga ne. Unë do të jap një napolon hashllëk, ruaje, mos e prish, kije për ndonjë hall të keq», dhe me këtë rast më b'ënte llogaritë që «mora borxh kaq dhe kaq bënë këpucët, kaq këmishët, kaq çorapet, kaq kapelloja, kaq «navlloja», rruga deri në Korçë» etj. Aneja më bëri një byrek, disa qofte të thata, ca djathë, një çyrek me bukë dhe m'i futi në një qese që t'i kisha për rrugës, pse do të flinim një natë në Përmet.

Në mëngjes ia hipëm automobilin në Sheshin e Cerçizit, ku ishin mbledhur burra të na përcillnin. Me anenë dhe me Sanon u puthëm dhe u përqafuam dulce qarë që të tre, që në shtëpi. Duke qarë ato më përcollën deri te furra. Hodha valixhen në krahë, xhaxhai më tubante qesen me bukë dhe pallton e madhe. U ndamë përsëri duke qarë e duke ua bërë me dorë të dashurave të mia, anesë dhe Sa nos që po i lija vetëm.

Pasi u përqafuam me xhaxhanë e me të tjerët në shesh, automobili kamion plot me studentë u nis. Ia filluam këngës duke zbritur xhadenë, ku linim aq kujtime të ëmbla të rinisë sonë, të vegjëlisë sonë. Rruga, kodrat, muret, pemët, qersat e çajret, ura e lumit, më dukeshin sikur na e bënë me dorë, sikur na përshëndetnin dhe na thoshin: «Kurrë mos na harroni, pse këtu është zemra juaj». Po hapej një faqe e re e jetës sime, me shpresa të mëdha, me ëndrra të bukura, me mendime dhe me një ndjenjë përgjegjësie më të madhe për detyrat e mia të djalërisë ndaj familjes dhe atdheut. Automobili ecte, rendte drejt Tepelenës, Këlcyrës, Përmetit, Leskovikut, Ersekës e Korçës. Sa gjëra po shikonim, atdheu na dukej i madh, i gjerë, pa mbarim. Ky ishte atdheu ynë i shtrenjtë, i dashur, i bukur, por i varfër e i mjeruar nën thundrën e satrapit Zog dhe të bejlerëve e agallarëve, kundër të cilëve do të luftoja pa mëshirë deri në shkatërrimin dhe asgjësimin e tyre të plotë.

SHËTITJE TË GËZUARA

I kam dashur shumë këto lloj shëtitjesh, ndoshta se këto kishin bukurinë e tyre, pse iknim nga sokakët me gurë, nga sheshi i vogël i xhamisë, ku luanim çdo ditë, nga Sheshi i Xhepit dhe shpella para portës së xha Rikos dhe dilnim në ajër e në hapësirë; ndoshta gëzoheshim edhe për atë që dilnim së toku gjithë shokët e klasës bashkë me mësuesit tanë, të cilët në këto raste bëheshin për ne shumë më të afërt, më të çlirët. Ruaj për këto shëtitje, tash në këtë moshë të kaluar, mallin e kohës së fëmijërisë e të rinisë sime. Mbyll nganjëherë sytë dhe, duke menduar për ato kohë të largëta, më duket sikur jam afër me aromën e barit, me erën që fërshëllen në qiparisa, me zhurmën e bletës që bredh nër cfakat luleverdha.

Kur qe puna për shëtitje, zakonisht mësuesi na thoshte:

- Nesër, djema, po të bëjë kohë e mirë, do të dalim shëtitje që në mëngjes dhe do të kthehemi në mbrëmje.

Me të dëgjuar këtë lajm, përplasnim duart, bërtitnim dhe hidheshim përperjetë nga gëzimi.

Njëri pyeste:

- Zoti mësues, të marrim bukë me vete?

Ai përgjigjej

- Medoemos, nuk na e ka shtruar njeri!

Tjetri vazhdonte:

- Zoti mësues, po ndonjë shishe me ujë të marrim?

Dikush priste fjalën:

- Ku do të shkojmë? Te Përroi i Shamanje?

- Ç' do të bëjmë né gurrë?

- Të vemi né teqenë e baba Manes né kodër.

Jo, né bahçenë e zotit Elmaz (ani. «Jo, është larg, jo, është afër, ka ujë, s'ka ujë, ka hije, s'ka hije») dhe mësuesi i jepte fund debatit tonë të gëzueshëm, duke thënë:

- Mos u bëni merak, se do të shkojmë né një vend të mirë, vetëm të na mbajë koha.

- Ah, të na mbajë koha!

Ne me të dalë nga dera e shkollës, e mbanim kokën përpjetë nga qielli.

- Dreqi, ka ca re!

- Sa e bukur është, qelq!

- Mos na prishet natën?

Më parë se të venim të flinim, nxirrnim kokën né penxhere ose dilnim né avlli dhe soditnim thellësitë e qiejve dhe misteret e tij. Do të kishte mëshirë për ne, do të bënte kohë e mirë? Mëngjesi herët përsëri do të na gjente né dritare o né avlli, për të parë kohën. Né çdo rast thoshim: «Do të vemi doemos shëtitje, me diell o pa diell, vetëm shi të mos bjerë».

Mirëpo «vendimi» i mësuesit dhe i drejtorit qëndronte mbi ne si shpata e Damokleut. Këtë shprehje, «shpatën e Damokleut» atëherë ne as e dinim, as e përdornim, por. dinim vetëm një gjë, se vendimi ishte i lidhur me diellin, me qiellin e kaltër. Varej nga ky vendim dhe nga ky diell, që gëzimi apo trishtimi të na pushtonte zemrat tona të vogla për gjithë atë ditë.

Kur dilja nga shkolla, pasi mësuesi na kishte thënë se të nesërmen do të venim shëtitje, unë, si gjithë shokët, shkoja né qafë qesen me libra dhe, me një të rënë të dorës, e shtyja né krah si torbën me zarzavate kur ma vinte né krah babai për ta çuar né shtëpi, dhe vrap me të katra për né shtëpi, duke rregulluar herë pas bere, qylafin né kokë, se mos më binte. Shollët e mia me proka e me maja i merrnin gurët përpara. Për këto aneja më thoshte:

- Ec me mend, mor djalë, se i grive shollët sikur i ke ngrënë me dhëmbë.

- Ç'të bëj unë, moj ane, s'janë dhëmbët, po janë gurët që i grijnë.

Veja kështu né shtëpi me një frymë, varja çantën né një peronë afër derës sé patit dhe drejt e tek aneja:

- Ane, nesër do té vemi shëtitje jashtë, do té rrimë gjithë ditën, prandaj duhet té marrim edhe bukë me vete, C'do té më bësh?

Ajo më thoshte: «Kësmet mor bir, do té mendoj, po shko luaj tanfi dhe mos u vono ! ».

Dhe unë dilja atje afër, tek ulliri i (uços ose né Karanxha dhe luaja me evgjitët, shokët e mi té afërt té vegjëlisë e miq té shtëpisë. Kur kthehesha né shtëpi, para se té vinin burrat, po ajo pyetje:

- Ane, ç'do té më bësh për nesër?

Dhe aneja e mirë kishte menduar për këtë. Zaten s'duhej varrë shumë mendja për aq pak gjëra që kishim atëherë.

- Do të të jap një vezë të zier, djathë, një qepë, dy qofte, një çikë kripë e rigon té përzier, té mbështjellë në një copë letër për té ngjier vezën dhe boll i ke.

Unë i gëzuar e ngalaska anenë dhe i thosha:

- Sa e mirë je ti. Po kur do Vi kem gati, që sonte apo nesër né mëngjes?

Ajo më thoshte:

- Mos u bën merak, nesër kur té shkosh, do të Vi lidh né një shami, do të Vi fus në qesen e librave dhe i ke gati. Tanfi shko bën mësimet!

Këtë aneja s'e harronte, por unë né té tilla net të gëzuara diku harroja dhe i thosha:

- Po nesër kemi pushim.

Aneja ma kthente:

- Punën e sotme, djalë, mos e le për nesër. - Dhe më ndizte idarenë, llambushkën.

Shtrihesha përdhe né dysHEME, se tryezë nuk kishim dhe barkazi shkruaja ose mësoja mësimin, gjersa vinin babai me xhaxhanë nga pazari dhe hanim bukë. Né atë kohë né Gjirokastër nuk thuhej «burrat venë ose vijnë nga puna», por «venë né pazar, vijnë nga pazari, janë né pazar». Pazari ishte epiqendra e qytetit.

Shkonim që në mëngjes në shkollë dhe vinim rrotull oborrit. Koha ishte e bukur, me diell. Pritnim sa të vinte ora e caktuar, bisedonim të gëzuar me njëri-tjetrin:

- Do të vijë gjithë shkolla apo disa klasa?

- Të tërë do të vemi, kush rri këtu! Pa shihni kanë marrë bukë edhe ata të klasave të tjera?

Të tilla ishin bisedat derisa dilnin mësuesit dhe njëri prej tyre përpiqte duart ose i binte ziles dhe thosh:

- Djema (se nuk kishte vajza), pa humbur kohë dhe pa zhurmë, vihuni në radhë, veç e veç çdo klasë, se do të nisemi për në kodrat e teqesë së baba Manes.

«Urra!» - të bërtitura nga gëzimi, vrapime andej-këtej për të gjetur klasën dhe shokët dhe pas një copë herë gurguleje niseshim nga rruga e Varoshit. Ndonjërit babai çoku i kishte dhënë ndonjë grosh. Ai, me lejen ose pa lejen e mësuesit, me të arritur te bishti i urës së vogël me gurë, mbi përruan që zbret nga Angonatët e më lart dhe cë tërhiqet zvar rë poshtë në zall, rrëzë binave të shtëpive, shkëputej dhe kthehej te dyqani i vogël, por aq i dashur për ne të vegjlit, te dyqani i koshallvaxhiut, Shaban Gegës. Atje gjeje tahirhallva, kadaif, hallva, koshallva, që ishte e bardhë me arra, që, kur veje blije, Shabani e thyente me një sëpatkë të vogël. Atje gjeje, gjithashtu, beblebli (qiqra të pjekura), arra, pllaka me sheqer të djegur, shufra të gjata «zariko», herë krejt të bardha, herë të bardha me një vijë të kuqe që për dridhej si gjar për. Sa gjëra të mira bënte «gega», se ne ashtu thoshim: «Te Bega», «Erdhi Bega», kur ai shëtiste nëpër mëhallë me një si sini të rrumbullakët prej druri, plot me gjërat që numërova më lart, të vënë në kokë mbi një kokorreth, ndërsa në dorë mbante një mbështetëse me tri këmbë. Kur i thoshe: «Gegë, dua një shufër, dua një grosh tahir», ai pa përtuar vinte këmbëzat, ulte tepsinë, të priste tahirë me thikë, merrte paratë, i fuste në xhep dhe vazhdonte rrugën duke bërtitur: «Koshallva, tahirhallva!».

Kolona jonë futej në rrugën që çan lagjen Varosh në mes. Ajo është tatëpjetë, me kalldrëm dhe me sufa përpara dyerve të shtëpive, të cilat në këtë rrugë, po t'i shikosh snt, na duken të vogla, kurse atëherë ë na dukeshin ndryshe, të larta. Në fillim të rrugës kishte edhe dyqane, ndonjë bakall, ndonjë ballomatar, ndonjë palo han, ndonjë opingar. Më poshtë, kur kaloje shtëpinë e Fane Rodit, shok shkollë, ishte një furrë, mbi të cilën qe një dyqan, ku shitej hindja (beze). Të gjitha këto i bie në mend, sikur shoh ndonjë film të vjetër, të vjetër, por aq të dashur e të dhembshur për mua. Ja, më poshtë rrugica që veje në shtëpinë e Fane Hidos, tregtar pasanik. Këtij ia dija emrin, pse, kur në familje bliheshin çitjane për motrat dhe për çupat e xhaxhait, vinte djali i Fane Hidos dhe sillte një tog me hindja që zgjidhnin gratë, pse në pazar gratë nuk shkonin.

Ja, më poshtë sokaku që të con në shtëpinë e Ficos dhe andej nga Sokaku i të Marrëve veje në shtëpinë tonë, ku rrinim pasi na u dogj shtëpia e parë. Këto rrugë i dija mirë, i doja shumë, pse më vonë, në një shkollë atje afër mbi përruan, për të cilin fola më lart, u hap Liceu i parë Francez në Gjirokastër. Këtu unë për herë të parë vajta në lice. Këta sokakë i doja edhe pse me anenë e me motrat veja te dajkoja në Hazmurat, duke kaluar nga Gjobeku, nga shtëpia e shokut tim Comes, djalit të Lipe Dhramit, i cili e kishte shtëpinë afër dorë Kasapit që bridhte rrugëve duke shitur -e duke thirrur: «Paga me këmbë, mer rni paga ! ».

Në rrugën e Varoshit ecnim në rreshta herë nga dy, herë nga tre, pse rruga diku ngushtohet, diku bëhej më e gjerë. Ecnim duke kënduar këngë patriotike, si: «Për mëmëdhenë», «Që më një të kollozhekut» etj.

Më në fund dilnim nga rruga dhe në të mëngjër linim shtëpitë e fundit të qytetit, hidheshim në zallin e Përroit të Qullos dhe ne, nxënësit, përhapeshim si zalli i kRij përroi. Aty s'kishte më radhë, rruga bëhej e mërztitshme për një copë kohë, pse ishte i detyruar të ecje mbi e nëpërmes poplave. Kalonim mbi kishën e rrethuar me ovoro dhe shpejt arrinim në këmbët e bregut, një tokë e butë shtufë. Atëherë, sikur të ishim çliruar nga gurët e përroit dhe për inat të tyre, ia fillonim me vrap ngjitjes së

bregores si kecer, «me një frymë», siç thoshim dhe, kur arrinim në krye, të skuqur në fytyrë e tërë djesë, as që donim t'ia dinim. Atje lart zinim ndonjë gur o ndonjë cep muri dhe shikonim me kënaqësi qytetin dhe shokët që ngjiteshin. Gjithsecili përpiqej të tregonte me gisht shtëpinë e tij, shtëpinë e shokut. Me tmerr shikonim Përroin e Çullos nga larg, sido që nga afër, kur venim me shokë dhe mblidhnim bizhgo, nuk na dukej i tillë. Kushedi, mundet që bizhgot e gjelbra e zbutnin ca pamjen e tij.

Kur ngjiteshim, nxënës dhe mësues, në majë të bregut dhe pasi çlodheshim pakëz, zoti Xhafo na hiqte nga rruga drejt jugperëndimit të kodrës dhe na thoshte:

- Djema, këtu, në këtë vend ku jemi tash, ka qëndruar edhe Çerçiz Topulli me shokët e tij të çetës. Ai priste të ktheheshin të dy shokët që kishte dërguar brenda në Gjirokastër për të vrarë bimbashin turk. Këtu Çerçizi dëgjonte me kujdes kur matanë të kërcitnin pushkët dhe vërente me sy shqiponjë atje tej.

Dhe zoti Xhafo na tregonte me gisht matanë bregut teqenë tjetër të baba Hasanit dhe qersat e Embro Totos nga do të dilnin të dy shokët e Çerçizit pasi të kryenin vrasjen.

- Bimbashi do të vritej, - vazhdonte zoti Xhafo, dhe kështu ngjau aty në rrugën që zbret nga pazari në Hazmurat, pse në atë lagje jetonte ai jezit. Kështu që atje, afër shtëpisë së Jupit, krisi pushka dhe bimbashi turkoman ra si viç i ngordhur mbi kadërdhëm. Të dy trimat e Çerçizit zbritën me shpejtësi sokakun dhe në vend që të dilnin poshtë në teqenë e baba Hasanit, kaluan Sokakun e Lulës dhe dolën para kishës. Ata ecnin si sorkadhe mali, rendnin si veriu.

Çerçizi i dëgjoi pushkët, u ngrit në këmbë, - vazhdonte zoti Xhafo, i cili u ngrit edhe ai në këmbë, - dhe Çerçizi thirri i gëzuar: «U vra halldupi! Rroftë Shqipëria e lirë!». Çerçizi pastaj dha urdhër: «Fishekët në grykë të dyfekut!». U dëgjua njëherësh zhurma «krak-krak» dhe e gjithë çeta rrinte në këmbë. Çerçizi, përpara saj, Ariste me atë trup të bukur, me gjerdanin plot fishekë në mes dhe me flokët e tij të lëshuar që ia mente era. «Ja, dolën shokët te kisha», tha Çerçizi dhe për t'i përshëndetur e nderuar ata për veprën e guximshme patriotike që kryen, u dha urdhër shokëve:

«Pushkët gati për qitje drejt huqumetit të Gjirokastrës, zjarr!» Dhe filloi batareja, për t'i thënë kështu Turqisë: «Edhe huqumetin ta godita, edhe bimbashin ta vrava».

- Këtu u mblodh gjithë çeta që luftonte për Shqipërinë e për lirinë, siç jemi mbledhur edhe ne sot, nxënës e mësues, që mësojmë dituri për të mirën e Shqipërisë, vazhdonte zoti Xhafo, me kokën përpara si të Ceços tonë, me sy që i lëshonin shkëndija. Dhe ne të vegjlit e shikonim me admirim zotin Xhafo, mësuesin tonë. Kokët tona vinin deri te zinxhiri i bardhë i sahatit të tij dhe në ato momente në sytë tanë të vegjël, të hutuar, ky zinxhir merrte forma kolosale të gjerdanit me fishekë.

- Zoti Xhafo, - bërtiti njëri, - e ke parë ti Cerçizin ?

- E kam parë, djema, kam biseduar e kam ngrënë bukë me të.

- Dinte t'ia merrte këngës Cerçizi? - tha një tjetër.

- Për bukuri, dinte jo vetëm t'ia merrte, po edhe t'ia kthente. Ishte i vetmi për të hedhur valle labçe.

- Zoti Xhafo, na thuaj ç'u bë më vonë?

- Një herë tjetër të tjerat, djema!

- Aman, zoti Xhafo, vazhdo !

Dhe mësuesi vazhdonte:

- Pasi Çerçizi i puthi dhe i përqafoi të dy shokët që vranë bimbashin, çeta mori atëherë rrugën për në Mashku

llorë. Kthehuni tani nga ana tjetër e kodrës, - na thoshte zoti Xhafo dhe na tregonte me gisht: - Ja Mashkullora, atje tej, në mal. Këtej Çerçizi zbriti si levend me çetën, me dyfekë në sup, kapërcyen atë zall atje dhe dolën në fshat, te miqtë e tyre besnikë mashkulloritë. U ulën nën rrapin e madh historik dhe i treguan popullit ngjarjen e madhe*. *(Më 20 mars 1978, shoku Enver Hoxha bëri një vizitë në Mashkullorë ku u ul gu më gu me popullin te rrapin. Lidhur me këtë, në Ditarin e Tij, ndër të tjera Ai shkruan: «Ishte një ditë shumë e bukur për mua... Kaluam përpara haurit ku Çerçizi luftoi me orë të tëra kundër hordhivë otomane... Duke kaluar përmes njerëzve që brohoritnin, u nisëm për te rrapin i famshëm. Me emocion të madh e shikoja atë pemë madhështore, që ka rihetur përgjithmonë në historinë e vendit tonë... Kam ardhur këtu të takohem me popullin e kësaj ane, t'ju shikoj dhe të gëzohem me ju, të shikoj rrapin historik... Ky rrap i ka rrënjët të forta si vetë Mashkullora dhe

njerëzit e saj...») Rrapi mbeti dhe do të mbetet në histori, pse atje luftuan si asllanë Çerçizi me shokë. Ju e dini këngën, vazhdonte zoti Xhafo.

*«Në Mashkullorë te Rrapi Te rrapi në Mashkullorë
Ergjeri ç'u vra bimbashi Foli Ceçua me gojë».*

Pas këtij tregimi historik, që na e bënte shëtitjen tonë aq shumë të gëzueshme, ne merrnim rr ugën e teqesë, rrugë me bar, vendet me hije, me lule e me cfaka. Futeshim në avllinë e teqesë nga porta e madhe si bletët në koshere, pastaj prapë shpërndareshim si ato nga të katër anët nëpër kopshte, lëndina, nën pemë, nën hije. Avllia e teqesë ishte mjaft e madhe, tek-tuk ajo ishte shtruar me pllaka dërrasash të murrme, sidomos pjesa që të çonte në shtëpinë ku rrinte baba Manja dhe ajo që të çonte në cepin tjetër të teqesë, ku rrinin dervishët. Pjesa tjetër e avllisë ishte pa dërrasa, baltë e shtypur, e fshirë nga plehu i bagëtisë. Siç duket kjo pjesë shërbente edhe si vathë e dhenve të teqesë, e cila kishte një kope të madhe. Dhentë ia falnin teqesë njerëzit që bëheshin muhibë.

Teqeja kishte zonën e vet të muhibëve, «zonën e influencës», në të cilën nuk ndërhynte teqeja tjetër, pse krijoheshin konflikte. Teqeja e baba Manes kishte si muhibë disa familje gjirokastrite, si ato të Javer Beut, të Sami Karagozit e të tjera familje agallarësh, por «zona» e saj ishin Mashkullora, Plesati, Prongjia, Picari etj. Të gjitha këto ishin të huaja për ne në atë kohë. Në shkollë ne jo vetëm që nuk na flitnin për fenë, por kishte mësues që na flitnin kundër saj. Në familjen tonë që nga baba Çeni, dervishët dhe hoxhallarët trajtoheshin xhahilë. Rreth oborrit-vathë teqeja kishte edhe koçekët. Mësuesit i bënë një vizitë babait, i cili i priste në odën e tij, u jepte nga një kafe dhe i nxirrte nga dhoma e madhe e dervishëve, «dhoma-kuzhinë», ku bëhej hashureja dhe ku dervishët luanin filxhanët, «se s'kanë ç'bëjnë», na thoshte zoti Rexho, një nga mësuesit që i mbante më në gojë dervishët. «Këta, - na tregonte zoti Rexho kur mblidheshim ne në qiparisa, - janë dembelhanët më të mëdhenj, hanë, pinë e lozin filxhane, nuk lahen kurrë, bien ere përç, por ç'të bësh. Mos i thoni njeriut për këto që ju thashë!».

Ne ngjiteshim nga fundi i oborrit nëpër disa shkallë dhe dilnim në një avlli tjetër, që ishte e tëra e shtruar me dërrasa. Në të majtë ishte muri që mbante kodrën, në të djathtë kishte disa oda dhe në një cep të saj - një pjergull hardhie e ngjitur në një rrjetë teli, që i bënte hije avllisë. Në krye të avllisë kishte një thoropullë, deriçkë e vogël, që të nxirrte në hapësirën e bahçeve të teqesë. Andej ne dilnim si bletët dhe shpërndareshim tufa-tufa nga të katër anët. Për orë të tëra, natyra, qiparisat, lofatat, fiqtë, çerçemet ku ngjiteshin pjergullat, bari, lulet, deri te varret dhe mekamet e baballarëve ishin tonat, ishin zaptuar nga ne, djemtë e shkollës.

Të vegjlit që vinin për herë të parë në bregun e teqesë, ndaleshin në dritaret e vogla të tyrbeve. Zakonisht rreth e r rotull ato mbaheshin pastër; kishte qiparisa të lartë e të zinj. Këta qiparisa të vrenjtur na dukeshin si njerëz të gjatë të heshtur që «ruanin» baballarët e vdekur. Shikonim nga penxheret qivuret e tyre të ftohta, me nga një taç të rrethuar, me një cohë jeshile ose me ndonjë namazbez. Nga frika ndienim të ftohtë në trup dhe largoheshim shpejt.

Ndaheshim togje-togje, përpiqeshim të gjenim vendet më të bukura nën hije, mbi bar, dhe atje, në rrëzë të pemës, shokët e grupit linin kush shaminë, kush qesen me bukë, disa z bathnin këpucët, disa hiqnin xhaketat, në kishin, dhe fillonim lojën. Lloj-lloj lojërash: arabadaulen, turanë, pëzen, merr-zjarr, pingëlin, lojën me pllaka, mundjet nga meset me të vënë ose pa të vënë këmbën. Në mes të lojërave ia merrnim ndonjë kënge shkolle ose kënge labe. Kodra ziente nga nxënësit. Ç'kënaqësi! Herë pas bere mësuesit na kalonin afër, hidhnin nga një sy dhe ne e ruanim këtë «sy» për të treguar zotësinë në të kërcyer, në të mundur o në të kënduar.

Kështu më kujtohet tani, në moshë të shkuar, se si na kalonin si era orët e gëzuara të lojërave të vegjëlisë në shëtitje. Luanim e luanim dhe nuk lodheshim, por më në fund stomaku gërthiste: «Dua bukë!». Atëherë vendosnim të hanim, ashtu së toku, nën hije, mbi bar, pajdash, rreth e rrotull ushqimeve që i bashkonim së toku, si shokë të pandarë që ishim. Pastaj vërsuleshim te çezma e teqesë për të pirë ujë. Vinim grushtet dhe futnim turinjtë në ujët e ftohtë që na kënaqte; ngopeshim

me ujë, lanim fytyrën, futnim dhe freskonim kokën dhe pastaj largoheshim, duke u lënë radhën shokëve që vinin vargan.

Pas kësaj mërzenim si qengjat nën hije ndonjë copë herë të gjatë. Ishte kërci i vapës. Mësuesit hanin bukë në teqe, mundet me baba Manen, mundet babai u kishte therur ndonjë mish, pse këtë gjë e bënte teqeja ngandonjëherë kur i venin miq. Kjo ishte traditë. I çonin teqesë pesë desh, ajo u therte nga një qengj, pavarësisht se asnjë nga mësuesit tanë nuk besonte, nuk çonte asgjë në teqe dhe zoti Rexho lukuriste gjithë ato kundër tyre.

Kur vente ora tre e pasdrekes, ne mbledheshim në lëmin e teqesë. Ai ishte një lëmë i gjerë, i rrethuar me sufa dhe rreth e rrotull kishte qiparisa. Andej ne bënim sehir fushën, lumin e Drinos, malet e Lunxhërisë, kalanë e Shëntriadhës. Ç'mrekulli nën rrezet e diellit që do të perëndonte ! Ne e donim vendin tonë me mall të madh. Rrinim mbi sufa, këmbët tona tundeshin e sytë kullotnin në natyrë.

Na vinte pranë zoti Arshi, mësues i gjeografisë. Ai na i mësonte përmendsh fshatrat e Lunxhërisë, që nga Erindi, Karjani e Kakozi e deri në Stegopul. Këtu ai na mësonte në natyrë, dhe pastaj me gishtin e tij të hollë na thoshte

- Ja Qesorati, ja Dhoksati.

- Ku, ku? - i thoshim ne.

Ja Qesorati, thoshte zoti Arshi, fshati i Koto Hoxhit, mësuesit tonë të madh të gjuhës shqipe! Djema, mos e harroni kurrë këtë burrë patriot të ndritur!

Ja - Dhoksati. Ky fshat ka tradita patriotike, luftëtarët myslimanë që kalonin këndeje pritëshin si vëllezër nga të krishterët, sic e keni dëgjuar dhe në këngët popullore. Dhe zoti Arshi vazhdonte: Dëgjoni këngën popullore të luftërave që bënë fshatarët kundër bandave. Këta i zinin në befasi, po dhe i goditnin ata që kalonin riga Dhoksati

*«Në divan te Koço Duda Të kish bënë Kaço Shkurta
Hidhej valle Hamit Guga O Hamit Gugë levendi
E kthen glikonë me kupa, Në Sopot t'u pre derveni».
O glikoja kupa-kupa*

Pastaj zoti Arshi me gishtin e tij të hollë na tregonte Sopotin, ku, gjithashtu, ishin bërë përpjekje me armiq të. Ne kthenim kokën si të magjepsur. Ç'vend i çuditshëm ky yni! Në çdo gërxh është bërë pushkë me zaptuesit!

Zoti Arshi vazhdonte

- S'ka fshatra më të bukura në botë se këto të Lunxhërisë, me ato shtëpitë në mes të pemëve frutore. Atje mbin për bukuri dardha, kumbulla, gorrica, mani, thana, ftoi, fiku, qershia, pjergulla. Atje ka ato goxha burime, çezma me ujë të freskët e të kulluar që del si me këngë nga mali, atje ka hauze ku grumbullohet ujët dhe ujiten kopshtet me zarzavate, qepë, presh, kunguj, spinaq, majdanoz e shumë të tjera, deri te dhiozma, që fshatarët na sjellin edhe neve në pazarin e Gjirokastrës të hënat dhe të xhumatë.

- Zoti mësues, - bërtet njëri nga muri, - xhikoja, kur na bën jahni, i hedh dhiozmë. Pse atje bëhet kjo?

Tjetri kërcen dhe thotë:

- Aneja ime i hedh jahnisë rigon, dhe këtë e mbledhim në Kucullë.

- Zoti Arshi! - pyet një tjetër, - po trëndelinë ka në Lunxhëri?

- Trëndelinë ka atje, - dhe zoti Arshi me gishtin e tij të hollë tregon një qafë mbi Erind: - Ja, ajo qafa quhet Serpen dhe pas saj është një «xhenet» që quhet Çajup. S'ka në botë si Çajupi!

- Po Çajupi është një poet i madh yni, zoti mësues!

Dhe zoti Arshi i papërtuar fillonte e shpjegonte prapë.

Në një shëtitje, ja aty, mbi një mur të lëmit nën qiparisa, ai u mësonte nxënësve të tij, ashtu thjesht e ëmbël, historinë e atdheut, gjeografinë, literaturën.

Vinte mbrëmja. Fillonim kthimin në shtëpi; ktheheshim në vatrat tona, siç ktheheshim në vathë dhentë e teqesë me desh përçorë në krye, me bipën e rëndë në qafë. Duke iu gëzuar bagëtisë, shoku që kisha përbri ia nisi:

*«Oh sa bukuri ka tufa, sa gaz bie bagëtia
Vinë posi mbletë e plotë, i bekoftë perëndia!».*

- Enver, - më kthehet mua pastaj, - ç'thotë mulla Hisenji, ka perëndi?
- Jo, - i them, - s'ka perëndi, thotë baba Çeni, të gjitha janë përralla të kurdisura nga xhahilët.
- Po mua më tha Mahmuti që babai i tij ngul këmë se ka perëndi. E ka parë një natë të nxirë kur binte shi me bubullimë...
- Pika që s'i ra! Të pyesim nesër zotin Rexho. Më mirë të besojmë zotin Rexho dhe baba Çenë, se këta janë të ditur e këndojnë libra, - i them une.
Kthehesha në shtëpi i gëzuar dhe aspak i lodhur. Në kokë më tingëllonin bataretë e Çerçizit, përfytyroja mundimet e Koto Hoxhit*, *(Një nga pionierët e Rilindjes sonë Kombëtare, pjesëtar në themelimin e Shoqërisë së Shkronjave të Stambollit e autor shkrimesh e librash patriotikë. Ka vepruar në qytetin dhe krahinën e Gjirokastrës.) lulet, pemët, bagëtitë, kukunaret, mekamet, dervishët, ata qiparisat e gjatë, burimet që rrjedhin si vargjet e Naimit dhe ua tregoja të gjitha anesë, nënos, motrave. Kur vinin xhaxhai me babanë po atë gjë bëja, pastaj haja bukë dhe shkoja e ia këputja një gjumi të atillë të ëmbël, që duhej të vinte aneja në mëngjes të më zgjonte për të vajtur në shkollë.
Si sot më kujtohen gjithë këto kohë kaq të ëmbla e kaq të largëta të fëmijërisë sime.

ARGËTIMET TONA

Natyrisht, kur t'i këndojnë këto që po shkruaj për fëmijët e mi, këta do të qeshin, pse shumë prej lojnavave të vegjëlisë sime tash nuk praktikohen më, mbasi të tjera, më të zhvilluara, më moderne, i kanë zëvendësuar.

Në vegjëli lëvonte topi me lecka. Aneja m'i qepte në fillim të vegjël, pastaj ata shkonin duke u rritur, siç rritesha dhe unë. Ajo i bënte mirë ata, përpiquej t'u jepte rrumbullakësinë, por shpeshherë dilnin si vezë. Si aneja, edhe ne, të vegjlit, nuk dinim që ekzistonte edhe një lloj topi si vezë, që e quanin «rugby». Top llastiku është edhe ai, por vonë mësuam që kishte të tillë dhe e pamë me sy. Ndonjërit nga shokët e vegjëlisë i sillnin ndonjë top të vogël llastiku me bojëra të afërmit nga Stambolli, nga Janina o nga Amerika. Kjo ishte një ngjarje e rrallë në atë kohë dhe ne, kur e merrnim vesh se kujt i kishte ardhur, do të na gjeje të grumbulluar te sokaku ose te sheshi afër shtëpisë së «të lumturit». Mirëpo lumturia nuk vazhdonte për shumë ditë, pse gurët e sokakut në Gjirokastrë dhe shollët (këpucët) tona me proka e çanin topin e bukur dhe ne ktheheshim përsëri te lodra e kadimisë. Futboll si ky i tashmi ne pamë vonë, kur vajtëm në shkollën qytetëse. Por topat për këtë lojë ishin shumë të shtrenjtë dhe të rrallë.

Me top ne nuk luanim vetëm me këmbë, por edhe me dorë. Praktiknim një lojë që e quanim «top-meso». Bëheshim tre veta, njëri nga të cilët rrinte në mes. Pasi caktonim distancat fillonim dlie qëllonim atë që rrinte në mes, duke bërë finta që të tre, por sidomos ai i mesit. Në rast se ky kur qëllon nga dy të anës nuk goditej, atëherë ai që nuk qëllonte mirë i zinte vendin, futej në mes. Por kjo lojë ishte më pak e rrezikshme dhe më «ekonomike» sesa topi me këmbë, prandaj ishte e rekomandueshme nga nënat, se i grinin në shollë, majat e të cilave ishin të parat që vuanin. Për këtë arsye ne, për të mos grisur shollët, preferonim të luanim zbathur. Shollët atëherë i varnim në ndonjë vrimë muri nga «hunda» e tyre, prandaj këmbët na bëheshin helaq. Çdo mbrëmje, kur ktheheshim

né shtëpi, dimër behar, duhej të lanim medoemos këmbët né muslluk me ujë të ftohtë akull, që të mos na qortonte aneja, se i ngjishnim shtëpinë, shkallët, odën.

Edhe vrapimet nuk i linim mënjane ne vegjelinë tonë.

Zaten të gjitha lojnat kishin këtë karakter, po veganërisht loja «merr zjarr». Kjo lojë ishte thjesht me të baritur me vr ap, pse të ndiqte tjetri të të kapte dhe, që ta evitoje këtë, ktheheshe né bazë, merrje frymë, çlodheshe, pra «merrje zjarr» dhe ia filloje prapë vrapit deri né rraskapitje të njërit ose të tjetrit.

Kush i mban mend, ne kishim edhe lojna të tjera. Fushat e lojnave tona të vegjëlisë ishin rrugicat e sokakët plot me gurë, kopshti i Cuçes, Sheshi i Xhepit, Sheshi i xhamisë, Sheshi i Mamanit.

Kur u rrita ca dhe pas djegies së shtëpisë vazhdonim të rronim akoma né Palorto, te shtëpia e Gjylfidanit, lojnat tona dilnin edhe jashtë caqeve të shesheve që përmenda më lart. Kuculla na tër hiqte dhe për këtë do të flas më vonë.

Tash do të flas për Shpellën e Zekatëve. Atje veja bëja «ski» me shokë. Por ky ishte një ski special, ski gjir okastrit çe, nuk ishte ski pa zhurmë, si ajo mbi borë dhe me kërbë, por me zhurmë, ulur, me një gur të lëmuar nën vete, të cilin e n lerrje né duar kur ngjitje shpellën dhe shkisje pastaj g jatshpellës së ndritur dhe të lëmuar me një zhurmë shurdhuese. Kjo lojë vazhdonte nga ne disa orë, «bënim qejf», soditnim edhe Gjirokastrën e bukur.

Loja me lajthi dhe me arra ishte, gjithashtu, e prefer uar nga ne, të vegjlit, pse kjo lojë ishte e lidhur edhe me barkun dhe në raport me lojnat e tjera merrte një karakter të ndryshëm nga çdo pikëpamje, jo vetëm «nga barku-», por edhe nga «interesi» i thjeshtë i pronës personale. Këto i kuptojmë tash, po nuk i kuptonim atëherë. Loja zhvillohej në dy mënyra: e para, vihej një arrë o lajthi në mes dhe e qëlloje nga larg. Kush e godiste, ai i merrte të gjitha. Me këtë variant loje duhej të ishte nishanxhi. Unë me këtë lloj loje nuk fitoja.

Mënyra tjetër ishte ajo e përplasjes së lajthive në mur, ku vinim një si shenjë dhe, në qoftë se kokrra që përplasnim i afrohej shenjës barazi me një pëllëmbë, i fitoje të tëra kokrrat. Me këtë mënyrë unë fitoja, se e kisha dorën të madhe dhe pëllëmba i afrohej shenjës pa vështirësi. Por kjo lojë ishte sezonale, nuk vazhdonte gjatë, pse, e para, lajthi dhe arra nuk na binin shpesh në duar dhe, kur na binin, barku i përfshinte që para se të mblidheshim të luanim me shokët.

Kur mungonin lajthitë, këto zëvendësoheshin me xinat (majat e penave), të reja e të vjetra, të bardha, të verdha e të skurjasura, shenjë kjo që tregonte se shkollat punonin.

Më kujtohet që një kohë lajthitë e xinat u zëvendësuan me kalamidhet e kokat e plumbave të fishekëve. Këta kishin një bezdi, se na rëndonin dhe na çirnin xhepat e brekëve. Po nga dolën gjithë këto kalamidhe, që u bënë lojë për ne? Do t'jua them, sic ia thashë një ditë, në qoftë se nuk gabohem, shokut Gogo, kur ishim tok në Gjirokastër dhe rrinim shikonim qytetin nga ballkoni i shtëpisë së Partisë. Unë kisha humbur në mendime, shikoja me vërejtje në drejtim të r rëpirës prapa shtëpisë së kulturës, kinemasë dhe ish-ndërtesës së Komitetit të Partisë. Gogoja më fliste, por unë nuk e dëgjoja, se nuk e kisha mendjen. Ai më në fund më pyeti:

- More, po çfarë dreq tra në atë rrëpirë, mbi të cilën tre njëzet minuta që po shikon dhe s'i heq sytë andej?

I thashë Gogos:

- Është e vërtetë, ti nuk tre se ç'sheh atje, por unë shoh veten dhe shokët e mi të vegjëlisë në atë vend, ku ditë me radhë mblidhnim plumba dhe kalamidhe pushkësh. Jo, atje nuk ishte bërë luftë. Vërtet, siç më tra thënë plaku, nga brigjet e teqesë së baba Manes, Çerçizi, për të mbrojtur tërheqjen e shokëve të tij që vranë bimbashin, qëllonte me ma liher në drejtim të penxhereve të huqumetit, por ato për ti cilat flas unë nuk ishin plumbat e pushkëve të Çerçizit por ishin plumbat që gjetëm pas djegies së një depoje në municion, të grekëve, që ishte pikërisht ku ishte kisha E vjetër e Unitëve. Një natë, pasi kishin ikur ata, nuk e d pse, depoja mori zjarr dhe tërë atë natë, bam-bum kërcistE municioni në Gjirokastër. Si u qetësua puna dhe rreziku u largua, atëherë u vërsulëm ne, vegjelia, dhe qëmtonim plumbat e kalamidhet si pulat kokrrat e kallamboqit. Kjo është historia e lojës me plumba.

Lojna të tjera kishim plot, por mund të përmend «arabadaulen» dhe lojën e «kalasë». Këto lojna më p-lqenin shumë, ishin lojna atletike, shpejtësie, shkathtësie, kërcimi. Tash «arabadaules» i thonë «kala dibrance» ose «kali i drunjtë», po atëherë është kali ishte kurrizi ynë. E vështirë bëhej kjo lojë kur ishte ndonjë trupmadh dhe mezi kapërcehej nga të tjerët dhe unë isha një prej tyre që vetë kapërceja më lehtë, por shokët më kapërcenin më me vështirësi. Kurse në lojën e «kalasë» isha «kalë» i mirë, më mbante kurrizi, dhe shokët një e dy e mbi mua.

Lojë ishte edhe «pëzja», si i thoshim, të cilën e kemi luajtur edhe vonë në lice, kur u rritëm. Në këtë lojë duhet të zësh sytë me njërin dorë për të mos parë shokët dhe tjetrën e tendos nën sqetull, duke mbajtur prapa shuplakën hapur lart që ta qëllon një nga shokët me sa fuqi që tra. Ti duhet të gjesh kush të qëlloi dhe, po e gjete, ai ndëshkohet, të zë vendin, ndryshe vazhdon të hash shuplaka. Në këtë lojë unë i kisha të dy avantazhet që sjell një dorë e madhe, edhe goditjen e fortë, por edhe fushën e gjerë të goditjes nga të tjerët. Kështu, pas mbarimit të kësaj loje, zor se të ngrinin duart, edhe sikur akull e kallkan të bënte jashtë.

E së njëjtës natyrë ishte edhe «loja me kokall» dhe me «dizbai». Dënimet jepeshin sipas dëshirës së kryetarit të lojës dhe priteshin në pëllëmbën e dorës së hapur me të goditurat e një shamie me trombe (me nyje) dhe shumë herë të njomur me ujë. Ky dënim ishte më keq se shufra e mulla Kamanit, kur na godiste në mejtep.

Mjaft tash me kujtimet për lojnat. Të hidhem në kujtime të tjera.

Populli i qytetit të Gjirokastrës e ka dashur arsimin, kulturën dhe artin, por jo vetëm qyteti. Njerëz të mësuar kanë dalë gjithë kohën nga qyteti, nga Libohova, nga Dropulli dhe nga Labëria, e cila shquhej për trima.

Populli është gjithçka, ai ka qenë gjithçka edhe në botën e vegjëlisë sime, sido që është e natyrshme, nuk i kisha as këto kuptime, as këto mend që kam sot. Populli i Gjirokastrës, një popull trim dhe i guximshëm, në të parë duket si i mbyllur, jo shumë i hedhur, ai është i matur në fjalë dhe në gjeste. Kjo vjen nga vuajtjet, nga përpjekjet, nga fatkeqësitë që i kanë ngjarë, si gjithë vendit tonë, por veçanërisht qarkut të Gjirokastrës, që kërcënohej nga grekërit shovinistë dhe nga shtypja ekonomike e agallarëve. Populli fukara luftonte për të nxjerrë një kokërr misër nga Buri, nga stralli, por ai kurrë nuk iu përul as agallarëve, as bejlerëve, as grekëve. Agallarët e ruajtën deri në çlirimin e atdheut fuqinë e tyre ekonomike, por duhet thënë, se populli fukara i Gjirokastrës kurrë nuk u nënshtrua tek agallarët, kurrë nuk iu bind forcës së tyre, ai hapët i përbuzte dhe i sulmonte.

Gjirokastritët dhe gjirokastritet janë njerëz shumë të dashur, janë mikpritës, bujarë, kanë respekt të veçantë sidomos për «jabanxhinjtë», interesohen për ta. i ndihmojnë, u krijojnë ambient të ngrohtë, por, kur ndonjëri ua ka me hile, dinë «Via këndojnë». Gjirokastritët e duan përparimin, duan folklorin e tyre, këngët e vallet. Ata kanë kënduar dhe kanë kërcyer vazhdimisht.

Kënga labe gjirokastrite ka karakteristikat e saj si nga përmbajtja, ashtu dhe nga muzika. Vallet po ashtu.

Gjirokastriti këndonte kudo, në dasma, në rrugë, në dyqanin ku punonte, në arë kur kosiste barin, kur çante dërrasa me vare në shpellat e Dunavatit e të Manalatit, kur punonte me talika, kur mbartte ujë me bucela, kur fuste fëndien në shollë, kur e rrihte këpucën me çekiç mbi një pllakë, vënë në gjurin e tij me kallo, kur kishte thesin një kuinal në krah, kur kulloste delet etj. Ai këndonte jo vetëm kur kishte gëzim, por edhe kur zemra e tij ishte e brengosur. Gjirokastriti këndon edhe kur është vetëm, pale kur bëhen kokë më kokë dy-tre e më shumë veta.

Gratë këndonin më pak se burrat në Gjirokastrë, ato e kishin të shtrenjtë këngën, vetëm me raste, në dasma e në gëzime këndonin. Kënga e grave gjirokastrite është e bukur e harmonishme. Vallja e tyre, veçanërisht, më pëlqen aq shumë, sidomos eleganca e ritmit të tyre.

Këngët gjirokastrite janë këngë luftërash, këngë trimash, këngë që u këndojnë edhe luftëtarëve të lirisë, por edhe trimave si individë, pavarësisht cilat ishin arsyet e aktit. Por s'ka vetëm këngë trimash në Gjirokastrë. ka edhe këngë që u këndojnë ngjarjeve të tjera të jetës, dashurisë, famijës, mësuesve pionierë, vendimeve të gjyqeve, bagëtisë, fshatarëve e shumë ngjarjeve të kohës. Satira në to është e hollë, sidomos në këngët e grave. Ato përbëjnë një thesar të madh, të pashtershëm të popullit që më ka r:ethuar dhe më ka frymëzuar në rininë time të thjeshtë.

Njëherë, kur isba në Komitetin e Partisë në Gjirokastrë. vura re se aty afër ishte ndërtesa e degës së bankës. S'kisha hyrë kurrë në ndonjë bankë. «Hajdeni ta fut një herë kokën në këtë vend të parasë», - u thashë shokëve. Iu afrova sportelit me tel dhe me të qeshur i thashë nëpunësit të bankës, duke i dhënë dorën:

- As kam pasur dhe as që dua të kem të bëj kur rë me para.

Nëpunësi që nuk po ma lëshonte dhe po ma mbante dorën fort, më tha:

- Atëherë, Enver, eja t'ia marrim një herë këngës si qëmoti.

E pashë me kujdes në sy, e njoha Poçolin, shokun e vjetër që ia kthente aq bukur me grykë në netët e ramazanit, kur ngjitnim e zbritnim, grumbull shokësh, rrugën e pazarit për në Hazmurat,

Fëmijët e mi! Një natë, mamaja më kishte përgatitur një «kurth», kish ndezur magnetofonin, kur unë këndoja nëpër dhembë e në surdinë disa këngë labe, pa ditur se ajo po më regjistronte. Kur e mora vesh, qesha. Kur i dëgjon në shirit, ato nuk kanë asnjë vlerë, por ajo që më bëri mamaja, më pëlqeu, sepse kur të plakemi, do ta hap magnetofonin dhe mamanë do ta detyroj jo vetëm t'i dëgjojë e t'i dëgjojë këngët labe, por edhe t'i mësojë e të më shoqërojë.

Më vjen keq që. mne g-jithë përpjekjet e mia. s'jua mësova dot të kënduarit labçe. Ku të dini ju sa keni humbur!

Ne në atë kohë i interpretonim ashtu siç ishin fjalët dhe. dulce i kënduar. shijonim burrërinë e njerëzve, përbuzjen përpara vdekjes dhe armikut apo beut.

«Qajnë malet me borë

Për hajdutët që zen e shkojnë, en e shkojnë në Mesallonjë,

Në Mesallonjë të shkretë,

Lufton Lord Bajroni vetë...».

Në shkollë ne mësuam ku ishte Mesallonja, kush ishte Lord Bajroni që kishte kaluar në anët tona, e që kishte shkruar aq gjëra të bukura për shqiptarët në «Çajld Harold»-in dhe cilët ishin këta «hajdutë» shqiptarë që i venin në ndihmë kryengritjes greke.

Ose vjersha që këndonim:

«Riza bej, Riza Kolonja

Palla jote pret perona...».

Aneja e di përmendsh këtë vjershë që është shumë e gj atë.

Riza Kolonjën dhe shpatën e tij i mbaj mend dhe unë. Ne kishim një gjithë, një plakë shumë të mirë, të ndershme dhe shumë shakatare. Ajo quhej Hava e Toros, kishte një djalë që e quanin Mahmut, që ishte burrë i ndershëm. Djali i Mahmutit është agronom i shquar i kohës së Partisë.

Teto Havaja na donte shumë, na gëzonte dhe na shkundte manin që kishte në oborr. Një ditë me diell në sufa të oborrit të Havasë ishte ulur një plak i moçëm me mustaqe të bardha. Unë mblodha në grusht nja dv kokl-ra mana dhe ia dhashë plaku. Ai më gëzoi kokën. Unë e p~,eta:

- Kush je zotrote?

- Unë jam Riza Kolonja. - m'u pëi-gjigj plaku.

Ai ishte kushë ri a niqastar i teto Havasë. kushedi, por mbaj mend që, kur luanim e, hanim mana në oborin e teto Havasë me Hiqmetin e Tartales dhe me Rushitin e mulla Refikut. Riza bej Kolonja i binte xhamit dhe na thërriste sipër t'i çonim ca mana. Nganjëherë i niblshnim edhe nga një ujë «Shkularakut», sic ia kish vënë emiro teco Havaja dhe në dhomë ai na tregonte «shpatën e famshme». dulce na thënë:

«Riza bej. Riza Koloizja, Palla jote pret perona».

Një ditë e pyeta:

- Xha Riza. nuK prishej palla, kur prisje perona zotrote?

Xha Rizai u ngrit në këmbë, e zhveshi pallën që ndriste dhe më tha:

- Ja, shihe vetë. është e prishur? Unë habitesha dhe i thosha:

- Jo, nuk është e prishur. Ai më gëzonte kokën dhe më thoshte:

- Kur të rritesh do ta kuptosh këtë gjë se si ngjiste.

Kjo që do të t'iem më poshtë nuk ka lidhje as me këngët, as me vallet, por me një ngjarje të hidhur. Më sipër fola për djalin e mulla Refik Mezinit, Rushitin, me të cilin hanim së toku mana në avllinë e teto Havasë. Ai ishte një shoku im i vegjëlisë. të cilin e thërritnim «Qepa» pse ngaherë binte erë qepë, ai rrallë lante duart, kurse not në lumë dinte të bënte mirë. «Çdo të hënë dhe çdo të premtë, kur bëhej ditë pazari në qy tet, vinte hidhej nga ura në lumë. jo nj -, herë . po shumë herë. Këtë nuk e bënte nga qejfi, po për të fituar ndonjë lek, për të blerë librat dhe defterët. Kështu që, kur vinin fshatarët e Lunxhit për të bërë pazarin në Gj irokastër. ai rrinte mbi urën e lumit dhe u thoshte: «Hidheni dot nga ura në lumë me rroba? Ja, unë hidhem, po të më jepni një grosh». Dhe kur i jepnin diçka fshatai-ët. ai hidhej. E kishte bërë këtë punë si zanat. Ne edhe e admironim «Qepën» për guximin e tij, por edhe e këshillonin ta linte këtë lojë të rrezikshme.

Nji, ditë nëndajkoa bleu një dhi, por e, zeza dhi duhej të hante. Nëndajkoja na vuri në të qëronirn drizat. Na dha nga një kizë dhe ia filluam gjithë mëngjesin. Në drekë m'u bënë flluska né duar. Me bicakun që mbaja lidhur me gjalmë e bëra vetë «operacionin». Mirëpo e pësova keq, m'u infektua plaga, më mblodhi qelb, u mahis, prandaj këtë herë duhej bërë operacioni i vërtetë dhe nga një doktor i vërtetë, «qir Telemahu», siç e thërriste nëndajkoja. Né pëllëmbën e dorës e kam akoma edhe tash shenjën e «operacionit». Pra, për një «operacion», u desh të bëheshin dy operacione. Nga dhimbja e dorës m'u fry vendi nën sqetull; ma futi dhe atje një thikë «qir Telemahu», prandaj e kam edhe atje shenjën. Kur ishim të rinj dhe laheshim né lumë shokët më pyetnin:

- Ç'ke atje, nën sqetull?

Unë me seriozitet u thosha:

- Jam plagosur né luftë.

Atëherë nuk e mendonim se edhe luftën e vërtetë do ta bënim, mund të plagoseshim edhe të vriteshim bile, por këtë herë jo për lojna, por për çështjen e madhe të popullit dhe të atdheut.

Bahqeja ishte një rrip i gjatë toke, që u përkiste shumë pronarëve, dajkos, xha Haxhi Shurdhit, xha Bastriut, xha Mujmanit, Bozgos dhe Selfo Qoftesë. Kufiri i gjithsecilit ishin cepat e shtëpive, kurse brenda né bahçe s'kishte as mure, as kufi për ne, bridhnim nga të donim nëpër pemë. Bela kishim vetëm plakun xha Mujman Qosenë, ca ters si njeri, por jo i keq. Ai na gjurmonte, se i hanim thanët dhe shegët. Manat s'ia ngitnim dot, se i kishte para derës së shtëpisë.

- Moj Gjulo, - i thosh xha Mujmani plakës, - i folë atij djalit se m'i shqeu thanët.

- U, xha Mujman, - i thosh aneja, - ç'thua kështu, nuk është nga ata djelm Enveri.

- Po kështu më thonë, moj Gjulo, se unë me sitë e mi nuk e kam parë.

Né shtëpi aneja m'i shkulte veshët. Dhe unë, që ta zbusja politikën me plakun xha Mujman, kur kthehesha nga shkolla dhe e takoja me torbën plot me zarzavate që sillte nga pazari, i thosha: «Xha Mujman, ma hidh mua né sup torbën, se zotrote je plak».

Xha Mujmani qeshte me djallëzi, se e kuptonte hilenë, por torbën ma hidhte né sup dhe një herë më tha: «Mundimin do të ta paguaj me thanë». Mua m'u skuqën veshët nga turpi, pse e doja xha Mujmanin, mbasi ishte njeri i drejtë dhe qe pa djem, dy që kishte, ishin larguar të vegjël né Amerikë dhe kishte ngelur kukuvriq me teto N azon e Qosejve, plakën e tij.

Bahçeja ishte dhe «ateliëja» jonë e muzikës. Fëmijët né kohët tona nuk kishin gjithë këto instrumente të ncryshme që kenë ju sot, jo vetëm pse ishim të varfër dhe s'kishim me se t'i blinim, por nuk kishte fare as né pazar. ï~'legjithatë zemra na këndonte, sidomos mé shumë né pranverë, kur celte gjethi, kur dilte manushaqja nën ferrë dhe këndonte bilbili mbi gjembin e bahçesë. Atëherë rroftë biçaku, fillonim bënim me duart tona camunxat dhe boritë me lëkurën e lofatës sidomos. Lëkura e lofatës na shërbente për camunxat e boritë dhe lulet e kuqe të saj i hanim si dhinë. Lëkurën e njomë të lofatës e nxirrnim me kujdes si rrip, past.aj e dridhnim si bori dhe né majë i vinim camunxën që edhe këtë e nxirrnim nga degë të holla dhe, për të dalë pa u prishur, i binim me kujdes me dorezën e biçakut, duke i kënduar këngën:

*«Dil bilbil, karafil
Në mos dalc të pë'caç».*

Nganjëherë bënim edhe cule pr ej dr uri. Ato i kishte zanat dhe i bënte mirë «Çobani», një vërsniku im nga fshati i Kardhiqit, babai i té cilit ishte pajtuar te dajot e babait tim. Çobani ishte djalë shumë i zgjuar, ngjitej si majmun ne pemë, vinte rrotull si rreth me këmbë e me duar, ruante dhinë dhe s'vinte në shkollë. Nën arën e dajkomadhit, siç i thoshim, ai bënte culen dhe unë i tregoja përralla nga librat, po përpiqesha t'i mësoja edhe abëcënë.

Më vonë në dyqane dolën bilbilë të vegjël që i sillnin nga Janina. Ua merrnim veshët banorëve të mëhallës me ta. Pastaj ata filluan t'i bënë artizanët e qytetit me teneqe.

E vetmja vegël popullore që shitej në treg, ishte fyelli prej teneqeje. Tek teneqexhiu Malo, varur afër fotive e triotriëve, do të gjeje edhe fyej prej teneqeje. Ata i blinin më shumë gobanët, leberit ua dinin zanatin dhe shijen, qytetarët jo. Në Gjirokastrë ishin dy njerëz të talentuar të mrekullueshëm që i binin fyellit si ata, dy qorra: Vehip Qorri dhe Selman Qorri. Këta ishin nga fshatrat e Labërisë, njerëz fukarenj, të këputur fare, që rronin në dy haur e, të mjeruar. Të dy lypnin nëpër rrugë, ata kishin një shkop në dorë, culen dhe asgjë tjetër, absolutisht asgjë. Po ishin njerëz të mrekullueshëm nga shpirti, ishin dy artistë të mrekullueshëm të fyellit; në mjerimin e tyre të pakufishëm nga çdo pikëpamje atyre u këndonte zemra. Unë i kam dashur me gjithë shpirt ata, që kur kam qenë i vogël 10 vjeç dhe derisa vdiqën. Selman Qorri vdiq në kohën e Zogut, kurse Vehip Qorri rrojti edhe pas Çlirimit, ai e gëzoi Çlirimin, pa edhe kujdesin e madh të Partisë, pse u vendos derisa vdiq në azilin e pleqve, i nderuar.

Vehipi dhe Selmani i binin cules edhe veç e veç, po edhe të dy tok, njëri ia merrte, tjetri ia priste, sipas porosisë, me të qarë, me të kënduar. Gishtërinjtë e tyre të skuqur, të verdhë, e shumë herë të nxirë nga duhani, lëviznin mbi cule si të xhindosur. Zëri i fyellit të tyre të magjepste. Por pak njerëz e shijonin këtë mrekulli. Unë, kur them fyell, kujtoj menjëherë Vehipin dhe Selmanin. Vehipi ishte edhe bejtexhi, ai nuk fliste në prozë, me tërë kuptimin e fjalës, po fliste me vjersha, me bejte.

Kur isha 10 vjeç, Vehipi mund të qe nja 30, Selmani qe edhe ca më i madh nga Vehipi. Të dy rronin në Palorto, në mëhallën tonë, po Vehipin e kishim afër shtëpisë. Unë, sidomos Vehipin, e doja si babanë tim, ndaja me të thelën e bukës së misrit me djathë që më jepte aneja në qindë. Ai më thoshte: «Haje ti or bir, se je i vogël dhe duhet të rritesh». Në bajram, kur mblidhja ndonjë lek, i ndaja me Vehip Qorrin, blinin cule dhe pasta te Stathi. Kurdoherë që takoheshim, kur e merrja nga dora dhe e çoja në haurin e tij të errët si nata ose nga Sokaku i të Marrëve, kur na zinte shiu në rrugë dhe fshiheshim nën strehën e ndonjë porte që të mos lageshim, Vehipi më thoshte:

- T'i bie një herë për ti?

- Bjeri, xha Vehip!

- Si e do?

- Me të qarë, xha Vehip. - Dhe këndonte me trishtim fveli i këtij artisti të panjohur.

Nganjëherë i thosha:

- Xha Vehip, bjer i «Tanës»! - dhe ai fillonte me fyell:

*«Tanë, moj Tanë,
Ngreu e zgjo babanë, Se dhentë na vanë
Dash përçor në hell e kanë».*

Kënga e çobanit të bagëtive, që i kishin rënë hajdutët në kope dhe lajmëron me anën e fyellit vajzën e të zotit të tufës.

Sa bejte kisha dëgjuar nga Vehip Qorri. Ai m'i bënte vetë ose ia kërkoi unë. Mjaftonte t'i thoshe subjektin dhe ai ne minutë ta kurdiste vjershën. Sa e ndiej veten fajtor, që në atë kohë të rinisë, që dija dhe shkrim e këndim, nuk i kam shkruar! Sa keq, sa keq kam bërë që nuk i kam mbajtur, por

atëherë nuk kisha këto mend që kam sot, prandaj u them të rinjve: asgjë të mos ju shpëtojë nga gura e popullit, mbani çdo gjë shënim!

Disa bejte të pakta, shumë të pakta të tij i kam shkruar diku në fletët e mia më vonë, por janë shumë pak. Më kujtohet kur isha në shkollën fillore, këndonim disa libra të vegjël, të rrallë të Naimit, të shtypur jashtë me alfabetin e Stambollit. Këta libra m'i gjente baba Çeni. Xha Vehipi më pyeste: «Ç'vlersha mësove sot, biro?».

Unë i thosha si të qëllonte... «Qiririn».

- Kush e ka bërë? - pyeste Vehipi.

- Naim Frashëri, - i përgjigjesha.

- Ma thuaj dhe mua. - Dhe unë, që e dija përmendsh, ia thosha, duke vështruar sytë e tij të bardhë, pa dritë, që sikur më shikonin. Mbaj mend njëherë që, kur e mbarova vjershën, Vehip Qorri tha: «Ah, të puthça në ballë Naim Bej» dhe kurdisi këtë bejt, që më kujtohet:

«Në haurin tim të mj erë

Unë po dëgjoj Enverë,

Naim Bej ti; qofsha falë

Hajde të të puth në ballë,

Ti je dritë, ti je dritë,

Je fener në errësirë

Vehipit i hape sitë».

Në kujtimet e mia të shkurtra, ku flas edhe për xha Vehipin, kam shënuar, në qoftë se nuk gabohem, edhe disa bejte të tij, që i kurdiste kur i tregoja ngjarjen. Diçka kam shënuar për revolucionarin e madh francez, Rob^ospierin, që kishte mbushur mendjet tona të reja, kur mësonim Revolucionin Francez, që rrëzoi monarkinë dhe i preu kokën mbretit, Luigjit të 16-të. Por nuk e di në e kam shënuar edhe këtë bejt, që xha Vehipi e bëri fët-fët, kur e shoqëroja në bahçen e teqesë ditën e pazarit, ku shkonte për të lypur ndonjë domate, ndonjë presh, o ndonjë kokë hudhër.

«O moj ti Franca e mjerë

Pse e vrave Robespierë

Atë që të dha lirinë

E çove në gijotinë».

Po një diçka tjetër, një thesar i madh i Vehip Qorrit, nuk mund të mblidhet. Ky thesar janë tingujt e mrekullueshëm që nxirrte nga curlja (fyelli) e tij prej teneqeje, që ia kishte falur Malo Teneqexhiu. Gëzimet, brengat e vuajtjet dilnin nga curlja e Vehip Qorrit. Këto melodi të mahnitshme, ne që i kishim dëgjuar, na kanë mbetur në mendje e në zemër dhe na janë bërë mish e gjak, ndjenja e shprehi, së toku me thesarin e madh të gurrës popullore.

Kur i binin fyellit Vehipi dhe Selman Qorri, pleqtë rrinin në bisht, siç thoshim në Gjirokastër dhe në djelmuria në këmbë dhe dëgjonim vajin e përmallshëm të këtvre dy «bardëve» popullorë, që i donte gjithë populli i Gjirokastrës. Kur Par t'ia çliroi atdheun, Vehip Qorri, që rronte akoma, e mori dhe e çoi në azilin e pieqve në Hazmurat, në pallatin e Kadareve, ku, duke vazhduar t'i binte fyellit, kaloi në prehje, në qetësi, në lumturi ditët që i kishin mbetur të rronte.

Vehipi kishte një vesh të çuditshëm. Ai ma njihte zërin edhe kur më humbiste nga sytë për vite të tëra. Kështu, kur kthehesha nga Korça apo nga Franca, bile edhe kur u ktheva nga lufta dhe vajta pas kaq vjetësh në Gjirokastër, ngjiste e njëjta gjë me të. Mjaftonte Vi thosha:

- Vehip, si të kam nga shëndeti? - Ai shtangej për një moment në vend, më shikonte me ata sy të zbrazët dhe i gëzuar më përgjigjej, pa i thënë kush isha:

- Ah, erdhe Enver?

Të tillë ishin Vehip dhe Selman Qorri, bij të mr ekullueshëm e të mjeruar të një populli të varfër, por të papërkulur përpara fatkeqësive.

Kur vajtëm në lice, profesorët shqiptarë dhe francezë na futën dëshirën edhe për instrumente muzikore, edhe për organizimin e orkestrinave. Në muzikë kishim profesor Pano Hidon. Ky i binte violinës. Leshrat, ndryshe nga të tjerët, ai i priste «karé». Ne organizuam orkestrinën tonë të shkollës në lice. Xhaxhai më bleu një mandolinë. Ky ishte një gëzim i madh për mua. Aneja i bëri asaj edhe një këllëf. Ne jepnim koncerte në lice dhe jashtë tij në ditë feste, në ditën e ndarjes së çmimeve në shkollë, në shfaqjet teatrale, si edhe në popull, nga ballkoni i klubit të studentëve, që binte mbi mesin e pazarit. Kështu që ne, rinia e shkollës, i dhamë një gjallëri të re qytetit në këtë degë të artit dhe të kulturës. Në fillim nuk na e vinin veshin, na thërritnin me nënvleftësim: «U bëtë si jolinxhinjtë»; domethënë si evgjijtë, por kjo nuk zgjati shumë. Ne e kapërcyem këtë vështirësi dhe populli e pëlqeu shumë veprën tonë. Kur ne u binim instrumenteve nga ballkoni, mesi i pazarit mbushej, njerëzit heshtnin, na dëgjonin dhe na duartrokitnin.

Me formimin e shoqërisë sonë të studentëve, ku merrnin pjesë aktive edhe shokë si Aqif Selfoja, Selami Xhaxhiu e të tjerë, që ktheheshin në pushime, u gjallërua shumë jeta kulturore dhe artistike në Gjirokastër. Në këtë drejtim ndihmoi edhe çelja e liceut, ndihmuan edhe profesorët, francezë e shqiptarë. Këto aktivitete ne i zhvilluam në shkollë dhe jashtë shkollës. Në shkollë kishim një bibliotekë me libra shqip dhe frëngjisht, por ne, të shoqërisë, dëshironim dhe krijuam bibliotekën edhe jashtë shkollës.

Duke mbledhur ndihma andej-këtej, në nxënës d'ne në popull, arritëm të merrnim me qir a një lokal në mes të pazarit, blemë dhe një dollap për libra, mblodhëm libra, caktuam bibliotekar një shokun tonë dhe vumë rregull për mbajtjen mirë të librave dhe për kthimin e tyre në kohën e caktuar, me qëllim që të bëhej si duhej qarkullimi i tyre, pse librat edhe të shtrenjtë ishin, edhe të paktë.

Kështu, siç thashë më lart, në këtë lokal mbledheshim pasdreke plot nxënës, lexoniriz libra, këndonim këngë në kor dhe orkestrina jonë u binte instrumenteve në ballkon, përmbi pazar. Ishte një gjë e bukur dhe shkonte mirë, sa që filluam ta zgjeronim aktivitetin edhe me konferenca.

Kjo na detyroi të ndërrojmë lokal, u përpoqëm dhe gjetëm ca më tej një lokal tjetër më të gjerë, prapë në pazar, në rrugën që të çonte në prefekturë. Ky lokal kishte tri-katër dhoma dhe ishte në katin e dytë mbi dyqane. Atje ngjiteshe nëpërmjet një palë shkallëve të lama. Dera poshtë ishte e hekurt dhe kishte një çelës të madh. Këtë çelës unë e mbaj mend mirë. Pse luftuam shumë për të mos e dorëzuar dhe nuk e dorëzuam, kur kërkuan të na prishnin klubin dhe shoqërinë. Klubin donin të na e mbyllnin, se gjoja bënim zhurmë, por halli nuk ishte atje, por për arsye se në aktivitetet tona ndihej rezistenca dhe satira kundër regjimit, theksoheshin nga ne me të madhe momentet patriotike, këndonim me sa zë që kishim ato këngë patriotike, në të cilat flitej për lirinë:

«Se mjaft në robëri, moj e mjera Shqipëri O djem rrëmbeni pushkat, ja vdekje ja liri...».

Atje ne theksonim momentet revolucionare të popullit francez që mësonim në lice etj. Këto natyrisht bënin përshtypje në popull dhe nuk u pëlqenin njerëzve të regjimit të Zogut që e kishte zënë zhvillimin e arsimit, veçanërisht në Gjirokastër. Në klub, ku mbledheshim çdo pasdreke, bënim edhe komentet e ndonjë libri që dilte.

Përveç komenteve të librave që dilnin shqip, ne recitonim edhe vjersha që i mësonim në shkollë dhe jashtë shkollës, si ato të Naimit, të Çajupit, të Vaso Pashës, të Ndre Mjedës e të tjerëve, recitonim, gjithashtu, vjersha të Viktor Hygoit, Lamartinit, La Fontenit e të tjerëve.

Një aktivitet tjetër letrar në klub ishte tregimi për shokët e romaneve që këndonim, si me rekomandimin e profesorëve ashtu edhe vetë. Mua më kishin ngarkuar të kallëzoja përmbledhjen e disa romaneve franceze, si «Les misérables», «Notre Dame de Paris», tregimet e Gritit e të Perrosë etj. Kamber Bilali kallëzonte romane të tjera shumë interesante, që ne nuk dinim se ku i kishte

kënduar ose kush ia kishte treguar, mbasi ai dinte shumë pak frëngjisht, shumë pak turqisht dhe shqip. Kamberi ishte nipi i Hysni Babametos, zëvendës drejtorit të liceut.

Intrigantët, pra, ndërhyjnë andej-këtej që të na pengonin në veprimtarinë tonë përparimtare jashtëshkollore. Ata donin të na e mbyllnin klubin, që të paralizojnë aktivitetin e shoqërisë. «Ç'ju duhet juve, studentëve, të keni klub! Ç'ju duhet juve bibliotekë në klub, librat e klubit i bashkojmë me ato të shkollës» etj., etj. Ne nuk bindeshim dhe rezistuam.

Më thirri një ditë në drejtori zoti Hysni Babameto dhe më tha:

- Mor djalë, dorëzoje çelësin e klubit, se po ngatërrohet kjo punë! Unë i thashë:

- Zoti Hysni, çelësin nuk e dorëzoj. - Dhe fillova t'i shpjegoja një nga një arsytet. Ai më dëgjonte dhe më shikonte. Përballë bangos së Babametos qëndronte drejtori francez i liceut, zoti Viktor Kutan, që edhe ai më shikonte me vëmendje, po nuk kuptonte shqip. Pasi ia shpjegoja çështjen dhe vendimin e shokëve zotit Hysni, ky më tha: «Prit ea jashtë». Si duket ai donte të bisedonte dhe bisedoi me francezin, pastaj më thirri dhe më tha: «Mirë, ne aprovojmë vendimin tuaj, hapeni klubin si më parë, por vetëm mos bëni shumë zhurmë atje, që t'ua hiqni kështu edhe atë armë gojëve të liga». Unë i falënderova dhe shkova me vrap te shokët që më pritnin me ankth: «Fituam, - u thashë, «klubin tash nuk na e mbyllin dot». Gëzimi ynë ishte i papërshtatshëm.

Një aktivitet tjetër jashtëshkollor, kulturor dhe artistik, ishte teatri. Ne, nxënësit e Liceut të Gjirokastrës, në bashkëpunim me shokët tanë gjirokastritë që mësonin në Liceun e Korçës, e që ktheheshin në verë në vendlindje, ishim ata që për herë të parë dolëm në skenë të teatrit.

Teatrin, këtë aktivitet të ri ne, studentët, e morëm me seriozitet dhe me zell të madh, po na duhej të kapërcenim shumë vështirësi. Duhet të them se kultura franceze, që po merrnim në lice, na ngjalli dëshirën dhe na nxiti ta zhvillonim këtë aktivitet të panjohur për ne gjirokastritët. Në lice ne studionim pjesë të Molierit, të Kornejit, tragjeditë e Rasinit. Shumë copa të këtyre tragjeditë dhe komedive i kishim analizuar në klasë me profesorët francezë, i kishim mësuar për mendsh dhe recituar përpara tyre. Shumë herë profesorët na vinin t'i recitonim edhe në formë dialogësh. Kjo nuk përbente shfaqje në skenë, por mësim në klasë. Natyrisht, kur na analizonin këto vepra dhe të tjera, profesorët na shpjegonin rëndësinë e teatrit, të komedisë, të satirës. Vetvetiu ne, nxënësve, na lindi mendimi dhe na u nxit dëshira të luanim teatër për popullin, natyrisht, në gjuhën shqipe. Po si të bënim? Kishim në lice një shok që quhej Naxhi Totozani, që më vonë e la shkollën dhe u bë tregtar. Ai, kur ne diskutonim për këtë punë, na tha: «Unë kam një të njohur, një kushëri timin, që e quajnë Dine Qadhimi. Po bisedoj një herë me të, se, kur ka jetuar në Shkodër, ai ka lojtur teatër, ka haber dhe mund të na organizojë». Dhe ne iu futëm kësaj pune me zotin Dine Qadhimi.

Dinja ishte një burrë nja 40 vjeç, i hollë e i gjatë, serioz, s'kishte fjalë shumë, kishte edhe kulturë. Ai ishte demokrat. Duhet të kishte qenë më parë mësues o nëpunës, por, si duket, regjimi i Zogut e kishte pushuar, nuk e mbaj mend për ç'arsye, por sigurisht për pikëpamjet e tij. Dinja nuk përzihej me shumë njerëz, kishte lidhje vetëm me mësues. Ne e respektonim dhe e nderonim në rrugë xha Dinen. Ai na përshëndeste me njerzillëk dhe na simpatizonte. Një grup nxënësish nga ne morëm kontakt me të dhe i kërkuam ndihmë që të na organizonte dhe të na mësonte të luanim teatër përpara popullit. Më kujtohet se ai u emocionua shumë sa i venin lotët e mezi fliste nga emocion.

Dinja na tha: «Me gjithë qejf do ta bëj këtë punë dhe ne së toku do të bëjmë gjëra të bukura». Dhe Dine Qadhimi, ky pionier i talentuar i teatrit në Gjirokastrë, ia filloi punën së tij me një zell të madh me ne, brezin e ri. Çdo përgatitje me të e bënim jashtë shkollës, pa lënë, natyrisht, mësimet, pa asnjë shpenzim në fillim, pa kërkuar asnjë ndihmë nga kurrkush. Kishim orë të caktuara që na mblidhte xha Dinja në klub ose në natyrë dhe na bënte instruktazhin e përgjithshëm. Ai na foli më parë për rolin edukues të teatrit, për rëndësinë e tij, për vështirësitë e punës, na foli për rolet, se si duhej t'i mësonim, si duhej të shqiptonim fjalët, na fliste për mimikat, na fliste për rëndësinë e dekoreve, për grimazhet etj., etj. Dukej që ai ishte kompetent.

Neve s'na durohej dhe i thoshim zotit Dine:

- T'ia fillojmë. - Pse, si të rinj që ishim, s'kishim durim.

- Mos u ngutni, - na thosh ai, - për herë të parë ne duhet të bëjmë diçka të bukur, që të pataksim (çuditim) Gjirokastrën.

Më në fund erdhi edhe dita që gjetëm pjesën teatrale që duhej të mësonim dhe të luanim. Por çfarë të 'uanim? Pjesë teatrale në atë kohë kishte vetëm një: «Besa» e Sami Frashërit, që të gjithë e kishim kënduar dhe na kishte pëlqyer shumë.

- Aman, zoti Dine, - i thoshim, - të shfaqim «Besën».

- Jo, - thoshte zoti Dine, - mos u shpejtoni, përnjëherë e në thela. Ajo është pjesë e bukur, po e rëndë. Si për herë të parë duhet të gjejmë diçka më të lehtë dhe ta lozim mirë, pastaj herën e ditë, edhe «Besën» do ta lozim, edhe pjesë të tjera.

Dhe ai na solli një ditë pjesën që do të shfaqnim. Ishte diçka jo e shtypur, po e shkruar me dorë, mundet që Dinja ta kishte bërë edhe vetë. Ishte një pjesë me vjersha patriotike për çlirimin e Shqipërisë nga okupatorët e huaj. Ne e quajtëm atë «Shqipëria». Roli kryesor ishte Shqipëria e përfaqësuar me një grua. Në radhët tona ne nuk kishim gra apo vajza dhe rolin e tyre e luanin djem. Rolin kryesor Dinja ia dha Masar Kallajxhiut, pse ai e kishte zërin të hollë si vajzë. Masari ishte një djalë i dukur, i gjatë e me bel të hollë. Neve të tjerëve na u dhanë rolet e dyta, të treta dhe figurantë. Mua, më kujtohet, m'u dha roli i një luftëtari lab.

Erdhën edhe shokët për pushime nga Korça dhe ia filluam punës me zell të madh, duke përgatitur skenën. Nuk ishte një punë e lehtë. Vetë ne blemë trarët, dërrasat, të cilat i premë e i mbërthym në krye të divanit të shkollës, sipas këshillave që na jepte Dinja, blemë copat, veshëm skenën, bëmë perden etj. Më kujtohet se na duheshin edhe disa qilima, po ku t'i gjenim? Vajtëm iu lutëm xha Idriz Konjarit, babait të Elmazit. Ai na i dha, por na tha që «ju të dy jeni përgjegjës po të çirren ose të digjen». Ne i ruanim ato me kujdesin më të madh. Dy-tri ditë, para se të jepnim shfaqjen, unë, Aqifi, Elmazi dhe Fanja flinim në shkollë, mbi skenë, pse punonim deri vonë.

Biletat, pasi i shtypëm, i shitëm të gjitha. Kishte një kuriozitet të madh në Gjirokastrë për këtë shfaqje. Biletat ishin me klasa, I, II, III. Ata që kishin bileta të klasës III do të rrinin në bankat e klasave, të tjerët me frona, përpara fare ishin caktuar vendet për autoritetet, prandaj kishim vënë disa kolltukë. Atyre të radhëve të para nuk u vinim emrin, duhej të paguante secili sipas dëshirës, domethënë më shumë, tre-katërfish, kuptohej.

Mbrëmja arriti më së fundi. Çdo gjë ishte gati, ambienti ishte fshirë e rregulluar pastër. Populli erdhi dhe salla u mbush plot. Ne në skenë e në prapaskenë ishim shumë të emocionuar, se ishte hera e parë. Cilido nga ne ishte veshur sipas roleve. Mua më takoi të vishesha dy herë, të tjerëve po ashtu. Më kujtohet se mjekrat i lidhnim në kokë, por belaja ishte me mustaqet, se duhej t'i ngjitnim me zamkë dhe me njëfarë ilaçi që na e jepte Sulo Konjari, por që na ftohte buzët kur i lyenim dhe binte erë. Dinja na inkurajonte të gjithëve, lëvizte sa andej-këtej. «Mos trini frikë, - na thoshte ai, - trini mend jen këtu, kini mendjen atje, ti mos harro t'ia bësh kështu, ti ashtu...».

Shfaqja filloi me «Shqipërinë». Publiku duartrokiste, pse pjesa ishte prekëse dhe me përmbajtje patriotike, por fundi ishte më i bukur, pse atëherë dilte në mënyrë alegorike Shqipëria si grua e bukur, e gjatë, mbështjellë m flamur të kuq me shqiponjë, me flokë të zinj e të gjatë dh me duart të lidhura me zinxhirë prej karte. Masari, që luante këtë rol, filloi me një monolog në errësirë, pa,, taj në një dritë të zbehtë, pastaj, kur «Shqipëria» kë puste zinxhirët, ne ndiznim nga qindat e skenës disa fi shekzjarrë pa zhurmë, por si pishtarë që lëshonin drita t kuqe, të ndritshme. Kjo ishte apoteoza, «Shqipëria këpust zinxhirët». Salla u ngrit në këmbë e entuziazmuar dh buçiti kënga e flamurit. Ky ishte një sukses i madh i pa harrueshëm për ne.

Pas kësaj pjese filloi komedia. Edhe kja pati shumë sukses. Në mbarim, kur dolëm në skenë, u bë një zhurm e madhe, publiku na duartrokiste, bërtiste: «Bravo djelrr e duam prapë, e duam ta bëni dhe nesër». Ne atë donirr na doli frika dhe e shfaqëm nja tri a katër herë me radhi Njëherë e organizuam shfaqjen vetëm për gra. Salla kur doherë mbushej plot. Në Gjirokastrë ditë e javë me radh flitej për shfaqjen.

Mirëpo, historia e teatrit tonë kapërceu kufijtë e Gji rokastrës. Bashkia e Delvinës dhe ajo e Sarandës na ftua: të venim ta shfaqnim edhe atje. Ç'gëzim i madh për ne! Ne e pranuam ftesën me gjithë qejf. Do të shihnim Del vinën, Sarandën dhe detin. Ç'mrekulli! Filluam përgatit jet. Erdhën kamionët na morën. Të ngrënët, të pirët, shpen zimet e udhëtimit i kishin bashkitë. Dhamë dy

shfaqj? n Delvinë e dy në Sarandë dhe patëm shumë sukses. Të gjith na përgëzuan. Në Sarandë ne u habitëm nga bukuria e detil që e shihnim për herë të parë.

Pasi dhamë dy shfaqjet në Sarandë, një pjesë e shc këve, pa na lajmëruar fare, shkuan me një varkë të vjetë në Butrint. Mirëpo filloi të prishej koha, të 'ointe shi dh valët e detit të ngriheshin. Kur po errej filloi frika jonë për shokët se mos na mbyteshin, prandaj dolëm të gjithë te mo'. i vogël dhe me ankth shikonim nga deti, pritnim të kthehe varka, e cila më në fund mbërriti. U gëzuam shumë që n shpëtuan shokët, por edhe i qortuam. Ata, siç na treguar kishin qenë në rrezik të mbyteshin. Kur na përcollën, edhe delvinjotët, edhe sarandjotët na thanë që të venim prapë beharin tjetër.

Ne çdo vit përgatitnim pjesë teatrale. Të gjitha komeditë e Kristo Floqit i luajtëm. Vumë në skenë edhe «Besën» e Samiut, e cila, si të gjitha të tjerat, pati sukses të madh. Neve tash na kishte dalë frika dhe turpi i skenës dhe s'përtonim të luanim edhe pjesë të gjata. E tillë ishte drama me shumë akte «Fe e kombësi». Ajo ishte në vargje. Kur u ndanë rolet, mua më dhanë atë të Zylyftar Podës, pra rolin kryesor dhe më të gjatit. Ma besuan mua shokët, pse isha i gjatë, recitoja mirë dhe i mbaja mend shumë vjershat, të cilat i mësoja lirisht dhe i pëlqejja së tepërmi. Kështu që m'u desh të mësoja për mendsh gjithë rolin tim. Të gjithë u veshëm me fustanella dhe me jelekë të qëndisur, me pallacka dhe me pishqolla të argjendta në brez, me çibukë të qëndisur, «gratë» të veshura me çitjane, me këmishë penbezare dhe me jelekë të qëndisur. Ishb një gjë e bukur shumë. Rolin e grave dhe të vajzave e luanin vetëm katër veta, Reshat Totoja, Naxhi Totozani, Fane Rodi dhe Stavro Gjollma dhe ata e luanin shumë mirë. Pjesa pati sukses të madh. Më kujtohen disa vargje nga coli im:

*«...Porla, Shalësi, Barmashi
Kanë burra luftëtarë
Ikë Mahmut Pashë, ikë
Se s'ke parë kolonjarë».*

ose:

*«Melesini maja-maja
Gjëmon topi e kumbaraja».*

«Fe e kombësinë» ne e luajtëm disa herë.

Për sa i përket sportit, përveç atyre që kam thënë në fillim, kur hymë në lice futbollit ishte i vetmi dhe kryesori. Unë e luaja futbollin si gjithë shokët e mi. Unë rendja fort dhe luaja i mesit përpara. Fusha e futbollit ishte përtej lumit, në çairët. Në fillim portat i caktonim me p~lto, pastaj vumë shtylla, por pa rrjeta. Këpuçë futbollit s'blemë dot kurrë, se kushtonin, herë luanim me këpuçë të zakonshme, herë zbathur. Kur ktheheshim nga loja, vërsuleshim në lumi dhe ashtu, të djersitur, siç ishim, shtriheshim barkazi dhe pi nim ujë si kuajt.

Kalaja e Gjirokastrës ishte krenaria e vegjëlisë dhe i djalërisë sonë. Ajo ishte vendi i historisë, i legjendave bu rrërore, i patriotizmit të të parëve, i trimërisë, i sakrificave i luftërave kundër turqve. Ajo mbushte imagjinatat zona ti reja. Që nga mëngjesi dhe deri në mbrëmje, ngado që kthe nim kokën, na dilte përpara kalaja gjigante, e madhe, mahnitshme, me bedena të fortë si çeliku, muret e saj b' veshura me kulpra si mjekra e një plaku të moçëm, por ti pathinjur kurrë. Kalaja dominonte Gjirokastrën si një ma i gur të në mes të qytetit. Më kujtohen rreth e rrotull ovo rotë me vrima nga qëllohej armiku. Ato dukeshin si qën disma majë bedenave të lartë.

Unë nuk jam poet që të përshkruaj bukurinë dhe ma dhështinë e kësaj kalaje, e cila e ruajti këtë pamje, sido qi regjimi i poshtër i Zogut, që mbyllte shkollat dhe në vend ti tyre ndrtonte burgje, i shtoi asaj edhe burgun si një çibar të tmerrshëm, si një kërpudhë të keqe, që iu qep trupi le~fjendar të kalasë. Tash në regjimin tonë kalaja është bëri një vend i dashur për popullin, që ngjall inter es e i pël. qyeshëm për turistët, ruhet mirë, restaurohet çdo gjë m(kujdes.

Në rininë tonë ne hynim lirisht në kala, nga të dyj, portat*. *(Më 16 mars 1978, shoku Enver Hoxha shkoi për të vizituar kalanë. A donte të dilte nga porta që është afër Pazarit të Vjetër, për të cilën e kishte marrë malli. Por drejtori i muzeve i tha: «Shoku Enver, këtej nuk kalohet është mbyllur porta». Kurse shoku Enver iu përgjigj: «Pa më shiko një çikë në sy! Ato mos m'i thuaj mua! Ju nuk e kuptoni që unë nuk vij do çdo vit e të ngjitem deri këtu, në kala. Prandaj më lini të lcaloj, t'i shol të gjitha vendet e të çmullem...»).) Atje venim edhe me shkollë, edhe vetëm me shokë kur na tekej. Bridhnim nëpër kala nga të tëra anët, vetën në bodrume nuk futeshim thellë, se «ka gropa të thella» «ka mace dhe kafshë të egra që të shqyejnë», na thoshin Kur pyetnim pleqtë se ku e gjenin ujët për të pirë ushtarët që rrethoheshin nga turqit, para se të ndërtonte ura e mëdha Ali Pasha, ata na përgjigjeshirr: «Ka një vend të fshehtë diku në kala, që nuk e di njeri dhe andej me shkalla zbritnin njerëzit deri përposh në lumë dhe merrnin ujë». Kjo neve na shtonte habinë dhe misterin.

Mësuesit na tregonin në vend legjendën e famshme të Argjiros që, për të mos u dorëzuar tek turqit, u hodh nga bedenat e kalasë, duke mbajtur princshën e vogël në gji. Ata na tregonin me gisht: «Ja, këtej u hodh, atje poshtë mbi atë shpellë ra dhe atje, tek ajo shpellë, plakati vazhdojnë të venë pas kaq shekujsh dhe të ndezin qiri, si në një vend të shenjtë. Atje rrotull shpellës, po të shkoni dhe të këputni disa bimë, do të shihni se ato do të kullojnë «qumësht», që është qumështi i gjirit të Argjiros», na thoshin mësuesit. Dhe ne, të vegjëlvez kjo na bënte përshtypje të jashtëzakonshme, hapnim sytë, mbusheshim me krenari për stërgjyshërit tanë dhe për urrejtjen e madhe që kishin ata për turqit. Ne nuk e linim pa e vizituar shpellën, ku gjenim nga ndonjë bimë nga ato që i quanim «qumështore» dhe thoshim: «Ja, e vërtetë është ajo që na tha zoti Xhafo». Më vonë në lice e shkrova këtë legjendë në hartimin e frëngjishtes. Më kujtohet që profesori i frëngjishtes e pëlqeu shumë atë dhe më vuri notën më të mirë.

Si të gjithë djemtë e qytetit, edhe unë dua të shpreh këtu ndjenjat e mia dhe të tregoj se sa shumë e kam dashur qytetin tim, rrugët, rrugicat, sokakët, sheshet me gurë, shtëpitë e vjetra me dërrasa, avllitë e tyre, kopshtet me kumbulla të egra, me gurë e me ferra, ku kam ecur, kam bredhur e kam kërcyer në to. Çuditërisht tash që më kaloi mosha, kur rri e kujtoj Gjirokastrën, më vijnë ndër mend të gjitha, të gjitha, kaloj me imagjinatë në rrugicat, në sokakët e qytetit dhe them me vete: «Ja, atje rrinte filani, ajo shtëpi ishte e atij, atje rrinte filan shoku im, i zoti i asaj shtëpie ishte një ters, filan shtëpi nxinte, dera qëndronte kurdoherë e mbyllur etj.». Që në vegjëlinë time u lidha me qytetin, me njerëzit, me shtëpitë, me rrugët, me gurët. Çdo gjë për mua atje është e dashur, çdo gjë rron dhe nuk shuhet, ka mbetur e pashlyeshme. Të gjitha ato janë pjesë të atdheut, për të cilat më është irënjësor ajo dashuri e madhe si për mbarë atdheun, për tokën e për çdo gjë që rritet, që lind, që përtërihet, e mbështjellë me kujtime, me gëzime, me brenga e me hidhërimë. Tilla janë edhe kujtimet që lidhen me sëmudjen e pashë rueshme në atë kohë të vëllait.

Doktorët e këshillonin xhaxhanë dhe anenë që Beqirir në behar, ta çonin diku për verim, prandaj ata bënë ç'bë në, morën para hua, ndihmoi ca edhe dajkoja dhe e çuai tri herë për klimë, një herë në Cajup, një herë në Dhok sat dhe një herë në fshatin Stegopol. Me ta vajta dhe unë

Kur vajtëm në Cajup, më kujtohet se e patëm ca vësh tirë, pse atje nuk kishe ku të flije, nuk kishte asnjë kasolle pale shtëpi. Dajkoja i bleu anesë një çadër të madhe dhi një mëngjes u nisëm me kuaj. Çdo gjë e morëm me veti nga shtëpia. Kaluam nga rëza e Topalltisë dhe u ngjitëm për në Erind. Ne ishim kaluar, xhaxhai dhe qiraxhinjtë ecnin në këmbë. Ishte hera e parë për mua që kaloja fushër e Gjirokastrës dhe isha i gëzuar që më në fund do të shikoj, nga afër ato fshatra të bukura të Lunxhërisë, që i shikonin nga larg, nga shtëpitë e Gjirokastrës.

Lunxhëria, në jetën time të rinisë, ka qenë një kopshi bukur, i lulëzuar, me pemë, me hije, me ujëra dhe me kroje, me burime të freskëta, me prodhime të shumta, me njerëz të dashur, të ndershëm dhe punëtorë. Mos vallë kjo është vetëm fantazia ime e romantike nga leximet dhe mësimet e mësuesve, apo ëndërrimet e mia nga penxheret e shtëpisë, që orë e çast shihja përpara syve Lunxhërinë e pyllëzuar, me majat e maleve të mbuluara me borë në dimër, apo fshatin Qesorat me shtëpi të bardha? Nuk mund ta mohoj që fantazia ime punonte, por nuk ishte vetëm kjo. Me Lunxhin, lunxhjetët dhe lunxhjetet ishte lidhur ngushtë jeta e qytetit të Gjirokastrës. Lunxhi furnizonte qytetin me zarzavate dhe fruta të ndryshme.

Lunxhjetet vinin në qytet dimër e verë, me kostumet e tyre të bukura, të qëndisura me gajtanë dhe këto rroba, sido që të trasha, ishin të shëndetshme: Gratë dhe prodhimet e tyre zbukurorin pazarin, qytetin dhe ngjallnin te ne të rinjtë dashurinë për ata njerëz e për ato male që prodhonin aq gjëra të mira.

Në fshatin e Erindit u ndalëm në krua të pinim ujë e të freskoheshim para se të ngjitnim të përpjetën e Serpentit, me shpella e me gurë, në kërcën e vapës. Fshati ishte i përhapur, me shtëpi të vogla, të varrfra, plot haure. Në çezmë kishte gra që mbushnin ujë me bucela dhe me gjyme prej teneqeje, nga ato që varte në dyqanin e tij në Gjirokastër Malo Teneqexhiu. Nëpër këmbë të grave shihje edhe kalamanë si unë e më të vegjël se unë. Kujt mund t'i shkonte ndër mend atëherë se nga këta kalamanë të zbathur do të dilnin heronjtë e Luftës Nacionalçlirimtare, Mihal Duri dhe Misto Mame, të cilët do të bëheshin shokët e mi dhe do të luftonim së toku në rrugët e Tiranës e të Pezës, kundër okupatorit italian dhe për idenë e madhe të komunizmit e të çlirimit të atdheut?

Kur ngjitëm Serpentin dhe dolëm në qafë, një pamje madhështore na u hap përpara. Ishte i famshmi Çajup që ëndër ronim. Një fushë e bukur si një sini e madhe, e rrethuar me male, e gjelbëruar dhe plot me lule të verdha trëndeline. Matanë qafës nxinte një pyll i vogël. Në atë vend do të rrinim, se atje ishte çezma me ujë të kristaltë e të ftohtë si bora, për të cilin njerëzit në Gjir okastër thoshin: «Oftikaqarët (tuberkulozët) ai ujë o i shëron, o i qëron». Shpresa jonë e madhe ishte që të na shërohej vëllai.

Plaku me qiraxhinjtë ngritën çadrën, aneja rregulloi brenda kravatet prej kanavace, vuri mbi jorganët tanë edhe velenxat e dimrit, pse natën atje bën ftohtë edhe në verë. Natën e parë fjetëm si fjetëm, por gjumi ishte i lehtë. Në mëngjes plaku me qiraxhinjtë shkuan në pyllin atje afër dhe prenë disa degë të gjata për të ndërtuar një tendë, ku do të rrinim ditën në diell. Në tendë do të hanim drekën që na përgatiste aneja. Në Çajup s'kishte njeri veç nesh dhe një çobani me një kope bagëtish, që e kishte vathën ca më larg, kishte edhe një kasolle të mbuluar me degë pemësh si tenda jonë. Xhaxhai vajti bëri një copë herë muhabet me të dhe dolën të njohur. Ai ishte nga Kurveleshi. Xha Sulo e thoshin. Xhaxhai ra dakord me të që ai të na shiste qumësht çdo mëngjes dhe ndonjë mish kur të therte. Ai erdhi u poq me ne tok me një djalë të vogël të moshës sime, që e quanin Muharrem. Një djalë tjetër më të madh e kishte lënë me kopenë që kullose në mes të fushës. Ne u miqësua me ta sa ndenjëm në Çajup. Ushqimet do të na i dërgonte xhaxhai nga Gjir okastra në trikat ditë një herë me qiraxhi, ose me ndonjë fshatar nga fshatrat e Za. gorisë, që kalonte andej.

Jeta në Çajup. natyrisht, ishte monotone, por klima ishte e mrekullueshme. Vëllai po çelej dita-ditës, kollitej me pak dhe ne ishim të gëzuar. Ujët ishte aq i lehtë dhe ac i ftohtë, sa nuk e mbaje dot dorën. Oreksi na u shtua Ne kishim marrë edhe disa libra me vete, unë nga të shkollës. vëllai libra të Fan Nolit, «Bagëti e bujqësia» të Naimit «Baba Tomorin» e Çajupit etj.

Unë me djalin e xha Sulos, bridhnim lirisht në fushër e bukur me bar të Çajupit. Xha Suloja na bëri nga një shkop, u miqësua edhe me qentë, u hidhnim atyre bashki; kaçamakun dhe rrinim ruanim dhentë. Kur i milte xhi Suloja, na jepte ca kulloshtër. Ai na mësoi të bënim edhe kokorrehë të vegjël me trëndelinë të verdhë, të cilët, kur u kthyem, i mora në Gjirokastër dhe i varëm në mur.

Kur vinte edhe vëllai te xha Suloja, ia merrnim labçe,

Kështu kalonin ditët dhe netët në këtë vend të mrekullueshëm, por të vetmuar, ku, në mes të kësaj fushe me bar, me lule, me ujë të ftohtë e të pastër, me male rreth e rrotull, me qiellin e kaltër dhe natën plot e plot me yje, rronim vetëm ne dhe kopeja me dhen. Kisha shumë qejf të shikoja fshatin e Çajupit, për të cilin kishim lexuar vjershën që i kishte kushtuar («Fshati im»). Pyesja Muharremin: «E ke parë ti?».

Ai përgjigjej : «Po, po të vesh në qafë, duken Nivani, Sheperi etj.».

- Xha Sulo, - i drejtohesha çobanit, - kur do të verri në qafë të shohim fshatin që të këndova në libër?

- Do të verri edhe atje, por pasi të hajë kopeja barin në rregull.

Dhe një ditë vajtëm edhe në qafë e i pamë ato fshatra. të cilave u ka kënduar me aq mall Çajupi.

Kur u kthyem nga Çajupi në Gjirokastër. vëllai dukej më mirë. Aneja ishte e gëzuar dhe thoshte: «Ishallah na shërohet». Por «ishallaja» nuk do t'ia realizonte dëshirën.

Këto ishin disa nga kujtimet e mia të kohës së fëmijërisë, të dashur fëmijët e mi. Buzëqeshni po të doni, por nuk ka gjëra të tjera, kështu kalonin vitet e rinisë në atë kohë. Ne atëherë nuk kishim Partinë që kemi sot, që të na edukonte, të na mësonte, të na udhëhiqte në djalërinë tonë, u rritëm, si me thënë, jetimë, pa nënën e madhe Parti, por popullin, që na rriti e na frymëzoi që kur filluam të pinim sisën e mëmës, e kishim të pamposhtur.

UDHËTIM ME «FLUTURIDHË»

Një vit, nuk e mbaj mend mirë datën, por ishte akoma në kohën kur vazhdoja mësimet në Liceun e Gjirokastrës,

dajkoja më ftoi të veja të bëja pushimet në Fier, ku ai rrinte me gjithë fëmijë. Gëzimi im ishte i papërshtatshëm dhe prisja me padurim ditën. Ai i dha xhaxhait edhe të hollat që të më zinte automobilin. Udhëtimin aso kohe ishin shumë të vështira për në Vlorë, ato zgjatnin nganjë herë edhe dy ditë. Të thoshin të dilje që në mëngjes, por automobili nisej në drekë dhe, kur errej, pasi prishej e riparohej disa herë rrugës, shumë-shumë arrije deri në Tepelenë. Këtu, më kujtohet, fjeta në automobil, pse nuk kishte as han, por nuk kisha as para. Çdo gjë ishte llogaritur shtrënguar për të arritur deri në Vlorë.

Një automobil i vetëm ekzistonte atëherë dhe pronari i tij ishte Namik Alitja. Ky ishte një mesoburrë, korrozi nga fytyra, njeri punëtor, jo i pasur. I kishte vdekur gruaja dhe disa vite më vonë ai u martua me çupën e baba Çenit, Munimenë. Namiku ishte i pari që bleu këtë kamion italian, natyrisht, të përdorur. Automobili i Namikut ishte një ngjarje me rëndësi për Gjirokastrën, siç ishte edhe mulliri i blojës i Foto Tolës.

Mulliri i Foto Tolës, një makinë e vjetër «hamoqellë», siç thoshim në Gjirokastrë, ishte vendosur në një palo barakë nën Sheshin e Cerçizit, që në atë kohë nuk quhej kështu dhe nuk kishte as mure, as ovoro, por ishte një rrëpirë e keqe. Mulliri u inaugurua një mëngjes të bukur me një ulërimë sirene aq të fuqishme, sa çuditi dhe shqetësoi gjithë qytetin, banorët e të cilit dëgjonin për herë të parë një gjë të tillë. Më kujtohet se atë ditë do të nisesha për në shkollë, kur ia filloi ulërima. Aneja bërtiti dhe së toku shkuam me vr ap e në penxhere. Ajo thoshte: - Ç'është kjo gjë? Ç'është kjo ulërimë? Bobo, ç'na ngjau në Gjirokastrë! Mos dil të keqen, sa të merret vesh ç'është, se mos të të ngjasë gjë, - më thoshte mua.

- Ido të dal, - i thashë, - mos ki merak për mua, të vete të shoh, të marrim vesh ç'është.

Kjo ishte sirena e «fabrikës» së parë të Gjirokastrës.

Të vijnë tash përsëri te kamioni i parë. Namiku i kishte vënë edhe emër makinës, e quajti - Fluturidha». Shoferi i saj, që quhej «Arap», ishte i famshëm për zotësinë e tij dhe për vesin që pinte e shante si shumë shoferë të asaj kohe. Ishte i zi nga fytyra si dhe i zoti i kamionit, xha Namiku.

Kamioni, pra, atë ditë mezi u bë gati, kur dielli ishte ndonjëzet pashë lart në qiell. Ne shumë vend të gjithë mbi dengje, mbi thasë, mbi kasona; as e merrte vesh i pari të dytin, shtypur sa s'merrnim dot frymë, koka na prekte mushamanë dhe detyroheshim ta përkulnim në gjoks.

- U shtypëm, do të na zihet frima, mor xha Nainik. - i thoshim.

- Mos kini merak, - na përgjigjej ai, - zaval do të kini sa të nisemi, pastaj rrugës çdo gjë nga gropat do të rregullohet, do të shtipen plaçkat, dengjet dhe do të gjendeni si mbi çilte.

Në fillim xha Namiku udhëtonte edhe vetë pranë slzoferit. Rrugës ai as që pyeste fare ç'bëhej brenda në makinë, ku kishte njerëz që villnin e më të moshuarit dhe gra që vuanin. Ai në mes të rrugës e ndalte makinën, bisedonte me ndonjë udhëtar, i merrte qiranë dhe i thoshte: «Hip pas shpejt, se më more kohë». Kështu vepronte gjatë gjithë rrugës, derisa arritëm në Tepelenë, ku na zuri nata.

Në Tepelenë në atë kohë nuk kishte veç një poste xhandarmërie dhe disa baraka. Atje frynte një erez e marre që të ngrinte nga vendi. U karkallosëm nga era, pse

ishim të detyruar të zbritnim dhe të lëviznim ca këmbët e duart, se na ishin mpir ë e ishim bërë helaq. Por gëzimi im ishte i madh, isha i ri, s'doja t'ia dija. Fjetëm atë nate brenda në «Fluturidhë». Në mëngjes po ajo këngë: «Ni semi tash, ja dhe pak, se presim dikë, ja se Arapi ha bukë, ja se u ça goma» etj.

Afër drekës u nisëm për rrugë. Filloi ng jita, Salaria, fr enat që rënktonin, pluhuri që të mbyste e të nxirrte zorrët, kënga e «Arapit» që sokëllinte dhe frika e hajdutë ve që mund të na pritnin rrugën. Kusarët, si Shaqo Llapi, Mero e Hamit Lamçja, Sulo Bega e të tjerë, iz pritnin rrugën automobilave dhe u merrnin udhëtarëve parate dhe plaçkat. Me një fjalë i rripnin. Unë s'kisha frikë nga një gjë e tillë, pse isha i vogël, s'kisha asnjë lek në xhep, vetëm një bohça të vogël me ndërresa. Prandaj ma kishte qejfi të shikoja se si pritej rruga nga hajdutët. Kur kërcitnin fr enat dhe ndalej «Fluturidha» në ndonjë kthesë, një grua nga fundi i kamionit bërtiste «hajdutët»!

- Jo, moj motër, - i thoshte një burrë që bënte kryq, - mos u tremb, ç'ke që na i ben ters r rugën.

Në çdo çezmë e në çdo vijë «Arapit» ndalte makinën dhe i «potiste» motorin, që lëshonte tym sikur të kishte marre zjarr. «E kanë si njerëzit edhe makinat, - na thosh «Arapit», - kur ngjiten, dërsijnë dhe duan ujë të pinë, se kanë etje».

Te rrapit i Sevasterit u bë një pushim i gjatë. Njerëzit dhe makina aty çlodheshin, pushimi ishte i merituar, se dilnim nga kamioni të bardhë. Edhe une isha bërë si të tjerët, sikur kisha dalë nga mulliri i Ciços në Virua, ku kisha vajtur një herë me mushkë me úesulin (Culen) e xha Faros për të bluar kallamboq. Një nga një zbritëm në çezmë, shkundëm pluhurin e rrobave, hoqëm palltot, përveshëm duart, lamë fytyrën dhe pimë nga ai ujë i pastër, i qartë dhe i ftohtë akull. Pastaj nxora atë bukë e djathë që më kishte dhënë aneja dhe fillova ta haja me oreks. Atje ishte dhe një palo barakë që shiste birre. Birrat e ftohta në çezmë i pinin njerëz si «Arapit», nga dy-tri shishe.

Një burrë, kur pa se «Arapit» s'pushonte së piri, i bërtiti:

- Arap, për kokën e plakut mos pi më, se na more më qafë, do të na hedhësh nga ndonjë buzë!

- Mos kini merak, - ia ktheu «Arapit», - vetëm kur pi nuk më dridhen duart, prandaj në do të veç shëndoshë në Vlorë, paguajmë një birrë. Ne qeshnim dhe e admironim «Arapin». «S'ka shofer si 'Neki Arapit», më vonë thoshim edhe si Arshi Rucaj, si dhe Pandeliu dhe Arseni. Këta ishin shoferët nga më të shquarit e kohës së djalërisë sime.

Ia hipëm prapë makinës, lamë pas freskinë e rrapit dhe të çezmës së Sevasterit, të përpjetat dhe grykat e Salarisë, frikën e hajdutëve dhe u futëm në zonën heroike të ëndrrave tona. Po i afrohem Vlorës trime. Isha kurioz dhe nga brenda kamionit, si nga një tunel i errët, shikoja me kureshtje të madhe malet, kodrat, prisja të shikoja pyjet e ullinjve që na i kishin mësuar në shkollë. Kërkoja mos gjeja po atë vend të ullinjve të librit të Justin Godarit, një francezi që kishte ardhur në Gjirokastër, të cilin ne të vegjilit, që na nxorën në shesh me shkolla, e pritëm me lule. Godari bëri një libër në frëngjisht mbi Shqipërinë që ne e këndonim në lice. Atje, më kujtohet, kishte një fotografi të ullinjve, ku rrinin refugjatët e shpërngulur e të dëbuar nga vendet e tjera të atdheut nga okupatorët serbë e grekë. Duke pritur të arrinim në Vlorë, ia merrnim këngës:

*«Jam vlonjat e jam vlonjat,
Zhgabën e kam mëmë e at.
Zhgaba trime dykrenore
Vend' e saj e ka në Vlorë».*

Në mendjen time të vogël kalonin epopeja e Vlorës, trimëritë e Selam Musait, vullnetarët, flamurët, Ismail Qemali, vrasja e Avni Rustemit, Kryengritja e Qershorit, baba Çeni, Idriz Guri, Çerçizi, Marati, Robespieri dhe koka e prerë nga gijotina e Luigjit të 16-të. Më dukej sikur të gjitha këto dhe këta do t'i gjeja në Vlorë. Ishte ëndrra e madhe e rinisë sime që po realizohej.

Natyrisht, në Vlorë arritëm natën dhe «Fluturidha» ndaloi në hotelin «Korça» të Hilmi -Cipit, një kushëri i anesë e i dajkos. Atje ishte baza e «Fluturidhës», etapa e fundit e «trenit» Gjirokastër-Vlorë. Kishin dalë plot

njerëz që pritnin kush njeriun e tyre, kush një plaçkë, kush një letër. Mua s'më priste njeri. Atje takova Beti Sharrën, «Çalamanin», një ish-shok i shkollës qytetëse, që punonte si shërbëtor në hotelin e dajkos së tij. Ai më mori dhe i tha Hilmiut që isha nipi i Shyqyriut, i cili e kishte porositur për mua të më jepte një kr evat në hotel që të flija dhe të nesërmen me ndonjë automobil të më niste për në Fier. Kështu u bë. Unë fjeta një natë në Vlorë. Hoteli m'u duk si një «pallat». Fjeta në një dhomë me Betin. Krevatet kishin dhe «buzëla», kunupiere, pse atëherë të pinte kunupi në Vlorë. Me të zbritur, na u frynë fytyra dhe duart. I bëmë menjëherë me uthull, por pa fajde.

Unë doja të dilja pak të shihja Vlorën e ëndrrave të mia. Dolëm me Betin nga një sokak i errët në një shesh.

- Ja, - tha Beti, - këtu u ngrit Flamuri.

- Ku? Ku? - i thosha unë.

- Ja, në një shtëpi të vjetër, që tash nuk duket se është errët, në një ballkon prej druri.

- Më trego, Beti, detin, - i thashë.

Ai më tha:

- Je në vete, është larg skela, ka ferra, gjemba, duhet karrocë, s'vete dot me këmbë. - Kështu që atë natë as Vlorën nuk e pashë dot, as detin.

Në mëngjes herët u çova dhe, pa ngrënë bukë, dola vetë. Kisha etje të shihja Sazanin dhe Karaburunin e këngëve dhe të ëndrrave të mia heroike. Duke u siguruar se një veturë karakatinë «Ford» e Hiqmet Cipit do të nisej nga dreka për në Fier, unë ua mbatha lkëmbëve me të shpejtë drejt e në skelë dhe që andej ndenja mbi një gur jashtë në breg dhe shikoja Sazanin që na e kishte pushtuar Italia dhe Karaburunin. Nuk ngopesha duke I parë dhe duke kaluar në kokën time këngët që kisha mësuar.

Ullinjtë, ullinjtë doja të shihja. Kur ia hipa «Fordit», i thashë Hiqmetit:

- Aman, më trego ullinjtë.

- Mos ki merak, - më tha ai, - se nëpërmes tyre do të shkojmë.

Ç'mrekulli për mua! U habita. Si ishte e mundur? Pyje të tëra me gjelbërim, kurse në Gjirokastër nuk kishte asnjë rrënjë. «Ah, - thosha me vete, - këta vlonjatët janë të zotë të çdo gjëje».

Kur dolëm në qafën e Koshovicës, në zbritje, më bëri përshtypje hyrja e Fierit. Andej dukeshin fusha dhe qyteti, varrezat nga të dyja anët e rrugës dhe rrapet e trasha. E pyesja shofer Hiqmetin për çdo gjë.

- Pse ka dy lloj varresh?

- Nga një anë, - më shpjegonte ai, - janë varret e myslimanëve, nga ana tjetër ato të të krishterëve. Këto rrape janë shekullore; atje në kodër, mbi këtë lumë që quhet Gjanicë, është shtëpia e beut çalaman me këmbë të drunjtë, që kur ecën ia bën krëk-krëk. Ky këtu është pazari dhe shtëpia e pashait. Të gjitha këto dyqane janë të pashës, zaten gjithë Fieri, - thosh shofer Hiqmeti, është i Vrionasve.

Më në fund arrita në shtëpinë e dajkos, një shtëpi e vogël përdhese me tri dhoma të vogla dhe me një qilar, ku nuk vërtiteshin dot tre njerëz. Rreth e rrotull shtëpia ishte e rrethuar me gardh, në një qoshe ishte një pus, nga i cili ujin për të pirë e nxirrnin me çikrik. Unë u habita, sidomos me një copë të kopshtit, ku kishin punuar bostançe. Atje kishin mbjellë njëfarë kungulli, që s'e kisha parë kurrë. Siç më tha nëndajkoja, ky kungull nuk hahej, po e linin të thahej, e kruanin nga brenda dhe e mbanin për të pirë ujë. Të pish ujë me kungull? U habita.

Nëndajkoja u gëzua që vajta, po dajkoja ato ditë më duket nuk ishte atje, erdhi më vonë e u gëzua edhe ai kur më pa. Flija në një dhomë me nëndajkon. Ne shtronim çdo mbrëmje pas buke stromët në dhe, kurse dajkoja flinte në krevat.

Ditën e parë të vajtjes në Fier bëra «inspektimin» e oborrit, nxora kokën nga gardhi, në rrugë, u vërtita rreth e rrotull. Në ato kohë atje nuk kishte shumë shtëpi, kishte kasolle prej balte. Afër shtëpisë së dajkos ishte një shtëpi e madhe me dy kate.

Më duhej të gjeja ndonjë shok, me të cilin të dilja ose të luaja. «Të njoh unë», më tha nëndajkoja dhe një ditë shkua në «Çeligrad», që ishte aty afër, në anë të qytetit, në një shtëpi të vogël përdhese me baltë, por me lule në të hyrë dhe të pastër brenda. Atje na priti në familje një djalë i shtëpisë, me të cilin u njoha. Ai mësonte në Shkollën Teknike në Tiranë, luante edhe futboll. Kështu që mjaft herë ne dilnim me të në «Çeligrad» dhe luanim me top pasdreke me çunat e tjerë fierakë. Dajkoja, që ishte i kursyer, më thosh: «Mos luaj shumë, se të shqyhen këpucët». Po çfarë të bëja tjetër?

Unë veja në dyqanin e dajkos, dyqan i thënçin! Ishte një nga ato dyqanet e vogla, pronë e pashës Vrionas, me taraba prej dërrase dhe me dysHEME e mure prej balte. Xishte dy hyrje në dy rrugë, pse ishte në qoshe. Në mure kishte disa sergjene dhe në sergjene disa plaçka. Më kujtohen vetëm disa pasqyra të vogla rrumbullake, me nga një fytyrë gruaje nga pas. Këtë farë «malli» dajkoja e kishte blerë në Vjenë, kur vinte takonte djalin e tij, Zihninë, që e kishte dërguar për studime. Në dyqan rrinte kurdoherë Sotir Goga, kështu më duket se e quanin. Ai ishte „i një fshatar nga Myzeqeja, i hollë e i gjatë. Sotiri ishte i dashur, mua më donte dhe që ditën e parë më tha: «Zgjidh një pasqyrë të vogël dhe mbaje me vete të shikoiesh». M'u duk sikur ç'më dha.

Një mbrëmje tek po bisedonin në dyqan dajkoja me Sotirin, ky i fundit i tha:

- Shyqyri, ta marr edhe Enverin nesër në Roskovec?

- Merre, - i tha dajkoja.

Unë u hodha përpjetë nga gëzimi. Do të veja në Roskovec! Se ç'ishte Roskoveci, as që dija gjë, po nuk më zuri gjumi atë natë dhe në mëngjes herët erdhi Sotiri me një qerre që tërhiqej nga dy buaj e më mori. Për herë të parë hipja në qerre. Sotiri ngiste qetë me hosten, rrotat rënkonin. Ne venim në Roskovec të bënim pazar. Sotiri do të blinte rrush për të bërë verë për dyqanin dhe kush e di edhe me kë do të takohej. Arritëm në Roskovec, ku nuk kishte veçse disa baraka të vjetra, por bëhej pazar i madh, kishte mjaft popull që shiste dhe blinte. Sotiri piqej me njërin e me tjetrin, bisedonte me fshatarë me takije në kokë. Më në fund ai bleu tre kosha me rrush të kuq, i ngarkua mbi qerre dhe morëm rrugën e kthimit. «Mos u kurse fare, - më thoshte Sotiri, - ha rrush sa të duash, se agai ka». Unë s'kisha parë kurrë kaq thosha me veten time, - kush e di ç'bëhet prapa atyre mureve».

Nganjëherë Sotiri nga penxherja e dyqanit më thosh: «Ja, ky është Qemal bej Vrioni, ky është Kahreman Beu, na e rropnë lëkurën». Ku t'i shkonte në mendje fshatarit myzeqar, Sotirit, se çuni me të cilin po bisedonte dhe ai po i hapte zemrën, do t'ua merrte hakun atij dhe gjithë fshatarëve të Myzeqesë, duke u prerë kokën Qemal Beut dhe gjithë bejlerëve të Vrionit dhe se të tjerët do t'i shfarosnim përgjithmonë? Por kërdua do të bëhej më vonë kundër feudalëve shumë rrush. Hëngra disa kopanë sa u vela. Ky udhëtim në Myzeqe mbeti i paharruar për mua, siç më ka mbetur në kujtesë edhe një dasmë.

Sotiri më mori edhe një herë tjetër, vajtëm në një fshat, më duket në Marinëz, ku bashkë edhe me kushëririn dhe shokun tim të vegjëlisë, Sado Gamin, morëm pjesë në dasmën e djalit të xha Janit, që më duket e quanin Joti. Prapë ia hipëm qerres. Më kujtohet si tani toka e çarë atë vit nga thatësira, një numër kasollesh me baltë, fshatarë të ulur grumbull në shesh, në baltë, që pinin dhe këndonin. Ngandonjëherë ngriheshin dhe kërcenin. Unë rrija në një sofër me Sotirin dhe ia bëja «eeee», kur dasmorët këndonin. Që atëherë më pëlqeu e më pëlqen shumë kënga dhe vallja myzeqare. Fshatarët ishin të dashur, herë pas bere më përkëdhelnin e më përqaфонin dhe një plak bënte ç'bënte, më vinte takijen e tij mbi kokë e më thosh: «Do të të bëj myzeqar».

Kur bëhej pazari në Fier, unë kisha shumë qejf të veja të shikoja, shëtitja sa andej-këtej, i pyesja fshatarët «sa e shet këtë» «sa e shet atë», por nuk kisha gjë për të blerë. Ngandonjëherë nëndajkoja më jepte ndonjë lek dhe me ta blija fruta. Ditën e pazarit vinin shumë fshatarë në këtë qytet. Pazari bëhej afër shtëpisë së pashës së Vrionit, ishte në një shesh, ku kishte dhe disa pemë të larta me hije. Nga njëra anë e pazarit ngriheshin muret e larta që rrethonin bahçenë dhe pallatin e pashallarëve,

mure të errëta dhe misterioze për mua, asgjë nuk dukej nga jashtë, veç pemëve të larta. «Këtu rrinë gjakpirësit e popullit,

FURRXHINJTË E MËHALLËVE

E çuditshme mund t'u duket disave, që unë mendoj dhe shkruaj për furrxhinjtë e Gjirokastrës, që kanë jetuar e punuar të paktën 60-70 vjet më parë. Po ja, kështu është! S'më rrihet. Kam një dashuri dhe një nostalgji për këta njerëz të thjeshtë të popullit. Ata ishin punëtorë të zjarrit, të flakës, të tymit, ishin të nxirë nga fytyra dhe nga rrobat e punës, por zemrat e tyre rrihnin si e si të kënaqnin gjithë njerëzit e mëhallës ku punonin. Asnjëri nuk i thoshte furrxhiut se ishte «njeriu më i afërt» i tyre, shumë as e mendonin dhe as e kuptonin këtë çështje njerëzore dhe reale. Furrxhiu? «Hajde, me, një palo furrxhi është, r_a pjek bukët dhe ne e paguajmë për këtë». Furrxhiu nuk thirrej veçse rrallë e tek në dasma, në ziafete o në ndodhira të tjera dhe si për mëshirë. Zakonisht i dërgohej këtij nga një çanak kabuni, një copë mish i pjekur nga dora e tij dhe me kujdesin e tij, mbi këto i vihej edhe ndonjë thelë bakllava dhe «hajde, mjaft i kish!». Shumë herë ai vetë as i shijonte fare.

Ky njeri i mirë, i thjeshtë e i dashur nuk bënte fjalë dhe, pranë derës së furrës nga dilte afshi i zjarrit, e hante atë çka i dërgonin ose e ruan te dhe, kur mbyllte furrën në mbrëmje, ashtu i lodhur e i nxirë nga tymi dhe me trup të djersitur, hidhte pallton në sup, merrte çanakun e «dasmës» dhe e çonte në shtëpi ta hante me gruan, nënën, motrën e fëmijët. Që të gjithë pritnin nga duart e tij ! Ai sa cimbiste nga një çikë dhe ua linte të vegjëlve hisenë e tij. Për vete furrxhiu mjaftohej me një copë kur -ç misri të fortë, që e priste thela-thela, nxirrte prushin nga gjirra e patit të vogël ku rrinin, vinte cimbidhin mbi to dhe shtronte fetat e kulaçit, i thekte, i shkrifëronte, i skuqte, disa herë edhe i digjte, por i bënte të shijshme. Dhe kështu furrxhiu, miku më i mirë i popullit të mëhallës, pinte nga një gotë raki për të hequr mërzinë e për t'u çlodhur, hante kafshata-kafshata kulaçe me një çikë djathë e një qepë të thatë si meze dhe mendonte dertet dhe hallet e tij, që ishin si hallet e gjithë popullit.

Kur flas për furrxhinjtë, mendja më shkon te një kujtim i jetuar, i largët, i lashtë, që lidhet me furrxhi Dautin, i cili pranë oxhakut thekte copën e kulaçit. Mbiemrin atij nuk ia mbaj mend, por di që e thërritnim Dauti i Çiçimakos. Çiçimakoja ishte mëma e tij. Kështu e thërriste furrxhiun aneja, kështu e thërritnim edhe ne, fëmijët e saj.

Dauti i Çiçimakos ishte furrxhiu i furrës së Mamanit, mu në Sheshin e Zemanit. Lidhur me këtë emër më ka mbetur në kujtesë një ngjarje me Sanon, kur ishte e vogël. Aneja na dërgonte me kokorthe në kokë për të shpënë gjërat për t'i pjekur në furrë. Siç duket, Sanos, duke i rënduar vazhdimisht tepsia në kokë, i qe ngulur në mendje emri i furrës Mamani dhe, kur vajtën për herë të parë në shkollë, të zëna dorë për dore me Balen dhe mësuesja që do t'i regjistronte i pyeti për emrat, Balja, çupa e baba Cenit, xhaxhait tonë, iu përgjigj asaj: «Më quajnë Bale Hisenj Hoxha», kurse Sanoja i tha: «Më quajnë Sano Halil Mamani». Mësuesja ngriti kokën, hapi sytë e çuditur se i njihte dhe u tha: «Si është e mundur që keni dy mbiemra të ndryshëm, kur ju jeni bila Hoxhate?». «Hoxha më thonë dhe mua, po çoj bukët e i pjekim te furra e Mamanit». Mësuesja ishte Urani Rumbo. Ajo qeshi me naivitetin e vajzave të vogla.

Furrxhi Dauti i Çiçimakos, një mesoburrë, më shfaqet edhe tash pas kaq dekadash në kujtesën time te dera e zjarrtë e furrës me llërë përveshur dhe vetëm me një kë mishë, pse për të dimër behar ishte kurdoherë v apë e madhe. Ai mbante disa copa paçature në një dorë dhe në tjetrën herë një kanxhë, herë një lopatë me bisht të gjatë.

Xha Dauti ishte mbreti i furrës, si Qato evgjiti mbret i farkës. Ai ishte «perëndia» e zjarrit. Hija e tij binte e zmadhohej mbi shtratin e gjerë dhe të gjatë me dhoga të nxira të furrës, që mbushej dinga me lloj-lloj enësh kuzhine: mamaca me bukë misri të ardhura dhe të trasha, me tepsi të holla me qollopita, me shapkate, me laropita, me byrekë me djathë ose lakrorë me mish me thembra të ngritura rreth e rrotull e të mbushura në mes me qepë të thata e të grira e me copa mishi të vogla.

Në shtratin e furrës shihje lloj-lloj tepsish të vogla e të mëdha me kulaçe prej misri, të qëndisur artistikisht me thikë në katrorë ose në rrathë, në to, ngandonjëherë, edhe nga një vizatim i bërë me majën e lugës. Kështu i qëndiste ngaherë aneja kulaçet. Në shtratin e furrës shihje gjyveçë «me veshë e pa veshë» me birjane të ndryshme me zarzavate, me mish e pa mish dhe kur këta ishin me oriz, këtë xha Dautit ia çonim veç në një gotë ose në një çafkë që t'ia hidhte birjanit kur duhej.

Mërzia jonë ishte vetëm kur çonim dhe merrnim tepsitë nga furra. Këtu ishin edhe zënkat me Haxhon, Balen dhe Sanon. Jo «shpjere ti», jo «pse ta shpie unë?».

«Hë, hë, - më thoshte mua aneja, - lëri llafet, do të shkosh ti, se je djalë!» dhe, para se të veja në shkollë, më rraste mbi kokë mamacën. Atëherë unë, dulce e mbajtur tepsinë me të dyja duart në ekuilibër, se mos më derdhej ose më binte, zbrisja sokakun plot me gurë, një sokak i ngushtë nga të dyja anët me mure të larta, nga një anë ai i kopshtit të Çoktanit, ku hanim mana dhe kumbulla, pse teto Zurkon e kishim gjitone me portat karshi-karshi dhe nga ana tjetër muret e shtëpisë së Lame Calit dhe të mësuesit të vjetër patriot nga Cipat. Pastaj rrëshqisja në mes të poplave nën haurin e labes Venetike, nëna e «labushkës» Hasibe, siç e thërritnim shoqen time dhe të Sanos, me të cilën luanim çdo ditë dhe e kishim si motër.

Zbrisja pastaj nën shtëpinë e xha Iljaz Hoxhës, njërit nga mësuesit e mi patriotë, nga të parët mësues të gjuhës shqipe në Gjirokastrë dhe andej dilja te furra e Mamanit. Me të shpejtë e lëshoja tepsinë mbi shtratin e furrës, se mos më ikte koha e shkollës dhe i bërtisja xha Dautit: «Prura bukën!» ose «Prura kulaçin!», si të qëllonte. Ai herë-herë s'na përgjigjej fare, nganjëherë, kur ishte me inat, na bërtiste: «Nuk e sheh, m'u prish puna se e solle ti kulaçin!». Kur venim ta merrnim të pjekur, si të qëllonte, herë kishte dalë nga furra e herë jo. Kur kishte dalë, hidhnim sytë dhe kërkonim gjënë tonë. Kurrë s'gabonim, por xha Dauti nganjëherë bërtiste: «Kujdes xhanëm, mos na ngatërroni tepsitë, pse hajde merru vesh pastaj me gratë!».

Kur në dimër bënte ftohtë e frynte thëllimi, ne futeshim në furrë, ku ishte aq ngrohtë dhe javash-javash si macet, pa zhurmë, i afroheshim zjarrit të furrës. Xha Dauti i Çiçimakos bënte sikur s'na shikonte, ai vazhonte të punonte, por, kur e shihte se shtoheshin dhe vëcër-vëcër e pengonim, ai thoshte me të qeshur, me atë gojë dhe fytyrë të skuqur dhe të djersitur nga afshi i furrës: «Largohuni, djema, se më bëtë vapë!». Kur ishte behar dhe pritnim të dilte furra, ne luanim në Sheshin e Zemanit me pllaka, arabadaulet ose si të qëllonte.

Të premtëve xha Dauti e mbyllte furrën, nuk piqte dhe këtë të gjithë banorët e lagjes e dinin. Atë ditë për të ishte pushim «pajdos», siç i thoshin atëherë.

Ky ishte Dauti i Çiçimakos, njëri nga furrxhinjtë e mirë të mëhallës së Palortosë, miku im i vegjëlisë, që më ushqeu kur isha i vogël, duke na pjekur bukët, dhe që ia di për të mirë, prandaj s'e harroj kurrë.

Nën mejtepin e vjetër, nën këtë ndërtesë të madhe të qytetit, nën këtë shkollë, pra, në rrëzë të murit të oborrit të saj, ndodhej dhe ndodhet akoma një furrë jo shumë e madhe, që në ato kohë e quanim «Furra e beut». E cilit bej ? Nuk e di.

Pas Çlirimit, unë jam interesuar se kush ka qenë furrxhi në këtë furrë. Më kanë thënë se atje ka pasë punuar Maloja i Zeres, shoku im i vegjëlisë, ndërsa tash furrxhi është Xhevat Avdalli, këngëtar i shquar i këngës labe gjirokastrite*. *(Më 23 mars 1978, shoku Enver Hoxha doli shëtitje nëpër sokakët e Gjirokastrës. Për këtë ditë, në Ditarin e Tij shkruan: «Dulce ecur nëpër rrugë arrita në krye të Sokakut të të Marrëve, ku më doli përpara këngëtari i njohur i këngëve gjirokastrite, furrxhiu Xhevat Avdalli. U përqafova me të dhe... ia morëm këngës: Dërgoi Gjoleka njerinë/ Lum' i Vlorësë të vijë/ Ç'u shkulën që në Radhimë...».) Këngët e Xhevatit, të Lavos, të Resultit, i kam në magnetofon, ato i dëgjoj herë pas here dhe kënaqem. Xhevatin e njoh si këngëtar të mirë, por besoj se është edhe furrxhi i mirë.

Kur hyje nga Sheshi i Kokonës furra kishte një korridor të vogël dhe në krah të djathtë të tij ishte një ndarje e vogël. Kjo duhej të ishte dhoma ku flinte furrxhiu. Ky ishte një burrë ndonja 45-50 vjeç, siç më kujtohet. Ishte dropullit dhe e quanin Jani. Nuk e di nga ç'fshat i Dropullit ishte, por familjes sonë dhe ne të vegjëlve as na interesonte nga ishte furrxhiu, nëse ishte i krishter o mysliman, ai ishte furrxhiu ynë; s'kishte rëndësi fare për ne që quhej Jani. E gjithë edukata jonë nga baba Çeni, xhaxhai, aneja, nënoja, dajkoja, nëndajkoja, ishte afetare.

Ne, të vegjlit, e kishim kurdoherë mirë me usta Janin jo vetëm pse ishte furrxhiu ynë që na piqte mamacen dhe qollopitën që e hanim të ngrohtë me aq qejf me djathë, mbasi kjo furrë ishte afër shtëpisë sonë. Ne nuk mërzhiteshim në këtë furrë, se nuk ishte aq larg, sa ajo e Mamanit, por ishte afër shtëpisë dhe shkollës. Dukë vajtur në shkollë s'na vinte rëndë të çonim edhe çfarë kishim për të shpurë në furrë dhe kur dilnim në drekë, ktheheshim me vrap, merrnim gjënë të pjekur dhe me vrap ia çonim anesë, se na grinte uria. Aq uri kishim kur dilnim nga shkolla, sa, kur hynim në furrë, harronim të mbyllnim derën. Mirëpo në dimër ishte ftohtë dhe bëhej korrent. Jani furrxhiu na bërtiste: «Pedhimu, mbylle derën se do të më beni oftika!». Dhe ne ktheheshim dhe mbyllnim derën se oftikanë e dinim që ishte një sëmundje e tmerrshme. Ne e donim furrxhiun tonë dhe s'donim kurrë të na sëmurej.

Por ne, të vegjlit e Hoxhatëve, e donim dhe na donte xha Jani edhe për një arsye tjetër, atë e donte baba Çeni dhe ishin miq. Baba Çeni, sido që ishte kryetar i bashkisë, ishte njeri shulrë i thjeshtë, ai i urrente agallarët dhe ishte «rrogos asqer» me vegjëlinë. Kur kthehej në mbrëmje nga beledieja, në xhep të xhybes kishte nganjëherë një shishe me raki dhe në një kartë shtupellë mbante të mbështjella disa mëlçiçka të zeza.

Baba Çeni kthehej te furra e Janit, hipte mbi shtratin e furrës, ulej pajdash, nxirrte shishen e rakisë dhe ia jepte Janit mëlçiçkat. Furrxhiu i vinte ato mbi prushet e furrës dhe fillonin e pinin që të dy me të njëjtën shishe, duke ngrënë mëlçiçkat e qepë të thatë si meze. Kur nxehej mullai, atëherë «me mjekrën e tij në luftë», me sarëkun në kokë, që ia nxinte tymi, fillonte të sharat dhe nuk linte gjë pa thënë kundër agallarëve: Karagjozatëve, Hasanajve, arkondëve, si: Papadhopullët, Litot, Lolomanët etj. Dhe kështu, kur shishja mbaronte, që të dy, furrxhiu dhe belediereizi, duke iu marrë këmbët, zbritnin Sokakurz e të Marrëve dhe venin në shtëpi. Te porta furrxhiu përpiqej t'i puthte dorën mullait, kurse ky e merrte për qafe furrxhiun, e puthte dhe i thoshte duke bërtitur: «Mos i puth dorën njeriut, ndryshe nuk të kam më mik!».

Ne nga brenda e dëgjonim poteren. Nënaja më thoshte: «Dil, Enver, merre babanë nga krahu, se do të thyejë kokën në shkalla». Kur hipte baba Çeni sipër, në divan, na puthte «mac e muc», na bënte gjithë jarga e lot, kurse nënosë i puthte dorën. Ajo serioze i thoshte:

- More Hisenj, more derëzi, kë ngjave këslltu, kishe një deli baba, nuk bën të piç me këta njerëz, se nuk është mirë. të shajnë!

Baba Çeni atëherë ë inatosej dhe i thoshte nëlâosë, po me respekt se e donte shumë:

- Po me kë të rri, me maskarenjtë si Hasanajt e si Sami Karagjozi me shokë? Jo, Jeko, unë do të rri me zuzarët, me brazhnjarët, me jevgj, me kasapë, me furrxhinj, pse këta janë njerëz të mirë, të thjeshtë. Unë e di sa lodhen gjithë këta duke punuar dhe meójithatë nuk nxjerrin dot as bukën e gojës, kurse ata, të tjerët, janë veshur me cohë, kanë potina me sumbulla dhe rrinë e heqin tespitë.

Dhe pas gjithë këtyre të sharave baba Çeni lukuriste mbi agallarët e Gjirokastrës shpellën e madhe (thoshte një fjalë që unë s'po e shkruaj). Nënaja ulte kokën dhe thoshte: «Ç'na gjeti me këtë!».

Kurse ne të vegjlit qeshnim, e gëzonim babanë, i nduknim dhe i fshinim mjekrën. Baba Çeni na puthte dhe vazhdimisht duke qarë na thoshte: «I vritni ata qena kur të rriteni!». Nënosë nuk i durohej, kërcente dhe i thoshte: «Ooo! Aferim Hisenj, ç'janë këto që thua para fëmijëve? Enver, të keqen, - më thosh mua, - mos e dëgjo babanë, se ai nuk di se ç'thotë!».

Aneja e merrte baba Çenin për qafe, i fshinte lotët, i lante fytyrën me ballomë të lagur, e zhvishte, i vishte sadenë e natës dhe, ashtu siç ishte, shumë herë e zinte gjumi mbi minder. Ne e mbulonim me jorgan, i vinim një vito me fyt plot me ujë afër dhe e linim të flinte.

Këto janë disa kujtime për furrxhiun tjetër tonin, furrxhi Janin. Sjell tash në kujtesë se si në mbrëmje, kur zbrisja nga Kuculla, ku luanim, dhe dulce kaluar nëpër lukuramën nga shtëpia e Kamber Bilalit, shokut tim, nga shtëpia e Muharrem Qemos, dilja pastaj në rrugën e furrës, gjeja atje usta Janin të mbështetur në penxherenë e furrës që pinte cigaren e dredhur dhe ëndërronte! I thosha «natën e mirë, usta Jani» dhe ai ma kthente: Orakali pedhimu*.*(Udhë të mbarë, djali im)

Ai e dinte kur kthehej baba Çeni në shtëpi dhe nga penxherja e furrës i thoshte:

- U ktheve, mulla?

- U ktheva, bëfsh gjumin e mirë, usta Jani! - i thoshte babai.

Dhe tash në këtë moshë, si nipi i baba Çenit, ndiej kënaqësi që si djalë i popullit dhe ushtar i Partisë, bëra edhe unë diçka për popullin tim të mirë e trim, për bijtë e bijat, për nipërit dhe mbesat dropullite të usta Janit, vëllezërit dhe motrat tona dropullite, pjesëtarë të barabar të në detyra dhe në të drejta në atdheun tonë socialist.

Familja jonë, kur qëllonte që mbylleshin për një arsye o një tjetër të dyja furrat që përmenda më lart, bukët i piqte edhe më larg, te furra e Angonatëve. Kjo furrë jo e madhe ndodhej afër portës së madhe të bllokut të shtëpive të Angonatëve, ngritur mu në këmbët e një ure të vogël, mbi një përrua që zbriste i rrëmbyer së larti nga mali, përrua që kalonte në mes të lagjes së D_unavatit të Sipërm. Ky përrua sillte gurë, shpella, pemë të shkulura, me një fjalë, çdo gjë që gjente përpara. Urat ngandonjëherë i merrte, ngandonjëherë ua shalonte, po kjo ishte qederi i beledies. Vetëm furrës nuk kishte ç't'i bënte përroi, por zhurma, ama, i çante veshët furrxhi Shabanit. Këtë ne nuk e kishim aq të afërt si dy furrxhinjtë e tjerë. Kush e di, kjo mund të vinte edhe për shkak se furra ishte larg dhe t'i bije e t'i shpije kaq larg kulaçet na e sillte shpirtin në majë të hundës, gjë që na e bënte të largët edhe furrxhi Shabanin. Ky ishte ca nevrík, nuk qeshte kurrë. Njeri i keq nuk ishte, por vogëlsia e shtratit të furrës mundet që ia «ngushtonte» ca edhe zemrën, pse na bërtiste: «Hajde, lini llafet, merrni ç'u përket dhe ikni se s'kam ku të vë tepsitë!», ose «Hajde, rrini jashtë!».

- Po bie tello, xha Shaban, - i thoshim ne, - kur binte shi.

- M'u prish puna mua, - na e priste ai.

Dhe ne, të qullur, kush me thes në kokë të bërë si kaçule, kush duke hedhur cepin e palltos në kokë, dilnim jashtë dhe grumbulloheshim kokë më kokë nën çatinë e portës së madhe me sufa të Angonatëve.

Edhe kur banonim për një kohë në Cfakë, nga furia, natyrisht, nuk mund të shpëtoje. Ajo «shyqyr» nuk ishte dhe aq larg nga shtëpia. Kur zbrisje, ishte mirë, por kur e ngjisje me tepsi, me zimbilen e zarzavateve që nga panari dhe me çantën e shkollës, atëherë djersije. Por të rinj ishim, s'donim t'ia dinim.

Furrxhiu quhej xha Bastri, ishte burrë i shkurtër, me një mustaqe të vogël të zbardhur si leshrat dhe të zverdhur mbi buzë nga cigari që e pinte me një çibuk të vogël të verdhë me «qelibar», siç thoshte ai. Sido që mesoburrë, ai ishte i shkathët, tepsitë i përpikte sa mundte, kur i nxirrte nga furia, i vringëllonte mbi shtrat, se edhe digjnin e përvëltonin.

Në Hazmurat kishte dy furia jo larg njëra-tjetrës, njëra ishte e xha Abaz Cuçit dhe tjetra e Bido Çanos.

Tek e para ne venim e vinim kur ishim të vegjël, pse furra e Çanos, që ishte afër shtëpisë së dajkos, nuk ishte e hapur dhe kjo e detyronte nëndajkon të piqte te furra e Abazit.

Furrxhiu i xha Abazit, Kola, e donte nëndajkon, e respektonte, po ia kishte edhe frikën, pse ajo nuk përtonte të hidhte shallin në kokë dhe drejt e te Kola, me të cilin grindej. Kola i thoshte: «Mirë moj teto Hasije, ja, u dogj dreqi, se i hodha furrës ca dru më shumë», ose «duhej ta kishe dërguar më parë dhe jo aq vonP» etj. Edhe xha Kola nuk mbetej pas nga arsyet, ai i përcillte njerëzit, por sidoqoftë me teto Hasijenë bënte ca kujdes, dhe ne, të vegjëlve, kur venim merrnim gjërat në furrë, na thoshte: «Me Açenë mos i zer lopët, lere, të tundësh këmishën, asgjë nuk i shpëton asaj».

Të bëhesh furrxhi, mund të bëhesh, por të jesh me të vërtetë i tillë, nuk është punë e lehtë. Zanati është i rëndë dhe jo sidokudo, duhen vite pune që të fitosh. Të gjithë furrxhinjtë që tram njohur në rininë time kanë qenë burra të moshuar dhe medoemos duhej të kishin eksperiencë të madhe. Nuk ishte punë e lehtë, sic e kuptoja unë atëherë zanatin e furrxhiut me mendjen time të vogël, kur prisja të dilte tepsia nga furra dhe, i mbështetur në shtratin e saj, rrija e mendoja duke bërë sehir furrën që skuqte nga zjarri dhe Kolën duke punuar.

Ç'kuzhinier i mbaruar duhej të ishte furrxhiu! Ç'kuzhinë të madhe i kishin lënë në duar xha Kolës! Nga zotësia dhe dora e tij vare] kënaqësia në familje! Ishte buka e çdo dite! Buka! Buka! I tërë populli ynë çdo gjë e lidh me bukën. «Dua bukë», «S'kam ngrënë bukë», «Shkojmë të hamë bukë», «Mbaruam bukë» etj. Kurdoherë «bukë»! Në çdo cast «bukë»! Kur mblidheshim në sufra na mësonin «Mos e bëni bukën thërrime!», «I mblidhni thërrimet e bukës dhe i futni në gojë!», «Bukën e puthni dhe e vini në ballë, para se ta hani!». Dhe bukën na e piqte furrxhiu i mirë dhe ky furrxhi i

mirë, ky kuzhinier i madh i gjithë mëhallës, ishte më i varfri, më i rraskapituri, që shumë herë flinte mbi shtratin e furrës, shumë pak njerëz kishin konsideratë për të.

Ju dua dhe ju respektoj shumë, furrxhinj, ngado që jeni, kudo që punoni. Ju tram dashur edhe kur tram qenë i vogël dhe i ri, por tash e kuptoj si duhet sa vlerë të madhe treni ju, punëtorë nga më të mirët të zjarrit e të flakës.

Plaku xha Abaz Çuçi, pronar i furrës haur, ku piqte xha Kola, ishte një burrë i shkurtër me leshra të bardha, që i rrinin përpjetë, me mustaqe të bardha, me një palë syze të vogla të lidhura me tel. Xha Abazi ishte fytyrëvogël, shurdh nga veshët dhe sahatçi me zanat. Ishte njeri i mirë. Ai e donte xha Kolën, na donte edhe ne, pse ishte kushëriri i dajkos dhe i anesë sime. Kur kthehej nga dyqani i vogël, ku rregullonte sahatet e popullit, kalonte nga furra, përshëndetej me furrxhiun dhe nuk mungonte ta pyeste:

- Kolë, si të ecën qepa? (sahati i xhepit).

- Shumë mirë Abazo, - i përgjigjej Kola.

Kur binte shi dhe dilte nga shtëpia në furrë, xha Abazi, që të mos i lagej koka e thinjur, vinte në kokë një bragaç të zi me grykë të gjerë si kaskat e gjermanëve dhe vegën e tij e shkante nën mjekër, sikur të ishte rripi i kaskës.

Më kujtohet një ditë kur rrija mbi minder në hajat afër tij dhe i them:

- Xha Abaz, edhe unë e dua xha Kolën si ti.

- Pse e do? - më pyeti plaku.

- Se na pjek mirë bukët dhe byreqet që na bën aneja.

- Dëgjo këtu, o djalë i vogël i Gjulos, - më tha xha Abaz plaku. - Në botë tra njerëz të mëdhenj e të vegjël. Këta janë si aletet e sahatit që punon. Unë i njoh mirë këto alete, më kanë dalë sitë duke punuar. Më tre parë kur tre ardhur në duqanin ku punoj tok me Eqremin? Vë një dulbi të vogël në si, pse vetëm ajo më zmadhon aletet e vogla. Këto alete të vogla janë shpirti i sahatit, jo pllakat e mëdha. Sahati pa aletet e vogla nuk punon, po u thie «qimja», s'punon sahati, po u ça pllaka e madhe, as prish punë shumë, sahati prapë ecën. Kola është «qimja». Ja pse e dua unë furrxhi Kolën, - më tha xha Abaz shurdhi e mendjemprehti.

Unë hapa sytë dhe me mendjen time thashë: «Xha Kola «qime»!»! dhe i habitur shikoja plakun. Ai më kuptoi dhe me dorën e tij të vogël, me gishtërinj të hollë, më gëzoi kokën dhe më tha:

- Djali i vogël i Gjulos, mbaji mend këto fjalë të xha Abazit, paçka se s'i kupton si duhet tani, do t'i kuptosh më mirë më vonë, kur të rritesh!

Tash, i dashur dhe i nderuar xha Abaz e-uçi, të kujtoj me mirënjohje të thellë, kujtoj dhe kuptoj filozofinë e thellë të fjalëve të tua të thëna në gjuhën e popullit, mbi vlerën e madhe dhe vendimtare në zhvillimin e shoqërisë dhe të përparimit të shtresave të vegjëlisë, të popullit. Mirënjohje të pafund nga unë, për ty dhe për shumë të tjerë si ti, që më mësuat qysh kur isha i ri të dua vegjëlinë dhe t'i shërbej asaj me besnikëri derisa të kem jetë.

Kalonin vite dhe unë rritesha, veja rregullisht në lice dhe mësoja. Bota, jeta, njerëzit më dukeshin ndryshe, i shikoja me sy tjetër, gjykoja më me pjekuri për çdo gjë, horizonte më të gjera po na hapnin çdo ditë shkolla dhe mësuesit tanë. Mendjet tona, mendimet tona, dilnin nga rrethi gjirokastrit. Ne njihnim tash më mirë e me gjerë historinë e madhe të popullit tonë, trimëritë e tij, luftërat e Skënderbeut, të rilindësve, të Bajos e të (erçizit. Ne mësonim këngë që i këndonim labçe dhe shkollarçe, mësonim gjeografinë e vendit dhe të botës. Mendja jonë shkante edhe më larg atdheut. Ne mësonim gjuhën frëngjishte, historinë e popullit francez, mësonim matematikë etj., etj. Kur u larguam nga mëhalla e Cfaqës dhe erdhëm në Hazmurat, unë isha më i rritur, familja ishte më e varfër, por njohuritë në trurin tim qenë më të gjera.

Jeta në Hazmurat dhe marrëdhëniet me xha Kolën ishin si ngahera shumë të mira. Xha Kola u bë mik me xhaxhanë, flitnin dhe greqisht me njëri-tjetrin, pse plaku im dinte edhe greqishten, edhe turçen. (Një tog me libra turçe të tij i ruajmë si kujtim në shtëpi.)

Më kujtohet një ditë kur vajta në furrë. Gjëja jonë nuk kishte dalë akoma nga furra; xha Kolë furrxhiu ishte më nge dhe, i mbështetur në të dy krahët mbi shtratin e furrës, filloi të më pyeste:

- Është e rëndë gjuha frëngjishte për të mësuar, c Enver?
- Nuk është e lehtë xha Kolë, po është gjuhë e bukur, duhet të mësojmë çdo fjalë hezber, ta mbajmë menti dhe të dimë ta përdorim.
- Çdo gjë do zanatin e vet, - tha Kola. - Edhe puna e furrxhiut është një zanat jo i lehtë. Po, pa më thuaj, o djalë, - vazhdoi Kola, - si i thonë bukës në frëngjisht?
- Pen (pain).
- Po ujit?
- O (eau).
- O! O! Çudi! - tha Kola, - është e lehtë ta mbaç mend këtë fjalë. Ne punëtorët që na dhemb mesi na puna, themi nahera oh! oh!, po edhe gjirokastritët që vuajnë për ujë, munti ta mbajnë mend fare mirë këtë fjalë, se nahera e çdo orë holasin dhe ata. U dhemb dhe u ka ardhur shpirti në hundë.
- Mirë, mo Enver, por birjanit si i thonë në frëngjisht? - më pyeti më tej xha Kola.

Këtu ngeca.

- Ah, nuk e di këtë, xha Kolë.
- Po shapkatit, laropitës, i di?
- Jo, edhe këto nuk i di.

Xha Kola më vështroi në sy dhe më tha:

- Shih djalë, vuru veshin mësimëve, duhet të mësoç, se presin plaku dhe plaka nga ti!
 - Si urdhëron xha Kolë, - i thashë, - mora tepsinë dhe ika kokulur, provimin nuk e kalova mirë.
- Furrxhiu është njeriu më i afërt i familjeve të mëhallës ku punon. Shumëve nuk u shkon në mendje një gjë e tillë, po furrxhiu rron me hallet dhe me gëzimet e të gjithë njerëzve të mëhallës. Ai gëzohet me ta dhe qederoset për ta jo vetëm që Vi kënaqë duke u pjekur mirë gjellët, por zanatin e lidh me ndjenjat, me sentimentet, me gëzimet dhe me hidhërimet e njerëzve.
- Më tepër se gjysmë shekulli ka kaluar, por këto gjë- a të pakta që them, dalin nga zemra dhe janë të vërteta. Të K gjitha i kujtoj me nostalgji, të gjithë i kujtoj me respekt të madh dhe me mirënjohje, pse kanë qenë punëtorë, pr oletarë nze gjithë kuptimin e fjalës.

MJE SHTËR TË GURIT E TË HEKURIT

Në oborrin e shtëpisë së dajkos ishte hauri dhe odajashta, e cila përbëhej nga dy oda të mëdha, që i kishin penxheret mbi bahce, nga një pat i futur përposh, si dhe nga një katua i vogël. Që në kohën e vegjëlisë sime, gjatë rinisë dhe deri në kohën e okupacionit, kur çdo gjë u dogj, në shtëpinë e dajkos dhe në kthinat rreth e rrotull saj, tërë jetën kanë banuar muratorë, «mjeshtrit», sic i thërritnim. Këta njerëz kis'hin ardhur me familje nga fshatrat e Oparit të Korçës dhe ishin vendosur në Gjirokastër. Ata ishin proletarë të vërtetë. Të tërë, me burra, gra dhe fëmijë, ishin nga njerëzit më të dashur dhe më të ndershëm që kam njohur në jetën time, që nga koha e vegjëlisë dhe e rinisë.

Mjeshtrit, burrat dhe «mickët», fëmijët e tyre, të cilëve prindërit zakonisht u mësonin zanatin e muratorit, ishin duarartë. Ata ishin me famë në Gjirokastër, ndërtonin shtëpitë me gurë, zinin pikat e çative, ngrinin muret e oborreve kur rrëzoheshin, r ropateshin tërë ditën, ngriheshin që pa gdhirë dhe ktheheshin në familje vonë, natën. Ata ishin njerëz nga më të mirët të Gjirokastrës, nga më të ndershmit, nga më të domosdoshmit, por ishin edhe nga më të mjeruarit nga ana ekonomike, punonin vetëm për bukën e gojës dhe shumë herë as këtë nuk e nxirrnin. Ata konsideroheshin nga agallarët e Gjirokastrës si njerëz të shkallës së fundit të shoqërisë. Me muratorët, si edhe me evgjitet, familja ime dhe unë kemi jetuar dhe kemi kaluar tok gëzimet dhe hidhërimet e jetës, kemi qenë si një familje me ta.

Me mirënjohje të pafund unë i kujtoj këta proletarë, plakun usta Leko dhe gruan e tij, teto Maron, teto Ninen dhe dy dje-mtë e saj, usta Xhoxhin, usta Tasin dhe nusët e tyre, usta Xhelin, usta Vasilin dhe gruan e tij, Katen tonë të dashur, dy djemtë e dy vajzat e saj që ishin më të vegjël se ne dhe, më në fund, atë që kisha më afër, usta Mihalin, djalin e usta Lekos e të teto Marës, shokun tim të vegjëlisë (megjithëse ishte ca më i madh se unë), shokun tim të Partisë.

Këta muratorë proletarë më kanë lënë mbresa të pashlyeshme në ndërgjegje dhe kanë ndikuar në formimin e karakterit tim. Me të gjithë këta nuk kishte dallim në familjet tona, nuk kishte mure që të na ndanin, nuk kishte dyer të mbyllura, nuk kishte dasi shoqërore, midis nesh nuk bëhej dallim në myslimanë e të krishterë, nuk kishte fanatizëm sa të fshiheshin gratë e njëri-tjetrit nga burrat e këtyre familjeve. Mihali ishte si vëllai ynë, Xhoxhi dhe Tasi po ashtu, për këta motrat e mia ishin si motrat e tyre. Maroja, Ninia, Katja ishin për mua si aneja. Usta Lekon dhe të tjerët i kisha si xhaxhanë.

Të gjithë këta mjeshtër të gurit u hodhën në Luftën Nacionalçlirimtare tok me fëmijët e tyre, me vajza dhe me djem.

Kur mbarova qytetësen dhe në vjeshtë do të hynim për herë të parë në lice, unë rashë sëmure. Nuk më kujtohet nga çfarë sëmundje, por u bëra keq, për vdekje, siç thotë aneja. Mezi më shpëtuan. Aneja, xhaxhai, vëllai, Ninia, Katja u bënë copë. Doktor Harxhi, që rrinte afër nesh, vinte më shikonte dy herë ditën. «Na rropi doktori, gjithato napolona flori i dhamë përnjëherë, - më thotë aneja, - por të shpëtoi, ishte doktor i zoti». Unë, më kujtohet, isha shtrirë i sëmure në patin e madh përposh, kurse vëllai kishte zënë dyshekun sipër. Për shumë net me radhë, siç më thonë, unë isha në «bethoj», pa ndjenja, vëllai lart në odën e madhe kollitej, kollitej, kollitej.

Aneja u copëtua e mjera, atë e ndihmonin në punë edhe ditën, edhe natën Katja me Ninen. Në kohën e sëmundje: sime Ninia plakë, më kujtohet, veshur me të zeza ng, koka në këmbë, me trup të vogël, me sytë e saj të përlotur e me qepalla të kuqe, kjo bijë, grua dhe nënë e mjeshtërve proletarë, më ruante tërë natën mbi kokën e jas. tëkut. Ajo i thoshte anesë: «Shko fli ti, se e ruaj unë Enverin natën». Dhe ajo rrinte tërë natën pa gjumë, heri më vinte ballomat me ujë në kokë, kur më hipte temperatura, herë më fshinte djersën, herë më mbante kokën kur më dhimbe. Ngandonjëherë i mbylleshin sytë ng, pagjumi dhe mua më vinte keq kur e zgjoja: «Nine, du, ujë, se plasa». «Mirë të keqen, - thoshte plaka, - të je! Ninia». Kurrë nuk mund të shlyhen nga mendja dhe ngE zemra këto kujtime dhe këto janë ato gjëra që lënë mbres., të thella në ndërgjegje dhe mbruhën me karakterin njeriut.

Kur kujtoj njerëzit e thjeshtë nuk mund të lë pa përmendur edhe kovaçët, këta mjeshtër të hekurit, që bënë një punë të rëndë, por aq të nevojshme për fshatarët dhe qytetarët. Me vare në duar ata i binin fort hekurit në farkë, e skuqnin atë në zjarr, e kthenin për ta bëri si u duhej, e futnin në ujë, e kalitnin, kaliteshin dhe vetë

I kam si tanfi parasysht kovaçët e Gjirokastrës. Karr. folur diku për Qaton, për kovaghanën e tij si për shtëpinë që e kishte sa kaloje dyqanin e Shaban Gegës. Por tan; dua të bëj disa shënime për kovaçin Aziz Buduku, që ishte mik i familjes sonë.

Xha Azizi ishte kovaç dhe armëndr eqës. Dyqanin E kishte mu në mes të shkallëve afër prefekturës, në një bodrum plot lagështirë. Në dyqan ai kishte një farkë të vjetër, një mengene, një trapano të vjetër, disa çekiçë, një vare, ca cimbidhe, disa lima dhe asgjë tjetër. Ai bënte me to çdo gjë prej hekuri, ndreqte edhe pushkët E vjetra. Xha Azizi ishte burrë i shkurtër, me vetulla e më duar të trasha. Kur e shihje për herë të parë, të frikësonte, po herën e dytë e kuptoje sa njeri i mirë ishte, sa i dashur dhe sa i drejtë. S'e hiqje nga mendja xha Azizin.

Aneja thoshte: «S'ka burrë më të mirë se çelo Azizi. ai është <doktor> i mbaruar, se më shpëtoi vajzën (Haxhon)». Haxhoja kishte thyer këmbën dhe xha Azizi i bëri një këpucë me hekura.

Unë veja shpeshherë në dyqanin e xha Azizit dhe drejt e te farka: merrja zinxhirin dhe fryja kaçupët që ndiznin qymyrin. «Jepi, se po skuqet hekuri», - thoshte plaku dhe, kur hekuri skuqej, e mer rte atë me cimbidhe, me një dorë e mbante dhe me dorën tjetër i binte me ritëm me çekiç ai dhe Shabani. Kur mbaronin, atëherë unë merrja një çekiç të vogël dhe i bija mengenesë kot, sa për të bërë zhurmë. Herë-herë dridhja në boshllëk dorën e trapanos. Xha Azizi më linte, nuk më pengonte në punën time.

Shtëpinë xha Azizi e kishte nën xhade, në një brokërimë që rrëshqiste në çezmat e Meçites, afër shtëpive të Harxhit, nën shtëpinë e Sabri Kallajxhiut. Unë veja ngandonjëherë atje, se më merrte aneja më vinte përpar a, kur shkonte të vizitonte teto Fekon.

Zakonisht që andej shkonim te dajkua, né Ha zmurat, zbritnim né Meçite, dilnim te Xhanoja e Përroit, ngjiteshim nga shtëpia e teto Shekos (motra e anesë), ngjitnim sokakun e Shahin Karagjozit e të Idriz Konjarit dhe dilnim né rrugë të madhe. Atje lart, né majë të bregut, ishte shtëpia e nëndajko Hasijesë.

KËNDO TANI O SAHAT*

*(Letër dërguar nxënësve dhe mësuesve të shkollës së mesme të përgjithshme «Asim Zeneli», Gjirokastrë.)

Të dashur xha Thoma Papapano* *(Thoma Papapano, basho Thomai ose xha Thomai - mësue patriot, një nga pionierët e shkollës shqipe në Gjirokastrë, mësues i gjuhës i shokut Enver. Në kohën që ëërgohet letra, xha Thoma ndonëse në moshë të thyer vazhdonte të jepte mësim né shkollë e mesme të përgjithshme «Asim Zeneli»), nxënës e mësue të gjimnazit «Asim Zeneli»,

Ju falënderoj nga zemra që më kujtoni, por edhe unë kurrë s'ju harroj. Kërkesën që më keni bërë dhe që ma ri për sërtni, ju siguroj se nuk e kam harruar. Zemrën e kan plot kujtime për shkollën time të parë, për mësuesit e m të dashur. Por dëshirën tuaj nuk jua plotësova më parë, j se përtoja të shkruaja, se shkolla ku unë mësova abëcën nuk na mësoi përtacë, por letrën time dëshiroja ta shoq, roja me diçka që më kërkoni, si të them me diçka që të plotësonte dëshirën tuaj dhe timen, me diçka që të m, kujtonte vegjëlinë time.

Ju e dini, xha Thoma, se 47 vjet kanë kaluar ng dita që kur unë u paraqita për herë të parë né bankën shkollës përpara jush. Një jetë e tërë ka kaluar, por dit, e parë e shkollës nuk harrohet. Né zemër ndieja gëzin të përzier me frikën e parë, por fjalët e ëmbla të mësue sit tim dhe copa e kulaçit të misërt me pak djathë e një qepë që mëma më kishte futur në qesen e librave, kur më përcolli për në shkollë, sikur ma ngrohni zemrën, ma hiqni ndrydhjen.

Furtuna kaluan mbi atdheun që nga ajo kohë kur ju, basho Thoma, hapët shkollën e parë shqipe në Gjirokastrë, dhe unë hapa për herë të parë sytë në jetë. Jeta e familjes sime dhe imja, si jeta e gjithë bashkëqytetarëve të mi, kaloi herë me brenga, herë me gëzime, por kurdoherë me shpresa për të ardhmen.

Ju e mbani mend, xha Thoma, kur neve na u dogj shtëpia në kohën e okupacionit të parë të grekëve. Unë atëherë isha i vogël, por mbaj mend se mëma, e llahtaritur, më shkundi nga gjumi dhe më shtyu përpara në mes të flakëve dhe të tymit për të më shpëtuar. Në shkallët që po digjeshin, nuk e harroj as tash, ktheva kryet dhe shikova mëmën në mes të tymit që në një sjetull mbante motrën time, foshnjë të vogël, dhe në sjetullën tjetër një sahat të vjetër që e ruante varur në odën e gjumit dhe që zilja e tij e zgjoi atë nga gjumi në atë natë të frikshme. Çdo gjë na e dogji zjarri, motra më e vogël na vdiq, por unë d:he sahati jetuam. Këtë sahat, të vetmen gjë të shtrenjtë që kam të familjes, po ia dërgoj shkollës sime të dashur, mësuesit tim të vjetër, nxënësve dhe mësuesve të rinj.

Të dashur shoqe dhe shokë të rinj, poet dhe shkrimtar unë s'jam, por, kur isha dhe unë i ri si ju, ëndërroja për poezi, për dashuri, këtë jua them se unë i besoj poetët kur ata thonë se edhe sendet kanë jetën e tyre dhe «ligjërojnë» historinë e tyre. Sahati që po ju dërgoj s'është v eç një mekanizëm i thjeshtë dhe i vjetër, i lyer me pak bojë për t'i fshehur pleqërinë, ashtu siç bërnin dikur nënat tona plaka që vinin këna në flokë për të fshehur thinjat e bardha. Sipas mëmës, ky sahat ka afro një shekuil që i shrben familjes sime. Një shekull s'është pak, por dëgjojeni me kujdes, ai këndon vazhdimisht si... bilbil. Mos t'ju vijë keq, i nderuari xha Thoma, edhe ju nuk jeni i ri, por zëri juaj vazhdon të këndojë si ngahera nga klasa në klasë, nga viti në vit për më shumë se 50 vjet me radhë vjershat dhe këngët e bukura të Naimit që i këndonte Shqipërisë dhe së ardhmes, këngët e fuqishme të punonjësve të rinj që ndërtojnë socializmin me vrullin rinor. Sahati që po ju dërgoj dhuratë, është i thjeshtë, por për mua është i dhembshur. Kur i mora leje mëmës që t'jua dërgoja juve, ajo më tha: «Hallall e pastë shkolla jote, dërgojua! Zilja e këtij sahati të zgjonte çdo mëngjes kur të nisja për shkollë, dhe shkolla ku ti mësove të hapi sytë. S'kemi tjetër gjë nga e kaluara t'u dërgojmë të rinjve

dhe të rejave, biro». Nëna ime më porositi t'ju them juve se ajo ju çon të fala dhe ju puth sytë. Ju këshillon të doni atdheun, popullin dhe Partinë si shpirtin, dhe të mësoni mirë e bukur. Ajo m'u lut, gjithashtu, t'ju tregoj juve edhe «jetën», historinë e sahatit.

«Ju thuaj djemve dhe bilave të Gjirokastrës se të gjitha gëzimet dhe hidhërimet e zemrës i ka parë dhe dëgjuar, na i di ki sahat i shkretë. Ki sahat ka parë mullanë të bisedonte fshehurazi me Cerçizë, me Duro Gurrë dhe Idriz Gurrë*. *(Duro Guri (1874-1930), Idriz Guri (1878-1941) - dy vëllezër patriotë, pjesëtarë aktivë të lëvizjes kombëtare në Gjirokastër, shokë të Cergiz Topullit, të njohur dhe për talentin e tyre si artistë, i pari piktor i dyti drugdhendës.) Tiktaket e sahatit rrihnin si zemrat tona dhe të gjithë gjirokastritëve, kur mullai iu përgjigj ultimatumit të gjeneralit grek* *(Ultimatum i gjeneralit grek - është fjala për ultimatumin e ushtrisë greke në tetor 1913, të cilin patriotët gjirokastritë me Hysen Hoxhën në krye e hodhën poshtë.) që donte të digjte Gjirokastrën. Të gjithë pritnim vdekjen nga ora në çast, pritnim të na digjeshin shtëpitë dhe brenda, por VenizellosIt dhe Zografos* *(E. Venizellos - politikan reaksionar grek që është përpjekur për të realizuar synimet grabitqare të borgjezisë shoviniste greke ndaj viseve tona të Jugut.

J. Zografi - shqiptar grekoman, i vënë në shërbim të shovinistëve grekë, një nga udhëheqësit e së ashtuquajturës Lëvizje vorioepirote që synonte për shpëtimin e tokave shqiptare në fav or të Greqis.) nuk i dorëzoheshim. Përpara trimërisë së popullit, gjenerali grek u zbraps. Qyteti shpëtoi nga djegia. Më vonë na pllakosi varfëria, ki sahat na i di hadhet, por nuk u turpëruam. Një pjesë të fëmijëve i përcolla në varr, ki sahat m'i nje hidhërimet. Ki ma di llahtarën time kur na zaptuan italianët dhe gjermanët. Sahati e di mirë frikën dhe dhimbjen që ndieja në zemër, kur ti, biro, biri im, dhe djemtë e mëmave të tjera shqiptar e dolën ilegalë me Partinë, kur luftonin në demonstrata, kur shkuan në luftë e s'i pashë më, derisa u çlirua Shqipëria. Orët më dukeshin ditë dhe ditët vite. Kërcitnin çdo natë pushkët e bombat në Tiranë dhe sikur më godisnin në zemër. Binte zilja e këtij të flamosurit sahat. Mendoja djalin tim, mendoja djemtë e bilat e nënave që kishin dalë në mal partizanë dhe luftonin për popullin me flamur të kuq në dorë... Por ja u kthyen nga mali fitimtarë, qeshi nga gëzimi gjithë Tirana, gjithë Shqipëria. Tani zile e sahatit më dukesh si këngë e bukur. Një ditë, duke shikuar sahatin, i thaçë atij: ditëshkurtër, sa shumë kemi vojtur ti dhe unë, por ç'e zë dhe nuk e kalon njeriu. Njeriu ëslztë më i fortë se ti, më i fortë se hekur i. Tani i thaçë sahatit : këndo se s'do ketë më di të të zeza as për popullin, as për ne, as për ti».

Këtë sahat, pra, po i dërgoj si dhuratë të thjeshtë shkollës sime të parë e të dashur. Unë e mbaja këtë ne odën e punës, por mendoj se te ju do të jetë më mirë, pse pleqtë gëzojnë dhe kanë nevojë të rrinë me të rinjtë, pse u kujtohet rinia e tyre, pse duan kurdoherë të jenë të rinj, pse duan të gëzojnë, të punojnë si të rinjtë pse, kur rrinë me të rinjtë, të vjetrit marrin forca të reja për t'u shërbyer deri në mbrëmjen e jetës së tyre së resë, atdheut socialist, Partisë sonë të lavdishme.

Edhe unë ju siguroj, të dashur shokë, shoqe e miq të gjimnazit «Asim Zeneli» të Gjirokastrës, se me të gjitha forcat e mia, sa të kem fuqi do të punoj, do të luftoj deri në fund, si ushtar i Partisë dhe i popullit, për lumturinë e njerëzve të Shqipërisë, për lumturinë e brezit të ri.

Të rrojë në shekuj. në lavdi e në lumturi populli ynë i mrekullueshëm, Partia jonë e lavdishme. rinia jonë her oike!

Ju përqafoj dhe mirupafshim shokë dhe miq të mi të vjetër dhe të rinj!

Juaji

ENVER HOXHA

Tiranë, 17 shtator 1962

II

NGJARJE TË MËDHA

DITËN KUR LINDI PARTIA

Atë natë që do të gdhiehet data 8 Nëntor ne u drejtuam për në shtëpinë e vogël që po na priste. Në këto kujtime nuk do ta përshkruaj atë, sepse shtëpia ku u themelua Partia Komuniste e Shqipërisë tash është bërë një monument i shquar i vendit tonë, të cilin e njohin i madh e i vogël në Shqipëri, si edhe mijëra e mijëra miq, shokë e vizitorë të huaj. Anembanë rrugicat qenë siguruar me shokë të armatosur, të vendosur e të qetë. Që më parë ishin bërë hetime të kujdesshme për të gjitha familjet rreth e rrotull shtëpisë. Ato ishin familje të varfra, punëtorësh, qirakësh dhe patriotësh.

Në errësirën e natës u futëm në shtëpinë e vogël një nga një, me rregull e në heshtje. Të gjitha dritaret ishin mbuluar nga brenda me batanije. Nuk dukej asnjë dritë. Nuk ndihej asnjë zhurmë. Ilegalitet i plotë. Hymë në shtëpinë e vogël me shpresa të mëdha, me një gëzim dhe me një besim të papërshkruar por, ta themi hapur, ashtu siç e ndienim, të gjitha këto i mbulonte një cipë ankthi. Me siguri secili prej nesh, që po vinte aty me dëshirën e madhe të y:rijimit të Partisë, thoshte me vete: «Si do të shkojë puna? A do Via arrijmë qëllimit të shenjtë?». Atje gjetëm Miladinin, Dushanin, Vasilin dhe Qemalin. U përqaftuam me shokët jugosllavë dhe me të tjerët. Por, të them të drejtën, me shokët e Grupit të Shkodrës përqaftimi që më shumë se i zakonshëm. Kur erdhën krerët e Grupit të «Të Rinjve», takimi që i ftohtë, por pa shenjë armiqësie.

U mbledhëm të gjithë. Nga grupi ynë, për të marrë pjesë në Mbledhje, qenë caktuar: Koço Tashkoja, Pilo Peristeri, Enver Hoxha, Koçi Xoxe dhe Sotir Vullkani. Kishim ardhur të gjithë me përjashtim të Koçi Xoxes, të cilin disa ditë më parë e kishim dërguar në Korçë që të vinte në dijani Mihan dhe shokët e atjeshëm mbi platformën që kishim vendosur të ndiqnim në Mbledhjen Themeluese, si dhe për të dhënë udhëzimet e fundit rreth një demonstrate të madhe që kishim vendosur të organizohej në Korçë më 8 nëntor. Nga Grupi i Shkodrës ishin të pranishëm Qemal Stafa, Vasil Shantoja, Kristo Themelkoja, Tuk Jakova, kurse riga Grupi i «Të Rinjve» ishin të pranishëm Ramadan Çitaku, Anastas Lula, Sadik Premtja dhe një shok kosovar. Në shtëpi komandonin Vasil Shantoja e Piloja. Ata ria caktuan rregullat që duhej t'i zbatonim me disiplinë të hekurt: Nuk do të flitej me zë të fortë as ditën, as natën; ditën asnjëri nuk mund të nxirrte kokën as në dritare, as te dera, as në oborr. Përgatitja e ushqimit do të bëhej tek oxhaku i dhomës së Mbledhjes riga Vasili me ndihmën e Pilos; Xhemali dhe Zylfija, si njerëz të shtëpisë, mund të hynin e të dilnin sipas nevojës, por pa ndryshuar zakonet, që të mos binin as në sy të fqinjëve. Në hajatin e vogël dhe në dhomën tjetër të katit të poshtëm do të hanim bukën, do të bënim edhe pushim. Në atë dhomë disa edhe mund të flinin, por fjetja do të bëhej kryesisht në dy dhomat e katit të sipërm dhe në divanin e vogël midis tyre. Të gjithë do të flinin përdhe, njëri në krah të tjetrit. Në dhomat sipër do të ngjiteshim vetëm riga shkalla prej druri që lidhte dhomën e Mbledhjes poshtë me katin e sipërm dhe jo riga shkallët e jashtme.

Këtë «regjim» e zbatuam gjatë gjithë kohës së Mbledhjes. Kur shkuam të flinin sipër, Vasili ria çoi në atë dhomë e cila ka edhe një dritare që bie në kopsht riga aria e lindjes. Në rast rreziku dhe rrethimi, ne do të dilnim riga kjo dritare, dulce çarë edhe me luftë, po ta kërkonte rasti, do të kapërcenim riga kopshti dhe prej tij do të kalonim në një kopsht tjetër që të nxirrte në një shesh, ku ndodhej një shtëpi që ishte bazë jona, dera e së cilës do të qëndronte e hapur që të futeshin shokët. Në qoftë se s'do të kishte rrethim, mund të kalohej në rrugicë, ku porta e parë dhe e katërta qenë bazat tona. Në to mund të hynim brenda derisa të kalonte rreziku.

Natyrisht, atë natë historike ne thuajse s'fjetëm fare Miladini ria fliste për luftën e partizanëve jugosllavë, ria tregonte si e kishin organizuar ata partinë dhe komitetet e saj. Ne e dëgjonim me kujdes. Më të çelur e më të çlirët qëndronin Piloja me Vasilin, si punëtorë që ishin; ata bënin shaka

dhe qeshnin. Këtë atmosferë ria e komunikuan edhe neve që rrinim akoma si të ngrirë. Qemali filloi edhe ai me të qeshur, pse kishte humor dhe me spec. Si kurdoherë, me të qeshur, tha - Erdhi dita, Koço, të takohemi e të bisedojmë si komunistë, kurse deri dje mund të të haja të gjallë edhe ty. po edhe Anastasin.

Po me të qeshur ia prita dhe unë, duke i thënë:

- Qemal, do të vuaje riga stomaku, pse shihi ç'lëkurë kanë, si zor të treten.

Qesl-i, ~5m të gjithë, por Koçoja me Anastasin qeshën «thartë». Pastaj kërceu Tuk Jakova dhe i tha Qemalit:

- E ke me vete mandolinën t'ia marrim një këngë?

- Pse, për të bërë serenata kemi ardhur këtu? - ia preu Qemali.

- S'ka këngë këtu, ndërhyri Koçoja.

- Me zë fare të ulët edhe mund të ketë, - thashë unë, - po më mirë të pyesim furrxhiun.

- Nuk lejohet as me zë të ulët, - u përgjigj Vasili.

- Po kur të formojmë Partinë, - i thashë, - do të ria ndalosh të këndojmë Internacionalen?

- Atëherë jo vetëm që do ta këndojmë, - tha Vasil Shantoja, - por edhe me zë të fortë, që ta dëgjojë gjithë Shqipëria.

Një gëzim i madh shkëlqeu fytyrat e të gjithëve ne. përveç fytyrave të errëta, të rrudhura e të ngrira si nate dimri të Anastas Lulës dhe të Sadik Premtes.

Më 8 Nëntor 1941 filloi Mbledhja e parë e përfagësuesve të të tri grupeve komuniste.

Si grupit më veteran e më të madh në lëvizjen e gjeratëhershme komuniste në Shqipëri, nderi për të çelur Mbledhjen Themeluese i takoi Grupit të Korçës. Siç kam shënuar më parë, grupi më kishte ngarkuar mua të flisja. U ngrita në këmbë

, - Shokë, - fillova, - është një gëzim e një nder i madh për Grupin tonë të Korçës, dhe për mua personalisht, që na u dha fjala të parëve.

Isha krejt i emocionuar, por pak nga pak «makina» u ndez.

- Në fillim, - shqiptova, - ftoj Mbledhjen të nderojmë kujtimin e të gjithë shokëve komunistë dhe luftëtarëve të tjerë trima, shqiptarë e të huaj, që kanë rënë e po bien në fushën e nderit duke luftuar kundër fashizmit për lirinë e popujve; të nderojmë kujtimin e Ali Kelmendit, të Mujo Ulqinakut e të bijve të thjeshtë të popullit tonë që u vunë pushkën pushtuesve fashiistë; të nderojmë kujtimin e heronjve të Luftës së Spanjës, të heronjve të Bashkimit të madh Sovjetik që japin jetën në luftën për çlirimin kundër bishës naziste; të nderojmë vëllezërit tanë, heronjtë komunistë jugosllavë të rënë në fushën e betejës.

Të gjithë u ngritëm në këmbë dhe mbajtëm një minutë zi në heshtje.

Pas këtyre, siç kishim vendosur në grupin tonë, parashtrova propozimin e Grupit të Korçës për Themelimin e Partisë që ditën e parë, për arsytet që kam shënuar më lart, kur diskutuam në grup dhe për të cilat flitet edhe në dokumentet e Partisë.

Atëherë u ngrita në këmbë shumë i emocionuar dhe thashë:

- Shokë, në bazë të propozimit të Grupit Komunist të Korçës dhe mendimeve të shfaqura nga gjithë të pranishmit po vë në votë projektvendimin: «Sot, më 8 Nëntor të vitit 1941, përfaqësuesit e të tri Grupeve Komuniste, të Korçës, të Shkodrës dhe të «Të Rinjve», të mbledhur në seancë plenare dhe pas diskutimeve konstruktive me frymë komuniste, duke u bazuar në mandatin që u kanë dhënë shokët e grupeve të tyre, Themeluan Partinë Komuniste të Shqipërisë». Kush është pro, të ngrejë dorën.

Të gjithë ngritën dorën. Nuk pati asnjë kundër, asnjëabstenim. Një gëzim i papërshkruar na pushtoi të gjithë. U kurorëzua me sukses hapi kryesor, detyr a vendimtare që i kishim vënë vetes kur u nisëm për në këtë Mbledhje historike !

Atëherë deklarova:

- Me unanimitet të plotë u Themelua Partia Komuniste e Shqipërisë. Rroftë Partia Komuniste e Shqipërisë!

Të gjithë, të gëzuar e të emocionuar, u ngritëm në këmbë dhe, me grushtin përtpjetë, në dritën e llambës me vajguri, kënduam me zë të ulët Internacionalen, pastaj brohoritëm e brohoritëm për

Partinë Komuniste të Shqipërisë, por kurdoherë në surdinë: «Rroftë Partia Bolshevike!», «Rroftë Stalini!», «Lavdi Marksit-Engelsit-Leninit!», «Rroftë Partia Komuniste e Jugosllavisë!», «Poshtë fashizmi!», «Rroftëpopulli ynë heroik!» etj. Filluam përqaqimet, puthjet. Për herë të parë dhe të fundit përqafova atë natë Anastaa Lulën dhe Sadik Premten.

Qemali tha:

- Nuk mund të na zërë gjumi sonte, hajde të këndojmë.

Të gjithë gati ishim. Ia filluam lehtë-lehtë. Kënduam këngë patriotike nga tonat, u shkuam pas edhe shokëve jugosllavë në këngët e tyre partizane, të cilave, edhe pse nuk ua dinim fjalët, të shumtave ua dinim melodinë, sepse edhe jugosllavët i kishin marrë nga këngët e Revolucionit të Tetorit e nga Radio Moska, këngë që u bënë aq të njohura dhe te ne gjatë Luftës Nacionalçlirimtare.

Kështu, natën e 8 Nëntorit 1941, lindi Partia jonë, që do ta udhëhiqte popullin shqiptar në betejat më të mëdha të të gjithë historisë së tij. Ajo lindi nga gjiri i popullit, nga zjarri dhe nga dufi i tij revolucionar, i pushuar në shekuj, lindi si një diell i ndritshëm në errësirën e kobshme të skllavërisë dhe të terrorit fashist, që kishte mbuluar popullin dhe atdheun.

Ishim të gjithë në kulmin e gëzimit e të entuziazmit për fitoren e madhe që kishim arritur, kur, pak para mesnatës, hyn brenda një nga rojat dhe na thotë se ka ar dhur filani dhe kërkon të na njoftojë diçka që ka ngjarë në Korçë. (Sfido që, për vetë karakterin tepër sekret të ngjarjes, qenien tonë në këtë bazë e dinin shumë pak veta, të zgjedhur e të caktuar me kujdes të madh, prapëseprapë ne kishim marrë të gjitha masat që komunikimet e nevojshme e të domosdoshme me jashtë të vazhdonin rregullisht.)

Dola në korridorin e vogël të shtëpisë dhe takova një shok që sapo kishte mbërritur nga Korça. Më informoi mbi demonstratën e madhe që qe zhvilluar atë ditë atje dhe unë menjëherë hyra në dhomën ku bënim Mbledhjen.

- Shokë, - u thashë, - punëtorët, nxënësit e shkolave, krejt populli i Korçës, me ne krye komunistët, pikërisht në këtë ditë historike, kanë bërë një demonstratë masive dhe janë ndeshur me forca të armatosura të pushtuesve, të kuesturës e të milicisë fashiste. Në ballë të popullit demonstrues ndodhej punëtori Koci Bako, komunist i orëve të para i Grupit të Korçës. Kur turma kishte arritur para Monumentit të Themistokli Gërmenjit, forcat armike qëlluan me armë mbi popullin dhe hodhën bomba. Ra i vrarë shoku ynë i paharruar Koci Bakoja dhe dhjetëra të tjerë u plagosën, midis të cilëve edhe Muharrem Butka, djali i patriotit Sali Butka. Ne, shokët e ish-Grupit të Korçës, që vendosëm së bashku me ju t'i japim fund gjendjes së grupeve e njihnim mirë Koci Bakon, komunistin proletar, dhe ëndrrën e tij për krijimin e kësaj Partie që ne sapo e realizuam. Gjaku i Kocit dhe i gjithë komunistëve e patriotëve të tjerë do t'i çimentojë themelet e Partisë që porsa krijuam.

Jo vetëm ne shokët e ish-Grupit të Korçës që e njihnim nga afër Koci Bakon, por gjithë të pranishmit ndien një hidhërim të thellë, por ne qemë komunistë dhe vdekja heroike e shokut tonë të dashur do të na çonte peshë e do të na jepte forca të reja në ato ditë historike e në ditët që vinin.

E mori fjalën Vasil Shantoja:

- Propozoj, - tha, - të mbajmë një minutë heshtje për shokun Koci Bako, si për dëshmorin e parë komunist të Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Kaq tha ai dhe ngriti grushtin përpjetë me nderim. E pasuam të gjithë.

Natën, vonë, shumë vonë. ngjitem shkallën e vogël të drunjtë për të shkuar në dhoma. Zëmra at na gufonin. Themelimi i Partisë na hapte perspektiva të ndritura për popullin e për të ardhmen e tij. Kujtoja në ato çaste të lumtura Aliun të Kelmendin, i cili edhe pse tuberkulozi s'iu nda deri në vdekje, luftoi me gjithë shpirt për komunizmin, luftoi deri në fund për Via arritur kësaj dite; kujtoja Koci Bakon me të cilin, kur ishim të rinj, në Korçë, rrinim së bashku në heshtje rreth radios së vogël në pasticerinë e tij dhe dëgjonim Internacionalen që jepte Radio Moska; kujtoja Asim Vokshin, Teni Konomin dhe heronjtë e tjerë të Spanjës; Thanas Zikon e shokët e tjerë, komunistë a revolucionarë, që dhanë jetën për një jetë të re. Themelimi i Partisë ishte kurorëzimi i dëshirave të heronjve të popullit të rënë në betejat, i patriotëve, i heronjve të panumërt që kishin luftuar për lirinë e Shqipërisë, sepse, paskëtaj, Partia, që u themelua, do të ngrinte finte lart flamurin e Marksit,

Engelsit, Leninit e Stalinit, së toku me flamurin e Skënderveut, e do të hidhej në beteja të reja me një besim të qindfishuar në fitoren e madhe të çlirimit.

Të nesër men e deri më 14 nëntor vazhduan debatet. Folën të gjithë shokët pjesëmarrës në Mbledhje. Debatet ishin të ngjeshura, shumë herë edhe të ashpra.

Kështu, pas 7 ditësh pune intensive, Mbledhja mbaseo punimet me një fitore të madhe, Themelimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, me një vijë të drejtë e program të qartë.

Me gëzim në zemër e plot entuziazëm iu vumë punës me zell e me optimizëm.

TI SHKREPJE SI VETËTIMA MBI OKUPATORËT DHE TRADHTARËT

(THEMELIMI I RINISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË)

Organizimi i rinisë së vendit për të luftuar okupatorin italian dhe reaksionin e brendshëm ishte një nga detyrat kryesore që Partia Komuniste e Shqipërisë i vuri vetes, që në ditët e para të themelimit të saj. Jo vetëm Partia jonë që po formohej ishte e re nga mosha, por edhe ne, anëtarët e saj të parë, shumica ishim të rinj. Partia e kuptoi drejt situatën e rëndë që u krijua në vend nga okupatorët dhe i vlerësoi drejt anët klasore të forcave që do të përlesheshin me armikun, si edhe anën e shtresave dhe të moshës së njerëzve që do të angazhoheshin në luftë.

Që në debatet kur po themelohej Partia, një nga çështjet kryesore ishte që, pasi të organizonim Partinë, duhej të krijohej menjëherë Organizata e Rinisë Komuniste të Shqipërisë, e cila duhej të bëhej dhe u bë ndihmësja e lavdishme e Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Vendimi i Mbledhjes së Themelimit të Partisë, për krijimin e Organizatës së Rinisë Komuniste të Shqipërisë u zbatua pikërisht më 23 nëntor 1941, 15 ditë pas Themelimit të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Kjo është një ditë historike për luftën e popullit tonë, ditë historike e lavdishme për rininë tonë heroike, është një ditë historike për popullin shqiptar dhe njëkohësisht plot emocione dhe kujtime të pashlyeshme nga mendja jonë për ne që morëm pjesë në ato mbledhje të paharruara, kur themeluam këtë organizatë, duke realizuar vullnetin dhe dëshirën e Partisë dhe të rinisë sonë luftarake.

Në shtëpinë ku u themelua Partia punova me Qemalin për organizimin e mbledhjes themeluese të rinisë komuniste.

Pasi i mbaruam këto, si Qemali dhe unë u përgatitëm për mbledhjen. Unë do të flisja për formimin e Partisë, për nevojën e krijimit të organizatës së rinisë, për situatën ndërkombëtare dhe për luftën tonë kundër okupatorëve. Qemali do të mbante referatin kryesor për themelimin dhe organizimin e Rinisë Komuniste, për vijën politike dhe ideologjike të kësaj organizate.

Kur ishim duke punuar me Qemalin në dritën e llambushkës, shoku që ruante jashtë hyri në dhomë dhe na tha:

- Ka ardhur Anastas Lula dhe kërkon të takohet me ju, pse ka një gjë urgjente.
- Fute, - i thamë.
- Ç'ka Qorri që po vjen? - tha Qemali.
- Të shohim, - iu përgjigja.

Hyri Anastasi, gjoja me një frymë, dhe tha:

- Spiuni Ali Reçi po ngjit Rrugën e Spitalit, ai është vetëm, hajdeni ta ekzekutojmë!

U ngrita në këmbë, mora një nga nagantet që mbanim pranë mbi tryezë, drodha rrotën, u sigurova që ishte plot me fishekë dhe ia ndera Qorrit, duke i thënë:

- Merre nagantin, shko e vraje dhe, me të dëgjuar krismat, ne do të largohemi nga kjo bazë! - Anastasi shtangu.

- Ç'pret, - i thashë unë, - nisu!

- Na, - i tha Qemali, - merre dhe këtë bombë, kije në xhep! - Anastasi shtrëngoi kasketën në kokë dhe u zhduk në errësirë. Ne vazhduam punën. Qemali tha:

- Enver, ky Anastasi, i poshtër ka qenë dhe i poshtër do të mbetet.

- Ishte provokacion nga ana e tij, - i thashë Qemalit,

- po nuk na e hedh dot. Ai as atentat tra bërë, as do të bëjë, prite kur të kthehet.

Dhe nuk mungoi të kthehej. Pas ndonjë ore erdhi si i dëshpëruar dhe tha

- Iku, s'e arrita dot, dhe vuri koburen dhe bombën mbi bankë.

- S'!_a gjë, - i thashë, - herë tjetër.

- Na tën e mirë, - i tha Qemali i ina tosur, - shko tash, se kemi punë. - Dhe, pasi doli nga dhoma, Qemali shfreu:

- Gjarpri me syze!

Pas dy ditësh u hap mbledhja për themelimin e Rinisë Komuniste. Shokët që do të bënin pjesë në këtë mbledhje ishin lajmëruar që në ditën e caktuar duhet të ishin te shtëpia e Sabrije Vokshit, në fund të bulevardit që sot mban emrin «Stalin».

Bije Vokshi është halla e Asim Vokshit, luftëtar i brigadave ndërkombëtare, i rënë në Spánjë. Bija është kosovare, pikërisht nga Gjakova, nga një familje me emër dhe nga më patriotet në Kosovë. Ajo me nipërit e saj ishte vendosur në Tiranë. Ishte një grua pale e kaluar në moshë, po burrneshë, patriote, e guximshme, komuniste e vendosur e ish-Grupit të Shkodrës. Kishte një zemër flori. Ajo ishte antifashiste në kulm, siç janë komunistët. Vdekja heroike e Asimit në Spanjë kishte ngjallur në zemrën e saj një urrejtje të pakufishme kundër fashizmit. Ajo ishte shumë e zgjuar, konspirative, e heshtur, punëtor e. Shtëpia e saj ishte një nga bazat më të rëndësishme tonat, të ilegalëve. Bija na vinte rrotull të gjithëve, na bënte të hanim, na lante rrobat, fshinte shtëpinë që ta gjenim të pastër. Shtëpia e Bijes ishte «depo armësh», atje vinin dengjet me trakte dhe merreshin nga shokët për t'i shpërndarë.

Një mbrëmje, pasi krijuam Partinë dhe organizatën e rinisë, më qëlloi të ndodhesha kur Bija u ndau shokëve pakot me trakte. Në mes tyre ishte dhe nipi i saj. Bija kishte radhitur si ushtarë shokët, i thërriste ata me radhë njërin pas tjetrit, u jepte pjesën e trakteve që i takonin secilit, një paleo dhe një bombë n,jërit, tjetrit një paleo dhe një kobure me nja dy fishekë, një të treti një paleo dhe një thikë, e kështu me radhë. I erdhi radha nipit të saj, të cilit i dha patron me trakte, po jo armë.

- Po mua, - i tha nipi, - pa armë do të më nisësh?

- U mbaruan, merr një urë zjarri po të duash, - i tha Bija, - dhe nisu e të pakta fjalët!

Shokët humbën nëpër natë për të shpërndarë traktet. Rrija dhe shikoja Bijen. E tillë ishte kjo grua patriote kosovare nga familja e Vokshëve, që nipin e saj nuk e vinte më parë nga të tjerët.

Shtëpia e Bijes, ku u bë mbledhja për formimin e organizatës së rinisë, ishte një shtëpi përdhese tiranase. Ajo ishte rrethuar nga rruga dhe nga të gjitha anët e tjera me mure e shtëpi të vogla prej qerpiçi. Kishte dy hyrje dhe kjo na favorizonte shumë. Nga ana e rrugës kryesore hyje më parë në një kopsht me drurë e pemë, si akacie, lofatë, ndonjë file, ndonjë ftua, man (sidoqoftë edhe ky kopsht ishte i favorshëm për punën tonë ilegale), pastaj kishte një deriçkë, që unë e quaja «thoropullë». Qemali qeshte kur thosha thoropullë, kurse Bija nuk e shqiptonte dot dhe më thoshte: «Çfarë drea, fjale asht kjo?». Nga fundi i kopshtit, në rast rrethimi dhe kontrolli nga armiku, mund të kapërcenim murin dhe të dilnim tej, shtëpi më shtëpi, në fushë. Kështu shpëtoi në një rast Qemali. Porta tjetër ishte një portë e zakonshme, me dy kanate prej dërrase të vjetruar dhe me lloz nga pas. Te kjo portë duhej të vije nga një rrugicë e ngushtë dhe me disa kthesa në mes një numri shtëpish të tjera të ulëta tiranase, ku jetonin familje të popullit patriot. Nga kjo anë ishim edhe më të sigurt.

Për të hyrë në shtëpi kaloje në një oborr që pjesërisht ishte shtruar me kalldrëm, pjesa tjetër ishte me dhe, kishte një pus dhe anës murit ndonjë lule. Shtëpia kishte tri dhoma, dy nga të cilat ishin me dysHEME, një e vogël e një tjetër më e madhe, kurse një e ndarë tjetër ishte shtruar me baltë, ishte pa tavan e pa oxhak, siç ishin «shtëpitë e zjarrit» të zakonshme tiranase, ku Bija ndizte zjarrin, gatuante gjellët, ndante traktet. Atje ne zhvishnim këpucët me llucë dhe hidhnim mbi një tryezë

palltot o mushamatë e qullura. Der a e këtij hauri-kuzhinë, siç mund ta quanim, ditte në një hajat të shtruar me baltë të ngjeshur në vend të plloçave, i hapur nga përpara me dy a tre trarë në vend të kolonadave dhe i mbuluar nga sipër me tjegulla, por pa tavan.

Në të dyja dhomat me dysheme, të cilat komunikonin me një derë, mund të hyje nga një dërë nga oborri që të çonte në dhomën e vogël dhe nga një derë nga kuzhina që të çonte te dhoma më e madhe. Në dhomën e vogël me dysheme u bë mbledhja historike. Shokët që nuk ishin ilegalë, hynin me kujdesin më të madh në të ngrysur, kush nga dera e kopshtit, kush nga dera tjetër e rrugicës. Ne, ilegalët, vëmë kur u err mirë. Më kujtohet që hyra nga r ruga kryesore, dera e madhe, zbrita kopshtin në errësirë, duke më mbajtur shoku që ruante, se ishte ca tatëpjetë dhe nga shiu ishte bërë baltë e mund të rrëshqitje. Pasi kapërceva deriçkën, takova Bijen. U përqaftuam. Më thotë:

- Të gjithë shokët kanë ardhur, po hanë.

Lashë pallton në kuzhinë dhe nga dhoma_a e madhe hyra në atë të voglën dhe i pashë të gjithë shokët të mbledhur tok, pranë njëri-tjetrit, që hanin e bisedonin të gëzuar. Dhoma ishte e vogël, po mua m'u duk e madhe. Disa shokë i njihja, disa i shihja për herë të parë nga fytyra. Qemali m'i prezantoi njërin pas tjetrit. Në mes të shokëve ishte edhe një shoqe e vetme, shoqja Nexhmije Xhuglini. Qemali, duke ma prezantuar, më tha:

- Kjo është Nexhmija, shoqja jonë komuniste nga më të mirat, nga më të vendosurat, që të kam folur.

Nexhmija, me fytyrë të skuqur, i tha:

- Qemal, të lutem, lëri këto. . .

- E po mirë, atëherë, - i tha Qemali, - që të mos të lëvdoj, po i them Enverit që unë i kam vënë 13exhmijes një pseudonim: «DLlikatja».

Të gjithë qeshëm.

- Por, - shtoi Qemali, - në fakt ajo është e fortë si malësoret.

Dhoma ishte rrethuar me mindere, më një anë kishte tryezën dhe disa frona, në një qoshe kishte një sobë dhe dhoma ishte mbushur plot me tym, por jo me tym cigareje, se nuk pinin shokët e rinj, por me tym të bukës së pjekur e të thekur në sobë, ku valonte dhe çajniku. Ishim të varfër, ajo ishte darka e festës sonë: çaj dhe bukë të thekur. Çajin nuk e pinim në çafka, se nuk kishim, por ne sapllakë prej alumini që na përvëltonin buzët. Qëllonte që me një sapllak pinim edhe dy veta përnjëherë, një gllënjë njëri dhe një gllënjë tjetri. Mora edhe unë racionin tim dhe pastaj shpejt e shpejt spastruam dhomën, rregulluam tryezat dhe rreth orës 9 të mbrëmjes filloi mbledhja historike. Mbledhjen e hapa unë në emër të Komitetit Qendror Provizor të Partisë Komuniste të Shqipërisë.

U shpreha më parë përshëndetjet e përzemërta revolucionare të Komitetit Qendror Provizor të Partisë Komuniste të Shqipërisë delegatëve të rinisë së vendit, të mbledhur për të themeluar Organizatën e Rinisë Komuniste të Shqipërisë dhe u urova sukses të plotë në punën e tyre.

Qemali foli ndonjë orë e gjysmë; ai fliste rrjedhshëm, qartë, me një të folur gegërishte në mes elbasançes dhe shkodrançes.

Pasi foli Qemali, e mbyllëm seancën aty nga mesnata e datës 22. Natyrisht dyshekë e mbulesa për të gjithë nuk kishte. Si gjithnjë, ne këto raste disa shokë shtriheshin pranë njëri-tjetrit, duke vënë kokën në jastëk ose në minder, veshur siç ishin, koburet nën jastëk dhe këmbët të shtrira në dër rasa. Në disa raste, kur ishim shumë, disave u binte të flinin ndenjtur, në dërrasa ose mbi karrige, duke mbështetur kokën mbi tryezë, ose në murin e ftohtë, ose në supin e ngrohtë të ndonjë shoku. Nexhmija që më e fituara në këtë mbledhje, ajo fjeti në krevatin e Bijes.

Të nesërmen, në mëngjesin e 23 Nëntorit, u ngritëm herët. Bija na dha nga një gotë me çaj lule bliri dhe një copë bukë. E vazhduam mbledhjen me diskutimet mbi vijën dhe direktivat e Partisë dhe mbi detyrat për Organizatën e Rinisë Komuniste.

Mbi disc probleme të gjendjes ndërkombëtare, si dhe për rininë në Tiranë e në Durrës dhe mbi disa masa për ta ruajtur atë nga demagogjia fashiste foli Nako Spiru. Mbi punën me të rinjtë punëtorë në Korçë e në Shkodër folën Tasi Mitrushin dhe Ndoc Mazi.

Nexhmija foli mbi veprimtarinë e të rejave komuniste, veçanërisht në Institutin Femëror të Tiranës, mbi mundësitë e mëdha për të shtrirë lëvizjen antifashiste jo vetëm brenda kësaj shkolle, por edhe

nëpërmjet saj në të gjithë vendin, sepse në këtë Institut për mësuese, i vetmi në vend, vinin vajza nga të gjitha krahinat e Shqipërisë. Kishte mjaft vajza edhe nga shtresat e varfra dhe përparimdashëse, që, me shumë sakrifica, kush me ndonjë bursë, kush me shpenzimet e veta, përpiqeshin të përfitonin profesionin e mësueses për të siguruar të ardhmen e tyre dhe për Lë ndihmuar familjet.

Përpjekjet që bëri Zogu për t'i lidhur pas qerres së tij këto edukatore të brezit të ri, duke organizuar me anën e motrave të tij pritje e parada karnavaleske, nuk patën sukses. Kur erdhi puna të mbrohej atdheu, vajzat e Institutit, bashkë me shokët e rinisë shkollore e punëtore, organizuan shfaqje teatrale patriotike, dolën në demonstrata, kërkuan para pallatit të mbretit armë për të luftuar, dolën vullnetare për t'u përgatitur si infermiere, duke menduar se armiku do të pritej me armë.

Me ardhjen e pushtuesve fashistë filloi një lëvizje më e gjallë në shkollë, se shoqet komuniste dolën nga guaska e tyre, nga puna e ngushtë me masat. Nexhmija përshkroi se si sabotoheshin në shkollë ngritja e «flamurit me sëpata», mësimi mbi fashizmin, aktivitetet e pedagogëve fashistë italianë për shfaqje fizkulturore, parada e të tjera manifestime fashiste. Kur erdhi për vizitë Konti Çianoja, ministër i Jashtëm i Duçes, vajzat e Institutit që i nxorën me detyrim, dolën me grykëset e zeza, duke hequr në mënyrë demonstrative jakat e bardha dhe disa qanin, disa i kthyen shpinën. (Për këtë pritje Çianoja ka shkruar edhe në ditarin e tij.)

Nexhmija theksoi se një veprimtari e tillë zhvillohej jo vetëm në shkollë. Të rejat e grupeve komuniste dhe aktivistet antifashiste kishin filluar të punonin edhe me vajzat shtëpiake, të cilat, tha ajo, i dëgjojnë me shumë etje bisedat tona dhe janë të gatshme të hidhen edhe në aksione, megjithëse pengohen shumë nga fanatizmi i rrethit të tyre familjar dhe i opinionit ku luftojnë. Megjithëse shumica e vajzave shtëpiake janë me çarçaf, ndonjëra e ka hedhur atë dhe ka dalë në demonstrata, të tjera ikin pa leje e vijnë në mbledhjet tona, lexojnë libra dhe trakte dhe që s'dinë kërkojnë të mësojnë. Nexhmija vuri në dukje me të rejat punëtore punohet vetëm nëpërmjet motra të disa shokëve punëtorë, të cilat punojnë edhe ato në f brikën e cigareve ose si rrobaqepëse etj.

Diskutimet vazhduan ditën e dytë. Ato ishin të zjarr plot barut dhe entuziazëm, në unitet të plotë me Parti Komuniste të Shqipërisë. Diskutimet treguan besnikërinë madhe të rinisë ndaj Partisë së tyre, që sapo ishte formu~ dhe shokët u betuan se do t'i qëndronin besnikë deri

vdekje mësimeve të saj, se do të luftonin nën urdhrat saj deri në fitore për lirinë e plotë të popullit. Të gjithë: anëtarët e mbledhjes me diskutimet e tyre aprovuan një zëri raportin tim që u mbajta në emër të Komitetit Qendr Provizor, si edhe raportin e shokut gemal Stafa. Në mb rim të diskutimeve u vu në votë dhe me një entuziazëm të papërshkruar u themelua Organizata e Rinisë Kom niste të Shqipërisë. U përqafuam, kënduam. Ishte data ; Nëntor e vitit 1941.

Pas themelimit të organizatës duhej bërë zgjedhja Komitetit Qendror Provizor të Rinisë. U vendos që p çështje konspiracioni nuk do të paraqiteshin kandidatit me emra. por me numra dhe përbri secilit numër karakt ristikat. Pra do të votohej për numrin, pa ditur kush isht por dulce u bazuar në karakteristikat. Unë dhe Qemr kishim shkëmbyer mendime edhe më parë për kandidatit por, pasi na ngarkoi mbledhja, i riformuluam, i plotësua karakteristikat dhe i paraqitëm. U zgjodhën pikërisht sa duhej dhe të gjitha votat ishin unanime për numrat c u caktuan. Emrat tash dihen. U zgjodhën 5 veta: Qem Stafa, Nako Spiru, Nexhmije Xhuglini, Tasi Mitrusi dl një shok që, menjëherë pas mbledhjes, u dërgua me pus në Kosovë e në vend të tij u zgjodh Misto Mame.

Mbledhja historike mbaroi me sukses. Rinia heroil e vendit tonë kishte tash organizatën e saj, udhëheqjE e saj. Kjo organizatë do të zgjerohej, do të forcohej, do kalitej në luftë, do të bënte heroizma të paparë kurrë historinë e popullit tonë, ajo do të nxirrte nga gjiri i s heronj legjendarë, udhëheqës të shquar të Partisë, ajo u bë dhe mbeti fidanishtja e pashterur e Partisë. Brezi i të rinjve, që luftuan si luanë, u bë brezi i parë i lavdishëm i Partisë dhe sot kjo organizatë me një histori të madhe, nën udhëheqjen e Partisë, qëndron né ballë të ndërtimit të socializmit.

Pasi mbaroi mbledhja, shokët u shpërndanë nëpër vendet nga kishin ardhur dhe tash që atyre iu gel perspektiva, të armatosur me udhëzime dhe me direktiva të qarta, me entuziazëm do t'i shpërndanin dhe do t'i rrënjosnin këto né gjithë rininë e vendit tonë. Tash duhej të fillonte anembanë vendit organizimi i rinisë.

Me shokët e Komitetit Qendror bëmë disa mbledhje, Shoku Qemal Stafa u zgjodh me entuziazëm dhe me unënimitet sekretar politik i Rinisë Komuniste të Shqipërisë. Zgjedhja e Qemalit, anëtarit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, si sekretar politik i Organizatës së Rinisë Komuniste, ishte një garanci e madhe për Partinë dhe për organizatën e rinisë, pse Qemali ishte një shok me cilësi të rralla për moshën e tij të re. Ai ishte shumë i ri, por edhe shumë i pjekur, ai ishte i thellë dhe serioz në mendime e në diskutime. Me të rinjtë ai dinte të fliste për çështje të thella, por me një ton të dashur, të qeshur, shumë herë me humor. Qemali ishte i atillë që e ndiqnin të rinjtë, e rrethonin, ishte njeri me kulturë dhe këtë kulturë dinte ta përdorte, ta adaptonte, nuk ishte nga ata që donte të tregohej se dinte, por te cili~do e linte thellë përshtypjen se di, nte. Sa për guxim dhe trimëri, ai ishte i patundur dhe i hedhur. Shumë pak rrojta e punova me Qemal Stafën, pse shumë pak rrojti ky shok i lavdishëm dhe jetën e tij të re, derisa u vra duke luftuar, ua kushtoi komunizmit dhe Partisë. Kohët e vështira e të turbullta të luftës ilegale më lidhën ngushtë me Qemalin. Kur ktheheshim në mëngjes ose në errësirën e natës në baza për të shkëmbyer mendime dhe për të marrë vendime, kur mbaronim hallet, Qemali fillonte barcaletat, une i përgjigjesha me të miat. Hynte kështu pak të qeshur dhe çlodhje në jetën tonë.

Nexhmijen e njoha për herë të parë në mbledhjen e thepëlimit të Rinisë Komuniste të Shqipërisë. E dëgjova me vëmendje diskutimin e sai dhe më pëlqeu. E filloi diskutimin pak e emocionuar, si dukej i vinte turp nga ne, si më të rritur dhe të njohur të rinj. Më la përshtypje të thellë qartësia dhe vendosmëria e saj me të cilën foli.

Një simpati e madhe prej shoku lindi tek unë për këtë shoqe të re e të vendosur. Në mbledhjet e mëvonshme të Komitetit Qendror të Rinisë, ku asistova dhe unë, e njoha më mirë Nexhmijen. Ajo tanfi fliste lirisht e me zjarr në këto mbledhje, i doli turpi nga unë. U nda puna në Komitetin e Rinisë. Qemali e propozoi Nexhmijen të drejtonte organizatën e rinisë së Tiranës. Përgjegjësi e madhe. Nexhmija me thjeshtësinë e saj tha:

- Unë jam ushtarë e Partisë, do të vë të gjitha forcat, por a do ta bëj dot?
- Do ta bësh, - i tha Qemali, - se s'do të jesh vetëm.
- Do të të ndihmojmë, - i thashë unë.

Kjo ishte njohja e parë me Nexhmijen, që më vonë çoi në ato lidhje që u kalitën në luftën tonë të përbashkët kundër okupatorëve dhe tradhtarëve, si dy ushtarë besnikë deri në vdekje në shërbim të Partisë dhe të kauzës së madhe të komunizmit e të socializmit.

Në intervalet e këtyre mbledhjeve nuk mund të harroj nga kujtesa ato çaste të gëzueshme që kalonim me shokët e rinisë, këngët që i këndonim në surdinë, të shoqëruar a me mandolinë nga Qemali.

- Bije, - i thoshte Qemali, - bën ç'të duash, vrit pesë fashistë, por ne sonte duam hallvë, se formuam Rininë Komuniste.

- Ju baj, djelt e Bijes, - thoshte ajo duke qeshur dhe, kur dridhte luharen në tenxheren ku bëhej hallva, ne rrinim rreth e rrotull dhe lëpinim buzët.

Ose herë tjetër Qemali i thoshte Bije Vokshit, e cila e donte aq shumë Qemalin:

- Mjaft Bije, na ngope me ujë të zier, në vend të çajit ne duam harapash.

Qemali ishte edhe fotograf amator, kishte një aparat të vjetër dhe punonte, si të thuash, në njëfarë biruce që përdorej për Vu larë, e cila kishte një vrimë si penxhere. Qemali e kishte kthyer këtë në «dhomë të zezë», ku lante fotografitë.

- Qemal, - i thashë një ditë, - më bën një fotografi për një letërnjoftim fals?

- Posi, - tha Qemali dhe ma bëri e ma lau shpejt. Ishte ajo fotografi që ekziston në një letërnjoftim timin fals, ku kam dalë me syze dhe me mustaqe. Ajo është kujtim nga Qemal Stafa.

Që nga themelimi i Organizatës së Rinisë Komuniste dhe derisa u vra nga fashistët, megjithëse në ilegalitet të rëndë, Qemali shkoi në Shkodër, Durrës, Lushnjë, Berat, Gjirokastër e gjetkë për të organizuar, për të udhëzuar dhe për të mobilizuar organizatat e Partisë dhe të rinisë. Ai bënte një punë të madhe dhe, kur kthehej, bisedonim së toku dhe me shokë të tjerë, i raportonim shoqi-shoqit, merrnim vendime dhe hidheshim në punë.

Dita e fundit e pjekjes sime me Qemalin ishte më 4 maj. U poqëm në bazën nr. 66, në Rrugën e Shëngjergjit; në shtëpinë e Hysen Dashit. Ishte një familje e ndershme populli. Kryetari i familjes ishte një patriot, një plak me virtyte të larta, që na donte shumë. Ai e dinte ç'ishim ne, po kurrë nuk u tremb nga patrullat. Gruaja dhe fëmijët e tij ishin të gjithë tanët. «Zjarr le të marrë shtëpia, thoshte plaku, - rroftë Partia Kamuniste» (si tiranas që ishte, nuk e thoshte dot komuniste). Plaku na donte të gjithë, po Gogo Nushin e donte më shumë nga të gjithë.

Me Qemalin ndenjëm tërë ditën brenda në dhomë dhe punuam. Plaku na solli të hanim. Unë po përgatitja një leksion për Ushtrinë e Kuqe, Qemali përgatitej se të nesërmen që në mëngjes, duke gdhirë 5 maj, do të nisej për në Vlorë. Ramë e fjetëm afër njëri-tjetrit, në një mindeltë mbuluar me batanije.

Në mëngjes u p^orqafuam dhe u ndamë. Ai u nis për në Vlorë, unë për një mbledhje me shokë. Sido që ne baritnim çdo herë, si thotë populli, «me qefin në kokë», me kobure në brez dhe me bomba nëpër xhepa, as nuk mendonim për vdekjen që na priste në çdo qoshe rruge. Si mund të mendoja unë se e putha dhe e shtrëngova për herë të fundit në kraharorin tim shokun, nga më të mirët e Partisë, shokun dhe bashkëluftëtarin tim të dashur, Qemal Stafën?!

Në bazën ku isha, erdhi një shok dhe, dulce qarë, më tha:

- Armiku na vrau Qemal Stafën!

Vura duart në kokë dhe nuk i mbajta dot lotët.

- Ku e vranë? - i thashë.

- Në Tiranë, - më tha shoku, - në një shtëpi në bregun e lumit të Tiranës.

U ngr ita në këmbë dhe me shpresë i thashë:

- S'duhet të jetë e vërtetë, Qemali që në mëngjes u nis për në Vlorë. Për këtë jam i sigurt, mos e besoni, se armiku hap parulla!

- Mjerisht, - më tha shoku, - kjo është e vërtetë. Qemali u vra dulce luftuar, ra heroikisht dhe mbrojti tërë

heqjen e shokëve që shpëtuan. Ai harxhoi gjithë municionin që kishte. - Dhe më tregoi tërë historinë e ngjarjes që ka përshkruar historia.

Kështu mbaroi Qemal Stafa, heroi i Partisë, Heroi i Popullit. Ai ra, për të mos vdekur kurrë, ai u bë simbol i madh i luftës dhe i vetëmohimit për kauzën e madhe të komunizmit, të socializmit, për kauzën e Partisë dhe të Rinisë Komuniste të Shqipërisë, për këto ditë të bukura që gëzojnë populli dhe atdheu ynë socialist.

T y rini e mrekullueshme e atdheut tonë, asgjë nuk të ndali në rrugën e çlirimit kombëtar dhe shoqëror, ku të udhëhiqte Partia e shtrenjtë. Ti shkrepje si vetëtima mbi okupatorët dhe tradhtarët, ty s't'u drodh kurrë dora, ti ishe zjarr, barut e çelik.

Të pashë në demonstrata, në luftë të hapur dhe në ilegalitet, të pashë në aksione dhe në beteja, ku ti qëndroje si heroinë, ti u ndodhe në vendet më të rrezikshme ku të

kaktonte Partia. Ti rini e vendit tonë ia bëre të padurueshme jetën armikut në qytete, ti mbushe çetat, batalionet e brigadat tona të lavdishme partizane dhe e godite për vdekje armikun. Ti me Partinë Komuniste të Shqipërisë, si nënë

të lavdishme, si edukatore dhe udhëheqëse të pagabueshme, dole vigane në fitoren e madhe të çlirimit.

Partia dhe populli jo vetëm mburreshin me ty, pjellën e tyre të kalitur në zjarr e në furtuna. por që në ditët e para të Çlirimit të besuan detyra të rënda dhe të lavdishme. Kishte njerëz që thoshin: «Këta s'do t'ia dalin dot mbanë, pse janë të rinj», por për Partinë ju ishit më të pjekurit e më të zotët, se ju pikërisht në Luftën Nacionalçlirimtare fituat një eksperiencë kolosale.

Dhe skeptikët u çarmatosën: Libri i ndritur i Shqipërisë socialiste është i hapur dhe shkëlqen, pse në të pasqyrohen edhe përpjekjet, luftërat, guximi, heroizmi, sakrificat, gjaku, dituria e zotësia e rinisë sonë heroike, edhe drejtimi i drejtë politik, ideologjik dhe organizativ i asaj Rinie Komuniste që u formua në zjarrin e mitralozave, të asaj rinie që sot quhet Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë, që udhëhiqet si kurdoherë nga Partia e Punës e Shqipërisë në betejat e reja për ndërtimin e socializmit.

KONGRESI HISTORIK I PËRMETIT

Gjithmonë e kujtoj me mall Përmetin e majit 1944 me pamjen e tij festive, sallën e Kongr esit të zbuluar, mensën e pastër me tavolina të gjata, shokët që u kër citnin tytat e armëve kur takoheshin me njëri-tjetrin. Të gjitha këto sfidonin gërmadhat e shkaktuara nga lufta dhe ishin një gëzim i madh që na mbushte zemrat. I shoh shokët, ashtu të rinj, siç kanë qenë atëherë, të gjallë, të qeshur, entuziastë.

Kur kujtoj Përmetin e ditëve heroike, bëhem shumë më i ri se ç'jam sot që po shkruaj këto radhë. Është e natyrshme që kujtesa nuk është aq e freskët, sa të vij në mend të gjitha gjërat një për një, por ai «fluid» i mrekullueshëm i atyre kohëve heroike por të vështira, ai e..taziazëm i madh i ditëve të paharruara të Kongresit, ai zjarr që vlonte në zemrat tona, edhe tani, me po atë forcë më vlon e më përshkon gjithë trupin dhe e ndiej se jam akoma i ri.

Mbrëmjen dhe natën e 23 majit e kaluam në një atmosferë të gëzueshme. Zienin lënga dhe vallja, bisedat e përzemërta, skeçet luftarake që do të vazhdonin gjatë gjithë ditëve të zhvillimit të Kongresit e që i shfaqnin partizanët në skena të improvizuara mbi gërmadhat. Bile në Përmet ato dite u zhvillua edhe java e artit revolucionar. Këtu. nga aktorët më të mire partizanë. u krijua grupi teatral dhe fillon edhe historia e teatrit tonë të realizmit socialist.

Darka për delegatët ishte shtruar në një ish-kazermë të armikut, pastruar e rregulluar më së miri, me tryeza të gjata. pjata e gota për secilin. Kishte në ndonjë rast edhe ndonië kupë raki e ca meze të thjeshta. Çdo drekë kishim riga dy gjellë bile disa herë provuam edhe hallvë!

Dhe ja. të nesërmen më 24 maj 1944 delegato e të fuqar. zncs untuziazmit të popullit e të partizanëve. u drejtuan për në sallën historike ku do të zhvillonte punimet Kongresi. Në orën dhjetë hvmë në sallë, në shokët e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar dhe të Shtabit të Përgjithshëm. Delegatë e të ftuar, pleq e të rinj, partizanë e komandantë, gra, klerikë, patriotë, ria pritën në duartrokitje e për minuta të tëra. në këmbë. brohritnim së bashku.

Salla ishte e porsalyer me gëlqere. Një flamur i madh Shqipërisë mbulonte murin përballë. kurse anash tij ishin vendosur portretet e Skënderbeut e të Ismail Qemalit. Një rletër mbi tokë, rreth sallës, ishte vendosur një zinxhir i ndërpre:-ë riga parulla: «Vdekje fashizmit - Liri popullit».

Kongresin e hapëm me një minutë heshtje për të rënë në luftë dhe, pas këtij nderimi solemn për ata që kishin dhënë gjakun, rininë, dhe jetën për lirinë e atdheut, Omer Nishani mbajti fjalën e hyrjes. Duke bërë një përmbledhje të shkurtër të përpjekjeve lridashëse të popullit tonë. ai evokoi lëvizjet e popullit shqiptar për të mbrojtur tokën arbëore.

- Fjalën ia jap shokut Enver Hoxha, përfundoi doktor Nishani. Në emër të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar ai do të mbajë raportin «Zhvillimi i Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar në lidhje me ngjarjet ndërkombëtare».

Kisha marrz pjesë, kisha folur e kisha drejtuar mbledhje e konferenca të rëndësishme të Partisë. të Frontit. e të pushtetit katër vjet me radhë: në të gjitha këto. bashkë me sigurinë e vendosmërinë që ria jepte forca e Parlisë dhe e luftës. kishte ndër edhe emocione të thella, por ndjenjat e emocionet që më përshkuan këtë radhë, ndërsa po bëhesha gati të nisja raportin, ishin të veçanta e që s'do t'i harroj kurrë.

Megjithatë, duartrokitjet dhe ovacionet e gjata të delegatëve, thirrjet e tyre entuziaste e të pandërprera, më dhanë kohë ta n lbulidli ja veten e zëri të buçiste me at ë siguri e atë forcë që e kërkonte vetë kjo ngjarje e rradhe.

- Par tia Komuniste e Shqipërisë, - deklarova rii. Kongres. - vuri në shërbim të atdheut e të popullit jetër e anëtarëve të saj dhe çdo gjë që kishte të sajën. Ajo u bë organizuesja dhe udhëheqësja e vërtetë në kryengritjen znt armë kundër okupatorit dhe reaksionit më të tërbuar. ajo ka qëndruar kurdoherë në krye të luftës dhe është përpjekje: për të bashkuar masat e popullit dhe të gjithë nacionalistët e ndershëm dhe patriotët në një front të përbashkët kundër pushtuesve.

Kjo deklaratë që u prit me brohoritje dhe me entuziazëm, pasqyrore një fakt historik të pakundërshtueshëm. Edhe më parë. gjatë luftës, ne kishim folur për rolin e Partisë Komuniste, për udhëheqjen e saj në Front e në Ushtrinë Nacionalçlirimtare dhe, më e rëndësishmja, e kishim zbatuar këtë në jetë. Por aktualisht kishte rëndësi të madhe afirmimi i Partisë si faktori vendimtar i fitores në një ngjarje të tillë të macilhe si Kongresi i Përmetit. Me këtë ne, në parim dhe në praktikë, riafirmuam dhe ruam edhe në të ardhmen rolin udhëheqës të Partisë.

Më tej në raportin tim fola për përpjekjet e reaksionit për të minuar e për të sabotuar Luftën Nacionalçlirimtare, për të larguar popullin nga Partia dhe nga Fronti.

Pas ekspozesë që i bëra luftës sonë kundër okupatorëve dhe tradhtarëve, në raport trajtoja çështjen e masave dhe vendimeve të domosdoshme për çlirimin dhe të ardhmen e vendit, në dritën e evenimenteve të jashtme e ndër kombëtare.

Përfundimin e raportit që mbajta në Kongresin e Përmetit delegatët e pritën me duartrokitje e brohoritje të pareshtura. të cilat ishin shprehje të optimizmit revolucionar, të gëzimit dhe të vendosmërisë për të ecur përpara në rrugën që tregonte Partia.

Të paljaruara do të mbeten për lina entuziazmi prekës i delegatëve. fjalët e tyre të zjarrta në diskutime. Përfaqësuesit e popullit flitnin për fitoret e ushtrisë sonë, për pushtetin popullor që vepronte gjallërisht, sillnin fakte të reja për veprimtarinë e reaksionarëve, aprovonin vendimet që propozoheshin. Është pak të thuash se salla që e elektrizuar. Atmosfera festive dhe entuziazmi i të pranishmëve gjente rastin të shpërthente kur doktor Nishani, në hapje apo gjatë seancave, njoftonte lajmet më të fundit për sukseset e repartëve partizane në frontin e luftës, apo lexonte letrat përshëndetëse që i vinin Kongresit. Mes tyre ishin edhe përshëndetjet e shokëve tanë Baba Faja e Haki Stërmilli që nuk kishin mundur të vinin në këtë kuvend historik.

Për gati dy ditë vazhduan diskutimet rreth raportit.

Të nesërmen, më 28 maj, ishte dita e mbylljes së Kongresit Antifashist të Përmetit. Seanca përfundimtare, ku do të aprovoheshin vendimet historike për popullin shqiptar, u la të zhvillohej pasdite; në mbrëmje delegatët do të festonin bashkë me popullin patriot e mikpritës të Përmetit, do të përshëndeteshin e do të ndaheshin me të, që të nesërmen në mëngjes secili të nisej për atje ku e thërriste detyra ndaj atdheut.

Një atmosferë optimiste dhe e gëzuar zotëronte atë ditë. Ajo ndihej në shtëpitë përmetare, në rrugë, lexohej në fytyrat dhe në sytë e qeshur të shokëve delegatë, komandantë e komisarë, të cilët vinin e na takonin për çështje pune, sillnin raporte e informacione, merrnin urdhra e udhëzime e niseshin të gatshëm në detyrë. Ndërkohë vinin edhe të tjerë, për takime e biseda të lira, vinin miq e shokë për t'u çmallur e për t'u përshëndetur se «ku i dihet, mbase nuk shihemi më». Sikurse edhe shokët e tjerë, edhe unë kisha shumë punë dhe nuk më vinte mirë t'i ndërprisja ato po, kur hapej dera e hynte në dhomë, bie fjala, Hasan Puloja, e më ftonte për një kafe e për një duhan, nuk mërzitesha se nga këto takime me shokët e dashur e njerëz të mirë të popullit të freskohet mendja, të gëzohet zemra, të shtohet vullneti për punë.

Pasdite, kur hymë në sallë, delegatët, që kishin zënë vend e këndonin grupe-grupe, na pritën me duartrokitje e ovacione për Partinë, për Frontin e për Ushtrinë Nacionalçlirimtare. Nuk pushonin ato për minuta të tëra, sado që Omer Nishani, edhe vetë i emocionuar, i ftonte delegatët të vendosnin qetësinë. Më në fund, kur u vu disi «regulli», doktori shpalli hapjen e seancës dhe i dha fjalën sekretarit të Kryesisë së KANÇ-it për të lexua projektvendimet që do t'i aprovonte përfundimisht Kongresi. Leximi i projektit, që normalisht nuk do të donte as një orë, zgjati shumë më tepër, se duartrokitjet shpërthenin pas çdo vendimi, bile edhe midis tyre, për vete të veçanta. Si të mos brohoritnin me gjithë zemër të dërgua rit e këtij populli që kishte luftuar në shekuj për liri drejtësi, kur dëgjonin: «Të ndërtohet Shqipëria e re demokratike e popullore sipas vullnetit të popullit!»! Ata shikonin në të kurorëzimin e luftës së gjatë e të vështirë qëllimin për të cilin mijëra e mijëra shokë të tyre kishin derdhur gjakun, kishin dhënë rininë dhe jetën e tyre. U unanimet aprovuan ata edhe vendimin që Ahmet Zogut satrapit e tradhtarit të popullit shqiptar dhe familjes së tij t'i ndalohej hyrja në Shqipëri. U lexua ky vendim dhe Omer Nishani, që drejtonte seancën, pyeti:
- A e aprovon Kongresi?

Në sallë këtë herë nuk pati duartrokitje. Delegatët i shprehën mendimin e tyre me thirrjet «Poshtë Zogu!» dhe me përplasje të këmbëve. Njëzëri i aprovoi Kongresi edhe vendimet e tjera për mosnjohjen e asnjë qeverie tjetër që mund të formohej brenda ose jashtë vendit, për vazhdimin dhe ashpërsimin e luftës kundër pushtuesve, kuislin, gëve, Ballit Kombëtar, Legalitetit e çdo grupi tjetër reaksionar. Kongresi, gjithashtu, aprovoi vijën politike të Kë. shillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe veprimtarinë e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shprehu dëshirën që pranë tij të vinin misionet ushtarake të Bashkimit Sovjetik e të SHBA-së. Pastaj Kongresi i lexuan edhe vendimet e tjera të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar e të Kryesisë së tij, mes të cilave edhe ato për rishikimin e prishjen e të gjitha marrëveshjeve politike e ekonomike skllavëruese të Zogut me vendet e tjera për funksionet e kompetencat e KANÇ-it e të Kryesisë si tij etj.

Me duartrokitje e ovacione u prit nga delegatët vendimi i Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar për emërimin dhe përbërjen e Komitetit Antifashist me funksionet e një qeverie provizore.

Kështu, me këto vendime të një rëndësie historike, që hapnin një epokë të re të ndritur në historinë e lashtë të popullit shqiptar, Kongresi Antifashist i Përmetit kreu misionin e tij historik. Me grushtin e tyre të ngritur lart, ashtu siç përshëndetnim njëri-tjetrin në luftë për liri, delegatët vulosën aktet themelore që shënonin lindjen e shtetit të ri shqiptar dhe ravijëzonin konturet e rrugës në të cilën do të ecte Shqipëria në të ardhmen. E gjithë fryma revolucionare e Kongresit të Përmetit, përvoja e Luftës sonë Nacionalçlirimtare, bashkë me vendimet historike që u morën, ishin pasqyruar në Deklaratën e Kongresit, të cilën e lexoi Sami Baholli dhe u përshëndet e u aprovua njëzëri.

Në këtë Deklaratë, e cila shpejt do t'i bëhej e njohur gjithë popullit, sintetizohej lufta e popullit shqiptar që nga 7 prilli 1939, etapat dhe momentet themelore të saj, konstatohej roli antikombëtar e antipopullor i regjimit të Zogut, i qeverisë kuislinge, i tradhtarëve dhe i kolaboracionistëve ballistë, zogistë e të tjerë, vihej me forcë në dukje roli udhëheqës e frymëzues i Partisë Komuniste në Luftën Nacionalçlirimtare. Në analizën e faktorëve të jashtëm, në Deklaratë theksohej lufta e popujve sovjetikë dhe e Ushtrisë së Kuqe nën udhëheqjen e Stalinit si faktori kryesor i fitores së koalicionit antifashist të popujve, vlerësohej drejt lufta e anglo-amerikanëve si dhe ajo e popujve të Ballkanit.

Pas leximit të Deklaratës dhe të disa mesazheve, në mbyllje e mora fjalën unë me cilësinë e kryetarit të Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar.

- Ky Kongres, - thashë mes të tjerash në fjalimin tim të shkurtër, - është një nga sukseset më të mëdha të lëvizjes sonë, është tribuna ku për herë të parë në Shqipëri shfaqen lirisht mendimet dhe dëshirat e popullit, ku u morën vendime me rëndësi për fatin e atdheut tonë, për zhvillimin e luftës dhe për krijimin e një të ardhmeje të lumtur.

Të ndërgjegjshëm për barrën e rëndë që populli shqiptar na ngarkon, - vazhdova më poshtë, - do të vëmë të gjitha forcat tona dhe jetën tonë në shërbim të popullit dhe të atdheut, do të qëndrojmë besnikë deri në vdekje vullnetit të popullit tonë për realizimin e një Shqipërie independente e demokratike.

Vendimet e këtij Kongresi të Vi çojmë menjëherë në popull, bashkë me të të luftojmë që Vi zbatojmë pa kursyer as jetën, të mobilizojmë të gjitha forcat e gjalla të popullit dhe, të bashkuar rreth Këshillit e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar, të hidhemi më me hov në luftë për të shpejtuar çlirimin e popullit tonë!

Pas fjalës sime të gjithë delegatët njëri pas tjetrit vunë nënshkrimin e tyre poshtë vendimeve që ishin përmbledhur në Librin e Kongresit, në atë libër ku, në mënyrë simbolike, kemi vënë firmat sa herë kemi vajtur në Përmet, në përvjetorët e kësaj ngjarjeje të lavdishme.

Kështu u mbyll Kongresi i Përmetit, një nga ngjarjet më të rëndësishme të epopesë së Luftës sonë Nacionalçlirimtare, një monument i ngritur nga lufta dhe mençuria e Partisë dhe e popullit, një vepër e madhe me rëndësi kolosale për të ardhmen e Shqipërisë.

Në Përmet Shqipëria, e udhëhequr nga Partia e saj heroike Komuniste, u tregoi miqve dhe armiqve se ishte e patundur në rrugën e saj të drejtë. Hesapet nuk bëheshin më si dikur, ato kohë kishin

kaluar për të mos u kthyer më kurrë. Historia s'përsëritej më si donin ata: populli ishte bërë zot i fateve të veta.

NË HELMËS, NË MES BREZIT HEROIK TË SHQIPËRISË

Pikërisht në valën e këtyre punëve Partia vendosi që të zhvillohej Kongresi I i Organizatës së BRASH-it. Kjo ishte një ngjarje e madhe jo vetëm për rininë, por edhe për Partinë e për gjithë popullin tonë, sepse rinia ishte forca më e gjallë dhe aktive në luftë dhe nesër, pas Çlirimit, kjo armate e pamposhtur dhe e organizuar, do të luante një rol të pazëvendësueshëm në gjithë jetën e vendit, në rindërtimin, në fushën politike, në qeverisje. E edukuar me frymën e patriotizmit të lartë, kurdoherë rezervë luftarake e Partisë, ajo do të ishte vazhduesja e stafetës së revolucionit tonë të paparë ndonjëherë në historinë e popullit.

Pikërisht se e vlerësuam kështu, prandaj ne, shokë të udhëheqjes së Partisë, të Komitetit Antifashist e të Kryesisë, që ishim rivendosur përsëri në Helmës, me gjithë punët e shumta, u ndodhëm ato dite pranë të rejave e të rinjve të revolucionarë.

Kongresi do të mbahej në Helmës, në një fushë të bukur mbi fshat. Ishin ditë të gëzuara dhe plot punë. Nakoja e Nexhmija përgatitën raportin, të cilin pastaj e pamë së toku; shokët e tjerë të rinisë po bënë përgatitjet për të pritur delegatët dhe të gjithë, edhe ne «më të moshuarit», pritnim ditën kur do të hapesh Kongresi. Nga të gjitha anët e vendit vinin delegatët e rinisë, zbritnin nga repartet ushtarake, nga çetat, nga terreni, legalë e ilegalë, gjithë zjarr e plot vrull rinor, me një dashuri dhe besnikëri të madhe për Partinë dhe Luftën Nacionalçlirimtare.

Ditën që filloi punimet Kongresi, më 8 gusht, u nisëm që në mëngjes nga Helmësi tok me doktor Nishanin dhe me shokë të tjerë dhe u ngjitëm në fushën e bukur të Lirëzës, që buçiste nga këngët e brohoritjet për Partinë Komuniste të Shqipërisë. Të gjithë delegatët të gëzuar, të qeshur, të lumtur, dulce u hapur nga të dyja anët, na liruan rrugën dhe ne kaluam përmes tyre në revistë, si para një truproje nderi, të përbërë nga të reja e të rinj partizanë vendosur përballë njëri-tjetrit në pozicion për nder arme. Zëmë vend në tribunën e Kongresit krahas me shokë të udhëheqjes së rinisë, si: Nako Spiru, Ramiz Alia, Nexhmije Xhuglini, Alqi Kondi, Tasi Mitrushi e të tjerë.

Për një moment u vendos qetësia dhe zeri i kthjellët e plot emocione i një të riu na preku të gjithë:

- Shokë. - tha ai, - në emrin e të gjithë delegatëve që përfaqësojnë rininë e zonave të çliruara e të paçliruara dhe të të gjitha reparteve të ushtrisë sonë u uroj mirëseardhjen në Kongresin e Rinisë udhëheqësve kryesorë të Partisë Komuniste, të ushtrisë e të shtetit tonë të ri. Duke i falënderuar nga zemra, ne e quajmë pjesëmarrjen e tyre në Konees një nder, inkurajim e ndihmë të madhe për brezin e ri të Shqipërisë!

Ky i ri, me trup ende të imët, por me shikim të mprehtë e fjalë të zjarrta, ishte shoku Ramiz Alia. Me të për herë të parë u poqa në Helmës, ndërsa nga larg, si të thuash, qemë njohur me kohë. Shokët, sidomos Nakoja e Nexhmija, më kishin folur për Ramizin me respekt e simpati si për një shok të ri të shkathët e luftarak që ishte dalluar qysh në fillim në Tiranë e sidomos në organizimin dhe udhëheqjen e Komitetit e të organizatës së Rinisë të Qarkut të Beratit. Personalisht dy muaj më parë kisha marrë prej tij një letër, në të cilën menjëherë më tërhoqi vëmendjen kompetenca me të cilën ai ngrinte probleme të punës politike e të punës me rininë në Brigadën VII Sulmuese, ku qysh në fillim ishte ngarkuar me detyrat e përgjegjësive të rinisë dhe në seksionin politik të brigadës. Në përgjigjen time e përgëzoja dhe i transmetoja këshilla e udhëzime të udhëheqjes së Partisë për ta çuar edhe më tej punën për edukimin e rinisë. Atëherë Ramizi që djalë fare i ri, por me mendime të pjekura e të qarta, tip luftarak e me iniciativë, cilësi këto që ai i shfaqti edhe në ditët kur zhvillonte punimet Kongresi. Në Helmës delegatët e zgjedhën atë anëtar të udhëheqjes së BRASH-it dhe që këtej, me punë e veprimtari të pandërprerë e të frytshme, ai do ta çonte më tej rrugën e nisur si një nga udhëheqës kryesorë të rinisë e më pas të Partisë dhe së bashku do të na lidhte një bashkëpunim e miqësi e ngushtë, që e ka bazën në punën tonë për triumfin e idealit të Partisë.

Salla e Kongresit I të Rinisë ishte fusha, seancat e tij u zhvilluan në hapësirë, në ajrin e pastër të Qafës së Martës.

E mora edhe unë fjalën dhe në emër të Komitetit Qendror të Partisë, duke përshëndetur Kongresin, u fola përfaqësuesve të rinisë për besimin e madh që kishte pasur gjithmonë Partia te brezi i ri heroik i Shqipërisë, vlerësua lart kontributin e madh të të rinjve në luftën për çlirim dhe theksova:

- Beteja të reja na presin për të ndërtuar atdheun, për të forcuar pushtetin demokratik, për ta futur Shqipërinë tonë në udhën e lumturisë! Prandaj ju, të rinjtë e të rejat e Shqipërisë, ashtu siç jeni sot në ballë të luftës virane për lirinë e atdheut, të jeni që nga këto momente e kurdoherë edhe në ballë të punës për rindërtimin e vendit, për zhdukjen e prapambetjes, për mbrojtjen dhe lulëzimin e këtij trualli që po e vaditim me gjak.

Delegatët e pritën me ovacione fjalën time përshëndetëse në emër të Komitetit Qendror. Me brohoritjet dhe thirrjet e tyre të zjarrta, ashtu si edhe në diskutimet, ata shprehën dashurinë dhe besimin e patundur te Partia Komuniste, vendosmërinë për të ecur pa lëkundje në rrugën e saj.

Kishim shumë dëshirë të rrinim edhe ne atje në fushën e Lirëzës, ku ndihej freskia, vrulli dhe forca e rinisë. Por i lamë të rinjtë të vazhdonin punën, pse na pritnin punë dhe detyra të reja. Kur po zbritnim të gëzuar të tatëpjetën, të përcjellë nga brohoritjet, përsëritnim pareshtur lajtmotivin e bisc-aave tona:

- Ne do të fitojmë patjetër mbi çdo armik që do të na dalë përpara !

Doktor Nishani, tepër i emocionuar, fshinte me shami lotët dhe thoshte:

- Ç'ka bërë, ç'ka bërë kjo Parti! Ç'patriotizëm ka ngjallur në zemrat e të rinjve!

Duke i lënë të rinjtë lart të zhvillonin Kongresin e tyre në anëtarët e Komitetit Qendror të Partisë, të Komitetit Antifashist dhe të Kryesisë së Këshillit vazhdonim punën nga mëngjesi deri natën vonë duke përcaktuar masat për ta bërë sa më të afërt ditën e Çlirimit, për të shëruar plagët e luftës, për të rindërtuar shtëpitë, shkollat, urat, për të siguruar bukën e popullit, për të mëkëmbur atë çikë industri që kishim etj.

NË TIRANËN E ÇLIRUAR NGA ARMËT PARTIZANE

Dhe ja në mbrëmjen e 16 nëntorit na erdhi në Berat lajmi se Tirana, kryeqyteti i atdheut tonë, thuajse ishte çliruar plotësisht. Pushtuesve dhe tradhtarëve nuk u kishin mbetur më shumë se disa orë jetë. Me një gëzim të papërmbajtur dhe me një emocion të veçantë, u ula dhe shkrova qysh atë mbrëmje mesazhin drejtuar popullit shqiptar për këtë shtet të madh, kurse të nesërmen, në mëngjesin e 17 nëntorit, u dëgjuan pushkët e fundit dhe kryeqyteti i atdheut tonë u çlirua një herë e përgjithmonë.

Rruga për Tiranë tashmë ishte e hapur. Pas kaq vjet betejash e përpjekjesh, mundimesh e sakrificash në krye të Partisë e të luftës për liri, erdhi çasti që ne djemtë e vajzat e popullit të hynim fitimtarë në kryeqytet.

Propozova që Qeveria të hynte në Tiranë më 28 Nëntor, në ditën e shënuar të Shpalljes së Pavarësisë. Vetë zgjedhja e kësaj dite për vendosjen e Qeverisë Demokratike në kryeqytetin e çliruar nga armët partizane do të ishte kuptimplote.

Ndonëse në kushte normale distanca nga Berati në Tiranë me automjet mbulohej në jo më tepër se tri orë, ne u nisëm nga Berati një ditë më parë, sepse rrugët ishin të prishura dhe mund të ndodhte edhe ndonjë vonesë e paparashikuar. Dhe me të vërtetë udhëtimi ynë i parë nëpëratdheun e sapoçliruar s'mundi t'i shmangej njëfarë odi-seje. Deri tek ura e Hasan Beut, siç i thoshin në atë kohë Urës Vajguror e, shkuam me disa automobila e me triçikla, që ia kishim zënë armikut apo i kishim rekuizuar. Aty i lamë makinat e triçiklat, sepse më tutje nuk kalonin dot, ngaqë gjermanët në tërheqje e sipër e kishin hedhur në erë urën.

Kaluam, pra, Osumin me mjete rrethore dhe matanë hipëm në një autobus që na priste. Kur arritëm tek ura e Kuçit zbritëm edhe nga autobusi, e kaluam lumin me vështirësi mbi një trap të

improvizuar dhe vazhduam rrugën, derisa në Rrogozhinë na «doli» përpara një tjetër pengesë: Shkumbini. E lamë autobusin, hodhëm lumin gru-pe-grupe me një trap të vogël dhe, me disa vetura të ardhura posaçërisht nga Tirana, u kthyem djathtas, në drejtim të Elbasanit, sepse rruga Rrogozhinë-Kavajë-Tiranë ishte e minuar dhe me ura të shkatërruara.

Meqë kishim kaluar vështirësi të panumërta gjatë luftës, nuk na bënë ndonjë përshtypje të jashtëzakonshme këto peripeci të udhëtimit. Përkundrazi, na jepnin rast edhe për ndonjë shaka e humor. Sidoqoftë, gjatë gjithë kohës që udhëtuam., duke parë majtas e djathtas mendoja se ç'punë të mëdha na pritnin, se rindërtimi duhej filluar nga gjithçka, nga shtëpitë e djegura e nga këto ura, pa të cilat s'bëhej një hap.

Qyteti i Elbasanit kishte dy javë që ishte çliruar. Nga ballkoni i hotelit akoma me emrin e mëparshëm «Moderno», ku u vendosëm për të kaluar natën, përshëndeta popullin, që kishte mbushur sheshin dhe rrugët. Të nesërmen në mëngjes, më 28 Nëntor, kolona jonë u nis për në Tiranë përcjellë me dashuri nga grumbuj njerëzish, nga të dy anët e rrugës, deri në të dalë të Elbasanit.

Edhe këtë rruga ishte e dëmtuar, kudo dukeshin të freskëta gjurmët e luftës. Kolonat gjermane, të ardhura nga Greqia, nuk e kaluan dot Qafën e Kërrabës për t'u ardhur në ndihmë forcave të tyre, të futura në një darëtë zjarrtë në Tiranë. Goditjet tona të fuqishme i shpartalluan krejtësisht. Anash rrugës shikonim tanke e autoblanda të përmbysura, automjete të djegura, të zhvendosura pak sa për të hapur kalimin, pirgje me gëzhoja mitralozash, helmata ushtarësh armiq. Sa më tepër i afroheshim Tiranës aq më të dukshme bëheshin, nga të dyja anët e udhës, armët e shkatërruara të armiqve. Kishte diçka të bukur e simbolike në këtë peizazh: fitimtarët kalonin krenarë përmes armëve të thyera e mbeturinave të t5 mundurve, të pushtuesve.

Po ktheheshim në Tiranë tonë të dashur dhe, për herë të parë pas kaq vietësh, hynim atje jo ilegalë, me emra e me dokumente false, por lirisht e, për më tepër, fitimtarë! Tirana që për vite me radhë ngrysej e gdhiehej mes fishkëllimave të bilbilave, sirenave të alarmit e në coprificoco, tanfi ishte e çliruar pas një lufte heroike e të lavdishme. Këtë luftë e udhëhoqi Partia jonë marksiste-leniniste syshqinonjë, që nuk gaboi asnjëherë në vijë, se kishte në zemër dëshirat dhe aspiratat e popullit. Ajo mori përsipër barrën më të rëndë, por të shenjtë dhe e mbajti me nder duke e çuar këtë herë popullin tonë në fitoren e plotë, krahas lirisë ajo e solli popullin në fuqi, në pushtet.

Duke iu afruar kryeqytetit, ndihesha i emocionuar dhe nëpër mend më vinin ditët qz kisha kaluar atje, kur bashkë me shokë të dashur e të afërt, me Qemalin, me Vasilin e të tjerë, punuam që nga grupet e veguara, në grindje me njëri-tjetrin, të krijonim Partinë tonë Komuniste, avangardën e çeliktë të popullit. Kujtoja demonstratat e aksionet tona të para, ditët e netët kur ilegalisht kalonim nga njëra bazë në tjetrën, të ruajtur nga dashuria e njerëzve të thjeshtë të popullit. Këtu në Tiranë qemë rritur, qemë kalitur, kishim fituar eksperiencë për të organizuar e për të drejtuar, për të kryer detyrat që na kishte ngarkuar Partia jonë e dashur.

Që nga Pallati i Brigadave, gjatë Rrugës së Elbasanit e deri në qendër, dukeshin gjurmët e luftës heroike. Nëpër rrugë, në gërmadhat e mureve të shtëpive e në godinat e tjera dukeshin shenjat që kishin lënë predhat e plumbat, deri edhe minarja në qendër, pranë sahatit të madh, ishte e prerë përgjysmë nga goditjet e artilerisë.

Por popullin e Tiranës e gjetëm të gëzuar, me këngë në gojë, entuziast e optimist, tek priste Qeverinë e tij. Një masë e madhe njerëzish kishte mbushur rrugët e bulevardin e madh para hotel «Dajtit».

Nga një tribunë e thjeshtë e përshëndeta popullin me rastin e Ditës së Pavarësisë, të cilën për herë të parë pas kaq vjet lufte e festonim të lirë.

- Flamuri ynë i lavdishëm, - thashë i emocionuar, - i skuqur me gjakun e heronjve të popullit të rënë në këtë luftë antifashiste, valon sot krenar në qiellin e Shqipërisë së lirë. Pesë vjet kanë kaluar nga robëria e rëndë fashiste, pesë herë nëpër rrugët e qyteteve të Shqipërisë, në çdo 28 Nëntor është derdhur gjaku i bijve heroikë, që përlesheshin me bajonetat e okupatorit dhe të tradhtarëve. Dita e Flamurit u bë kështu dita dy herë e shenjtë, Dita e Shpalljes së Pavarësisë dhe e bashkimit të popullit shqiptar.

I ndërprerë shpesh nga brohoritjet e duartrokitjet e pareshtura, fola për luftën heroike të popullit tonë, i cili iu përgjigj menjëherë kushtrimit të bijve të tij më të mirë dhe, me Partinë në krye, arriti të çlirojë një herë e për

gjithmonë atdheun e të marrë vetë frenat e së ardhmes në dorë.

- Ndërtimi i Shqipërisë, zhvillimi i ekonomisë, i kulturës dhe i arsimit të popullit, ngritja e nivelit të jetesës së tij hapin një faqe tjetër të historisë sonë, histori që është në dorën tonë ta bëjmë dhe do ta bëjmë po aq të lavdishme sa edhe Luftën Nacionalçlirimtare, - thashë më poshtë. - Edhe në këtë luftë do të dalim fitimtarë, sepse tani ne kemi pushtetin tonë, që është i popullit dhe punon për popullin. Prandaj të japim çdo gjë për pushtetin, ta bëjmë këtë të fortë, se kështu do ta ndërtojmë vendin tonë të djegur, do të mëkëmbim bujqësinë dhe ekonominë tonë. do të ngremë shtëpitë e shkatër ruara, do të çelim shkolla e do të ndërtojmë spitale. Shqipëria do të bëhet një kantier i madh pune. Në luftën për çlirim ne nuk kursyem as jetën, sot nuk duhet të kursejmë as mundin dhe djersën. I madh dhe i vogël e kupton se nuk robtohet më për të huajt. por punon e ndërton vendin e tij, jetën e tifi.

Ishin gaste historike, emocionante e të paharruara për Partinë dhe për popullin tonë ! Ishin çastet e gëzimit të fitores së madhe. Me gjak, me djersë, me mund e sakrificë kishim kryer një vepër gjigante dhe madhështore.

Të nesërmen e kësaj dite të paharruar na erdhi lajmi i çlirimit të qytetit të Shkodrës, i cili shënonte dhe çlirimin e gjithë Shqipërisë.

III

HERONJ DHE TRIMA LUPTËTARË

PROLETARI VASIL SHANTO

Një të diel, tek po shëtija në një rrugë të Tiranës, një djalë me biçikletë u ndal në krahun tim, zbriti, më dha dorën, e duke më përshëndetur me emër, më tha

- Jam Vasil Shantoja.

- Të njoh, - iu përgjigja.

- Bëjmë një copë rrugë tok dhe shkëmbejmë disa fjalë? - më propozoi Vasili.

- S'kam kundërshtim, - i thashë, - po ç'keni për të më thënë?

Vasil Shantoja, duke më vështruar me ata sytë e ëmbël ëndërrimtarë, më tha

- Shoku Enver, kështu do të vazhdojmë ne, të zihemi e të grindemi? Ne as të takohemi me njëri-tjetrin nuk guxojmë!

Të them të drejtën, në ato momente e shikova Vasil Shanton me ndjenja të përziera: e ndieja se kisha përpara një punëtor, një proletar që po më zgjaste dorën dhe kjo më shtynte të afrohesha pa ngurruar, por, nga ana tjetër, nxirrte kokë edhe mendimi se këta ishin të gabuar në idetë e tyre, ndërsa ne ishim «në vijë të drejtë». Hezitova pak, por, pasi u mendova, vendosa: «Në djall të vejë Koço Tashkoja! - thashë me vete. - Unë do t'ua shpjegoj shokëve të grupit, Pilos, Ilos e të tjerëve, bile edhe Koços vetë, dhe e di se Piloja me shokë do të më mbështetin». Atëherë i thashë Vasilit

- Pse jo, takohemi, do të jetë mirë të bisedojmë.

Vasili u gëzua, qeshi dhe më tha:

- Gëzohem që gjeta mirëkuptim tek ti, se Koço Tashkoja s'pranon. Kur do të takohemi dhe ku dëshiron ti? - më pyeti.

- Për mua s'ka rëndësi vendi, - iu përgjigja. Takohemi ku të duash, vetëm ta lëmë mbas disa ditësh, se duhet të bisedoj më parë me shokët.

- E kuptoj, - ra dakord Vasili. - Atëherë takohemi në shtëpinë e dy mësuesve, shokë të mirë, simpatizantë të grupit tonë, Spiro dhe Bojka Lazri i quajnë.

Më tregoi rrugën dhe shtëpinë e tyre, e cila ndodhej afër vendit, ku sot është stacioni i trenit i Tiranës. Caktuam ditën e takimit dhe u ndamë, duke i shtrënguar dori~n njëri-tjetrit. S'kishte ardhur akoma koha e përqaftimeve.

Në ditën e caktuar për t'u takuar me Vasilin unë shkova në shtëpinë e Spiro Lazrit dhe të Bojkës. Këta ishin dy mësues, burrë e grua, të dy nga Shkodra. Që ditën e parë u bëmë miq, ishin simpatikë dhe të sinqer të. Ata rrinin në një dhomë përdhese, por të pastër. Bojka dinte mirë edhe gjuhën serbe.

Erdhi dhe Vasili, u përqaftua me Spiron e me Bojkën, ndërsa ne të dy shtrënguam fort duart.

- Për hajër na qoftë! - i thashë Bojkës. - Në strehën tënde bujare po piqemi, Vasili dhe unë, dy komunistë nga dy grupe të ndryshme, por që jemi grindur e po grindemi për çështje parimore.

- Mali me mal nuk piqen, - themi ne andej, - por njerëzit s'ka si të mos piqen e të mos merren vesh, shtoi Vasil Shantoja, duke buzëqeshur, dhe më pa me dashuri me ata sytë e bukur, të ëmbël, të kaltër e me pika si flori.

Si komunist e si intelektual kisha lexuar mjaft dhe nga ato që kisha mësuar më erdhi ndër mend një shprehje e një psikologu francez: «Sytë janë pasqyrë e ndjenjave të brendshme». Instinktivisht i thashë vetes: «Enver, Vasil Shantoja është njeri i mirë, ai është proletar, është komunist. S'ka si të jetë ndryshe. Ne themi se këta bëjnë gabime, po ne, vallë, nuk bëjmë? Duhet të gjykojmë njëri-tjetrin dhe secili vetveten».

I rashë me pëllëmbë në gju Vasilit gjithë dashamirësi dhe i thashë

- Duhet medoemos të merremi vesh.

Bojka, që ishte më zemërçelur, u ngrit në këmbë e gëzuar, na përqafoi përsëri të dy dhe iu drejtua burrit të saj

- Hajde Spiro, t'u përgatitim nga një kafe miqve dhe t'u blejmë ndonjë mollë.

Kjo ishte mënyra më e lezetshme nga ana e Bojkës për të na lënë vetëm mua me Vasilin. Sa dolën të zotët e shtëpisë nga dhoma, i thashë Vasilit

- Vasil, atë ditë kur u takuam, ti më shtrove çështjen:

«A do të vazhdojmë të grindemi, kur atdheu ynë është në rrezik të madh?». Jo, ne nuk duhet të grindemi, por të merremi vesh. Këtë, natyrisht, nuk e kemi të lehtë, se ka plot gjëra që na ndajnë. Ka njerëz brenda dhe jashtë radhëve tona që nuk e duan bashkimin e grupeve komuniste dhe shkrirjen e tyre në një parti të vetme komuniste, ka antimarksistë që hiqen si komunistë, ka ambiciozë e intrigantë që shpifin për njërin e për tjetrin grup, ka edhe pikëpamje të gabuara dhe këto janë më të rrezikshmet. Ne e dimë se këto vështirësi që janë grumbulluar dhe që e pengojnë bashkimin tonë, nuk zhduken në një ditë.

- Jam dakord me çka po thua ti, Enver, - më tha Vasil Shantoja. - Do të na duhet ca kohë t'i sqarojmë këto, por me vullnet duhet ta bëjmë.

- Shoku Vasil, - i thashë, - jemi të gjithë bij të Shqipërisë, a do të luftojmë për atdheun dhe për popullin tonë të shumëvujtur e t'i çlirojmë nga zgjedha?

- Patjetër duhet të luftojmë, Enver, edhe sikur jetën të japim, - m'u përgjigj me vendosmëri Vasili.

I mora dorën, ia shtrëngova fort dhe i thashë:

- Shoku Vasil, pika jetike, akordi bazë për të vendosur është ky. Çështja tjetër që dua të diskutoj me ty është kjo: Do të luftojmë si komunistë për çlirimin e popullit dhe të atdheut apo si çfarëdo «nacionalist»?

- Sigurisht, si komunistë, - u përgjigj Vasili.

- Atëherë, - shtova unë, - ne duhet të bashkohemi, se komunistët nuk mund të luftojnë të përc-arë. Duhet të luftojmë të formojmë edhe ne Partinë tonë Komuniste. Në këto kushte kur ne e quajmë

Grupin tonë të Korc-ës «parti», ju të Shkodrës thoni «jemi ne partia», nga ana tjetër Andrea Zisi deklaroi se «vulën e Kominternit» e ka ai etj., nuk mund të arrijmë asgjë. Të gjitha këto pretendime shoqërohen me ide e me pikëpamje të ndryshme. Ka prej tyre që janë të drejta, por ka edhe të gabuara, false e trockiste si ato të Zisit, Anastasit, Aristidhit e, pse të mos e them, edhe të Zef Malës, që ne e dënojmë. Pikërisht këto janë poplat që janë grumbulluar Vasil, - i thashë. - Këto duhet t'i spastrojmë dhe të hapim rrugën tonë të drejtë. Këtë gjë nuk e bëjmë dot që sot, as vetëm ne të dy, por të biem dakord që të përgatitemi, edhe ju edhe ne, dhe të ecim me vendosmëri drejt gjetjes së momentit më të përshtatshëm për t'u ballafaquar e për të bërë një punë konstruktive historike. Je dakord në parim, shoku Vasil? Unë mendoj që edhe për këtë afrim duhet t'i pyesim patjetër edhe shokët që na kanë dërguar.

- Jam plotësisht dakord, - u përgjigj Vasil Shantoja. - Meqë zure në gojë Zef Malën, po të them se jam dakord me ty, ai është një renegat që na tradhtoi. Por dhe një gjë duhet të na kuptosh, shoku Enver, - shtoi ai. Unë e një pjesë e mirë e shokëve e njohim dhe e dënojmë Zef Malën, por ka dhe nga ata që akoma kanë iluzione për të. Ka bile ndonjë që e quan konfuzin antimarksist Zef Mala si «teoricien të madh». Ne për Zef Malën po i sqarojmë shokët me durim, se s'duam t'i humbasim.

- Shumë drejt e ke, shoku Vasil, - i thashë. - Kjo është detyra juaj, por dhe jona, e të gjithë komunistëve të ndershëm. Ne duhet të qartësojmë e të llogarisim c-do mendje, sepse luftën që kemi përpara s'do ta bëjmë vetëm ne komunistët, por gjithë bijtë e ndershëm e revolucionarë të vendit.

- Këtë kërkojmë edhe ne, për këtë do të luftojmë, - tha Vasili.

- Vasil, - iu drejtova, - edhe një gjë dua të shtroj me ty. Ne do të takohemi prapë, do të bisedojmë dhe do të vendosim, por c-ështëja qëndron këtu: nuk mund të parashikojmë që tani se kur do ta spastrojmë krejt rrugën dhe c'ua arrijmë asaj dite të lumtur e historike, krijimit të Partisë sonë, por gjatë kësaj kohe propozoj që t'u para

shtrojmë grupeve tona mendimin për të gjetur rrugë e forma të tilla bashkëpunimi që do të na ndihmojnë për veprime të përbashkëta kundër armikut. Ne jemi për aksione.

- Edhe ne jemi për aksion, - theksoi Vasili, - prandaj e pëlqej mendimin tënd. Unë personalisht jam dakord, por duhet t'ua parashtrij shokëve, sic- do të bësh edhe ti.

Mirëkuptimi me Vasilin në të gjitha c-ështëjet bazë që shtr uam, më mbushi me gëzim dhe me optimizëm të madh.

- Vasil, më duket se bëmë një hap e punë paraprake të mirë, - i thashë, dhe për herë të parë u përqaftuam fort si shokë.

- Të them të drejtën, - më tha Vasili, - kam pasursimpatit për Miha Lakon, për Pilo Peristerin dhe për ty. Kurse Koc-on, - vazhdoi duke qeshur, - nuk e shihja dot, kur më dilte bulevardit me atë konen aë e mbante prej zinxhiri.

Erdhi Bojka me burrin, na sollën kafënë dhe frutat. Ajo hapi perdet e bar dha të dy dritar eve dhe tha:

- Shihni, u kthjellua qielli!

U ndava me Vasilin dhe i premtova se do të shkoja ta takoja në furrën ku punonte, e cila ishte në rrugën që sot mban emrin «Konferenca e Pezës», përkrah ish-radiostacionit të vogël të dikurshëm.

Natyrisht u mblodhëm me shokët e grupit tonë dhe u raportova për bisedën që pata me Vasil Shanton, duke e treguar haptazi përshtypjen time të mirë në përgjithësi.

TAKIMI I PARË ME QEMALIN

Lidhjet me Vasilin vazhdova t'i mbaj e t'i shtoj. Një ditë, ndërsa po bisedonim, i thashë se dëshiroja të takohesha edhe me Qemal Stafën, për të cilin kisha krijuar një mendim të mirë, pavarësisht se nuk e kisha njohur nga afër.

- Do të jetë një gjë shumë e mirë, - më tha Vasili. - Edhe Qemali të njeh ty, nga larg, e më ka shprehur të njëjtën dëshirë.

E lamé të takoheshim te furra e Vasilit.

Ditën e caktuar, kur hyra në furrë, pashë se afër derës së saj, buzë shtratit, në një stol, ishte ulur Qemali. Vasili rrinte në këmbë me llërë përveshur dhe, me të më parë mua, më doli përpara e më coi te Qemali, i cili u ngrit dhe i dhamë dorën njëri-tjetrit.

- Jam i gëzuar që po njihemi nga afër, - i thashë, - dhe këtë ia di për të mirë Vasilit.

- Edhe unë, - tha Qemali me zë të qetë, - jam i gëzuar, sido që po grindemi me vite.

- Më duket se me vullnet të mirë, - iu përgjigja, kjo gjendje duhet të sqarohet për interesin e popullit dhe të atdheut që no vuan nën zgjedhë.

Qemali dhe unë ishim ulur në dy stola të vegjël, përballë njëri-tjetrit, ndërsa Vasili që rrinte në këmbë, veshët i kishte në bisedën tonë, kurse sytë i mbante nga dera e nga dritarja për të vëzhguar lëvizjet e armikut.

Qemali më bëri një përshtypje shumë të mirë. Ai ishte i paktë nga trupi, kishte një fytyrë simpatike, dy sy të thellë, që, duke folur, herë merrnin pamje serioze dhe herë të gëzueshme. Ai mbante syze. I pari e mora fjalën unë dhe, me ton shoqëror, i shpjegova çka i kisha thënë Vasilit në shtëpinë e Spiro e Bojka Lazrit, çka kishim vendosur dhe si do të vepronim këtej e tutje. Qemali, me ata sy të zgjuar e të ëmbël prapa xhamave të syzeve, më dëgjonte me kujdes e me dashamirësi. Ai m'u përgjigj, duke shtjelluar pikëpamjet e grupit të tij për një varg çështjesh që shtrova unë. Në përgjithësi ai ishte dakord me problemet principiale siç qenë ato të domosdoshmërisë së formimit të Partisë, të përpjekjeve të përbashkëta që duhet të bënim për të çelur rrugën drejt bashkimit, të gjallërimit e të forcimit të propagandës antifashiste në popull etj.

Formova mendimin se ishte një shok i zgjuar e me kulturë, ashtu siç më kishin thënë. Më pas u takova edhe herë të tjera me të, por «mali» i mërive e i mosmarrëveshjeve të vjetra e të reja midis grupeve tona ishte akoma i madh. Krahas eliminimit të një sërë pengesash, lindnin edhe pengesa e vështirësi të reja, kështu që s'duhet menduar se që në takimin tonë të parë u gjet përfundimisht fjala e përbashkët.

Sidoqoftë këto takime ishin hapa të drejtë e të sigurt drejt sheshimit të mosmarrëveshjeve. I rëndësishëm ishte, gjithashtu, fakti që me Qemalin, ashtu si edhe me Vasilin, që në takimet e para unë personalisht thuajse nuk kisha asnjë mosmarrëveshje të rëndësishme; mendimet e dëshirat tona përputheshin. Por çështja për të cilën luftonim nuk varej vetëm nga ne; ne qemë akoma anëtarë të grupeve dhe akoma jo luftëtarë të një partie të vetme.

ME QEMALIN

Të gjithë të deleguarit, disa legalë, disa ilegalë, me të gjitha çfarë përmenda më lart, u nisëm në qendra të ndryshme për të organizuar konferencat e Partisë në qarqe nga do të dilnin komitetet e Partisë. Unë me Qemalin, siç thashë, qëndruam në Tiranë, edhe për të ndihmuar organizimin këtu, edhe për të organizuar lidhjet me qarqet, por edhe për të formuluar Rezolucionin e për të shkruar Thirrjen, siç u vendos në Mbledhje. Rezolucioni njihet dhe është dokumenti i parë bazë i Partisë Komuniste të Shqipërisë. E tërë Partia duhej ta studionte dhe në bazë të tij të organizohej dhe të luftonte në të gjitha drejtimet.

Gjatë kësaj kohe Qemali dhe unë u njohëm më mirë me njëri-tjetrin. Qemali ishte i dashur, i thellë në mendime, me një karakter të hapët, me kulturë, i qeshur, ishte komunist i vendosur dhe trim. Ai e donte muzikën, këngën. Kishte humor dhe në pushime, pas një pune të lodhshme, Qemalin do ta shihje të merrej edhe me disa lodra të vogla prej druri ose prej metali, apo edhe me zare qelqi nga ato që luajnë kalamajtë, si e si të çlodhej sadopak. Ky komunist e kishte shpirtin e ri, prandaj, sa jetoj, luftoi me zjarr të madh për Partinë dhe për rininë.

Iu vumë hartimit të Rezolucionit e të Thirrjes se duhej t'i mbaronim shpejt. Ata duheshin shtypur dhe duheshin dërguar në të katër anët e vendit. Edhe kjo, ana teknike, ishte një problem kolosal. Duhet t'i kesh jetuar ato momente të rënda për ta marrë me mend sa i vështirë ishte problemi, pse

tash duket sikur mund të bëheshin fare lehtë shtypja dhe shpërndarja e materialit ilegal. Armiku përgjonte, kontrollonte, kapte, burgoste, vriste dhe varte shokë.

Kishte ditë dhe net që na bëhej koka daulle.

- Mjaft punuam, Enver, - më thoshte Qemali, kur kalonin orë të tëra pa pushuar, - ia marrim një këngë?

Këngët që ai këndonte i shoqëronte me mandolinë, kurse këngët e mia labçe, jo vetëm me mandolinë nuk shoqëroheshin, por atyre s'kishte as kush t'ua kthente e kush t'ua mbushte ; duheshin tre veta për labçen, kurse ne ishim dy, një shkodran* *(shoku Emer e quan Qemalin shkodran për arsye të lcohës së gjatë që ai qëndroi në Shkodër.) dhe një gjirokastrit. Në idetë e komunizmit ishim të akorduar, kurse në muzikë jo.

- Mësomë dhe mua t'ia kthej, - më thoshte Qemali.

- A, a, - i thosha unë, - labçja nuk di të ketë pasur profesor muzike kurrë, veçse popullin. Rri, dëgjoje dhe mëso vetë. - Qeshnim.

Rezolucionin e mbaruam si tërësi. Por sa ditë të tjera na u deshën ta shihnim e ta r'ishihnim, hiq andej, shto këtej, jo këtu duhet theksuar kjo e metë ose ky gabim, jo duhet bërë më e qartë e më e plotë kjo direktivë, e kështu me radhë.

Rezolucioni do të qe një dokument bazë, dokumenti principial ku do të sintetizohej krejt e kaluara e lëvizjes komuniste shqiptare e do të formulohej saktë e qartë vija e ardhshme e Partisë dhe e popullit; programi i saj luftarak. Ne duhej të sintetizonim gjithçka ishte thënë në diskutimet e shumta për a-'7 ditë e net me radhë, të qëronim çdo bar të huaj. të përcaktonim çdo gjë që duhej përcaktuar.

Për njërin ose për tjetrën çështje ngecnim. Atëherë thërritnim ata shokë të Komitetit Qendror që ndodheshin në Tiranë e konsultoheshim me ta. U lexonim paragrafë të tërë. sqaronim gjithçka duhej sqaruar e vazhdonim më tej. Por. dihet. formulimi i Rezolucionit ishte për Qemalin dhe për mua vetëm një ndër detyrat e mëdha e të shumta të atyre ditëve.

Vetëm 7-8 ditë pas mbarimit të Mbledhjes së Themelimit të Partisë, dihet se u themelua Rinia Komuniste. Si unë dhe Qemali u ngarkuam e u mobilizuam të organizonim krejt punën edhe për këtë ngjarje të rëndësishme. Të dy ne morëm pjesë në këtë mbledhje nga fillimi gjer në fund. Pikër ishte në valët e këtyre punëve shkruanim edhe Rezolucionin. Ai u shkrua në luftë e siper, në të, vetë pjesëmarrja jonë aktive në ngjarjet që zhvilloheshin, bëri që të hynin edhe disa ngjarje që i takojnë periudhës fill pas Themelimit. Më pas në një mbledhje të Komitetit Qendror të Përkohshëm, aty nga fundi i nëntorit, pas diskutimesh që u bënë, u aprovua Rezolucioni dhe e mora unë përsipër për të rregulluar shtypjen e tij.

Pasi përfunduam Rezolucionin, Qemali u nis për në qarqe, për punën e Partisë e të Rinisë. Unë vazhdova hartimin e Traktit të parë të rëndësishëm programatik të Partisë drejtuar popullit, «Thirrjen e Parë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë drejtuar popullit shqiptar pas krijimit të Partisë». Thirrja shpejt u bë gati, por ajo u shtyp dhe u shpërnda në dhjetor të vitit 1941.

SI E NJOHA E U BËRA MIK ME MYSLIM PEZËN

Qysh më 1939, sapo mora vesh se Myslim Peza ishte kthyer në Shqipëri nga emigrimi i gjatë politik, u përpoqa dhe arrita të takohesha e të bisedoja me të.

U bëra mik me Myslimin, e doja dhe e çmoja për trimërinë e për mprehtësinë e tij prej fshatari të zgjuar.

Mbaj mend se në një nga takimet tona, ndërsa ishim ulur e po bisedonim kokë më kokë, ia dhanë sirenat e alarmit. Hyri me shpejtësi Esati*. *(Esat Dishnica - patriot që mori pjesë aktive në Luftën Nacionalclirimtare)

- Alarm ajror! - tha, - q'do të bëjmë?

Vështrova Myslimin që qëndronte gjakftohtë e i përqendruar, sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

- Si të dojë Baba, - i thashë Esatit. - Për mua në daç rrimë, në daç ikim.

- Është gjithë kjo Tiranë, - tha Myslimi, - e ku drejtin do na gjejë bumja në ketë copë vend!

- Meqë unë s'kam kokë tjetër, po iki, - na e ktheu Esati me shaka dhe na la vetëm që të vazhdonim. Unë, që e njihja mirë Esatin, e dija se ai s'qe nga ata që u trembeshin fishkëllimave. Gjithë merakun e kishte për ne.

_ Në bisedë Myslimi ishte i përqendruar e i vëmendshëm. Nuk kishte mundur të arsimohej, por shkolla e vuajtjeve dhe e përpjekjeve të pandërprera e kishte bërë të mprehtë e të aftë të kuptonte çdo problem. Dhe s'kishte gëzim më të madh për mua kur ai me gojën e tij më foli me simpati për komunizmin. Në mërgim ishte njohur me patriotin dhe me revolucionarin e shquar, Haxhi Lleshin dhe ky atje i kishte folur e i kishte lexuar Myslimit për Leninin, për revolucionin e për komunizmin.

- Unë, or babë, - tha Myslimi, - komunist nuk jam, por komunizmin e dua.

- Ne komunistët, shoku Myslim, - i thashë, - jemi për luftë, për luftë me armë kundër fashistëve. A do të jesh edhe ti me ne?

- Oj, si nuk do të jem?! Pse erdha unë? Për të luftuar erdha, - m'u përgjigj Myslim Peza. - Do të jem në ballë të luftës me ju komunistët dhe me të gjithë ata që duan të luftojnë për vatanin.

I shtrëngua dorën me dashuri e forcë njëri-tjetrit dhe ndjemë se kishte lindur një miqësi luftarake, jo vetëm në mes nesh, të dyve, por te Myslimi ne, komunistët (e më vonë Partia), kishim gjetur një luftëtar besnik e të vendosur për Luftën Nacionalçlirimtare dhe bashkimin e popullit në një front të vetëm, në rrugën që këshillonin komunistët e, më vonë, kur lindi Partia, në rrugën që tregonte ajo. Folëm gjatë për fashistët e tradhtarët dhe luftën që duhej të organizonim kundër tyre, i folëm njëri-tjetrit për shokë e miq, tek të cilët duhej të mbështeteshim e t'i bënim për vete. E kuptuam njëri-tjetrin sikur të kishim 20 vjet që njiheshim.

Lidhjet me Myslimin shkuan duke u forcuar. Njëherë i dhurova një «Mauzer» të ri, një njëzetshe. Më duket se ishte fillimi i vitit 1941. Myslimi ishte njohës i madh i armëve dhe nëpër duar kishte kaluar mar ka armësh nga më të ndryshmet, por, kur mori dhuratën time, i ndritën sytë:

- S'ka si bëhet peshqesh më i madh, - tha dhe e përkëdheli revolverin me duar. Ai te kjo dhuratë pa edhe respektin tonë për të, por edhe dëshirën e sinjalit e komunistëve. Tashmë ai e kishte rritur cetën dhe e vuri atë në dispozicion të luftës për çlirimin e atdheut. Në mars të vitit 1941 Myslimi goditi italianët në rrugën e Pezës dhe doli ilegal me gjithë çetë. Ne, menjëherë pas këtij vepr imi, hodhëm një trakt, i cili, megjithëse u shpërnda në pak kopje, se aq kishim mundësi, bëri jehonë. Njëkohësisht filluam të organizonim e Vi dërgonim ndihma Myslimit me anën e Esatit dhe të Dem Xhepës. I nisnim ushqime, veshje dhe të holla, të cilat herë vinte i merrte korrieri i çetës, Rat Mëçalla, herë ia dërgonim me anën e «Qeleshexhiut», një mik tiranas i Myslimit.

I paharruar do të mbetet për mua takimi me babë Myslimin dhe çetën e tij në verën e vitit 1941. Ishte koha kur grupet tona komuniste, e veçanërisht ai i Korçës e i Shkodrës, po gjenin rrugën e drejtë e të sigurt drejt she

shimit të mosmarrëveshjeve, koha kur sapo kishte hyrë në luftën vendimtare Bashkimi Sovjetik, koha kur po merrte vrull vetë lufta e popullit tonë për liri e pavarësi. Me babë Myslimin tash isha mik i vjetër, e njihnim e i kishim

dhënë besën njëri-tjetrit se do të luftonim gjer në fund për çështjen e përbashkët. Unë vetë kisha shfaqur dëshirën të takohesha me Çetën e Pezës.

Kur i cova fjalë Myslimit, m'u përgjigj menjëherë:

Hajde kur të duash. Të presim.

Takimi u organizua në një pyll afër Pezës së Vogël. U përqafova me Myslimin, e pastaj me të gjithë pjesëtarët e çetës një për një. Me ta unë nuk isha njohur më parë, por përzemërsia me të cilën më pritën dhe mirëkuptimi që arritëm për të gjitha problemet që diskutuam, më bindën se Myslimi e kishte bërë punën e vet me ta, u kishte folur mirë për mua e për çështjen që përfaqësoja. Atje pashë e përqafova për herë të parë trimin sypatrembur, Kajo Ka

rafilin. Partia i dha trimërisë së tij mençurinë e mprehtësinë, Partia i dha Kajos përmbajtjen e vërtetë të heroizmit.

Kajoja, nga ana e tij, u dha Partisë e popullit gjithçka, gjer edhe jetën.

Atje njoha luftëtarin e pandarë nga Myslimi, Shabë Rexhën dhe xha Kasemin, i cili, ndonëse nuk shihte mirë, e ndiqte Myslimin kudo që shkonte.

U ulëm e biseduam gjatë me çetën. I përgëzoja për përleshjet që kishin zhvilluar, u shpreha dhimbjen e thellë për shokët e parë që kishin rënë në përleshje me armiqtë, bisedova me ta për qëllimet dhe të ardhmen e luftës sonë. U fola për situatën në vend dhe për jehonën e madhe që kishin shkaktuar përpjekjet e para me fashistët e, ndër to, edhe përpjekjet e atyre luftëtarëve trima me të cilët isha ulur e bisedoja.

Ndejtëm gjatë atë ditë të paharruar në pyllin e Pezës, dhe, kur erdhi koha të ndaheshim, iu drejtova Myslimit:

- Dua një fjalë prej teje, o Myslim, - i thashë.

- Urdhno, o babë, - m'u përgjigj ai.

- Siç kemi biseduar bashkë edhe më përpara, ne

inendojmë të dërgojmë këtu në Pezë shokë të rinj, komunistë. Si thua?!

- Çeta, që se hyre ti këtu, or babë, - m'u përgjigj Myslimi, - ka komunistët brenda. Sill sa të duash, se pa shokë s'kemi ç'bëjmë.

- A mund t'i mbani dot 40-50 veta? - e pyeta.

- Që tani i mbajmë 500, - m'u përgjigj Myslim Peza. - më vonë edhe më shumë !

Qesha me të madhe dhe e përqafova.

1 tillë ishte Myslim Peza, komandanti tr im i së parës çetë partizane, e më pas një ndër luftëtarët më legjendarë të Ushtrisë sonë Nacionalclirimtare.

KOZMA NUSHI

Kozmai ishte fëmija e parë e familjes Nushi. Ai ishte i përgatitur ideologjikisht dhe i prerë në vendimet që merrte. Partia që në ditët e saj të para pa te Kozmai një nga anëtarët e saj më besnikë, prandaj e caktoi me detyra me përgjegjësi, të cilat ai i kreu me devotshmërinë e një komunisti proletar.

Sidomos pas Themelimit të Partisë Kozmai u bë një nga bashkëpunëtorët e mi më të afërt. Këshillohesha me të dhe shkëmbenim vazhdimisht mendime. Te Kozmai gjeje cilësitë e një proletari të vërtetë, e një shoku të zgjuar, të matur, të mprehtë dhe shumë simpatik. Bashkë me të qeshurën e ëmbël, që tek ai kishte diçka të veçantë, tërheqëse, spikaste edhe thjeshtësia karakteristike e Nushajve.

Siç duket, në këtë anë gjithë fëmijët: Kozmain, Gogon, Çenon, Shanën dhe Lilon, nënë Valideja sikur i kishte prerë me «një gërshërë». Kozmai, siç e kanë zakon Nushajt, ecte duke tundur kokën. Sytë i kishte të mprehtë dhe të zgjuar. Ishte konspirativ i regjur, shihte çdo skutë, i afrohej çdo grumbulli njerëzish. Vër ente në çdo qoshe rruge ku kishte shtëpi ilegalësh, se mos ndiente ndonjë lëvizje të dyshimtë. ose shikonte ndonjë njeri të huaj që «mbante poza të sehirxhiut të hutuar», siç i quante ai vëzhguesit e policisë. Ashtu si me të gjithë shokët e tjerë, edhe me të e diskutoja më parë detyrën që do të kryente, i shpjegoja arsyen dhe qëllimin dhe ai e zbatonte atë pa hezitim. Në fund. kur e kryente, vinte më informonte. Unë, veçanërisht Kozmait, i tregoja vendin ku do të ndodhesha, kështu që mund të më gjente kur të donte, ditën ose natën.

Kozmait i pëlqenin shumë këngët epike të Bregut, të cilat i këndonte me pasion të rrallë. Kur këndonte harrohej i zhytur i tëri në këngë dhe shpesh mu në mes të saj thoshte:

- Iso, djema, iso!

Nga kjo i mbeti edhe pseudonimi «Iso». Natyra aq poetike e bregdetit Jon, e kishte bërë edhe vetë Kozmanë poet. Konspiratorit dhe trimit me fletë nga Bregu i pëlqente të thurte edhe vargje, të bënte edhe fotografi dhe të gjente kudo të bukurën, atë të bukur për të cilën luftonte dhe donte ta bënte të përjetshme.

Kozmai fjalët i kishte të shtrenjta, fliste pak, por çdo gjë e peshonte mirë dhe fisheku i qëllonte kurdoherë drejt. Për të nuk ekzistonte shoqëri e sëmurë, ai s'e kishte kurrë zakon t'i bënte tjetrit lajka. Çdo gjë e shikonte me syrin e Partisë dhe për të mirën e saj. Ai kishte respekt prej komunisti ndaj shokëve udhëheqës, por, kur ndeshte me ata që nuk sillleshin e nuk vepronin mirë, ishte i pamëshirshëm. Këtë veti të mrekullueshme të tij e kisha njohur në shumë raste, por e paharruar më ka mbetur një ndodhi midis meje, Kozmait dhe një personi që e mbanim pranë udhëheqjes së Partisë. Kozmai atë person e njihte që në Francë, ku familja e Nushajve, si shumë fshatarë të tjerë nga Vunoj dhe nga Bregu, kishte shkuar të punonte në minierat e qymyrit në krahinën e Lionit dhe në Firmini.

Shtëpia e tyre në Desinë u bë qendra kryesore, ose më mirë e vetmja qendër e sigurt e komunistëve shqiptarë që punonin në Francë. Lioni ishte një qendër e madhe punëtore, bashkinë e këtij qyteti e dominonin radikalsocialistët me Eduard Herionë* *(Personalitet politik francez (1872-1957). Njëri nga udhëheqësit kryesorë të partisë së radikalëve dhe të radikalsocialistëve.) në krye. Atje edhe partia komuniste kishte pozita të forta dhe në këtë pellg qymyri celulat komuniste ishin të shumta.

Kozmai dhe Gogoja ishin nga anëtarët më aktivë të Partisë Komuniste të Francës. Gazeta shqip «Sazani»

Halim Xhelos, e Kozmait, e Gogos dhe e Qamil Çelës për gatitej prej këtyre dhe shtypej nga vëllezërit Nushi. Ku Zai Fundo tradhtoi, qëndroi në Paris me trockistët e Gal tier-Buasierit. Edhe Sejfulla Malëshova, përpara se të kthej hej në Shqipëri, në verën e vitit 1943, për Vu dhënë «mend Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe Lëvizjes sonë Nacic nacionalizmitare, kishte shkuar njëherë në Paris dhe, me ini ciativën e tij, kishte bërë përpjekje të pijej me Zogun, t bisedonte me të dhe të kurdiste aleancë me katilin. M vonë, pasi që kthyer në Shqipëri, Sejfullai më foli për këtë «vijë gjeniale politike», të cilën unë ia hodha m indinjatë poshtë si shprehje e një miopie politike dhe një oportunizmi ekstrem. Por se ç'që kjo -«ide» dhe «e mbrojtja» Sejfulla Malëshova do të flasim në tjetër vend.

Le të vijmë te qëndrimi i prerë i Kozma Nushit me personin që përmenda më lart e, që vite më parë, kishte qenë anëtar i Partisë Komuniste të Francës. Shokët e Lionit dhe Nushaj e njihnin sa «interesohej» ai person për punët që zhvillo heshin atje, ata njihnin po ashtu karakterin e lehtë të tij liberalizmin dhe oportunizmin e tij politik. Kur u kthyer nga Franca Gogoja me Kozmanë dhe biseduam për punën, për këtë person ata më thanë:

- Ta përdorim si anëtar partie, se di të flasë dhe i je, për të shkruajë. Është antifashist. Ta kalitim në luftë, po kurdoherë duhet të kemi kujdes me të.

Njëherë, kur ky shok erdhi në Tiranë të më raporton. te për punën në zonën ku e kishte dërguar Partia, Kozmai sa e mori vesh, na gjeti në bazën ilegale ku ndodheshim Unë po i lexoja këtij personi një letër që kisha përgatituri për Nexhip Vinçanin e shokët e tij, që organizonin drekë dhe darka.

- Hajde Kozma, - i thashë, - kemi nevojë për ca piper të kuq, nga ai i tërbuari, Via hedhim kësaj gjelle për «Xhipkën*» *(Nexhip) dhe «Pëllumbin*» *(Pëllumb Dishnica) . Do të na ndihmosh? - E pyeta.

- Për këtë kam ardhur, - tha, - pa e ditur se ç'po gatuan. Më lejo, shoku Enver. m'u drejtua Kozmai me fytyrë të vrenjtur, do të të flas si Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë për këtë shok, pse edhe ky nuk është në rrugën e drejtë të Partisë.

Për mua që i papritur ky sulm i Kozmait, por ishte i stilit të tij. Shikova tjetrin, i cili ishte bërë dyllë i verdhë në fytyrë dhe vështronte i vrenjtur Kozmanë.

- Fol Kozma, - i thashë.

Kozmai filloi me ton të prerë, si sëpata e dardharit:

- Këtij, - tha, - i pëlqen të bëjë më mirë dashuri me një grua nga Parisi, sesa t'u vërë gjoksin punës dhe luftës, në një kohë kur shokët komunistë dhe populli na vriten nëpër rrugë.

Tjetri, i skuqur, u ngrit në këmbë dhe bërtiti:

- Kozma, po më akuzon rëndë. Shoku Enver, nuk mund ta duroj këtë ofendim.

- Ulu, - ia ktheva atij, - mbaj gjakftohtësinë.

- Ju mund ta mbani gjakftohtësinë, - m'u përgjigj, - pse nuk jeni i ofenduar.

Kozmai nuk lëvizi as qepallat e syve, po mbante një gjakftohtësi prej prokurori proletar.

- Kozmai nuk ta do të keqen kur i thotë këto. Ai me siguri do më parë të mirën e Partisë, pastaj edhe tënden. Prandaj ta dëgjoj më deri në fund, se edhe Kozmai do të flasë me qetësi.

Dhe Kozmai vazhdoi të flasë me fakte konkrete, i qetë, por i pamëshir shëm në kritikën e tij, ndaj të metave të shokut. Nga ato që dëgjova prej Kozmait për atë shok, që i dërgonte çorape e të tjera sende një gruaje në Paris, më hipi gjaku në kokë.

- Dëgjo, - i thashë, - faktet janë fakte dhe Kozmai ka të drejtë. Si mund t'ia lejosh vetes të merresh me të tilla gjëra, sidomos në një kohë kur nuk dimë ku kemi kokën, kur Partia lufton dhe kur populli vuan! Shiko, vazhdova, - po dëgjova herë tjetër jo për këtë çështje. por edhe për ndonjë çështje tjetër të kësaj natyre, atëherë do ta shtroj në udhëheqjen e Partisë dhe do të marrim masa të rrepta kundër teje.

- Ju jap fjalën, shokë, - premtoi ai, - të tilla gabime nuk do të bëj më, - dhe pas pak u ngrit dhe iku. Mbetëm vetëm me Kozmanë.

- Bëre mirë që erdhe, Kozma, dhe ia the troç, t'i bëhet një mësim i mirë, por, si më thua, a do të vëre mend'

Kozmai u mendua pak dhe më tha

- Mos u ki besim të tillë njerëzve; të tillë si ky hai^orojnë luftën e tradhtojnë.

- Je shumë i prerë dhe i rreptë, Kozma.

- Dëgjomë mua, Enver, mbaji sytë hapur nga këta. që më shumë janë demokratë sesa komunistë e të lënë në mes të rrugës.

- Nuk do ta harroj kurrë këshillën tënde, i dashuri Kozma, - i thashë, dhe me kaq u ndamë atë ditë.

1 tillë ishte komunisti Kozma Nushi. Ai të vërtetën e thoshte ashtu siç ishte dhe kritikën e bënte ashtu si duhej, pa doreza, pa oportunitizëm. Qëndrimi i sëmurë, mikroborgjez ndaj të metave apo gabimeve të shokëve ishte i huaj dhe i papranueshëm për karakterin burror, të çiltër dhe të kalitur në përpjekje të Kozma Nushit.

Tani që po shkruaj këta rreshta më kujtohet qëndrimi i pjekur dhe diskutimi i Kozma Nushit në Konferencën e Parë të Vendit të Partisë Komuniste të Shqipërisë, ndaj të metave të Gjini Markut. Kozma Nushi i donte punëtoret me mish e me shpirt dhe kishte besim të patundur te forcat e tyre. Ky besim rridhte, në radhë të parë, nga njohja e thellë, jashtë çdo euforie të energjive dhe të forcës së madhe transformuese që ka klasa punëtore. Kur Gjini Marku filloi të flasë për mospasjen e një pune të organizuar në Kuçovë, Kozma Nushi u hodh dhë i tha Gjinit, se «Ti nuk i njeh si duhet Kuçovën ane naftëtarët e saj, sepse që t'i njohësh mirë punëtorët dhe naftëtarët duhet të jetosh me ta, të rrish me ta». Dhe trimi Kozma Nushi i tha ballë pr balië Gjini Markut se gjendja në Kuçovë nuk ishte ashtu si e përshkruante ai dhe lçjo kishte ardhur se Gjini nuk e kishte kryer detyrën e Partisë lidhur me naftëtarët.

Takimet në Konferencën e Parë të Vendit të PKSH dhe në prill e në pjesën e parë të majit në Tiranë, ishin nga takimet e fundit me shokun tim të paharruar. Kozma Nushin, sepse, ndërsa unë do të nisesha për në Vlorë për të demaskuar fraksionin e Sadik Premtes (Xhepit). ai do të nisej për në Durrës, ku u zgjodh Sekretar Politik i Qarkorit, detyrë që do ta kryente me devotshmëri. ashtu si i kishte kryer deri atëherë të gjitha detyrat që i kishte ngarkuar Partia.

E doja shumë Kozmanë, po ashtu edhe Gogon. 1 doja me zemër këta shokë kaq të vendosur të Partisë. besnikë të idealeve të saj, të gatshër për sakrificën më sublime. Nga mendimet dhe qëndrimet e këtyre dy komunistëve proletarë kam mësuar shumë.

Më vonë e vëreja personin për të cilin biseduam me Kozmanë të vërtitej tok me Sejfulla Malëshovën. I tërhoqa shumë herë vëmendjen për gabimet oportuniste që bënte dhe ia kisha frikën qëndrimin të tij. Dhe vërtet ai tradhtoi. Kur e mora vesh tradhtinë e tij, i r ashë bangos me grusht në dhomën e Shtabit dhe thashë: «I poshtri! Kjo është tradhti!», dhe në atë moment më doli përpara fytyra e ndritur e shokut tim të dashur Kozma Nushit.

TRE KOMUNISTË LEGJENDARË

Akti heroik për të cilin do të flasë brez pas brezi historia e popullit tonë, është lufta e madhe deri në sakrificën e fundit të shokëve Vojo Kushi, Xhoxhi Martini dhe Sadik Stavaleci. Të tre këta luftëtarë legjendarë të popullit tonë, për herë të fundit, i takova një ditë para rënies së tyre heroike, në shtëpinë e Hatixhe Farkës, nëna trime tiranase, së cilës si fëmijët e saj ashtu edhe ne të gjithë i thërritnim Ije.

Ije Farka ishte një nënë me pesë djem jetimë. Gjithë ditën punonte e robtohej, kurrë s'e shihje të prehej. Ajo ishte, veçanërisht, e gjallë, e shkathët, e donte rregullin dhe fliste si burrneshë. Edhe pse mori plagë të mëdha Ija qëndroi e fortë. Gjatë viteve të luftës djali i madh, Shyqyriu, i cili u lidh me lëvizjen i vdiq i sëmurë. Më pas fashistët i arrestuan djalin e tretë, Ramazanin, e torturuan dhe pastaj e internuan në Prishtinë, ku edhe e ekzekutuan. Edhe pse fare i ri, rreth 19 vjeç, ai bënte pjesë në njësitet guerile. Megjithëkëtë Ija nuk u dha, por vazhdoi të punojë për Luftën Nacionalçlirimtare, sepse është nga ato nëna që thonë me krenari

- Gjakun e djalit ia kam falë Partisë!

Shtëpia e Ijes ndodhet në një rrugicë në Kodrën e Kuqe. Partia e ruan këtë banesë, e cila është kthyer në njëfarë muzeu, që e vizitojnë me mijëra veta, të rinj e të moshuar.

Dhe nënë Ije Farka bën ciceronin, pse ajo ishte atje që kur filloi dhe derisa mbaroi lufta heroike e shokëve.

Vojoja, Xhoxhi dhe Sadiku ishin që të tre komunistë legjendarë, trima syapatrembur, besnikë deri në vdekje të Partisë dhe të popullit. Vojo Kushi ishte nga Shkodra, Xhoxhi Martini nga Tirana, Sadik Stavaleci nga Kosova. Të tre vinin nga grupe të ndryshme komuniste. Ata u lidhën si mishi me kockën me Partinë e tyre, me Partinë Komuniste. Ata kishin një zemër, një ideal, luftonin për mëmën Shqipëri si një trup i vetëm. Sa trima, sa të vendosur ishin, aq edhe të thjeshtë qenë.

Me Vojon u njoha në Tiranë jo shumë kohë pas tmemelimit të Partisë, në periudhën kur kryeja edhe detyrën e Sekretarit Politik të Qarkorit të Tiranës. Njësitet guerile të kryeqytetit, të udhëhequra dhe të drejtuara me zgjuarsin nga qarkori dhe komunistët, kishin kr yer aksione të guximshme, atje ku ar mikut dhe agjentëve të tij nuk mund t'u shkonte kurrë mendja. Por zhvillimi i luftës kërkonte që aksionet të organizoheshin më mirë e të bëheshin më të shpeshta, në mënyrë që populli të shihte se kush ishin komunistët dhe armiqve t'u dridhej toka nën këmbë. Më kishin folur shumë për trimërinë dhe për aftësitë drejtuese të një të riu. të quajtur Vojo Kushi, ndaj kërkova të njihem nga afër me të, me mendimin që, si militant trini dhe të vendosur të Partisë, ta vinim në krye të njësiteve guerile të Tiranës. Në ditën e caktuar për takim, ndërsa punoja në shtëpinë e Dullë e Mine Ketës, bashkë me një shok të qarkorit hyri edhe një hamall me trup të fuqishëm, i r reckosur e tërë pluhur.

- Jam Vojo Kushi, - më tha me një zë sa të ëmbël, aq burrëror «hamaili». - vij nga Shkodra.

I shtrëngova në fillim dorën dhe pasta] mu aty në mes të oborrit të shtëpisë së Mine e Dullë Ketës. u prqafova fort me Vojo Kushin, i cili mbas disa muajsh do të bëhej heroi legjendar i Kodrës së Kuqe së bashku me shokët e tij, Xhoxhi Martinin dhe Sadik Stavalecin.

U futëm brenda dhe qëndruam për një çast në heshtje. Aty vura re për herë të parë se ndryshe nga përshtypja që mund të krijonte fiziku prej atleti i Vojos, ai ishte një tip timid, i ndjeshëm dhe që skuqej menjëherë në fytyrë.

Vojoja ishte një djalë i gjatë, me shpatulla të gjer a. me një fytyrë të çelur, plot shëndet. flokët i priste kurdoherë rrafsh. Trupin e mbante drejt dhe kokën lart. Rrija pranë Vojos në shtëpinë e Mine Ketës dhe mendoja i gëzuar që në radhët e luftëtarëve dhe të organizatorëve të njësiteve guerile të Tiranës ishte shtuar edhe një luftëtar i tillë. i vendosur dhe trim. i thjeshtë dhe i zgjuar.

Mbasi më tregoi si kishte ardhur. i foli për detyrën që qarkori kishte vendosur t'i ngarkonte. I theksova se alo ishte një detyrë e vështirë dhe tepër e rëndësishme, po që Partia kishte besim të patundur se anëtari i saj. Vojo Kushi. do ta kryente me sukses.

- Ti. - i thashë. - do të kesh pranë shokë të sprovu~:r në beteja, me të cilët do të bashkëpunosh ngushtë. Që sot fillon edhe bashkëpunimi ynë i ngushtë. - shtova në fund.

- Do të ve tërë forcat e mia që detyrën ta kryej me nder. tha Vojoja. Që në takimin tonë të parë dhe të paharruar vura re se Vojoja fliste shumë shkurt dhe prerë. Këtë veti do ta vija re edhe më tepër kur do të qëndronim bashkë deri vonë duke menduar planet e aksioneve. mënyrën e kryerjes së tyre. Ndërsa po bisedonim nxora nagantin tim të ri dhe ia zgjata. Atij i shkëlqyen sytë, e mbështolli armën me duar dhe e puthi:

- Do ta bëj të këndoje si bilbil kundër armiqve. shoku Taras* *(Një nga pseudonimet e shokut Enver gjatë luftës.) - më tha, dhe pastaj, si të ishte kultuar për diçka. më vështroi në sy dhe shtoi: - Po ju mbetët pa të !

- S'ka gjë, do të gjej tjetër, i thashë.

Vojoja më falënderoi përsëri dhe duke i shtrënguar duart njëri-tjetrit u ndamë për atë ditë.

Vojo Kushi ishte një militant i mrekLillueshëm. Puna dhe lufta jonë e përbashkët vazhdoi kështu dite e nate. deri një ditë para se të binte si Nero. kur vajta e u takova me të në shtëpinë e Ije Farkës. Ai ishte takimi dhe biseda ime e fundit me Vojo Kushin dhe me dy shokët e tij, Xhoxhi Martinin dhe Sadik Stavalecin.

Xhoxhi Martini ishte një shok i ri nga Tirana. Ishte punëtor. Dy herë e kisha takuar dhe më kishte lënë përshtypje të thellë, se ishte një luftëtar i pararojës. Ishte «zhivë» si Misto Mame, si Mihal Duri e dhjetëra të tjerë të rinj, që militonin në organizatën e Tiranës. Vojoja e Gogoja më flitnin me admirim për të, ashtu si dhe për Shyqyri Ishmin, Lym Shyrin, Lym Ketën e të tjerë. Vërtet dy herë e kisha takuar Xhoxhi Martinin, por shumë herë ia kisha dëgjuar emrin, sepse ai merrte pjesë në aksione, në sulme, në atentate që u bëheshin spiunëve.

Xhoxhi Martini mori pjesë në djegien e një shkolle fashiste dhe së bashku me Sabaudin Gabranin dogji Centralin Telefonik të Tiranës. Ky aksion, përveç guximit dhe trimërisë që nuk u mungonin për asnjë çast shokëve tanë, kërkonte edhe gjakftohtësi dhe zgjuarsi. Njësitë, ku bënte pjesë Xhoxhi me Sabaudinin, hyri në central, çarmatosi karabinierët dhe si lagu me benzinë ndërtesën e centralit i vuri zjarrin. Flakët përpinë qiellin duke ngrohur zemrat e njerëzve e të popullit. Për këtë aksion u fol shumë, me një ndjenjë krenarie të ligjshme nga të gjithë.

Pikërisht në një nga këto aksione fashistët e kapën shokun tonë të pahar ruar Shyqyri Ishmin, e f utën në burg, e torturuan në mënyrën më barbare, por asgjë nuk nxorën nga goja e tij.

Në aksion u plagos edhe Xhoxhi Martini, por arriti të tërhiqej dhe të mos binte në duar të armikut. Shokët e kishin çuar të plagosur në shtëpinë e Ije Farkës, ku kishte shkuar edhe Vojoja ta shikonte. Mua më lajmëruan për ngjarjen dhe për vendin ku ishte Xhoxhi, më thanë po ashtu se atje ishte dhe Sadik Stavaleci, i cili donte të takohej me mua, se do të shkonte për në Kosovë e të më pyeste nëse kisha ndonjë porosi për shokët e atjeshëm.

U nisa me biçikletë, duke bërë xhiro rrugicave për të humbur gjurmët. Pasi u sigurova se nuk më ndiqte ndonjë spiun u futa në rrugicën e shtëpisë së Ijes dhe i rashë derës me sinjalin që kishim.

Hyra brenda. Përqafova Xhoxhin, që rrinte në divan, pastaj Sadikun, Vojon dhe e fillova bisedën me një qortim për Xhoxhin. Ky qe çuar ndenjtur në krevat, kishte zbrërthyer krejt «dhjetëshen turke» dhe i fshinte çdo pjesë.

E përgëzova Xhoxhin për aksionin dhe e putha, duke e përqaftuar fort.

- Duhet të të shërohet plaga, pastaj të lëvizësh, - i thashë.

- U shërua! - tha Xhoxhi.

- Lëri fjalët! - i fola.

Shkuam pastaj në dhomën tjetër me Sadikun dhe me Vojon. Sadikun ishte hera e dytë që e takoja. Ishte një komunist i vendosur, që e donte me shpirt Partinë. Ishte njeri i sakrificës dhe i qetë. Sadiku jetën e kishte kaluar si jetim dhe kur lindi Partia (ai u pranua anëtar partie që me krijimin e saj), gjeti ngrohtësinë e shokëve të idealit të bashkuar rreth Nënës sonë të madhe, e cila i kishte munguar deri atëherë. Sadiku vuri tërë forcat për triumfin e ideve të Partisë dhe ashtu si kishte pohuar në gjyqin fashist kundër komunistëve në shkurt të vitit 1939, përkrah Qemal Stafës e Vasil Shantos me shokë, se ishte komunist i bindur, ashtu edhe mbeti deri në Eund të jetës së tij. Nga trupi vinte i

dobët. Mjerisht ishte i sëmurë nga mushkëritë. Shokët e Kosovës e kërkonin të shkonte atje të punonte dhe ne, aslftu siç kishim bërë për shumë të tjerë, vendosëm ta çonim. Ai do të ikte të pasnesërmen. «Merrni çdo masë për udhëtimin e tij », porosita Vojon dhe, dulce e përqaftuar fort Sadikun, u ndava prej tij dhe prej shokëve. E si mund ta merrja me mend që po puthesha dhe po përqafohesha për herë të fundit me tre shokët e dashur, me tre heronjtë komunistë?!

Kur po zbrisja shkallët. më doli përpara Ija:

- Hyjmë ca te kjo dhoma poshtë. - më tha, - se kam me t'kallzu diçka.

- Posi, - i thashë dhe hymë.

- Dëgjo, Taras, - më tha Ija. - ju e dini më mirë, unë frikë nuk kam as për vete, as për djemtë e mi. zjarri le t'i futet shtëpisë, por kam hall për të siguruar jetën e shokëve. Këtu venë e vijnë plot njerëz dhe, siç e di, Anastas Lula e Xhepi (Sadik Premtja) kur ishin në Tir anë hynin e dilnin nga dy herë ditën. Nuk bën kështu, do të na diktojë policia, pale tash që kemi edhe Xhoxhin të plaSosur.

- Ije, - i thashë, - ke shumë të drejtë, bërë mirë që ma the dhe që tash do të shkoj t'i porosis shokët. Dëgjo, Ije, mos e hap derën me sinjalin që kishim. Vetëm kur të dëgjosh këtë sinjal., - dhe i caktova një sinjal të ri, - do ta hapësh dhe ai që do të vijë, dije se është i dërguar nga unë.

- Mirë të keqen, - tha Ija, - rregulloje këtë!

Me biçikletën shkova drejt e te shtëpia e Picukut (Perikli Borova), tek ish-Rruga e Fortuzit, sot rruga «Asim Vokshi», ku takova një nga shokët tanë, i dhashë porosi të prerë për të ndaluar qdo hyrje në shtëpinë e Ije Farkës pa autorizimin tim dhe prej këtu., u hodha drejt e në anën tjetër të Tiranës. Atje u strehova në një shtëpi që e kishte zënë me qira Syrja Selfoja, i cili do të martohet së shpejti, por shtëpia ishte alcoma bosh dhe gjendej afër Xhamisë së Zajmët. Prapa kësaj shtëpie ishte shtëpia e një kushëriri të Nexhmijes, e punëtorit mekanik, Mersin Qylafku, simpatizant i Lëvizjes sonë Nacionalçlirimtar-e. Nga hyrja e kësaj shtëpie dilte Nexhmija, që me sillte lajme dhe ndonjë gjë për të ngrënë. Atë ditë Nexhmija erdhi dhe qëndruam bashkë se punuam së toku një artikull.

Ende pa aguar dita u dëgjuan të shtëna pushkësh, krisën bataretë e mitralozave dhe plasjet e bombave.

Shuam dritat dhe dolëm në dritare. Me ankth e me një hidhërim të pafund në zemër i dëgjoja ato gjëmime, se isha i sigurt që diku shokët po luftonin në rrethim. Po ku dhe cilët po luftonin? Ishte një pyetje që më godiste si ckan në kokë. Në këto momente s'kishim ç'të bënim, vetëm shpresa na mbante kurdoherë se shokët mund ta çanin rrethimin.

Më në fund, gjëhimet e pushkëve dhe të bombave erdhën duke u shuar.

- Të dal të shoh, --- i thashë Nexhmi jes.

- Në asnjë mënyrë, - më tha ajo, - rrugët dullet të jenë bllokuar, presim edhe ca dhe dal unë të marr vesh ç'ka ngjarë.

Pas ndonjë gjysmë ore, Nexhmija, si komuniste e patrembur, doli dhe pas një kohe u kthye. Ajo u fut në dhomë dhe ia plasi të qarit, më pushtoi dhe më tha:

- Të na rrojë Partia, por na vranë Vojo Kushin, Sadikun dhe Xhoxhin. Ata luftuan heroikisht. Vojoja iu hodh armikut me bomba mbi tank, u vranë shumë fashistë.

Mua m'u këputën këmbët dhe rashë mbi një minder, duke qarë si i vogël. Po shpejt e mblodha veten. Lufta ka dhe dëshmorët e saj, mendova dhe u ula në bankë, ku shkrova me një frymë traktin «Tre heronj për lirinë e atdheut», të cilin e mo ri Nexhmija dhe ua çoi shokëve, që e shtypën që atë ditë dhe e shpërndanë.

Më vonë erdhën dy shokë dhe më vunë në dijeni me hollësi për ngjarjen e hidhur. Pas kësaj ngjarjeje shtëpia e Ije Farkës qëndroi e rrethuar për disa javë rresht, por nëna nuk u tremb, me gjithë presionet që i bënë armiqtë. Ishte grua trime dhe kishte besim të madh te Partia e te lufta e saj.

BIR I MOKRËS TRIME

U nisa që herët nga bazat e Korçës, me qëllim që ora e caktuar të më gjente në fshat. Duke ecur mendoja rrugën e Reshit Çollakut që ishte e ngjashme me rrugën e tërë atyre komandantëve trima

dhe të zgjuar, të cilët populli ynë i ka nxjerrë nga gjiri i tij, sa herë i ka bërë Lhirrje atdheu. Por luftës së tyre Partia u dha një perspektivë të qartë dhe të sigurt. Nuk kishte shumë kohë që ishte formuar Batalioni i Mokrës me rreth 300 partizanë, por çeta e mëparshme, që tash qe bërë batalion, kishte fituar një përvojë të madhe në luftë kundër pushtuesit italian, në demaskimin e veprimtarisë minuese dhe armiqësore të organizatës tradhtarë të Ballit Kombëtar, në zhdukjen e tarafeve dhe të gjaqeve. Shokët e qarkorit më informuan për marrëdhëniet e ngrohta të Reshitit me fshatarët e Mokrës dhe me partizanët e batalionit. Një dashuri po kaq të madhe ushqenin edhe ata për komandantin e tyre të zgjuar, të kujdpsshëm dhe trim. Në Slatinë mbërritëm në orën e caktuar. Reshiti, pa pushkë, kishte zbritur nga shkallët e shtëpisë ku kishim lënë takimin poshtë në kopsht, mbi rrugë, dhe po më priste tok me Liko Gjonin, një malësor i kaluar nga mosha, burrë trim nga të moçmit, mik i ngushtë i Çollakëve. U prezantua, u përqafova dhe xha Liko Gjoni, si i moshuar që ishte, na tha mua dhe dy partizanëve

- Urdhëroni të ngjitemi në dhomë.

Pasi shkëmbyem përshëndetjet e zakonshme dhe pasi pimë kafënë, i zoti i shtëpisë dhe të tjerët na lanë në dhomë vetëm, Reshitin dhe mua.

Që në fillim Reshiti më bëri përshtypje shumë të mirë. Ishte një shok shumë i çiltër, i qeshur, me sy të zinj që i ndritnin në një fytyrë të mprehtë. Edhe shtatin e kishte të hollë, por të lidhur. Portreti i tij ishte portreti i një komandanti partizan të matur dhe të qetë.

Pasi i dhashë të falat e shokëve të qarkorit të Korçës

dhe të babë Myslimit, e urova dhe i shpreha gëzimin tim, për pranimin e tij në radhët e Partisë. Reshiti ndihej i gë

zuar dhe krenar për besimin që kishin treguar shokët dulce e pranuar anëtar partie. Ai e ndiente se kjo gjë e ngarkonte akoma më shumë me përgjegjësi, por kishte besim se do ta justifikonte denjësisht këtë nder të madh. Unë i thashë se ai e meritonte plotësisht qenien në Parti dhe këtë e kishte vërtetuar me luftën e tij, me mendjen dhe me zemrën e tij. Reshiti më falënderoi dhe filloi të më pyesë për zhvillimin e lëvizjes.

Unë i tregova Reshitit gjendjen e luftës kundër pushtuesit italian e tradhtarëve, i fola për programin e Partisë, dulce i vënë në dukje se Shqipëria dhe populli ynë do të shpëtonin nga robëria e rëndë vetëm nëpërmjet luftës që kishte nisur dhe që po vazhdonte me sukses.

- Ne, bijtë e popullit, - i thashë, - kemi vetëm një detyrë të shenjtë dhe të madhe: të luftojmë për çlirimin e atdheut. E dimë, - i them Reshitit, - historinë e lavdishme, po të hidhur të popullit tonë, i njohim luftërat çli

rintare të prindërve dhe të gjyshërve tanë kundër shkelësve të ndryshëm dhe rajave të tyre, por njohim edhe rezultatet e hidhura të këtyre luftërave, kur nga gjaku dhe sakrificat e popullit përfitonin bejlerët, Zogu dhe hajdutët e tij. Partia jonë është e vendosur që tok me popullin dhe me patriotët, jo vetëm të çlirojë Shqipërinë, por historitë e hidhura të së kaluarës të mos përsëriten më kurrë në jetën e popullit.

Qëllimi kryesor i Partisë sonë, i shprehur në programin e saj, - vazhdova t'i them, - është, në radhë të parë, zhvillimi me sukses deri në fitore i Luftës Nacionalçlirimtare.

Për këtë duhet të shumëzohet çetat, batalionet e brigadat dhe të kr ijohet kështu Ushtria Nacionalçlirimtare. Çështja e dytë me rëndësi të madhe është ajo që Partia, duke luftuar kundër pushtuesit dhe tradhtarëve, lufton edhe për shkatërrimin e pushtetit të tyre. Në vend të tij Partia ka në program të ndërtojë një pushtet të ri, që të zëvendësojë të vjetrin, që është i korruptuar, antidemokratik, shtypës. Pushteti i ri do të ndërtohet nga vetë populli, do të jetë i popullit dhe për popullin. Ky pushtet i ri përfaqësohet nga këshillat nacionalçlirimtarë që ti i njeh dhe e di ç'janë. Partia në këtë luftë u bëri thirrje dhe do të vazhdojë t'u bëjë thirrje për luftë dhe për bashkim jo vetëm gjithë popullit, por edhe individëve të veçantë, sepse disa nevojën dhe domosdoshmërinë e luftës e kanë kuptuar menjëherë, kurse disa të tjerë për një arsye ose për një tjetër mund ta kuptojnë më vonë. Ne duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet që pushtuesi të izolohet dhe të goditet për vdekje.

- Ju, - i them Reshitit, - ngritët çetën dhe pastaj formuat batalionin. Kjo është diçka e madhe, kjo është një fitore e madhe e Partisë dhe e popullit të kr ahinës së Mokrës. Ju jeni një patriot dhe

komunist i flaktë dhe dëshiroj që së bashku të studiojmë mundësitë për të organizuar në Mokrën trime edhe njësite apo çeta e batalione të tjera. Kjo do ta ndezë akoma më tepër këtë krahinë dhe do të jetë një grusht vdekjeprurës për pushtuesit e huaj dhe veglat e tyre qorre. Ju i njihni Mokrën dhe mokrarët, edhe ata të njohin ty, se je djali i këtyre maleve, ke ngrënë bukën e misërt me qepë dhe ke pirë ujin e kulluar të kësaj toke e të këtyre burimeve. Fjala jote, e bashkuar me zërin e fuqishëm të Partisë dhe të Frontit Nacionalçlirimtar, do të jetë një kushtrim në këto anë dhe unë kam bindjen se Mokra do të bëhet një kala edhe më e pamposhtur e Luftës Nacionalçlirimtare.

Reshiti më dëgjonte me kujdes dhe kur mbarova unë, e mori ai fjalën. Në substancë më tha:

- Unë falënderoj Partinë Komuniste, që më pranoi në r'adhët e saj, falënderoj babë Myslimin dhe ju që erdhët të takoheshit e të bisedonit me mua për një çështje kaq të madhe që ka pushtuar zemrën time. Unë e kam të qartë programin e Partisë Komuniste dhe po të them si burri burrit që do ta zbatoj atë der i në vdekje. Unë i urrej dhe do t'i luftoj deri në fund pushtuesit italianë, o Enver Hoxha, dhe në këtë luftë çlirimtar e do të jem kurdoherë me Partinë, me popullin, me babë Myslimin, me ju. Miqtë dhe shokët e mi që kanë igrëmyer armët dhe luftojnë kundër fashistëve italianë këtu në Mokër janë të shumtë. Këtu kemi dhe armiq, bejlerë e ballistë që na ngatërrojnë punë, na spiunojnë, nxikin hasmëritë, sjellin xhandarë dhe milicë të urryer për të frikësuar popullin, për ta detyruar atë të vejë të punojë tokat e tyre e për t'u marrë të dhjetat etj. Prandaj unë jam dakord me ju që në Mokër duhet ta zgjerojmë dhe ta thellojmë akoma më tepër luftën tonë, sepse edhe armiqtë do t'i shtypim më shpejt, edhe populli do të shohë se në gjirin e tij fle një forcë e madhe.

Pas një pushimi që bëmë jashtë në kopshtin e pjerrët me kumbulla malore, të ulur mbi barin e njomë, afër e afër njëri-tjetrit, si dy shokë të ngushtë që njiheshim me kohë, biseduam për ndërtimin e batalionit meqenëse ai ishte i sapoformuar. Reshiti kishte kulturë dhe e njihnte artin ushtarak. Biseduam gjatë për aksionet që duhej të organizonte batalioni dhe i thashë se ne do të dërgonim edhe komunistë të tjerë, edhe partizanë nga qarku i Korçës dhe i Elbasanit.

Folëm, gjithashtu, edhe për rolin që ka komisari politik i batalionit, i cili bashkëpunonte shumë ngushtë me të e vendimet i merrnin së bashku. Reshiti ishte plotësisht dakord me mua. U ngrit problemi i pajisjes me armë i batalionit dhe ndonjë ndihmë në të holla, sa të fillonte buka e re. Unë i shpjegova Reshimit që lufta jonë ishte një luftë popullore, prandaj do të hanim atë që do të na jepte populli dhe ato që do t'i rrëmbenim me luftë armikut.

- Edhe armët, - i thashë, - po në këtë rrugë do t'i sigurojmë. Por, sidoqoftë, Partia dhe Fronti do t'ju ndihmojnë edhe me një sasi pushkësh, edhe me një sasi të hollash.

Ramë dakord për çdo gjë me Reshitin, për organizimin e batalionit, për dërgimin e shokëve të Partisë, për dërgimin e armëve, të municionit dhe të të hollave. Reshiti ishte trim i vendosur, fjalën që thoshte e maste, nuk fliste shumë, por fjalët i kishte të peshuara e me zjarr.

Mbasi mbaruam bisedën u përqafova fort me shokun Reshit Qollaku dhe shkuam brenda, ku na priste Liko Gjoni.

- Xha Liko, - i tha Reshiti, - me Enver Hoxhën biseduam për zgjerimin e luftës këtu në Mokër dhe krahas batalionit tonë të organizojmë edhe njësite të tjera. Tash neve na bie si detyrë të kalojmë fshat më fshat e shtëpi më shtëpi që t'i ngremë të gjithë në këmbë.

- Për haiër! - tha Liko Gjoni. - Tani do të marrë 7 jarr tërë Moira.

Gjithë dreka kaloi duke biseduar për luftën dhe jo vetëm që u miqësova shumë me Reshitin, por edhe me xha Liko Gjonin. Pas buie u ngrita, u lashë lamtumirën të gjithëve, u putha e u përqafova fort me shokun Reshit Qollaku. (Unë nuk do të takohesha më me të. Ishte puthja dhe përqaftimi i parë dhe i fundit me Heroin e Popullit, Reshit Çollaku.)

N6 Batalionin e Mokrës krahas komandantit dhe komisarit, komunistit veteran Pilo Peristeri, Ptoleme Xhuvanit, luftonin fshatarët e varfër dhe të mesëm mokrarë, trima dhe të vendosur.

Batalioni u armatos dhe filloi menjëherë veprimet. Mokra u spastrua nga xhandarët. Bejlerët e Pogradecit dhe të Velçanit s'futnin dot këmbët në Mokër, fshatarët u çliruan nga çdo taksë, puna e tyre mbrohej, forcat armike nuk guxonin të hynin në grykat e në qafat e Mokrës. U forcua dhe u rrit roli i këshillave nacionalçlirimtarë dhe Reshiti e Piloja organizonin goditje kundër trupave armike gjatë rrugës automobilistike.

Njëra nga këto ishte beteja e Pojskës. Një kolonë armike do të kalonte në rrugën Përrenjas-Pogradec. Reshiti vendosi ta godasë në Pojskë. Ai mori të gjitha masat për t'i prerë ndihmën kolonës, qoftë nga Pogradeci, qoftë nga Lini. Dhe e goditi kolonën. U vranë një numër i mirë italianësh dhe u dogjën kamionë, por shtabi i batalionit nuk e kishte llogaritur si duhej largësinë e fushës së tërheqjes dhe mjetet e blinduara të armikut, të cilat me të dëgjuar luftën, u nisën nga Pogradeci, çanë pritën dhe e zunë pjesën e batalionit në tërheqje drejt kodrave të Pojskës. Reshiti dhe shokët luftuan me heroizëm në pararojë për të mbuluar dhe për të shpëtuar forcën më të madhe të batalionit. Ata ranë heroikisht në fushën e nderit për çlirimin e Shqipërisë. Vdekja e Reshimit më hidhëroi pa masë. Menjëherë, në emër të Shtabit të Përgjithshëm, bashkë me Spiro Moisiun, u dërguam ngushëllimet batalionit dhe familjes.

SHOKU IM ALAI KONDI*

*(Alqi Kondi (1925-1945) anëtar i KQ të PKSH dhe sekretar i KQ të BRPSH. U vra aksidentalisht më 24 qershor 1945. Shoku Enver me këtë rast më 1 korrik 1945 shkroi këtë artikull.)

Të njoha fare të ri dhe në kohën më të rrezikshme që kalonte atdheu. I fshehur në shtëpinë e një duhanxhiu të varfër patriot tiranas, të kisha lënë pjekjen e parë. Erdhe më takove, erdhe të merrje udhëzimet për organizimin e kryengritjes së madhe. Të pashë të mitur e me trupin delikat, duart e tua të holla s'gjenin vend ku të futeshin nga turpi, por kjo vazhdoi pak minuta, pse, me t'u parë, ne u bëmë shokë të pandarë, u lidhëm përjetë, zemrat dhe ndjenjat tona u bashkuan. Në dhomën e varfër të duhanxhiut tiranas, unë dhe ti s'ishim veçse dy ushtarë të thjeshtë të popullit, që kishim vendosur të luftonim dhe të vdisnim për pavarësinë e atdheut tonë të shtrenjtë.

Armiqtë na shanin për ndërmarrjen tonë; ata i quanin përpjekjet tona punë prej kalamajsh, po ne dinim ç'bënim. Ti dhe shokët e tu ishit kdlamaj nga mosha dhe nga trupi, por mendonit si burra të pjekur, pse kishit shpirt dhe zemër të madhe. Ju ishit shtylla e revolucionit popullor; ju ishit ndër ata që, qysh në urdhrin e parë, filluat rezistencën. Ti, Alqi, shoku im i vogël, ishe nga ata nxënës që në ditët e para të okupimit, me dhëmbët dhe grushtet shtrënguar, shkruanit në dërrasat e zeza të shkollave: «Poshtë Italia, do të luftojmë!». Ti Alqi, shoku im i vogël, ishe nga ata të demonstratave të para, të përleshjeve me karabinierët në sheshin «Skënderbej» të Tiranës.

Ti ishe shprehje vullneti e rinisë heroike, që do të shpëtonte atdheun. Para gjokseve tuaja të çelikut, ku rrihte zemra e një populli të tërë, do të thyeshin bajonetat e armikut. Kjo ishte bindja jonë e patundur dhe s'u gabuam.

Shoku im Alqi Kondi, të pashë të rriteshe në punë e në luftë, ndoqa me kujdes përparimin tënd të çuditshëm, për të cilin kishin aq nevojë populli dhe lufta jonë. Ndjenjat e tua të pastra dhe ideali i madh që të frymëzonte, të burrëruan, të hapën sytë, të edukuan, të bënë të doje popullin me gjithë shpirt, të ndriçuan rrugën tënde të lavdishme, të dhanë kurajë, zemër, të bënë hero. Dhe jeta jote prej militanti është plot heroizma.

Ishe ushtar i bindur dhe i disiplinuar, i pajisur me të gjitha kualitetet.

T'u dha urdhri të shkoje të organizoje rininë e Beratit, shkove, punove dhe luftove me vullnet të madh. Të kapi armiku, të burgosi, të torturoi për vdekje, gjoksi yt i vogël kulloi gjak, por ti qëndrove i pathyer. Sapo dole nga burgu dhe ende me gjoksin tërë plagë, t'u dha urdhri të shkoje në Elbasan. Ti shkove përnjëherësh, ushtar besnik i popullit. Për ty s'kishte kuptim jeta pa luftë, pa përpjekje, pa rreziqe. Vajtja jote në Elbasan i dha hov luftës në atë krahinë. Kontingjente të rinjsh vinin nga Elbasani në Çermenikë, mbushnin brigadat tona, ata ishin plot entuziazëm se kishin entuziazmin tënd që i kishte frymëzuar. U thirre dhe t'u ngarkua një detyrë e rëndësishme politike në Brigadën e Dytë. Ti qëndrove në lartësinë e detyrës. Momente të këqija kaloi kjo brigadë. Luftoi kundër reaktionit të tërbuar, kundër gjermanëve, kundër dimrit dhe urisë, por ti s'u theve. Ashpërsia e luftës të nxiste për një luftë më të madhe.

Alqi, shoku im, ti ishe një nga partizanët e mëdhenj të fitores, që s'u gabove në gjykimet e tua; në punën tënde dukej një siguri e madhe dhe një gjykim i thellë.

Me çlirimin e Shqipërisë na priste një punë e madhe dhe shumë e vështirë: kishim mbi shpatulla rregullimin e një shteti të ri që duhej ndërtuar nga themelet, kishim në kurriz një vend të shkatërruar nga lufta, që e kërcënonin uria dhe vuajtja. Ty s't'u tremb kurrë syri. Si në luftë ashtu dhe në problemet e pasluftës, zgjuarsia jote, vulineti yt, hovi yt në punë, ishin një garanci e madhe për pushtetin e për popullin. Të thirra pranë meje, në Sekretariatën e Përgjithshëm të Kryeministrit, pse kisha nevojë për ndihmën tënde, kisha besim në punën dhe në gjykimet e tua.

Tek ti, o Alqi Kondi, shihja të riun e vendit tonë, të riun e pastër, të drejtë, të guximshëm, të palodhur për kauzën e madhe të popullit.

Dhe zemra ime është copëtuar për ty, pse humba një nga bashkëpunëtorët e mi më të shquar dhe populli shqiptar një nga bijtë më trima dhe nga udhëheqësit e tij më të zotë.

Lufta jote, përpjekjet e tua, janë model për ne, për brezat e ardhshëm të vendit tonë. Në gjurmët e tua shkon një rini e tërë, një rini e shëndoshë dhe e pastër, që ka vendosur ta ndërrojë të shkuarën e sai të errët me një të ardhme të lulëzuar. Këtë rrugë ia ke caktuar ti dhe shokët e tu që shkritë jetën tuaj të re. Kujtimi yt dhe i shokëve të tu do të jetë i pavdekshëm dhe ai do të na japë zemër dhe vulinet për të korrur fitore të reja për popullin dhe atdheun, që ju i deshët aq shumë.

TRIMI I MADH VASIL LAÇI

Jam shumë i gëzuar që u takova me të gjithë ju, veçanërisht me ty, nënë e Heroit të Popullit Vasil Laçi*. *(Këtë bisedë shoku Enver Hoxha e bëri me familjen e heroit më 5 maj 1973 në Durrës.

Vasil Laçi lindi në fshatin Piqeras të Bregdetit të Sarandës më 1920 dhe u ekzekutua në litar nga fashistët në Tiranë më 28 maj 1941. Ishte punëtor. Më 18 maj 1941 qëllloi në rrugën e Durrësit (sot -Kongresi i Përmetit») mbretin Viktor Emanueli që kishte ardhur për vizitë në Shqipërinë e pushtuar nga ushtria e tij. Pas Çlirimit, Vasili është shpallur Hero i Popullit Vasili ka qenë një shoku ynë, një trim i madh, një bir i lavdishëm i popullit, që nuk kurseu as jetën për të, prandaj populli kurdoherë do ta kujtojë me respekt të madh veprën heroike të tij. Ai do të rrojë brez pas brezi në historinë e Shqipërisë si simbol i guximit dhe i trimërisë. Duke qëlluar mbi mbretin e shtetit armik që na kishte zaptuar vatanin, që na e shtypte atë me zjarr e hekur, na e digjte dhe e shkrumbonte, që vriste dhe skllavëronte njerëzit tanë, dulce zbrazur plumbin në drejtim të Viktor Emanuelit, Vasili shprehu me këtë vepër urrejtjen e mbarë popullit shqiptar kundër okupatorit gjakatar, pra, dulce shtirë kundër mbretit, ai shtiu njëkohësisht edhe kundër mbretërisë. Shembulli i tij i tregoi popullit shqiptar se duhej luftuar njëkohësisht si kundër mbretit, ashtu dhe kundër okupatorit që ai përfaqësonte.

Viktor Emanueli ishte një mbret i huaj. Populli vazhdimisht ka luftuar kundër mbretërve dhe, kur ka qenë i bashkuar, i ka rrëzuar ata, se rruga e tij ishte rruga e demokracisë. Po Viktor Emanueli ishte akoma më i keq, ishte mbret i shtetit fashist italian, që na kishte shkelur tokën e atdheut. Prandaj Vasili, që ushqente një urrejtje të madhe kundër okupatorit fashist, qëllloi kundër atij dhe thirri: «Poshtë mbreti», «Jashtë okupatorët!». Me trimërinë, guximin dhe heroizmin e tij, sido që ishte i ri nga mos'na, Vasili tregoi njëkohësisht një pjekuri të madhe politike dhe ideologjike. Patriotizmi, ndjenja e fuqishme e mbrojtjes së popullit dhe të atdheut nuk njeh moshë. Kush është i lidhur me zemër me popullin, qoftë ai i moshuar apo i ri, nuk mund të mos ketë të tilla ndjenja kaq të pastra e fisnike siç i kishte Vasili dhe të mos çajë përpara. Vasili ishte një djalë i ri i popullit, që e kuptoi qartë se duhej luftuar kundër armikut fashist okupator, i cili vetëm me zjarr dhe me plumb mund të mposhteje e të shporrej nga toka e shenjtë e mëmëdheut dhe ai kështu veproi.

Si i guximshëm që ishte Vasili pa se populli, të cilin ai e donte aq shumë, po gufonte nga urrejtja dhe zemërimi kundër armiqve. Ai u përpoq dhe kërkoi të gjente shokë, por në atë kohë akoma nuk ishte organizuar Partia. Ishte atëherë koha që në vendin tonë grupet komuniste po bënin përpjekje për t'u bashkuar, po Vasili nuk priti, ai qëllloi mbi kreun e perandorisë fashiste dhe bëri detyrën e tij

të madhe patriotike. Prandaj ju, nënë, motra, mbesa të heroit dhe ne, shokët e tij, gjithë populli ynë jemi krenarë për këtë, jemi krenarë për Vasilin dhe për veprën e tij të pavdekshme që kreu.

Kur Vasili kreu atentatin kundër mbretit të Italisë, unë isha në Tiranë ilegal, se më ndiqnin. Në atë moment ndodhesha në një shtëpi në fund të rrugës së Durrësit, tek Esat Dishnica dhe po bisedoja me të, po i flisja se ne nuk ishim akoma të organizuar, megjithatë, i thashë, po sikur t'i bëjmë ndonjë gjë këtij «qeni», Viktor Emanuelit, atë ditë që do të ikte. Kur, ja, krisi pushka dhe ne u ngritëm në këmbë. Mos bënë atë që duhej bërë?, thashë unë. Vallë kush qenë ata që e bënë këtë atentat, se të gjithë ne, komunistët e grupeve, ishim në lidhje me njëri-tjetrin dhe dinim çdo gjë që do të bënim. Nxora kokën nga dritarja dhe pashë një katrahurë të madhe, rrugëve rendnin me vrap milicë e karabinierë. U rrethua gjithë mëhalla. Çfarë të bënim që të merrnim vesh se ç'kishte ndodhur? Pak më vonë morëm vesh se si një djalë i ri nga Bregu i Detit, kishte q211uar me armë mbretin e Italisë. Ca thoshin se atentatori e vrau, ca të tjerë e p)agosi, një entuziazëm të madh kishte kudo në popull. Si e thonë?, pyeta unë. Vasil, më thanë, dhe e arrestuan, nuk e vranë.

Atë ditë lajmërova shokët, i pyeta në kishte njeri lidhje me Vasilin dhe njëri prej tyre më thotë se kishte pasur muhabet me të dhe në bisedat që bënin Vasili fliste me urrejtje kundër fashizmit. Këto ndjenja e shtynë atë që të qëllonte kundër mbr etit të vendit okupator.

Brez pas brezi Partia do të mësojë të rinjtë dhe të r e jat tona me dashuri dhe respekt të thellë për ata të rinj e të reja, për të gjithë ata që derdhën gjakun e tyre për lirinë e atdheut; do t'u shpjegojë përse e derdhën gjakun, do t'i frymëzojë që të mësojnë nga heroizmi dhe vendosmëria e heronjve dhe dëshmorëve, se si atyre vdekja u është dukur e ëmbël, se si edhe Vasili, një djalë i ri i dalë nga populli, u hodh përpara milicëve me kobure në dorë dhe shtiu mbi mbretin armik. Pse e bëri ai këtë? B bëri që populli të gëzonte të gjitha këto të mira që gëzon sot, për këto fusha të bukura, për uzinat, fabrikat, rrugët, hekurudhat, për hidrocentralet, shkollat e spitalet që po ndërtojmë vazhdimisht me gjak dhe me djersë, që populli të rrojë i lirë dhe i lumtur.

Të rinjtë tanë, vajzat dhe djemtë, të mos kujtojnë se këto të mira që gëzojnë sot kanë rënë nga qielli. Jo, në tabanin e tyre ato kanë sakrificat dhe gjakun e popullit. Prandaj nuk duhet të na zërë gjumi, po të punojmë që fitoret t'i ruajmë e t'i mbrojmë nga çdo rrezik, se armiku, beu, agai, kulaku përgjojnë. Ata tanfi nuk dalin dot hapur, por, po na panë të flemë gjumë, nuk presin, ata na goditin, na futin thikën. Prandaj kurdoherë të jemi vigjilentë, jo vetëm, ne, por edhe brezat e ardhshëm. Këtë mësim t'ua ngulim mirë në mendje çdo ditë të rinjve e të rejave, gjithë njerëzve tanë, këtë ata duhet të mos e harrojnë kurrë...

S' KA KALA QË NUK MARRIN KOMUNISTËT

*(Nga raporti
në Kongresin e 2-të të PPSH, 31 mars 1952)*

Në Mirditë rronte dhe luftonte një komunist i quaj-tur Ndrec Ndue Gjoka. Ai ishte mësues, ai s'mund të duronte as shtypjen as errësirën që ushtronin në Mirditë fashizmi dhe Gjon Marka Gjoni*. *(Bajraktar i Mirditës, shtypës e shfrytëzues i popullit të kësaj krahine, i vënë në shërbim të pushtuesve të huaj.) Fill pas Çlirimit i ndihmuar nga Bardhok Biba* *(Në atë kohë ishte sekretar i parë i Partisë për rrethin e Mirditës, vrarë tradhtisht nga armiqët e popullit.) ai, duke zbatuar direktivën e Partisë, me iniciativën e tij, që në dhjetor të vitit 1944, hapi në Mirditë 50 shkolla. Por a hapen 50 shkolla pa lokale, pa lapsa, pa fletore dhe sidomos pa mësues? Po, hapen. S'ka kala që nuk e marrin komunistët. Ndrec Ndue Gjoka, fshatar i varfër, lokalet e shkollave i krijoi në shtëpitë e fshatarëve, fletoret dhe lapsat, çau e ndau andej-këtej i mblodhi vetë, mësuesit, gjëja kryesore, i grumbulloi nga ishnxënësit e «konviktit

të Oroshit». Në fillim ai u foli për hapjen e shkollave dhe vetë u bëri atyre një kurs të shkurtër pedagogjik. Dhe shkollat u çelën, 50 shkolla, shokë, dhe këto funksionuan kështu për mrekulli derisa i aprovoi Ministria e Arsimit në vitin 1945. Me krenari nxënësit e vjetër të «konviktit të Oroshit»*, *(Konvikti që ngriti në Orosh para Çlirimit me shumë sakrifica po pulli i krahinës së Mirditës për bijtë e tij.) që tani janë bërë mësues me eksperiencë, thonë «na jena nga mësuesit e parë të përgatitur prej Ndrec Ndue Gjokës». Dhe shokur tonë, Ndrec Ndue Gjokën, na e vranë tradhtarët e Gjon Marka Gjoni në Qafën e Vorres më 1946, pikërisht për këtë vepër të madhe patriotike të tij. Unë e ftoj Kongresin që të nderojmë kujtimin e këtij pionieri të shquar komunist të dritës dhe të arsimit. Pë të mendojë dhe të veprojë çdo njeri kështu, dhe kështu duhet të mendojë dhe të veprojë, çështja e analfabetizmi do të hyjë shpejt në arkivin e historisë së Republikës Popullore të Shqipërisë.

IV NË GJIRIN E POPULLIT

AJO NËNË E PANJOHUR

Populli i thjeshtë i Tiranës, si në ato momente (Pranverë 1942,], ashtu edhe gjatë luftës, u tregua i patrembur, heroik, si titan, veçanërisht gratë tiranase. I shihja me sytë e mi, i ndieja me zemrën time në ato ditë të tmerrshme të furtunës, kur ato na hapnin portat e shtëpive, na futnin në gjirin e familjeve. U zhdruk kështu fanatizmi. Na njihnin ose jo, mjafton t'u jepje parullën dhe ndodheshe përnjëherë si në gjirin e familjes tënde, si në mes të njerëzve të afërm. Këto nëna, këto gra, këto vajza heroike s'njihnin frikë, sikur zjarri t'i dilte deri në çati shtëpise së tyre.

- Qyqja, - thoshin ato, - veç çunat dhe gocat që luftojnë t'i shpëtojmë nga hasmi!

Unë i dija gati të gjitha shtëpitë tona baza të ilegalëve. Për çdo moment rreziku futesha në to.

Një mbrëmje vonë, ndërsa po nxitoja me biçikletë të arrija shpejt në bazën e caktuar sepse kishte filluar koprifuokja, shoh se vinte drejt meje një patrullë milicësh. Për t'i shpëtuar kontrollit dhe pasojave të tjera, më duhej medoemos të fshihesha diku. Dija se në rrugicën pranë ishte shtëpia e një shokut tonë, që ma kishin treguar në të kaluar, por që unë brenda as kisha qenë ndonjëherë, as shokun nuk e njihja. Të më pyesësh sot se ku pikërisht është ajo shtëpi, nuk mund të them, jo vetëm se atje hyra vetëm një herë dhe në errësirë, por edhe se kanë shkuar shumë kohë dhe nuk u kam rënë më atyre rrugicave.

Shtyva, pra, derën me ngadalë dhe hyra në një oborr të vogël. Shtyva derën tjetër, u ndodha përpara një shtëpie tiranase dhe fola me zë të ulët:

- Nëne, a ka njeri këtu?

Në errësirë doli një plakë. Vetëm buzla e bardhë në kokë më bëri që ta dalloja:

- Të ndjekin, çuno? - më pyeti nëna.

- Po ! - i thashë.

- Ngjitu në dhomë, atje ka një hasër, shtrihu e çlodhu, pa ruan nëna.

As emrin më kërkoi nëna dhe as biri nuk ia dha emrin e tij. Nëna e njeh çunin e vet dhe i biri e njeh të emën. Pasi qëndrova brenda njëfarë kohe, zbrita prapë ngadalë, pashë nënën që ishte ulur në fund të shkallës dhe i thashë:

- Nëno, pa shiko, a ka ndonjë patrullë ose njeri të dyshimtë në rrugë?!

Ajo doli menjëherë, kontrolloi majtas e djathtas dhe, pasi u kthye, më tha

- Nuk ka frymë njeriu!

E ndjeu se u bëra gati të ndahesha, ndaj më hodhi duar t në supë e me një zë të dashur e të dridhshëm më tha:

- Do të shkosh. çuno, kështu si duket e ke punën. Shtëpinë e keni kurdoherë të çelur. Të ruajt zoti! Më shtrëngoi dhe e shtrëngova në kraharor dhe ndjeva në errësirën e natës se diçka po më fuste në xhep. Jashtë pashë se ishte një ko~kërr ftua i vogël.

O nëna ime e dashur tiranase, s'ta mësova kurrë emrin tënd, as ti nuk e mësove emrin tim. Më ka mbetur peng që nuk të kam njohur nga afër e nuk të kam takuar dot, veçse ti qëndron e ndritur në kujtimin dhe në zemrën time dhe, derisa të vdes, ai kujtim i asaj nate në furtunë nuk do të më shlyhet kurrë!

SHTËPIA E ILEGALËVE

Të dashurit e mi, nënë Mine, Dullë dhe Nazmije, sonte po shkruaj për ju, se më ka marrë malli. Ju vdiqët dulce luftuar e dulce punuar për Partinë, për këtë popull, për këtë atdhe. Ishit dhe mbetët të thjeshtë gjithë jetën tuaj, por edhe trimëresha e trima si populli fukara i Tiranës së atyre viteve.

Një ditë një shok tiranas vjen në dyqanin «Flora» dhe, dulce blerë, sa për adet, një paketë cigare, më thotë:

- Shoku Enver, kam një simpatizant të mirë, kam motmot që po e provoj, s'ka frikë fare, është i vendosur, prandaj mendoj ta propozoj për në grup. Si më këshillon ti?

- Ç'të të them unë, ti e njeh vetë, po të jetë i mirë, pse jo?! Po ç'punë bën dhe si e quajnë?

- Abdulla Keta e thonë, është berber.

- Shih, - i them, - se berberët flasin shumë, mbasi ua do edhe zanati.

- Dulla bën përjashtim, ai nga natyra i ka fjalët të pakta. Po ta shikosh në fytyrë, duket sikur i ke ngrënë bukën. Pasi ne ta udhëzojmë për punën tonë jam i sigurt që nuk do të flasë edhe sikur ta vrasin.

- Nga ç'shtresë është? - vazhdova unë.

- I pikur, i varfër, ushqen tre veta, as cigare nuk pi.

- More, - i them shokut, - nuk ma dërgon nesër në dyqan? Kalo nga ora dhjetë me të, t'ju shoh një herë pastaj lëre atë të vijë vetë dhe të kërkojë të blejë jo një paketë, po një pako me 50 paketa, që të kem rastin t'ia zgjat ca muhabetin pa u kuptuar.

Dhe kështu u bë. Të nesërmen nga ora dhjetë, kur po vëzhgoja nga xhami i vitrinës, pashë të shkëputej nga kalimtarët e të hynte brenda në dyqan një njeri. U ngrita në këmbë dhe e pyeta:

- Ç'dëshironi zotni? - dhe i qepa sytë e mi në të tijtë.

Zakonisht sytë e njerëzve janë si një pasqyrë. Nga shikimi i tyre krijoj përshtypjet e para të mira ose të këqija, nëse tram të bëj me njerëz të zgjuar, të thjeshtë, ose të djallëzuar. Shpeshherë i besoja shikimit dhe formoja pale a shumë një ide për njeriun me të cilin takohesha. Sytë e Dullës ishin të zinj, të zinj. Ata herë-herë vrenjteshin, por kishin qartësi dhe ëmbëlsi. Shikimi i tij të ngjallte besim. Kishte një ballë të ngushtë, dukej kokëfortë.

- Dua një paleo cigare, - tha Dulla.

- Një pako apo një paketë? - e pyeta unë.

- Një paleo me 50 paketa «Flora», - sqaroi ai edhe me këmbëngulje, edhe me hezitim.

- Si shumë kërkoke, shoko, - i thashë. - Cigareshitës je ti? - vazhdova ta pyesja, për të provuar nëse do të më gënjente.

- Jo, - tha ai, - jam berber.

- Po ç'i do 50 paketa, - e pyeta, - apo t'u japësh nga një cigare atyre që rruan?!

- Jo, or shoko, - më tha Dulla, - dua të nxjerr edhe unë ndonjë lek, se me zor po ia dal.

- Po ashtu fol, - i thashë, - por që të bëhesh dyqanxhi si unë, duhet ta kesh zanat. Ti po bën tregti në këmbë.

- Çfarë zanati, - më tha Dulla. - a ma shet patron, apo nuk ma shet? Lëri fjalët!

- Mos u nxeh, shoko, - i thashë. - A nuk e sheh se me këtë gjaknxehtësi s'bëhesh dot kurrë tregtar? Po, edhe berber, nuk e marr dot me mend se si punon kështu.

- Hajde një herë të të rruaj dhe të më shikosh si e tram dorën. Po unë e di që ju tregtarët, veni tek ata ber berë që kanë pasqyr a shumë, - theksoi ai.

Më hyri në zemër Dulla, se ishte i guximshëm dhe i hapët.

- Këtë herë, - i thashë, - po të jap një paleo, se nuk dua të të nxjerr me duar bosh, por harroje dyqanin tim, se më nuk të jap.

Unë e kisha hallin gjetkë, se mos Dullës i hipte në kokë dhe vinte vazhdimisht në dyqan, me qëllim që të më bënte propagandë komuniste dhe të më kishte «simpatizant». I dhashë pakon me cigare «Flora» dhe Dulla iku me të nën sjetull. Në mbrëmje erdhi shoku dhe më pyeti:

- E, Enver, ç'për shtypje të bëri?

- Të mirë, - i thashë, - pranojeni! Po unë ç'përshtypje i bëra atij?

- Përshtypjen e një tregtari, po shtoi: «Megjithatë pakon ma dha, veçse më tha mos eja më në dyqan».

Fillova t'i shpjegoja shokut arsyen pse ia preva Dullës rrugën për të ardhur prapë në dyqan.

- Mos e zgjat, - më tha ai, - e kuptova.

- Prandaj, - e këshillova, - kujdes, mos e komprometoni shumë. Ku e tra shtëpinë?

- Këtu afër, rreth nja dyqind metra më lart.

- Kë tra në shtëpi?

- Një nënë, një motër më të vogël dhe një vëlla, gjithashtu, të vogël.

- Shtëpinë, të tyren e kanë?

- Të tyren, dhe në çfarë pozicioni! Kanë një shtëpi shumë të mirë për punë ilegale. Hyn nëpër një sokak të ngushtë për të arr itur te porta e saj dhe pastaj në rast nevoje, mund të dalësh matanë, në rrugën «Çerçiz Topulli».

- Atëherë të ndalohet çdo lëvizje në shtëpinë e Dullës dhe ky të bëjë punën e berberit e të hiqet si budalla. Kuptove?

- Qartë, - tha shoku.

Kjo ishte njohja ime e parë me Dullën. Më vonë u takova përsëri me të kur u hodha në ilegalitet. Dullës i kishin thënë se në shtëpinë e tij do të strehohej një shok, që quhej Taras. Kështu ai priti një ditë në shtëpinë e vet «tregtarin» e cigareve «Flora».

- Ah, - tha Dulla, duke më përqaftuar, - ç'ma paske punu. Po msoj si duhet vepru i masku. Allahile, as ma merrte menja se ti ishe Tarasi.

Dulla më njohu me nënë Minen dhe me motrën e tij, Nazmijen. Në drekë më njohu edhe me vëllanë e vogël, Hakiun. M'u kujtua Gavroshi i Viktor Hygoit, që grumbullonte fishekë në barrikatat e komunarëve të Parisit, luftën e të cilëve Karl Marksi e ka vlerësuar aq lart në shumë shkrime dhe vepra e midis tyre edhe në veprën «Lufta civile në Francë».

Dulla u foli njerëzve të shtëpisë për mua, ashtu siç kishim rënë dakord bashkë që më parë, por edhe ca më shumë.

- Ije, Nazmije, ky asht një shoku ynë, e qujn Taras. Asgja mos bzani jashtë. Ma mirë të vritemi unë e Hakiu, sesa t'i preket një fije floku Tarasit, - tha Dulla me zërin e tij të trashë dhe theksin tiranas.

- S'kanë nevojë për këto fjalë as nëna, as motra, - iu drejtova Dullës. - Ato do të më duan dhe do t'i dua, asgjë nuk do të më ngjasë mua në këtë familje. Shko ti Dullë, - e këshillova, - se të pret ustai, më lër mua të flas me gratë e t'ua shpjegoj vetë si është puna.

Doli Dulla dhe Nazmija shkoi e i vuri shulin portës.

- Hajde or bir të të pjek një kafe, - më tha nënë Minja. - S'e mbajta men, si t'qujshin, se për herë të parë e nigjoj këtë emën.

- Taras, - i thashë.

- Urdhno, Taras, - dhe më udhëhoqi në një dhomë mjaft të madhe përdhese, me baltë, pa tavan, me dy penxhere të vogla lart në çati.

Duke pirë kafënë, u them nënë Mines dhe Nazmijes:

- Uluni këtu, afër meje.

Ato u ulën dhe po më shikonin ç'do t'u thosha.

- Unë jam një komunist si Dulla. Mua më ndjekin fashistët dhe policia që të më vrasin, si gjithë të tjerët që luftojnë, por në dorë unë nuk bie pa përpjekje. Tash luftoj duke qenë i fshehur, sot do të fle te ju, nesër gjetkë. Kohët janë të vështira e të rrezikshme. Po ju bëhem barrë e madhe.

- Mos e thuj ma atë fjalë, - më ndërpreu menjë

herë nënë Minja, - se na idhnon.

- Më falni, - u thashë dhe vazhdova, - nuk luftoj

vetëm unë, jemi me mijëra. Ja, në shtëpinë tuaj jemi pesë luftëtarë, të tërë njësoj të vendosur. «Taras» nuk është emri im i vërtetë, por i rremë, për të mos rënë në erë armiku, po për ju unë jam një djalë nga Gjirokastra, sic është Dulla nga Tirana. Ne, komunistët jemi të gjithë fukarenj, jemi të thjeshtë. Sa kohë që unë do të qëndroj te ju, do të ha atë që hanj ju dhe aq sa hanj ju, do të ushqehem me një pjesë nga ata të paktë lekë që fiton Dulla. Asgjë më tepër. Mund të harxhoj pak më shumë vajguri nga ju, pse do të më qëllojë të shkruaj natën vonë. Unë kam qenë edhe mësues, por tash e lashë atë zanat, penës i shtova edhe pushkën. Do të më vijnë rrallë, disa shokë këtu, por do të marrim masa që të mos bien në sy. Megjithatë unë nuk do të rri përherë këtu, po si të qëllojë, nga dy ose tri ditë e shumta, se Partia na mëson të ndërrojmë vazhdimisht bazat që armiku të mos na diktojë as shtëpitë, baza të luftës, as luftëtarët. Prandaj, ju lutem, - u thashë, - zëreni sikur unë s'jam këtu, ose sikur jam Dulla.

Kjo ishte familja e dashur e Mines, ku unë pa humbur kohë fillova punën.

Pas themelimit të Partisë lufta dhe puna jonë u shtuan, ato morën proporcione të reja, më të gjera. Dulla u bë ndërlidhësi im me shokët e Partisë. Ai çonte porositë që i jepja, ose letra me udhëzime dhe sillte përgjigjet, merrte traktet dhe artikujt që shkruaja dhe i çonte në shtypshkronjat tona ilegale. I mësoja Dullës se si ta bënte luftën ilegale:

- Ruaj gjakftohtësinë në çdo kohë, - i thosha, deri tanë e ke zbatuar mirë porosinë që të kam dhënë në fillim, prandaj vazhdimisht do të ecësh si «i trulllosur». sikur këmbët i ke mbi tokë, por trutë te hëna; shiko çdo gjë me kujdes, përpara dhe anash, duke u hequr sikur nuk shikon.

Herë tjetër e porosisja:

- Filani do të të vijë në dyqan ta qethësh, ti ule në fron dhe, kur t'i vësh çarçafin në qafë, këtë pusullë që po të jap, futja në gji nga qafa dhe, kur të mbarosh së rruari, bjeri me gisht në gjoks, duke i thënë: «Me shëndet!». Ndokush mund të të japë edhe bakshish, - i thosha Dullës, - ti fute përnjëherë dorën në xhep se tok me lekët mund të ketë ndonjë mesazh.

Kur mbaroja ndonjë shkrim, që duhej dorëzuar në shtypshkronjat tona ilegale, i thosha Dullës:

- Bli dy bileta kinemaje afër njëra-tjetrës; njëren jepja filan shoku, tjetrën mbaje për vete dhe, kur të fillojë filmi, në errësirë, i dorëzo shokut zarfin që do të jap.

Dhe komunisti Dullë Keta i kryente detyrat me përpikëri.

- U lodhe, Dullë? - i thosha.

- Çfarë të lodhuni, mor jahu, - më thoshte, - mu më duket sikur nuk po baj gja, du të baj atentate.

- Po të mos punoje me mua, - i thosha, - kush do të më ndihmonte këtu, apo fryma e shenjtë? Pse vetëm ti do që të bësh atentate, unë nuk dua? Por neve këto detyra na ka dhënë Partia, prandaj këto do të bëjmë. Kur ajo të na urdhërojë të bëjmë tjetër punë, ne do t'i themi asaj «gati». Prandaj, Dullë vëllai, mos mendo se ajo punë që kryen ti nuk është luftë. Ajo është luftë dhe luftë e zgjuar e tepër e vështirë, pse pikërisht këtë luftë kërkon të zbulojë armiku.

- Më fal, Taras, - thoshte Dulla, - tash e kuptova më mirë. Të futim në këto punë edhe Minen, Nazmijen dhe Hakiun?

- Mos u ngut, Dullë, ato janë futur në luftë dhe ne do t'i rnesojmë akoma edhe më shumë si të luftojnë. Ato janë zjarr, atë duan, por me kujdes do t'i mësoj se si duhet dhe çfarë duhet të bëjnë.

Ata më dëgjonin me vëmendje. Nazmija e Hakiu më shikonin ngultas dhe më përpinin çdo fjalë, si ajo toka e etur për ujë. Nënë Minja nganjëherë psherëtinte, mbase vuajtjet e jetës e bënin disi skeptike, dhe pëshpëriste ashtu ngadalë e mendueshëm: «qyqja», por, kur flitnim për luftën, ajo gjallërohej dhe, kur zinin në gojë emrat e armiqve, nuk mungonte të shprehej.

- T'i vrasim të gjithë qenat.

Nazmijen e njoha me Nexhmijen dhe ato e deshën shumë njëra-tjetrën. Nexhmija e vuri atë në lidhje me të reja të tjera dhe Nazmija u bë një nga aktivistet më të mira të luftës sonë. Ajo shkante shtëpi më shtëpi dhe ponte fjalën e Partisë te shoqet e saj. Dita-ditës ajo ngrihej, përparonte.

Njëherë e pyeta:

- Nazmije, po të na rrethojë policia, ke menduar si do të shpëtojmë?

- Kam menduar, Taras. Ja këtu, e sheh këtë derë të vogël? Këtej del në shtëpinë e xhajës sonë, ata janë njerëz të mirë dhe kanë rënë në erë që te ne vijnë ilegalë se, një ditë, më zuri plaka dhe më tha: «Shif gocë, unë marr vesh ç'po ngjet te ju, bani kujdes, mahalla ma shurnë nuk di, por shif, po të ngjasë gja, qiti këtej nga ne dhe së bashku mur mbi mur t'i qesim matanë».

- Të lumtë, Nazmije, - i thashë, - po mendon si revolucionare.

- Dua të kem edhe unë një kobure, - më tha një ditë goca.

Dhe unë i solla një «Beretë» të vogël. Ajo u hodh përjetë nga gëzimi, sytë e zinj i xixëllonin.

- Qyqja, - i tha Minja, - ç'të duhet ty koburja?!

- Të luftoj, ije, edhe unë si Nexhmija, si Tarasi, si Dulla.

Edhe Hakiu e mësuam të kishte më shumë disiplinë, pse, dulce luajtur me shokë, diku u hiqte nga një shpullë. Nga të gjitha anët e tjera ai ishte «pus»; vërtet i vogël, por ishte i zgjuar e i pjekur, kështu që ishim të sigurt se jashtë s'na nxirrte asnjë fjalë.

Një ditë i dhashë një broshurë të Leninit që fliste për rininë.

- Lexoje njëherë, - i thashë, - pastaj më pyet për ato që nuk do të kuptosh.

Dhe kështu bëri. Pyetjet që më drejtoi, natyrisht, ishin të shumta, por unë, si ish-mësues, as që çuditesha dhe as që mërzhitesha. Te Hakiu me shokë shihja të ardhmen e Partisë, kuadrot e rinj të dalë nga revolucioni. Hakiu e mësuam të bëhej edhe korrier i ilegalëve.

Shumë punë partie e veprime të tjera kryem, shumë trakte dhe artikuj shkruam në shtëpinë e nënë Mine Ketës. Iknim, humbisnim nga sytë e tyre me javë dhe me muaj të tërë, si të qëllonin puna dhe evenimentet e luftës, pastaj ktheheshim përsëri te Minja, te Nazmija, te Dulla, te Hakiu. S'e harroj atë gëzim që ndieja kur piqesha me ta.

Shtëpia e nënë Mines kështu vazhdoi të ishte deri ditën e Çlirimit, shtëpi e të gjithë shokëve ilegalë, shtëpia e Partisë. Ajo nuk u mbyll kurrë.

Dulla u ngarkua me detyrë nga Komiteti Qarkor i Partisë, konkretisht nga Gogoja, që të më sillte mua materiale partie në Çermenikë. Dullë Keta, si komunist i vendosur, eci ditë dhe natë pa pushim, kaloi postbllloqet e armiqve dhe doli në zonën e lirë. Atë e zuri një natë e egër, me furtunë, në një mal. Binte shi, vetëtinte dhe Dulla vazhdonte të ecte, por në një vend, siç kuptohet, nuk do të ketë parë se ishte hon dhe ai ra. U vra si partizan, komunisti trim Dullë Keta. Kur e gjetën trupin e tij, ai mbante me dorën e ngrirë xhepin me dokumente. Qava në errësirën e dhomës ku ndodhesha në Çermenikë, qava për shokun tim besnik, Dullën, qava për hidhërimin që do të ndienin për atë trim nënë Minja, Nazmija, Hakiu dhe të gjithë shokët që e njihnin.

ADEM E SABRIJE OSMANI

Pikërisht kur armiqtë dhe spiunët, me listat e emrave tanë nëpër xhepat e tyre na kërkonin në çdo skutë, si ata qentë pas erës, qarkori më caktoi të punoja në bazën e re, në rrugën «Sulejman Pasha». Shtëpia, ku do të punoja, ishte e parafundit në rrugicë, e cila mbaronte buzë Lanës, kështu që në rast rreziku mund të kaloje nëpër shkurret e lumit dhe të largoheshe pa u diktuar. Në krye të rrugicës naóodhej shtëpia e një kapiteni të milicisë, kështu që ajo ruhej nga «hija» e tij dhe pastaj edhe nga pozicioni i përshtatshëm. Po më tepër se nga kushdo rrugica do të ruhej nga populli dhe nga ilegalët.

Në bazën tonë të re, e cila ka mbetur në kujtesën time e pashlyer, unë shkova së bashku me komunistin internacionalist jugosllav, Miladin Popoviçin*,*(Komunist internacionalist jugosllav, mik i

PKSH dhe i popullit shqiptar që luftoi në Shqipëri në vitet 1941-1944 dhe u vra nga organet e UDB-së, të Titos në Prishtinë më 1945.) prandaj kujtimi i saj lidhet edhe me kujtimin e paharruar për këtë njeri me zemër të madhe, i cili e donte popullin shqiptar, ashtu si donte popullin e vet. Ne shkuam aty nga fundi i muajit prill dhe qëndruam deri nga fillimi i muajit qershor. Gjatë këtyre dy muajve unë kam shkuar dhe kam qëndruar edhe në baza të tjera, por shtëpia e re që zumë, u bë për këta dy muaj baza jonë kryesore.

Mbasi kontrolluam rrugën se mos po na ndiqnin, iu afruam derës dhe i ramë ziles. Zilja ishte montuar në një vend që nuk i binte kujtdo në sy, po të mos e dije. Vendin e saj do ta dinin shumë pak njerëz dhe kur ajo tringëllonte do të thoshte se ishin shokët tanë, ndërsa kur të trokiste dera, do të thoshte se duhej bërë kujdes.

Derën na e hapi një shok i ngarkuar nga qarkori, për të qëndruar me ne. Unë isha veshur si elektrikist, me kominoshe, kurse në kokë kisha rrasur një kasketë.

- Si je shok? - i thashë dhe i shtrëngova dorën.

Po kështu veproi Miladini, i cili vetëm i buzëqeshi, me atë buzëqeshjen e tij të ngrohtë dhe të çiltër, prej njeriu babaxhan dhe të sjellshëm.

Shtëpia më pëlqeu menjëherë. Shkova te pusi, lëshova kovën brenda dhe si e mbusha me ujë u shpëlava dhe u freskova pak.

Shoku që ndiqte veprimet e mia me kujdes, m'u duk burrë i heshtur dhe i vëmendshëm. Na tha se quhej Adem Osmani dhe punonte çirak opingar.

- Nga je? - e pyeta.

- Nga Shëngjini i Madh i Shëngjergjit, - m'u përgjigj.

- Atje i keni njerëzit?

- Po. Unë vetë punoj këtu, në Tiranë, bashkë me vëllanë e madh.

Pasi u ula për të punuar, Ademi hyri në kuzhinë për të na gatuar diçka. Nuk e mbaj mend se kur mbarova së shkruari, por, kur u ulëm për të ngrënë, pashë se dreka ishte ca si e bollshme për ato kohë lufte, prandaj i thashë Ademit

- Nuk gatuan keq, por qenka pak dorëlëshuar. Duhet të bëjmë kursime, sepse jemi të varfër dhe lekun mezi e gjejmë. Populli e heq nga goja e tij për të na e dhënë neve.

Ademi nuk foli por «kritikën» e mbajti vath në vesh.

Shumë shpejt do të bindesha se ishte një njeri i nder shëm, i vendosur, konspirator dhe aspak kurioz. Po baza jonë e re, për të cilën po shkruaj këto kujtime kishte një defekt, që na ra menjëherë në sy neve. por mund t'i binte në sy edhe ar mikut. Ky defekt duhej të ndreqej sa më parë. Shtëpia jonë kishte vetëm burra, dhe nuk mund të të linte përshtypjen se aty banojnë njerëz familjarë, që kanë hallet e tyre, jetën e tyre. Duhej patjetër të krijonim përshtypjen se ne që banonim me qira në atë shtëpi ishim njerëz të zakonshëm, që kishim ardhur në Tiranë dhe aty ishim zënë me punë. Këtë gjë e nuhati edhe Ademi, i cili më tha një ditë që të sillte të banonte këtu motrën e tij.

- Sa vjeç është? - e pyeta.

- Pesëmbëdhjetë!

- Mirë, nuk qenka e vogël. Por a ke punuar ndopak me të se mos frikësohet dhe e pësojmë, - i thashë dhe vura buzën në gaz për Vi dhënë të kuptoja se bëja shaka.

- I kam folur nga pak dhe ajo është gati të luftojë me ne.

- Shumë mirë ke bërë që i ke folur, - i thashë. Duhet të punojmë akoma më tepër me rininë dhe sidomos me të rejtat. Ato janë e do të jenë një forcë e madhe për luftën tonë. S'ma merr mendja se shëngjergjasit janë më pak trime se shëngjergjasit.

Kështu, pasi ia aprovova mendimin, Ademi u nis, i veshur si fshatar, të sillte motrën në bazën tonë. Atëherë ne do të bëheshim tamam një familje. Isha i sigurt se edhe motra do ti ngjiste vëllait.

Ra zilja jonë sekrete që tregonte se kishte ardhur Ademi me të motrën. Kjo ishte një vajzë me dy gërsheta, me fytyrë rrumbullake e me shtat mesatar. Më vështronte e hutuar dhe pak e habitur.

- Eja, si e ke emrin? - e pyeta për Via hequr hutimin e natyrshëm, sepse po hynte në një jetë të re, në jetën e ilegalëve.

- Sabrije, - m'u përgjigj me një zë të butë.

- Atëherë, ne do të të thërresim Sabrija e vogël. Apo tani që po hyn në një shtëpi ilegalësh, nuk të vjen mirë të të thërresin kështu?!

Sabrija uli kokën dhe nuk foli. Kur hymë brenda ajo i dha dorën Miladinit dhe pastaj u nguli sytë revoles dhe dy bombave të kuqe dore që i kisha lënë mbi tavolinën e punës. Ato siç duket e futën menjëherë në botën e ille galëve, midis të cilëve ajo do të jetonte dhe do të punonte, pavarësisht nga mosha e saj e njomë. Por Sabrija do ta justifikonte shpejt besimin tonë. Kuptohet, detyrat që i ngarkuam në fillim ishin më të thjeshta për t'i kuptuar e për t'i zbatuar. E porosita që të ecte sa më lirshëm e natyrshëm, veçanërisht para banorëve të rrugicës dhe, edhe kur s'kishte punë, të dilte dytri herë në ditë të hidhte plehrat në Lanë dhe të shikonte me kujdes mos kishte lëvizje të dyshimta në rrugicën tonë. Ajo ia mori shpejt dorën kësaj pune: dilte nga shtëpia, hidhte plehrat dhe askujt nuk mund t'i binte ndër mend, se ajo para së gjithash vëzhgonte.

- Nuk ka asnjë lëvizje, prandaj punoni të qetë, na thoshte dhe shkante të gatuate për mua, Miladinin dhe vëllanë e saj.

Kur dëgjoja radion ajo shkelte me majë të këmbëve mos bënte zhurmë. Sytë gjithmonë nuk ua ndante bombave të kuqe. Donte të më pyeste, po siç dukej Ademi e kishte porositur që të mos më pyeste për asgjë, prandaj heshtte. Më në fund, mori guximin dhe më pyeti:

- Shoku Taras, mirë revolen e di përse e doni, po këto dy vezë të kuqe përse i mban për herë në tavolinë?

Qesha dhe iu përgjigja:

- Këto «vezë» moj Sabrije janë bumje dhe me to mund të vrasësh armiqtë dhe Mustafa Krujën*. *(Armik i popullit, kryetar i qeverisë tradhtare vënë në shërbim të pushtuesve fashistë në vitet 1941-1942.)

- Vërtet?!

- Patjetër! - i thashë dhe vazhdova: - Po të t'i jap ty dhe të të them shko vraz Mustafa Krujën, shkon ti?

- Si nuk shkoj, shoku Taras!

Këtë ajo e thoshte me sinqeritet dhe me të vërtetë shkante, pa marrë parasysh asgjë, për të kryer detyrën e caktuar nga Partia.

Mbaj mend se një natë, ndërsa ishim të gjithë në shtëpi dhe unë me Miladinin po punonim një material, diku më tej, në zonën ku banonte Mustafa Kruja u dëgjuan bacare pushkësh. Lamë menjëherë materialin, morëm automatikët dhe u vumë në gatishmëri.

- Ç'të jetë, vallë! - pyeta i habitur. - Ne s'kemi vendosur për ndonjë aksion të afërt kundër Mustafa Krujës!

Ademi, ndërkaq kishte zënë pozicion në anën tjetër të shtëpisë, kurse Sabrija, që ishte zgjuar nga zhurma, më tha

- Shoku Taras, të marr një bumje?

- Jo, - i thashë, - më mirë merr revolen time, ti lash e di se si përdoret.

Ajo e mori, doli në oborr dhe shkoi pranë portës për të dëgjuar ndonjë lëvizje hapash apo zhurmë tjetër në rrugë.

Qëndruam në pritje njëfarë kohe dhe, kur ra qetësia

e nuk po dëgjohej më asnjë zhurmë, hoqëm armët e nisëm përsëri nga puna. Nuk e morëm vesh as ato çaste, as të nesërmen se ç'ishin ato batore pushke. Ndoshta

ndonjë patrullë fashistësh kishte qëlluar në erë, për t'i hequr frikën vetes e për të siguruar Mustafa tradhtarin

se «trimat» i kishte rrotull, gjë që ndodhte shpesh në ato vite, kur pushtuesit e tradhtarët ndodheshin vazhdimisht nën goditjet tona të pandërprera e të befasishme.

Të nesërmen, me shaka i thashë Sabrijes:

- Shpëtoi mbrëmë Mustafa! Nuk e zuri bumja!

- Shkoj unë dhe ia hedh mbi kokë, Mustafa tradhtarit, por nuk di si ta përdor, - m'u përgjigj ajo gjithë ser iozitet.

- Ta mësoj unë. Sapo të shohësh që po afrohet tradhtari hiqe me dhëmbë këtë dhe hidhja bombën. Bomba do të shpërthejë dhe do ta bëjë copë e çikë. Vetëm se mos ia kërcit vrapit, se do të të kapin menjëherë. Ti hidhi bombat dhe hiq sikur nuk ke bërë gjë. Mirë?

- Mirë.

- Dhe tani, shko bëj punët që të ka thënë Ademi.

Në qoftë se unë bëra shaka, vajza e vogël nuk e mori fare si shaka dhe gati çdo ditë më thoshte të shkonte të vriste Mustafa Krujë tradhtarin.

- Jo sot, sepse kemi punë të tjera, - i thosha, por kur shihja se fytyra e saj trishtohej, i rrihja shpatullat dhe shtoja: - Sabrije e vogël, puna që po bën tanfi, është shumë më e rëndësishme dhe shumë më e rrezikshme sesa të vrasësh një tradhtar.

Këto fjalë disi e qetësonin Sabrijen, që dilte «të derdhte» plehrat dhe të vëzhgonte lëvizjet në rrugë. Shumë shpejt ajo u mësua të ndiente që nga brenda oborrit edhe hapat e patrullave fashiste që kalonin herë pas here në rrugicën tonë. Në çaste të tilla ajo përqendrohej e tëra dhe ishte në gjendje të kuptonte nga larg nëse patrulla ecte normalisht, apo nxitonte për ndjekje ose kontroll. Tamam në një rast të tillë, një mbrëmje vonë, vëzhguesja jonë vigjilente për pale desh na dha alarmin. Kishte ndier hapat e një patrulle që po ecte në rrugicë dhe thuajse pa marrë frymë ishte vënë në përgjim prapa portës. Papritur, m'u përpara portës së shtëpisë sonë, patrulla kishte ndaluar.

«Dëgjon? - i tha shokut njëri nga milicët, - ca zhurma të dyshimta...».

Vërtet dëgjoheshin përplasje të rënda këmbësh në tokë dhe turfullima! Këtë radhë ishte leali i një karrocieri, që banonte ngjitur në shtëpinë tonë, «elementi i rrezikshëm», që me turfullimat e tij u futi lepurin në bark fashistëve! Por njëri nga pjesëtarët e patrullës (mund të ishte ai që e kishte shtëpinë në krye të rrugicës), u kujtua dhe i lehtësuar i tha tjetrit:

- Ule pushkën, se s'osht gja. Osht kali i një karrocaxhiu që hedh vicka.

Si u sigurua se patrulla u largua, Sabrija hyri me vrap brenda dhe nisi të na tregonte, tashmë duke qeshur, frikën që u kishte futur kali i komshiut fashistëve, por dhe ankthin që i kishte futur patrulla rojës sonë vigjilente.

Si unë ashtu edhe Miladini e donim shumë Sabrijen e vogël. Ajo e kishte gjallëruar jetën në shtëpinë tonë, duke kryer tërë ato punë të rëndomta, por të domosdoshme. Kur nxitonte nëpër oborrin e ngushtë dhe të gjatë, gërshetat i kërcenin mbi shpinë. Nuk lodhej kurrë dhe nuk ankohej kurrë. Njëherë, kur po bëhesha gati të dilja për të takuar një shok për një mbledhje të rëndësishme, dogja një gazetë dhe me hirin e saj nxiva fytyrën për t'u maskuar.

- Ç'bëni kështu, shoku Taras, ju sapo u latë? më tha Sabrija, dulce u përpjekur t'i jepte zërit të saj rinor, një ton prej të rrituri dhe qortues.

E vështrova në sy dhe i thashë:

- Do të rrish urtë, apo të t'i lidh gërshetat pas trëndafililit?

Sabrija uli kokën.

- U mërzite? - e pyeta duke vazhduar maskimin.

- Jo, - tha Sabrija, - më falni shoku Taras.

- Nuk ka gjë, nuk ka gjë, - e qetësova dhe dola në rrugë.

Një ditë kur isha duke u çlodhur me gjelbërimin e manit të oborrit tonë, shikoj Sabrijen që po merrej me punët e kuzhinës. I thirra dhe ajo erdhi pranë meje.

- Nuk të kam pyetur Sabrije, a di shkrim e këndim?

- Jo, shoku Taras, - m'u përgjigj ajo.

- Si?! - u habita unë. - Kjo nuk i shkon një të reje komuniste si je ti!

- Në fshat nuk kisha ku të mësoja, kurse këtu në qytet, shtëpia ka tërë ato halle dhe punë.

Në këtë kohë u afrua edhe Miladini.

- A e di se ç'do të bëjmë? T'i them Ademit të na sjellë nesër një abetare dhe unë do të të mësoj të lexosh dhe të shkruash, kurse ti ato që do të mësosh do t'ia thuash edhe këtij shoku, që edhe ai të lexojë dhe të shkruajë shqip. Mirë Sabrije?

- Mirë, shoku Taras. Po si do t'i jap mësim këtij shoku, kur unë nuk di për vete?!

- Mos u mërzit për këtë. Do të shohësh se ky shoku do të të bindet, si nxënësi më i urtë.

Kur ia shpjegova Miladinit këtë, ai qeshi dhe i tha Sabrijes: «Unë gati jam».

Kështu pas tre vjet ndërprerjeje, fillova përsëri profesionin tim të dashur të mësuesit. Sabrija ishte vajzë me sedër dhe filloi të mësojë alfabetin dhe të shkruajë, në fillim me një dorë të pasigurt gjerat e para të gjuhës sonë. Sapo mësonte një mësim shkonte te Miladini dhe mendohej t'ia mësonte edhe atij. Dhe Miladini, si gjatë periudhës së shkurtër të qëndrimit tonë në këtë shtëpi, ashtu edhe më parë e më pas, sa herë i paraqitej rasti e mundësia, tregohej nxënës i zellshëm për të mësuar gjuhën shqipe. Ai nga shqipja diçka kuptonte që nga Kosova, por shkrim e lexim mësoi këtej, gjatë tre-katër vjetëve që luftoi e punoi si internacionalist pranë nesh. Por fjalën e kishim te Sabrija, e cila gjatë majit e qershorit 1942, veç të tjerash, u bë edhe një nxënëse e vërtetë.

Kur largohesha për ditë të tëra nga «shtëpia» jonë, sapo kthehesha e pyesja Sabrijen:

- I ke bërë tërë detyrat që të lashë?

- Po, shoku Taras.

Por, ashtu si në tërë ato baza, edhe në bazën tonë të re nuk mund të punonim dhe të banonim gjatë. Një ditë Sabrija erdhi dhe më tha e shqetësuar se dikush e kishte pyetur se me sa çelësa e kishim derën. Ne këtë njoftim e morëm si një paralajmërim se ndoshta baza jonë mund të kishte rënë në sy. Dhe nuk kaloi shumë kohë, Sabrija hyri me nxitim në dhomën ku po punoja.

- Shoku Taras, - më tha me zërin që ia mbyste shqetësimi, - kur isha duke hedhur plehrat buzë Lanës, pashë një milic me biçikletë. Ai pa me radhë portat e shtëpive, ndaloi para portës sonë dhe mori në shënim numrin e saj. Pastaj i hipi biçikletës dhe iku.

Ishte e qartë se duhej të largoheshim. U ndamë me shoqen tonë të re, e cila u nis për në fshatin e saj. Nuk u takova dot me Sabrijen gjatë luftës. Ajo doli partizane dhe së bashku me vëllanë e saj Ademin, e vazhduan me nder luftën e nisur në qytet, nëpër brigadat partizane.

TEFTA TASHKO

Tefta Tashkoja ishte një nga këngëtarët më të mira të asaj kohe të errët e prapanike, siç ishte regjimi i Zogut. Artistët nuk përfillëshin fare. Zyrtarët anadollakë jo vetëm i përbuznin artin dhe kulturën, por i denigronin, i diskreditonin dhe i luftonin me të gjitha mjetet ata të paktë artistë, të cilët, me përpjekjet e veta dhe të familjeve të tyre, arrinin të mbaronin jashtë ndonjë shkollë pikturë, skulpturë ose shkollë kantoje.

Tefta kishte një zë të bukur, melodioz, ishte një soprano e mrekullueshme, këngëtare me një zë të përpunuar me mjeshtëri. Ajo i interpretonte me një aftësi të rrallë operat dhe ariet më të famshme të kompozitorëve më të dëgjuar francezë, italianë dhe të vendeve të tjera. Ishte një këngëtare e pasionuar, e çmonte fort zanatin e saj dhe kishte jo vetëm kulturë muzikore, por edhe kulturë të përgjithshme. Ishte e ngritur politikisht dhe qe një patriote e flaktë. Ajo kishte një dashuri të madhe veçanërisht për këngët popullore, të cilat i interpretonte me ndjenjë të thellë.

Megjithëse e shkurtër nga trupi, kishte një pamje të hijshme, me fytyrë rrumbullake, sy të zinj, të ndritshëm dhe të qeshur. Ajo se si i krihte e i rregullonte flokët dhe krijonte me ta një si kurorë rreth kokës. Ishte shumë serioze dhe me moral të pastër.

Një ditë Tefta do të jepte koncert në një nga kinematë e pakta të qytetit. E takova në rrugë, i dhashë dorën dhe më tha:

- Enver, sonte do të jap koncert, do të gëzohem po të vish të më dëgjosh.

- Si të mos vij!? Me kënaqësi të madhe, - iu përgjigja.

- Atëherë, - më tha Tefta, - merru vesh me Lekon* *(Aleko Tashko, vëllai i Teftës.) per çdo gjë.

E shtrenjta Tefta Tashko, ajo e dinte gjendjen time të mjeruar financiare prandaj më tha: «Merru vesh me Lekon». Në fakt Lekoja më takoi dhe më dha biletën e hyrjes në koncert. Ishte koncert i mrekullueshëm. Tefta këndoi arie të njohura klasike, këndoi këngë popullore, ndërmjet të cilave këngën «Kroi i fshatit tonë». U duartrokoi shumë. Ajo ishte e kënaqur, por edhe miqtë e shokët e saj ndienin kënaqësi për shoqen e tyre të talentuar.

Pas disa ditësh vajta i bëra një vizitë në shtëpi, për ta uruar. Lekoja që martuar dhe Tefta rrinte me nënën. Shtëpia e saj ishte nga «Shallvaret». Tani janë bërë kaq ndërtime, sa e kam vështirë ta përcaktoj tamam ku ishte dhe nuk e di nëse është akoma. Ishte një shtëpi dykatëshe, mjaft e re, e mobiluar me shumë gusto dhe Tefta e mbante shumë pastër. Ajo kishte një porte të madhe, që nuk binte në «Shallvaret», por nga mbrapa, në qoftë se nuk gabohem, me drejtim nga baraka e Nushajve, diku andej. Përpara shtëpisë kishte një kopsht të vogël. Tefta, vëllezërit dhe miqtë e afërt të saj nuk hynin nga porta e madhe, por nga një porte e vogël. Pikërisht nga pas, derë më derë, kopshtije më kopshtije, pas nja 200-300 metrash, mund të dilje në «Shallvaret», krejt nga ana e kundërt e portës së madhe. Tefta më priti me bujari, e përgëzova nxehtësisht dhe me gjithë zemër, për koncertin e bukur.

- Më thuaj përshtypjet si shok, - më tha Tefta.

- Teftë, - i them, - une muzikën nuk e kuptoj si ju, mundësi s'kam pasur të vete në opera, por disqe të këngëtareve të shquara kam dëgjuar. Jo se je jona, dhe une nuk e kam zakon të bëj komplimente të kota, por ti këndon si Gali-Kurçi* *(Këngëtare, soprane e njohur italiane e paraluftës.), edhe më mire se ajo.

Tefta qeshi me gjithë shpirt dhe më tha:

- Ky është kompliment, Enver.

- Jo, - i them, - por kur e dredh atë zërin melodioz, mendoj se edhe bilbili nuk e ben dot ashtu. Ah, Teftë, kur të vijë dita që populli të marre fuqinë, kur të kemi teatrot dhe operat tona, atëherë do të tingëllojë si duhet zëri yt dhe do të çojë peshë sa e sa vajza të reja, që do të të ndjekin në rrugën tënde. Kur dëgjoj këngë popullore, që ti i këndon, Teftë, atdheu ynë, qielli, yjet, toka, fshati, bëhen një mijë herë më të dashur, më të bukur.

- Enver, - më thotë Tefta, - ti je dhe poet.

- Desha të jem, po s'jam, por në zemrën time kam zjarr për këtë tokë e për këtë popull.

Mbaj mend, në një takim tjetër, Tefta më thotë:

- Enver, do të të jap një lajm, që do të të gëzojë: u fejova dhe së shpejti do të martohem.

E përqafova i gëzuar, e urova dhe e pyeta me kë ishte fejuar.

- Me Kristaq Koçon, artist, këngëtar edhe ai si une, djalë shumë i mire.

- E kam pare me ty në bulevard dhe më është dukur me të vërtetë djalë i mire. Unë nga karakteri nuk e njoh, se s'kam pasur rastin, por ti nuk gabon, vetëm po të them atë që kam dëgjuar dhe që kam pare nga jashtë: është një artist, këngëtar me talent dhe me perspektivë, djalë i mire dhe i thjeshtë, siç më kanë thënë, shtatin të gjatë si selvi dhe nga leshrat biond. Çifti është i zgjedhur.

- Enver, - më thotë Tefta, - të ftoj që tash të më vish kur të martohem.

- Medoemos, - i them, - si të mos vij kur të martohet motra ime?

Dhe, kur u martua Tefta me Kristaqin, shkova në dasmën e tyre, e cila që shumë e thjeshtë e pa ceremoni të kota.

Kur vendi u pushtua nga italianët e filloi Lufta guerile dhe ajo Nacionalçlirimtare, une hyra në ilegalitet. Një dite në rrugë, i maskuar me mustaqe dhe me syze, takova Teftën. Iu afrova dhe i dhashë dorën. Ajo nuk më njohu menjëherë, por shpejt dhe me forcë ma shtrëngoi dorën dhe më tha:

- Enver, si je, më ka marrë malli. Pyes Koçon për ty, por edhe atë e shoh rrallë.

- Teftë, - i them, - lufta zien dhe ne do të fitojmë, ashtu siç kemi biseduar shpeshherë.

- Enver, - më thotë Tefta, - mos na kurseni, se edhe ne duam të luftojmë. Ti e di shtëpinë tonë, ajo është e . Partisë, kurdoherë që të duash, kurdoherë që të jesh në rrezik, hyr te ne. Kalo nga «Shallvaret» se gjitonët i kemi njerëz të mirë, të popullit. Ruhu, ne do të fitojmë.

- Do të fitojmë, - i them, - dhe u ndava me Teftën.

Kaluan ca kohë. Tirana ishte ndezur zjarr: goditëshim nëpër rrugë, terrori ishte i madh. Dhashë urdhër që një pjesë e shokëve të ekspozuar, të sëmurë e të plagosur të dilnin në Pezë. Vetë, me - gjithë terrorin e madh, qëndrova brenda, u largova nga bazat e qytetit dhe shkova në Tiranën e Re. Por atje, në atë kohë, nuk kishte ndërtime, ishte fushë, livadhe e tek-tuk kishte disa shtëpi.

Në fund të Tiranës së Re, rrëzë kodrës, ndodhej një shtëpi me dy kate, mjaft e madhe, e lyster me bojë bari. N'ë atë shtëpi banonte një shok komunist, berber, emrin e të cilit e kam harruar. Më duket se ishte nga Kosova. Atje shkuam dhe u strehuam bashkë me një shok që ndenji me mua. Vendi ishte i mirë, mund ta shikoje nga larg rrezikun dhe të merrje masa.. Por atje s'qëndruam shumë. Informacioni ynë na lajmëroi se duhej të largoheshim sa më parë, mbasi shtëpia kishte rënë në sy dhe mund të kontrollohej. Në mbrëmje, sa u err pak, dolëm që të dy me shokun. Po ku të futnim kokën? Baza afër nuk kishim. Ç'të bënim! Ishim në rrezik, shtrëngonim nagantet dhe bombat në xhepat e palltos. Menjëherë më vjen ndër mend shtëpia e Tefta Tashkos.

- Hajde, - i them shokut, - se tash e gjeta vendin ku do të futim kokën.

Dhe me të shpejtë, drejt e nga porta e madhe, u futëm në oborr dhe trokitëm te dera e brendshme e shtëpisë së Teftës. E shtymë, por nuk hapej. Dëgjuam ca të ecura të shpejta, pastaj heshtja ra përsëri. I ramë prapë dhe më në fund u dëgjua zëri i ëmbël dhe aspak i emocionuar i Teftës:

- Kush është?

- Hape meftë, - i them, - jemi miq.

Der a u llap.

- Mirë se erdhët Enver, - tha ajo, - më gëzove.

E prezantova me shokun dhe na çoi sipër në sallon. Dritaret ishin errësuar me perde.

- Keni ngrënë? - na pyeti Tefta.

- Kemi ngrënë, - i thashë, por ajo nuk u gënjye dhe shkoi në kuzhinë.

U hap një derë tjetër dhe na hyri Koço Tashkoja, me fytyrë të vrenjtur e të verdhë. As na përshëndeti, por na tha

- Edhe këtu erdhët, ta komprometoni dhe Teftën? Do të bëni që edhe këtë ta arrestojnë!

Me këtë frikaman isha zënë keq dhe e kisha sikterisur pikërisht si frikaman. Koço Tashkoja qe struktur në shtëpinë e së motrës dhe s'lëvizte andej, kur të tjerët luftonin e binin nëpër rrugë për atdheun. Nuk e kisha menduar se do ta gjenim këtu Koço Tashkon.

Me inat, por me zë të ulët, që të , mos na dëgjonte Tef ta, i thashë

- Koço Tashko, s'kam ardhur tek ti, por te patriotja Tefta Koço. Ajo më ka thënë vetë të vij kur ta shoh pisk e unë erdha tok me shokun dhe Tefta na priti si trimëshë. Ne nuk do ta komprometojmë atë, ti qan hallin tënd e jo të asaj.

Hyri Tefta dhe e lamë këtë muhabet. Ajo shtroi tryezën. Si zakonisht thjesht: çaj, pak djathë, pak reçel, pak gjalpë dhe bukë.

- Me këto më gjetët, por zemra dhe shtëpia është juaja, - na tha.

E falënderuam e i kërkuam ndjesë. Na erdhi shumë mii ë që një shoqe jokomuniste i jepte një mësim të mirë një pseudokomunisti si Koço Tashkoja.

Biseduam shtruar, folëm gjatë për luftën e madhe që bëhej kudo kundër nazifashistëve, për luftën e popullit tonë, për të ardhmen e vendit tonë. Teftës i ndritnin sytë, ajo mori pjesë gjallërisht në bisedë dhe kërkoi me insistim që ta aktivizonim sa më shumë se «Edhe ajo donte të jepte gjithçka për atdheun e popullin». Unë i thashë se ajo, me këngët e saj, me zërin e saj, ndizte më tepër flakën e patriotizmit në zemrat e popullit dhe kjo ishte pjesëmarrje në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.

- Secili, - i thashë, - lufton me armët e veta; dikush me pushkë, dikush me bomba, të tjerë me penë e fjalë të zjarrta, ti me këngë e me zërin tënd të bukur. Pastaj, - i thashë, - ja, ç'po bën ti sonte? Po të na gjejnë ne këtu, me revole e bomba, jo vetëm që këto do të pëlcasin dhe s'dihet se si mbarojmë të gjithë, por të paktën ti do të mbarosh në burg.

- Lëri këto, Enver, - tha Tefta me të qeshur, - nuk trembem unë, por a nuk hapim pak radion se unë nuk rroj dot pa muzikë.

- Edhe ajo na duhet, - tha frikamani, - që të mos dëgjojmë gjë, në qoftë se na gjen ndonjë rrezik nga jashtë.

Ndenjëm vonë dhe Tefta na e hoqi mërzinë e brendshme.

- Do të vete t'ju shtroj. Ku do të flini? - tha Tefta. - Më mirë poshtë, Enver.

- Të ramë në qafë, - i thamë, - por u ndodhëm ngushtë.

- Uh, ç'është ajo që thua, - tha Tefta, - po më ofendon, ju mund të rrini këtu sa të doni. Nga mesi i natës shkuam e ramë të flinim në jatakët e shtruar përdhe e me çarçafë të bardhë. Në mëngjes herët u ngritëm. U çua edhe Tef ta dhe na bëri kafe, pastaj na shtroi mëngjesin me çaj e ca feta buke. Shoku hapi radion që të dëgjonte lajmet e mëngjesit dhe mbajti shënime. Në atë kohë hyri Tefta dhe kur na gjeti në këmbë, që ishim bërë gati të largoheshim, na tha

- Keni vend ku të veni? Në mos, rrini këtu.

- Kemi, - i thashë. - Shumë, shumë të falënderojmë, nuk do të ta harrojmë kurrë këtë dashuri që tregoni për ne, për Partinë e luftën e popullit, - dhe f dhamë dorën e dolëm.

NËNË ZYHRAJA

Fshati i parë që u bë streha jonë pas dështimit t'ë përpjekjeve për të kapërcyer Shkumbinin, në fillim të Operacionit armik të Dimrit, ishte Orenja, me njerëzit e saj trima e patriotë, midis të cilëve e paharruar do të mbetet figura e nënës trimëreshë, Zyhra Koçit.

Në shtëpinë e nënë Zyhrasë arritëm përmes llohës e acarit, ndaj të erruri. Ishim gjithsej 10 veta. Nëna na priti me atë që iu ndodh dhe dihet se ç'u ndodhej fshatarëve të varfër të Çermenikës në ato mote. Ajo na puthi të gjithë me radhë si të na njihte prej kohësh, si të ishim fëmijët e saj. Kasollja e saj ishte e vogël, gjysmën e kasolles e zinte dhia e vetme, gjysmën njerëzit. Dhinë nga njerëzit i ndante një gardh i thurur me purteka. Djemtë e nënës ishin partizanë dhe njëri ndër ta, Beqir Koçi, p ali më pas ra dëshmor. Megjithëse për këtë nënë kam folur, përsëri nuk mund të rri pa shkruar dhe pa kujtuar edhe një herë atë natë të ftohtë janari, kur ne u ngrohëm nga zjarri i dashurisë së saj për bijtë partizanë. Isha gati gjysmë për gjumë kur pashë nënë Zyhranë që nxori jashtë kasolles dhinë, atë dhi që i jepte një komb qumësht, për nipërit dhe mbesat e saj. Pas pak dëgjova blegërimën e dhisë dhe e mora me mend, nëna e kishte therur për ne. Ishte me të vërtetë një skenë prekëse, një skenë që nuk kam për ta harruar kurrë. Për Partinë, për luftën, nëna u hiqte nga goja nipërve e mbesave ushqimin e vetëm të tyre, qumështin; për Partinë, për luftën nëna ishte gati të sakrifikonte gjërat e saj më të shenjta, jetën e të gjithë pjesëtarëve të familjes. Dhe këtë sakrificë që bënte nënë Zyhraja mund ta bëjë vetëm një nënë e dashur, e dhimbshme, një nënë e madhe. Nënë Zyhra, me sa mall që të kujtoj!

Në mëngjes ti na the se brenda në fshat (shtëpia e nënë Zyhrasë ishte e veçuar nga fshati), kishte ballistë dhe tërë ditën bëre rojë, së bashku me nipin tënd të vogël, që ngrinte nga të ftohtët. Po ti i përballoje të gjitha dhe sa herë na lajmëroje për diçka, gjithmonë vije buzën në gaz. Ne të thoshim të vije të ngrohesh, por jo. Ti sa ngrohje pak duart dilje përsëri jashtë, për të na mbrojtur ne, Sijtë e tu. Në mbrëmje ty të qeshnin sytë. Ishe e lumtur që djemtë e tu nuk i gjeti gjë. Por si mund t'i gjente gjë djemtë, kur ata i mbronin dashuria e nënave, sakrifica e tyre e thjeshtë, e natyrshme! Të rrethuar nga kjo dashuri ne nuk do të pësonim gjë, ne do ta çanim rrethimin dhe do ta shpartallonim armikun. Ne të thamë se tani do të shkonim e ta kalonim natën në pyllin pranë. Ti u mërzite. Ne të thamë se do të piqemi përsëri. Na puthe me dashuri dhe na përcolle nga kasollja jote e vjetër, që ç'binte jashtë hynte brenda dhe na thé se do të na prisje. Derën do ta gjeni gjithmonë hapur, na the. E dimë o nënë, se kështu do të ndodhte, pse ti, para se të na hapje derën e kasolles, kishe hapur zemrën për Partinë, për bijtë e saj.

Ne u kthyem përsëri tek ti. mbas një dite dhe ti përsëri na prite. Në mëngjes, pa zbardhur mirë dita, u larguam për në pyll, duke të treguar vendin ku do të qëndronim.

Aty nga ora dy apo tre e mbasdites roja vjen dhe më lajmëron se drejt nesh po ngjitej një grua. Kush të jetë. thashë dhe dota ta shoh. Ishte nusja e nënë Zyhrasë, e cita po na silite bukë dhe pak gjizë. Kishte udhëtuar dhe ishte lodhur shumë.

- Të na falni, - tha Mahija. - që nuk ua solla më parë bukën.

- Ç'kemi ndonjë të re, nga fshati? - e pyetëm.

përve e mbesave ushqimin e vetëm të tyre, qumështin; për Partinë, për luftën nëna ishte gati të sakrifikoje gjërat e saj më të shenjta, jetën e të gjithë pjesëtarëve të familjes. Dhe këtë sakrificë që bënte nënë Zyhra mund ta bëjë vetëm një nënë e dashur, e dhimbshme, një nënë e madhe. Nënë Zyhra, me sa mall që të kujtoj!

Në mëngjes ti na the se brenda në fshat (shtëpia e nënë Zyhrasë ishte e veçuar nga fshati), kishte ballistë dhe tërë ditën bëre rojë, së bashku me nipin tënd të vogël, që ngrinte nga të ftohtit. Po ti i përballoje të gjitha dhe sa herë na lajmëroje për diçka, gjithmonë vije buzën në gaz. Ne të thoshim të vije të ngrohesh, por jo. Ti sa ngrohje pak duart dilje përsëri jashtë, për të na mbrojtur ne, Sijtë e tu. Në mbrëmje ty të qeshnin sytë. Ishe e lumtur që djemtë e tu nuk i gjeti gjë. Por si mund t'i gjente gjë djemtë, kur ata i mbronin dashuria e nënave, sakrifica e tyre e thjeshtë, e natyrshme! Të rrethuar nga kjo dashuri ne nuk do të pësonim gjë, ne do ta çanim rrethimin dhe do ta shpartallonim armikun. Ne të thamë se tani do të shkonim e ta kalonim natën në pyllin pranë. Ti u merrzite. Ne të thamë se do të piqemi përsëri. Na puthe me dashuri dhe na përcolle nga kasollja jote e vjetër, që ç'binte jashtë hynte brenda dhe na thé se do të na prisje. Derën do ta gjeni gjithmonë hapur, na the. E dimë o nënë, se kështu do të ndodhte, pse ti, para se të na hapje derën e kasolles, kishe hapur zemrën për Partinë, për bijtë e saj.

Ne u kthyem përsëri tek ti. mbas një dite dhe ti përsëri na prite. Në mëngjes, pa zbardhur mirë dita, u larguam për në pyll, duke të treguar vendin ku do të qëndronim.

Aty nga ora dy apo tre e mbasdites roja vjen dhe më lajmëron se drejt nesh po ngjitej një grua. Kush të jetë. thashë dhe dota ta shoh. Ishte nusja e nënë Zyhrasë, e cita po na silite bukë dhe pak gjizë. Kishte udhëtuar dhe ishte lodhur shumë.

- Të na falni, - tha Mahija. - që nuk ua solla më parë bukën.

- Ç'kemi ndonjë të re, nga fshati? - e pyetëm.

sytë armëve tona. E kuptuam ku e kishin hallin, i morëm me vete, dolëm matanë fshatit, në një vend të shkretë dhe i vumë të qëllonin me pushkë. U bënë miqtë tanë të vegjël dhe tërë ato ditë që ndejtëm atje, pritnin afër shtëpisë ku strehoheshim gjersa ne të dilnim për pak ajër. Kur kishim kohë, s'ua prishnim qejfin: shkonim matanë fshatit dhe kërciste pushka. Përgatiteshin luftëtarët e së ardhmes. Tani ata janë bërë baballarë, ndonjë ndoshta edhe gjysh, por unë ruaj në album fotografinë që kam bërë me ta kur ishin të vegjël e mësonin të merrnin nishan. E shoh shpesh atë fotografi dhe më vjen e gjallë ajo kohë heroike, më dalin parasysh Orenja e Gurakuqi, kasollet e varfra të atëhershme që u bënë streha jonë e Sigurt.

DERA E ALI DISHËS U ÇEL PËR PARTINË

Pasi lamë Orenjën e Gurakuqin ne u hodhëm në zonën e Shmilit, në shtëpinë e fshatarit të varfër, Ali Disha, që ishte bazë e sigurt e Partisë. Shtëpia ishte ngritur mbi një bokërimë që zotëronte tërë pamjen dhe sipër saj ngrihej një mal i zhveshur, mbi të cilin era hidhte vazhdimisht borën e madhe të janarit. Nga dritaret që shikonin nga veriu, dukej Orenja, si dhe një pjesë e zallit të Or enjës që bënte natën një zhurmë të madhe, duke zbritur nga Gurakuqi. Ali Disha «nuk kishte ç'humbiste veç zinxhirët». Kjo frazë e madhe e Marksit, e thënë për proletarët, i përshtatej plotësisht edhe fshatarit tonë të këputur. Dera e Ali Dishës u gel për Partinë, dhe ai mbeti besnik i saj derisa vdiq. Kur hymë, na priti plaka e shtëpisë, Rahimeja.

- Mirë se erdhët, - na tha ajo, - për ju flaka le t'i dalë shtëpisë.

Nuk ishte gjë e lehtë për Aliun dhe për familjen e tij, në qoftë se ne diktoheshim nga armiku: shtëpisë do t'i dilte zjarri në çati po e po, por i madh e i vogël që do të kapej brenda, do të pushkatohej në faqen e murit. Ali Disha ishte i ndërgjegjshëm për këtë, por ai nuk iu tremb vdekjes. Vdekja as që i shkoi ndër mend, fytyra e tij nuk shprehte as shenjën më të vogël të shqetësimit. I dashur Ali Disha, me sa respekt po të kujtoj !

Aliu ishte mesatar nga shtati. Sa vjeç ishte? Zor ta përcaktoje moshën e tij. Mund të ishte 45 vjeç, por dukej si 55. E kishte lodhur puna e rëndë në tokën «e egër» të Shmilit, në atë tokë të paktë në bokërimë, të hapur me thonj e me bel dhe duke tërhequr parmendën vetë, pse edhe kur e njoha, ai s'kishte as qe, as gomar, as dele, veç katër kokë dhi për të ushqyer pesë veta të familjes. Fytyrën Aliut ia kishin vrarë, nxirë, pjekur dhe rrudhosur shiu, dielli, bora, uria, mjerimet, por në këtë fytyrë të thatë e të skalitur ai kishte dy sy të qëndisur bojëkafe me pika, dy sy kurdoherë të qeshur, me një qeshje të ëmbël e të çiltër. Të dukej sikur nëpërmjet tyre e shihje qartë zemrën e tij të bardhë dhe trime. Ai kishte një fytyrë të rrumbullakët, me ballë të hapët e plot rrudha. Rruhej rrallë, kishte mustaqe bojë hiri, në krye mbante kurdoherë qeleshen dhe rrinte i veshur me xhamadan elbasançe, mbi të cilin kishte një xhaketë të zezë që shiu dhe dielli ia kishin nxjerrë bojën. Aliu mbante shallvare të leshta, në dimër çorape po të leshta dhe dimër e verë opinga llastiku të qepura me tel. Kështu më është ngulitur në kujtesë portreti i patriotit të zjarrtë Ali Disha, besnik i Partisë dhe i Luftës Nacionalçlirimtare, që e ktheu shtëpinë e tij në një bazë të sigurt tonën në fshatin Lugaxhi të Shmilit.

Aliu rronte me nipin e tij, Zenel Dishën, burrë ndonja 30-35 vjeç, i martuar me një fshatare të varfër, Kadifen, me të cilën kishte një djalë, Abazin e vogël, që ne e gjetëm gati tre vjeç. Zeneli kishte dhe nënën e tij, Rahimenë, plakën e shtëpisë. Të gjithë rronin në harmoni.

Lidhjet me shokët i mbanim nëpërmjet Aliut, që ishte korrier ideal, ishte si dhi e egër nga këmbët, ikte si era, ishte i thellë si pusi. Priste letrat që shkruaia, të cilat i vinte herë nën qeleshe, herë në xhepin e shallvareve.

- Po të të presin rrugën, Ali, ç'do të bësh? - e pyesja.

- S'bie kollaj në pus! Ali Disha, jam si derri i egër, e ndiej erën e armikut që larg, më kanë stërvitur hallet, por ti, o shoku Enver, mos u mërzit, bëj punën tënde, se unë e di ta bëj punën time.

Ai ishte analfabet dhe tok me Abazin e vogël rrinin e shikonin penën time që nxinte letrën e bardhë. Ajo ishte diçka «magjike» për Aliun, diçka për të cilën duhej të bëhej kujdes kur t'i çohet Sami Bahollit. Kurse Abazi donte të luante, ai donte ta zinte me dorë penën.

- Mos Abaaaz! - i thoshte Aliu, me atë zë të zgjatur, plot përkëdheli, por edhe me qortim, pse nuk donte që i vogli të më pengonte.

- Lëre çunin të luajë Ali, - i thosha, - se vetëm atëherë letra do të bëhet ashtu si dua unë.

Dhe kur mbaroja punën, e merrja Abazin në prehër, i fërkoja kokën e vogël dhe i jepja nja dy copa sheqer kokërr, që i r'uaja si sytë e ballit në çantën ushtarake, për t'ia dhënë herë pas bere Abazit.

Një mbrëmje, afër vatrës ku ndiznim zjarrin, Abazin e zuri gjumi me kokën të mbështetur mbi gjurin tim. Flaka ia ndriste fytyrën çunit si në përrallat dhe ai s'kishte si ta kuptonte se ne, rreth vatrës së varfër të Ali Dishës, bisedonim për luftën e madhe të Partisë e të popullit që do t'ia ndërronte faqen Shqipërisë dhe do të sillte për çunin e vogël të Zenel Dishës ditët e bukura e të lumtura të një shoqërie të re, të shoqërisë socialiste.

Herë pas bere Aliu thoshte

- Moj nuse, eja merre Abazin, se ia mpiu gjurin shokut Enver.

Nusja vinte, po unë i thosha:

- Si mund të më mpihet gjuri mua nga koka e vogël e Abazit, kurse ju keni një barrë kaq të rëndë duke na mbajtur ne?!

Një natë plaka e Zenel Dishës s'kishte ç'të më jepte, prandaj nxori nga një sepet i vjetër një dardhë dimërore dhe ma dha në vend të bukës. E mora, e vura në xhep të xhamadanit dhe u shtriva pranë Abazit të vogël që po flinte. Në mëngjes kur ai u çua filloi të më përgëzonte nagantin. Kur e pashë kështu, i thashë:

- Lëré koburen, gëzo «bombën»!

Dhe i dhashë dardhën, të cilën e mori menjëherë dhe mundi urinë, aq sa mund të mundet ajo me një dardhë.

Me marifete të ndryshme, bile duhej të bënim «akrobacira» me anën e Sami Bahollit për të ndihmuar familjen e Aliut me ca miell misri të bluar, me ca djathë, ca konserva, herë pas here me disa kile mish, për të mos

e fyer, sepse ne vërtet hanim pak dhe pa pretendime, se kohë luft'e ishte, por sidoqoftë duhej të ushqeheshim, prandaj familja e Aliut duhej ndihmuar.

Aliu thoshte:

- Shoku Enver, do të rrojmë me këtë që kemi.

- Ke të drejtë Ali, - i përgjigjesha, - gjella më e mirë për ne është kulaçi i ngrohtë dhe i kundërmuar i plakës që na pjek në saç, djathi dhe qepa. Por ç't'i bëjmë

këtij Sami Bahollit që na dërgon ngandonjëherë edhe mish, edhe konserva. Pastaj, Ali, ti e di se bejlerët e këtyre anëve i kanë shumë borxhe popullit, prandaj pasuritë tash Samiu ua ka «konfiskuar» dhe i ka vënë në shërbim të luftës! Prandaj, në qoftë se hamë nga një copë bukë më shumë, hamë nga buka që popullit ia kishin rrëmbyer të pasurit.

Aliu kënaqej, qeshte me gjithë zemër dhe më thoshte:

- Hajde Parti e të varfërve, hajde! Mos vdeksh kurrë, se ti do të na nxjerrësh në dritë. Po ja, dëgjo, shoku Enver, - shtonte ai pastaj, - Samiu ka qenë dhe është shumë i mirë; atë ne e duam dhe ai na do.

E mësuam Aliun dhe njerëzit e tjerë të shtëpisë që, duke jetuar në mënyrë legale, të vepronin si ilegalë.

Ata asgjë nuk duhej të ndryshonin nga jeta e zakonshme e tyre, bile deri te mbartja e ujit me bucelë në krahë nga nusja e Zenelit, që duhej të bëhej në kohën e zakonshme dhe në sasinë e zakonshme. Çdo gjë e tepërt apo e jashtëzakonshme do të bëhej ose do të sillej natën nga Zeneli, ose nga vetë Aliu, kështu që të mos binte asgjë në sy, pavarësisht se shtëpia e Aliut ishte e izoluar. Natën, me radhë bënim rojë dhe përgjonim Aliu, Zeneli, ne. Edhe ditën ata b'e'nin rojë dhe, vetëm kur ne i kishim ngarkuar me punë të tiera dhe nuk ndodheshin në shtëpi, dilte Kadifeja në shkallë me Abazin pranë dhe bënte çorape ose qepte ndonjë leckë, kurse plaka na përgatiste dr ekën. Ne shkruanim e lexonim.

Nuk do të rrinim shumë kohë tek Ali Disha, çështja ishte sa të vendosnim lidhjet e shkëputura nga reaksioni i egër me organizatat e terrenit, me Tiranën, për të marrë lajmet që këtej dhe për të dhënë drejtimet e reja në situatat e reja, për të vendosur lidhje me çetat dhe me batalionet e Elbasanit dhe për të çarë rrugën për në Jug. Sidoqoftë, po punonim me vështirësi, por me këmbëngulje. Kishim menduar po ashtu edhe për raste emergjence, për raste rreziku. Jo vetëm kishim organizuar mbrojtjen afër shtëpisë së Aliut, por, në rast se ndodhte gjë dhe i shpëtonim rrethimit, kishim drejtimin e bazave të tjera të sigurta që na pritnin në çdo kohë, por aë ne i ekonomizonim dhe i ruanim si i varfri kaun.

Një ditë, në mëngjes, na u dha alarmi. Forca të pushtuesit, të shoqëruara nga çeta të Ballit po hynin edhe në fshatin Lugaxhi. Ky është një fshat shumë i hapur, shtëpia e Aliut është e mënjanuar dhe e veçuar nga fshati dhe duhet të nisesh apostafat për të vajtur deri atje. Ndoshta armiku nuk ishte nisur për te ne. Po ku dihet? Ai mund të ketë dyshime ose informata të veçanta, ose ndoshta vjen se e di që Shmili, në përgjithësi, është bazë partizane. Ne duhej të shkonim në pozicionet e luftës që ishin lart, te shpella, mbi shtëpinë e Aliut. Morëm armët, municionet, Aliun dhe Abazin e vogël dhe u ngjitëm malit ku zumë pritrat. Zenelin e çuam në fshat, sikur s'dinte gjë, nusja shkoi për dushk dhe plaka, pasi spastroi dhomën se mos kishte mbetur ndonjë gjurmë nga ne, doli në shkallë dhe përgjonte. Lart në mal pritëm derisa kaloi dreka dhe erdhi Zeneli, i cili na tha se forcat armike kishin kaluar nga Shmili në drejtim të Orenjës.

Sidoqoftë matura e luftës ilegale na mësonte se duhej të ndërronim bazën, duhej të ndaheshim me mikun tonë të shtrenjtë e besnik, Ali Dishën dhe me familjen e tij aq bujare. Ndarja jonë me Aliun, me plakën, me Zenelin dhe me nusen e tij u bë afër mesit të natës. Të gjithëve sikur na kishte vënë dikush diçka të rëndë mbi kraharor dhe na pengonte të merrnim frymë. Ndarja me shokë, me miq, me të afërt është kurdoherë e hidhur, sidomos në kohët e vështira të luftës, kur as nuk dihet nëse mund të shihesh përsëri se lufta është e pamëshirshme.

Përpiqesha të mos e jepja veten e ta bëja ndarjen të gëzuar, të natyrshme, të domosdoshme, të pranueshme nga rretianat. U shpjegoja Aliut dhe familjes së tij forcën e madhe të Partisë sonë që mbështetej te populli fukara dhe trim, i hapja me fjalë të kuptueshme perspektivën e sigurt të fitores

mbi armikun pushtues, të jashtëm e të brendshëm dhe të ndërtimit të një Shqipërie krejt të re, të bukur, të lumtur, të popullit, vetëm të popullit të varfër e punëtor. Ata dëgjonin me besim të patundur. Aliu me një dorë thithte cigaren e dredhur me duhan të thërrmuar afër të nxehtit të vatrës dhe me dorën tjetër fërkonte ballin e tij të rrudhur, të cilin herë e mbulonte, herë e zbulonte nga qeleshja. Me zërin e tij të trashë si të ngjirur dhe me hundë ai thoshte:

- Patjetër ashtu do të bëhet. Në qoftë se ne nuk do të dalim gjallë nga lufta, Shqipërinë do ta gëzojnë Abazi dhe shokët e tij.

Ndërsa ne flitnim, Abazi i vogël flinte i qetë e pa cledere në prehrin e gjyshes.

- Or Enver, ti s'je martu, - më tha Aliu, - po tash asht luftë e s'asht koha, por kur të mbarojë ajo duhet të martohesh e të bash fëmijë, s'ka gëzim më të madh se fëmija. Ja, unë u plaka pa u martu, por, po dola gjallë nga kjo luftë, ja ku po ta them se do të martohem, do të bëj dhe fëmijë, se atëherë do ta ndiej veten më të ri.

U përqaftua fort me Ali Dishën e përlotur dhe me familjen e tij dhe në terrin e natës, me hapa të lehtë partizanësh, u futëm në dushqet e Shmilit, drejt bazës së re, kasolles së vetmuar në mes të pyllit, të një fshatari tjetër të varfër, po me atë emër, Ali, të Ali Gjurës. Krugës na ndiqte hap pas hapi zemra e bardhë dhe e pastër e Ali Dishës dhe unë, dulce ecur, mendoja për të që tanfi me sfiguri ishte ulur në shkallët e gurta të konakut të tij dhe shikonte thellë në terrin e natës, duke thithur cigaren.

Vitet kaluan, Lufta Nacionalçlirimtare triumfoi, pushtuesit i thyem në beteja të ashpra dhe i shporrëm nga atdheu ynë. Partia dhe populli morën në dorë pushtetin. Bejlerët, agallarët, kuislingët, të gjithë armiqtë e popullit morën dënimin e merituar dhe pësuan disfatën e plotë. Filloi me një hov revolucionar të paparë kurrë, mbi këtë tokë të shumëvuajtur, rindërtimi i Shqipërisë së shkatërruar nga lufta.

Një ditë, pas Çlirimit, tek po punoja në shtëpi, vjen oficeri i rojës dhe në lajmëron:

- Katër fshatarë nga Shmili duan të piqen e të bisedojnë, pse i ka marrë malli për ju.

- Futi menjëherë brenda, - i thashë, se e mora me mend kush ishin këta katër fshatarë nga Shmili që i kishte marrë malli për mua. Për këta fshatarë edhe mua më kishte marrë malli. Ishin Ali Disha, Ali Gjura, Ramë Karagjozi dhe Sherif Ceka.

U puthëm e u përqaftua me mallëngjim, u puthëm e u përqaftua përsëri, para se të uleshim dhe të fillonim bisedën e lënë përgjysmë në Shmil, në pikun e luftës. Ali Disha, si më plaku, ecte përpara. Më ra në sy se ai i kishte nxjerrë këpucët dhe i kishte lënë jashtë, sipas zakonisht të vjetër të fshatarëve tanë.

- Ali, ku i ke opingat, apo t'i mori gjermani? i thashë.

Me të qeshur ai më tha

- Ooo Enver, s'kam më opinga, por kam këpucë dhe i kam lënë jashtë, se nuk dua që të ngjishet me baltë dhoma.

- Balta e atdheut është e shenjtë, o Ali Disha, - i them, - për këtë tokë populli derdhi gjak, - dhe, dulce i lënë miqtë në këmbë në mes të dhomës, dola jashtë dhe mora këpucët e Aliut, i solla brenda dhe i them:

- Mbathi, Ali Disha, dhe shkel fort si burrë që je mbi këtë qilim që ti ke frikë se ndotet, shkel mbi të se ky qilim është i Shefqet Vërlacit, të cilit ia rrëmbyen me luftë partizanët!

Aliu veshi këpucët, nguli fort këmbët në tokë dhe ai e të gjithë ne bërtitëm:

- Vdekje bejlerëve!

Filluam muhabetin e përmallshëm, uno pyesja e ata përgjigjeshin. Pyesja për njerëzit e shtëpisë, për shëndetin e tyre, për njerëzit e shumtë të fshatit që i njihja personalisht, për plakun e Bozhiqit e djemtë e tij, për shkollën e fshatit që e dogjën pushtuesit dhe që e rindërtuam dhe e hapëm në kohën e luftës, pyesja për kasollen e fshehtë të Shmilit ku bënim mbledhje dhe kishim shtypin ilegal e që ata as që e dinin një gjë të tillë deri në këtë takim, kur ua thashë unë. E për çfarë nuk i pyeta? Për arat me grurë të Shmilit, për kasollet, për gërxhet e shpellat, për dushkun, për dy pulat e Ali Gjurës, për qenin e Ramë Karagjozit e për shumë gjëra të tjera. I pyesja me mallëngjim, mbasi më dukej sikur po jetoja edhe njëherë ato momente sa të vështira, aq të dashura të kohës së luftës.

Pastaj u fola, shokëve të mi fshatarë, për të ardhmen e vendit, për bujqësinë, për fshatrat e djegura që do t'i ndërtonim, për qytetet që do t'i bënim shumë më të bukura, për shkollat që do të hapnim kudo, për fabrikat që do të ndërtonim, për jetën e popullit që do ta bënim më të mirë, më të gëzuar, me punë, me djersë.

Nuk na bënte zemra të ndaheshim, hëngrëm bukë tok, me atë që na u ndodh. Erdhi Nexhmija nga puna, u puth e u përqaftua me ta.

- E njihni? - u thashë. - Është Nexhmija, gruaja ime, shoqja ime e vjetër partizane, po aq e vjetër në Parti dhe në luftë sa edhe unë.

- E njohim, - tha Ali Disha, - e kemi parë në Shmil e në Labinot me pushkë në dorë, por e njihnim me emrin Delegate dhe jo si gruan tënde.

- Të kërkojmë falje, Ali, - i thashë, - që ta kemi mbajtur të fshehtë një gjë të tillë, por kjo në atë kohë ishte një çështje vetëm personale.

- E fortë është kjo Partia jonë! - thirri në .sofër Ramë Karagjozi. - Dëgjo, or shoku Enver, atë natë në dushk, kur më bisedoje për luftën, për Partinë e komunistëve dhe kur shikoja tej larg, nga Librazhdi, dritat e kolonave të automobilave gjermanë që vinin për Tirano, thosha me vete: Jarabi, si do bëhet kjo çudi, që ne të varfrit të mundim këta kralë të mëdhenj. Por ja, i mundëm, Partia jonë dhe populli ynë ishin të fortë shumë.

Me urimet më të mira për Partinë u larguan këta fshatarë të dashur.

GJËMON BABJA

Ramë Karagjozi nuk kishte njeri në kasollen e tij dhe jetonte vetëm. Kishte një vëlla më të vogël, por as nuk e kisha pyetur ndonjëherë ku punonte. Ai kishte nja dhjetë kokë dele e dhi, që në dimër i ushqente me dushk e me bar të thatë që korrte vetë andej-këtej. Dushkun po ashtu e përgatiste vetë zahire për dimër dhe ndërtonte dy-tre mullarë rreth e rrotull, afër kasolles, duke përdorur për strumbullar ndonjë lis të thatë, që e zhvishte nga degët. Kasollja e Ramës nuk ishte shumë e madhe, kishte një dritare të vogël me taraba, nga lindja, në krye kishte një vatër zjarri, ku Rama piqte vetë kulaçin ose ngrohte ujë e ku ndonjëherë në hënë, siç i thonë një fjale, ziente ndonjë çikë mish. Dyshemeja ishte prej balte, në gjysmën e trullit rrinin bagëtitë, kurse gjysma tjetër ishte mbretëri e Ramës e u bë edhe... imja për netët dhe ditët që qëndrova aty. Me bagëtinë na ndante një mur hunjsh të ngulur rreth e rrotull, si vathë brenda «vathës» kasolle. Çdo mëngjes Rama, pasi u merrte atë pak qumësht që i jepnin, me ngrohte një ose dy gota që e bëja përsesh me bukë misri e me ca kripë që e lezetonte dhe e haja me qejf. Kurse nga të ftohtit natën nuk vuanim, sepse avulli i ngrohtë që lëshonte trupi i bagëtive na ngrohte dhe kështu shpëtonim edhe nga tymi që na nxirrte sytë.

Ramë Karagjozi ishte një fshatar i fortë nga trupi.

Ishte analfabet dhe njihnte vetëm qendrën e Elbasanit dhe Librazhdin (ku shkonte blinte misrin për të ngrënë, e kripën), si dhe dy-tri fshatra rreth e rrotull. Ndonjëherë dilte tek Ura e Haxhi Beqarit dhe aty, një ushtari italian i kishte blerë një pelerinë, të cilën e hidhte në krahë kur dilte ruante dhinë, e mbante në krahë kur mbështetej te muri i vatrës dhe i shërbente si jorgan kur shtrihej e flinte mbi rrogos. Kështu, kur binim e flinim, unë mbulohesha me një velenxë, Rama mbulohej me të famshmen pelerinë të imperos, që e kishte humbur krejt bojën.

Ditën, me shpatullat të mbështetura në murin e kasolles, unë shkruajta trakte që duhej t'i dërgoja në Tiranë dhe ur dhra veprimesh drejtuar batalioneve të Elbasanit dhe të Korçës, kurse Rama merrej me bagëtinë ose shkonte në Elbasan me porosi dhe kthehej në mbrëmje me letra e me gazeta. Ushqimet ishin të thata dhe kryesori që djathi që unë e doja dhe e dua vazhdimisht para çdo gjëje tjetër.

Rama nuk më shqetësonte kurrë kur më shihte që shkruaja, por në mbrëmje kur mblidheshim në kasolle me dhentë dhe me qenin e tij flokëkuq, ai më bënte ndonjë pyetje dhe unë i jepja shpjegime.

Kur ndodhesha pikërisht në kasollen e Ramës, më erdhën lajmet nga Elbasani se Batalioni partizan i Bërzeshtës i komanduar nga Luto Leka, Cen Blloshmi, Hoxhë Çota, do të sulmonte disa garnizone dhe depo municioni të pushtuesit, matanë Librazhdit, në orën 9^{oo} të natës. Ky aksion do të shoqërohej për diversion edhe me një goditje nga Batalioni i Dumresë, i komanduar nga Petrit Hakani, në rajonin afër Belshit.

Isha i gëzuar atë mbrëmje kur hapa letrat e qarkorit të Elbasanit. Partizanëve që ishin me mua u thashë të futeshin për të vëzhguar në dushk dhe të mos lëviznin. Rama futi bagëtinë, hëngri bukë shpejt e shpejt dhe doli nga kasollja.

- Ramë, - i thashë, - merr pushkën dhe qenin se do të ecim, do të dalim lart në kodër të shohim kolonat e automobilave që vijnë nga Librazhdi për në Elbasan.

Arritëm lart, në majën që dominonte rrugën automobilistike Korçë-Elbasan. Qetësia mbretëronte, unë shikoja herë pas here orën e dorës me fosfor dhe fërkoja kokën e qenit të Ramës me të cilin ishim bërë miq dhe më ulej gjithmonë te këmbët. Kishim kohë akoma dhe ndezëm me kujdes nga një cigare duke e mbajtur anën e ndezur

brenda në grusht, megjithëse nuk kishte asnjë rrezik. Akrepat e orës shënonin 9^{oo}, mua më rrihte zemra nga padurimi.

- Dëgjon gjë? - e pyes Ramën.

- Asgjë, - thotë Rama, duke nderur veshët. Ai s'e dinte ç'do të ngjiste. Kaloi 915 dhe më në fund në orën 930 plasi mitralozi larg, pas tij krisën pushkët dhe bombat. Unë u qetësova dhe ndera këmbët i kënaqur e i gëzuar. Qeni i shqetësuar filloi të lehte. Rama hovi në këmbë dhe i bërtiti qenit të pushonte.

- Lëre qenin të lehtë, Ramë, se diçka po dëgjon, i thashë. - Po ti dëgjon gjë?

- Ç'po pyet shoku Komisar, - më tha Rama, - po gjëmon Babja, po gjëmon Babja!

Gryka e Librazhdit po gjëmonte dhe sillte deri te ne zhurmën e përpjekjes së armatosur.

- Gjëmon fort Babja, shoku Komisar, s'ka dyshim, po bëhet luftë!

- Po, Ramë, luftojnë partizanët e krahinës suaj me

pushtuesit, po i grijnë. Armiku hëpërhë ka veç rrugët dhe qytetet, por malet, fshatrat dhe populli është me ne, po i grijmë!

- Jarabi, jarabi ç'na shohin sytë, - thoshte me zë të ulët Ramë Karagjozi.

Pushka vazhdoi ndonja 3 orë, pastaj filloi të pushojë

dhe të dëgjohej herë pas here nga një breshëri mitralozi e rëndë. Kjo ishte breshëria e frikës së armikut.

- Çohemi të flemë të qetë, - i them Ramës, - se partizanët tanë do t'i kenë dhënë një grusht të rëndë armikut. Këtë do ta marrim vesh më vonë.

Atë natë unë fjeta i qetë, ndërsa Rama si duket jo, pse në mëngjes, pasi nxori dhitë, filloi të më pyesë:

- E dije, shoku Komisar, ç'do ngjiste mbrëmë?

- E dija.

- Ti e kishe urdhnu?

- Jo, Partia.

- Po ku është Partia?

- Kudo, në fshat, në qytet, në çetë, në batalion, në brigadë, kudo ku luftohet.

- Jarabi, jarabi ç'forcë e madhe, - thoshte me zë të ulët Ramë Karagjozi.

Kur erdhi nata ishte Rama ai që më kërkoi të dilnim përsëri në majë të kodrës ku ishim mbrëmë. Ai tash donte luftë.

- A do të ketë goditje sonte shoku Komisar? - më pyeste duke ecur në errësirën e natës.

- Jo, Ramë, asnjëherë ne nuk godasim çdo natë dhe në një vend, por zgjedhim vendet dhe kohën ku dhe kur nuk e pret armiku. Kjo është mënyra jonë e luftës partizane. Kjo na bën më të fortë dhe e shqetëson tmerrësisht armikun. Ne kemi zgjedhur atë mënyrë luftimi që armiku të jetë ditë e natë në

ethe, kudo ku është të mos jetë i sigurt, ta godasim në befasi, t'i shkaktojmë shumë humbje në njerëz dhe në material, kurse ne të kemi sa më pak humbje.

U ulëm në majë të kodrës, përballë maleve të Polisit, Babjes, Librazhdit dhe unë vazhdova:

- Armiqtë thonë se neve këtë luftë na e kanë mësuar Lenini dhe bolshevikët. Po, Lenini dhe bolshevikët kanë bërë edhe luftën e partizanëve dhe kemi mësuar e mësojmë nga ata, por ne kemi edhe traditën tonë shumë të pasur. Populli ynë me shekuj ka zhvilluar një luftë të tillë të ashpër e të përgjakshme kundër pushtuesve osmanë, grekë, serbë, italianë. Çetat tona partizane kanë mësuar dhe e kanë në gjak mënyrën e luftës së baballarëve, gjyshërve dhe stërgjyshërve tanë. Shqiptari, i cili vazhdimisht ka qenë në shënjestër të armiqtve, nuk kishte si të jetonte pa pushkë dhe këto male ishin kalatë e popullit, aty të gjithë armiqtë që futeshin gjenin vdekjen. Kështu populli shqiptar nuk u zhduk nga faqja e dheut, siç janë zhdukur popuj të tjerë, por rrojti dhe tanfi do të rrojë i lirë, se luftoi dhe lufton me vetëmohim.

- Tërrrrr - tërrrrr - tërrrrr, - u dëgjua së largu mitralozi i rëndë.

- Filloi, - tha Rama, - po gjëmon përsëri Babja!

- Jo, Ramë, janë gjermanët që shtien kot, se kanë frikë nga partizanët dhe nga nata. Ata janë né ethe dhe ne atë duam. Armiku tash është né përgatitje, ai është strukur për t'u hedhur si i tërbuar né goditje, për të bërë arrestime né qytet, né rrugë e né ndonjë fshat. Por Partia i ka marrë masat. Ajo ka lajmëruar kudo që askush të mos rrijë i shkujdesur; partizanët janë tërhequr larg rrugëve, kanë zënë pozicionet né gryka dhe presin që po të hyjnë ushtarë armiq, t'i godasin né pusi. Njerëzit tanë né qytet janë të shumtë, ata edhe punojnë, edhe përgjojnë lëvizjet e përgatitjet që bën armiku për të zbuluar qëllimet dhe masat që ai merr. Ata pa humbur kohë lajmërojnë shokët e Partisë, të cilët vënë né veprim njerëzit tanë, atentatorët trima që natën né qytete vrasin oficerë armiq, spiunë, hedhin bomba, djegin depo. Të gjitha këto Partia i bën që Via prishë planet armikut, t'i prishë nervat, të mos e lërë të qetë, që të mos mund të dërgojë forca kundër fshatrave. Kështu e lidh Partia luftën e brigadave dhe të batalioneve partizane né male me luftën e njësiteve guerile të qytetit.

Këtë Parti kaq të madhe dhe të fortë nuk e kishin baballarët dhe gjyshërit e stërgjyshërit tanë, kurse sot populli ynë e nxori nga gjiri i tij, prandaj ai do ta fitojë këtë herë plotësisht luftën mbi armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm.

Kështu, atë natë né majë të kodrës përpiqesha Via shpjegoja thjesht, qartë, fshatarit të varfër të Shmilit, mekanizmin e luftës sonë, që ai të mund ta kuptonte.

KASOLLJA E GALIGATIT

Kaloja për herë të parë nëpër Shpat. Çdo shtëpi e kasolle fshatari të priste me krahë hapur, me dashuri dhe me besim të madh për të ardhmen. Edhe pse atdheu vuante nën zgjedhën e pushtuesit, edhe pse vrasjet e torturat që bënte ai ishin të tmerrshme, Lufta Nacionalçlirimtare, populli me bijtë e tij në krye, nuk epeshin, krismat e armëve të partizanëve dhe të bombave krijonin në masat e popullit ndjenjën e lartë të trimërisë e të heroizmit, ndjenjën e hakmarrjes kundër shkelësve të vendit tonë. Këtë gjë unë e shikoja kudo ku kaloja, por tash e shihja veçanërisht në Shpat. Duhet të them se kalimi nëpër këtë krahinë më ngjallte emocione të fuqishme edhe për diçka tjetër: Prej kohësh emrin Shpati e kisha adoptuar dhe e kisha përdorur si një ndër pseudonimet e mia të kohës së luftës. Me këtë emër kam firmosur qarkore të rëndësishme që u drejtoja komiteteve qarkore dhe organeve të tjera të Partisë dhe të ushtrisë, qarkore ku jepeshin udhëzime për veprime luftarake, për organizim partie e më në fund për organizimin e sulmit të përgjithshëm për çlirimin e plotë të Shqipërisë.

Dhe ja, në kulmin e dimrit të vitit 1944 isha në zemër të kësaj krahine patriotike. Tani udhëtonim më shumë natën se ditën, për shkak të disa çetave balliste që endeshin nga Shënepremtja dhe që, po të na diktonin, mund të lajmëronin forcat e armikut që po na kërkonin dhe kështu do të goditeshim prej tyre.

Të udhëhequr nga Dokë Tollumi prej Trepsenishti ecnim në drejtim të Galigatit. Rruga kalonte nëpër pyje me pisha, ahe e bredha. Xha Doka i dinte shtigjet e monopatet, pylli zbardhonte nga bora, zbardhonin pishat, çdo gjë ishte mbuluar me çarçafin e bardhë të saj. Kjo pamje më kujtonte vjershat e Viktor Hygoit, kur ai flet për Napoleonin që kthehet nga Rusia duke thënë: il neigeait, il neigeait*. *(Binte borë, binte borë.)

Gjatë rrugës për në Galigat binte borë pa pushim. Flokët e saj na njomnin fytyrën e na zbardhonin rrobat. Ruanim fishekët dhe tytën e pushkës, të cilën e kishim kthyer me grykë poshtë dhe vazhdonim të ecnim. Herë-herë uleshim në borë e çlodheshim duke pirë nga një cigare.

- Vend i shkretë, - tha Doka.

- S'është i shkretë xha Dokë, - i them, - mos e shiko tash në borë, por shihe kur vjen behari, kur vjen pranvera, lulëzon gjethi e këndojnë bilbili e mëllenja në këto pyje. Atëherë ti je më i gëzuar, apo jo?

- Ashtu është, shoku Komisar, - u përgjigj xha Doka, - por ja që hasmi dhe ky dimri i zi na bëjnë të mjeruar.

- Ashtu është, edhe zahire kemi pak xha Dokë, por do të kemi më shumë kur atdheun ta kemi të lirë, - i thashë.

Dokë Tollumi ishte një burrë trim dhe i zgjuar, i cili e njihte me pëllëmbë tërë krahinën e Shpatit, sepse e kishte shkelur kur kishte qenë kaçak. Tani, duke na udhëhequr drejt Galigatit, i ishte ndezur përsëri gjaku i kaçakut dhe na fuste rëndë shtigje të tilla që vetëm ai mund t'i dinte. Vërtet që nuk hasëm në forcat gjermano-balliste dhe ishim të sigurt se nuk do të hasnim, por dua të theksoj këtu se udhëtimi nga Trepsenishti në Galigat ishte më i lodhshmi dhe më i vështiri. Doka kishte një avantazh, nuk ishte i armatosur si ne, prandaj ai i gjendej gjithmonë në krah Spiro Moisiut, si më i moshuar që ishte, për ta ndihmuar.

Duke çarë borën e dendur arritëm te pylli, afër fshatit Galigat.

- Ju do të qëndroni këtu sa të shkoj të shoh si qëndron puna atje ku do t'ju çoj, - na tha Doka dhe u largua.

Po binte mbrëmja dhe të ftohtit po shtrëngonte shumë. Ne ishim të dërsirë nga rruga, por nuk mund të ndiznim zjarr sepse mund të diktoheshim nga forcat gjermano-balliste, që duhej të lëviznin atyre anëve. Më në fund Doka erdhi dhe ne u ngritëm përsëri dhe vazhduam rrugën. Kur ja, mes erës dhe tufanit të madh dalluam një kasolle, një kasolle në mes pemësh, mbuluar me kashtë, Na u duk diçka e mahnitshme, madhështore. Te dera e kasolles rrinte një fshatar, mesoburrë, i hollë, ca i verdhë nga fytyra e pa flokë. Ai ishte Ymer Cohë.

- Mirë se erdhët o burra, - na u drejtua xha Ymeri, - a ieni, si jeni?

Na përqafoi dhe e përqafoam, pastaj pyeti kush ishte Komisari, se i kishte vajtur lajmi.

- Ja, unë jam Komisari, - i them.

- Të paça me shëndet, - më tha xha Ymer Cohë, - kasollja është juaja. Po major Spiro Moisiu kush është? - pyeti.

la paraqita major Spiro Moisiun.

- E major Spiro, - i tha, - ty të njoh, se kur isba ushtar, ti ishe kapiten dhe komandoje batalionin tim, por tash të veshur si partizan nuk para të shqova dot.

U futëm në kasollen e Ymer Cohës, një kasolle e mjeruar, me një vatër në krye rreth së cilës ishin shtruar ca rrogoza. E shoqja e Ymer Cohës, Hurmaja, na priti me dashuri. E shtrënguam në gji plakën e Ymerit.

- Zini qoshet, - tha Ymeri. Pastaj na pyeti: - A u lodhët burra?

- Jo, - i thamë, - nuk u lodhëm. Xha Doka diti të na sillte, ngá monopatet e shtigjet më të lehta për të kaluar. Vërtet binte borë e frynte murlan, por ne nuk kemi frikë as nga bora, as nga murlani, as nga plumbi e as nga murtaja e armikut.

- Ah më ju lumtë! - tha Ymer Cohë. - Kur ju dëgjoj që flitni kështu, më lëvrin edhe mua gjaku në deje! Unë i dua partizanët, se ata janë trima. Më kanë thënë. vazhdoi Ymeri, - se është formuar një Parti e madhe, që i ka dalë hak kësaj pune. Unë nuk e di ç'është kjo Parti, por di vetëm që është Parti e fukarenjve, pra, Partia jonë,

dhe ju jeni ushtarët e saj. Shoku Komisar, - m'u drejtua mua Ymeri, - më fol pak si do të vejë ky halli ynë.

- Edhe ne për këtë punë kemi dalë në mal, - i thashë dhe fillova t'i shpjegoja qëllimet e luftës sonë, qëllimet e Partisë sonë Komuniste, i shpjegoja ç'do të thoshte fjala komunist, ç'ishim ne komunistët, ç'duam ne, përse dhe si luftojmë, i shpjegoja çfarë shpifin armiqtë për ne.

- Dhe ne komunistët ja ku jemi, ja si jemi, ne kudo populli na pret me krahë hapur, ashtu si ju sonte në këtë natë dimri, mes borës e murlanit, pa pasur frikë se nesër mund të vijmë milicë e ballistë t'jua djegin këtë kasolle. Kjo është forca jonë, - vazhdova t'i flisja, - forca e P'artisë dhe e popullit për çështjen e të cilit ajo po lufton dhe këtë luftë e bën tok me ju, prandaj ne jemi të fortë.

Ymer Coha më shikonte me sy të ndritur e iu drejtua së shoqes:

- Grua, dëgjo edhe ti, e dëgjon ç'thotë Komisari? S'do të ketë më shtypje as për ne e as për ty.

E shoqja e Ymerit uli kokën, vuri dorën në zemër dhe tha:

- Jetën e kam shkuar me ty, o Ymer Coha, në fukarallëk kemi shkuar, por bashkë kemi qenë, pra, së bashku do të jemi edhe më tej, mirë thotë Komisari edhe për ne do të ketë liri. Dhe tani me këto që na gjetët do të hamë sonte, - na tha ajo.

- Bashkojmë ushqimet tuaja me tonat, - i thamë.

- Jo, - tha Ymer Coha, - do të hamë më parë tonat, pastaj tuajat.

- Or bujar, or burrë shqiptar! - i them. - Sikur djali yt të të sjellë një çyrek bukë e gjysmë kile tërvok, a do ta hash së toku? Do ta hash. Pra, ne jemi bij të këtij populli të varfër, kemi dalë në male dhe kemi ditë që po bredhim për të shkuar në Korçë, pra, kemi mbetur dhe ne ditë pa ngrënë, jemi ushqyer nëpër shtëpitë e fshatarëve që na kanë pritur krahëhapur, kështu si na pritët edhe ju. Nga ato që na kanë dhënë me vete na ka tepruar diçka, ti na hape zemrën, ti na hape shtëpinë, prandaj sikur t'i bashkojmë këto që kemi edhe ti edhe ne?

- Jo, tha Ymeri, - s'e pranoj. - Grua, - iu drejtua së shoqes, - qit kulaçin, tërvokun edhe atë pak pekmez që kemi!

U shtrua sofa, u ça kulaçi i fortë si guri, por i ëmbël si sheqeri, ndonëse në të s'kishte asnjë grimë sheqeri, por ishte i ëmbël se qe gatuar me ndjenjën e dashurisë së pastër e të singertë të zemrave bujare të këtyre njerëzve të varfër të popullit. Në dritën e kandilit, afër zjarrit, hanim kulaçin prej misri që e prodhonte toka e varfër e Galigatit, kulaçin e mbujtur nga dora e një gruaje shqiptare, që e kishte pjekur saçi i saj prej teneqeje. Neve na dukej sikur ishim në një banket të madh. Ajo na vuri përpara nga një kokërr qepë.

- Hajeni kulaçin me gjizë, biro, se gjiza-është e kripur, - tha Hurmaja.

- Ma ke gjetur zemrën me këtë gjizë të kripur, - i them, - se unë jam gjirokastrit dhe plaka ime djathit i hidhte shumë kripë, pikërisht që të mos hanim shumë. Na jepte nga një copë të vogël, me një çikë kulaç dhe e hanim, ose e lëpinim, si me thënë, djathin, dhe e ngjyenim kulaçin shumë herë në shëllirën e tij të kripur. Po pse rri në këmbë, - i them Hurmasë, - hajde këtu afër meje.

- Jo, - tha ajo, - gratë rrinë në këmbë.

- Hajde këtu, - i fola, - çfarë biseduam deri tash me Ymer Cohën, që edhe gratë do të çlirohen.

Ajo u ul afër meje, më vuri një dorë në sup e tjetrën në gjunjë e më pyeti:

- O bir a ke nanë e babë?

- Kam edhe nënë, edhe babë, - iu përgjigja.

- Ku i ke? - më pyeti.

- Në Tiranë gjenden, por luftë është, u bënë kaq kohë që s'i kam parë, dhe nuk e di nëse rrojnë apo jo.

- Ç'është ajo fjalë! - u hodh menjëherë Hurmaja. - Shëndoshë t'i kesh gjithmonë, që edhe ata të gëzojnë ditët e mira.

- Të faleminderit, - i thashë dhe i përkëdhela dorën e saj të rreshkur nga punët, që kishte mbështetur në gjurin tim.

Kështu e kaluam atë natë, në muhabet me njerëzit e thjeshtë e të vuajtur të popullit, me Ymer Cohën e me gruan e tij të dashur e të dhimbsur, Hurmanë, ndanë vatrës ku digjeshin kucuret e pyllit që na

ndritnin fytyrën e na ngrohnin, por më tepër na ngrohte ngrohtësia e fjalëve të Ymerit, zemra e bardhë e të zotëve të kasolles, e cila na dukej si pallat. Ramë vonë për të fjetur, por gjumi s'na zinte, ëndërronim për të ardhmen.

Ymer Coha qe shtrirë pranë meje dhe herë pas here më pyeste:

- Po fle shoku Komisar?

- Jo Ymer, - i përgjigjesha.

- Po ç'bën kështu, - më thoshte, - fli se nesër je për udhë, por meqë je zgjuar do të të pyes për një gjë: tokën a do të na e japë neve qeveria jonë kur të fitojmë?

- Toka do të jetë juaja Ymer Coha, pyjet do të jenë tuajat, bagëtia do të jetë juaja, çdo gjë do të jetë juaja! Fëmijët tuaj do të mësojnë, do të jenë ata që do të drejtojnë vendin, që do të qeverisin, - i thosha.

- E qartë si drita e diellit, - fliste i lehtësuar Ymer Coha.

Dhe qetësia binte përsëri në terrin e kasolles. Pas pak përsëri, dulce më fërkuar krahët, me zë të ulët më pyeste:

- Shoku Komisar të zuri gjumi?

- Ja, po më zë Ymer, - i thosha.

- Po sa pa fjetur, a mund të më thuash edhe një gjë?

- Fol Ymer.

- A do të ketë para kur të qeverisim ne?

- Do të ketë Ymer, por do të jetë paraja jonë, paraja e popullit, këtë para që kemi sot do ta çjerrim e do të shtypim të reja që do të kenë vlerë të madhe dhe do ta mbushim tregun tonë me mallra e me prodhime që do t'i bëjmë vetë, këtu në vend.

Dhe Ymer Coha vazhdonte të më pyeste

- Po kripë do të kemi shoku Komisar?

- Patjetër do të kemi, - i përgjigjesha. - i tërë deti do të jetë yni. Gjermanët dhe tradhtarët do t'i flakirn tej. E ke parë detin?

- E kam parë, - thoshte Ymer Coha. - kur kam qenë ushtar né Durrës. Pra, i gjithë bregu i detit do të jetë yni dhe kripa del nga deti, kështu që do të kemi plot.

- Del edhe nga toka Ymer. Ne do të nxjerrim krupë edhe nga deti, edhe nga toka dhe atë do ta shesim fare lirë.

- O sa i mirë është ky komunizmi! - thoshte Ymer Coha. - Dhe tani fli, shoku Komisar, fli se të lashë pa gjumë.

- Jo Ymer, unë do të bisedoj me ty derisa të gdhihet, derisa të dalë dielli dhe bora të shkëlqejë. Por dielli do të shkëlqejë tamam i fuqishëm kur ne të mundim armikun; atëherë ëné atdheun tonë do të ndritë dielli i lirisë.

- Pli djali im, - dëgjoja zërin e Ymer Cohës. Por mua nuk më mbylleshin sytë, se e dija që né zemrën, né mendjen dhe né shpirtin e këtij fshatari të varfër heroik të Galigatit përplaseshin një mijë e një mendime, një mijë e një dëshira e aspirata, për realizimin e të cilave ai gjithë jetën e tij kishte ëndërruar e qe robtuar e megjithatë tërë jetën mezi bënte bukë për dy muaj e rronte né mjerim. Gjithçka që ne i thoshim né emër të Partisë, atij i dukej si diçka e mahnitshme, prandaj si mund të kishte për mua gjumë kur kisha afër meje vëllanë tim, babanë tim, mikun tim, shokun tim që kërkonte nga unë të dinte, të mësonte, të shpresonte, të luftonte?!

Galigat, Galigat, s'do të ta harroj kurrë atë zemër të ngrohtë, atë zemër të zjarrtë!

NË KISHTË, TE PATRIOTI FILE MUSAI

Më në fund, mes erës që sillte rrotull borën, pamë disa dr ita të zbehta, të largëta. Kishim arritur në Kishtë.

Ne iu afruam shtëpisë së Files dhe Neziri na ndali te disa lisa pak lar g shtëpisë.

- Po shkoj njëherë vetë të shoh si është gjendja te Filja dhe, po është mirë, po vij t'ju marr, - na tha ai.

Në Kishtë, File Musai kishte influencë të madhe për ndershmërinë dhe besnikërinë e tij, ndaj Lëvizjes Nacionalçlirimtare, për ndjenjat e larta patriotike që i mbante gjithmonë të ndezura. Këto ndjenja sikur i kishin gdhendur edhe portretin e tij burrëror. Filja kishte një fytyrë të mprehtë, sy të zgjuar dhe të flaktë, fliste me urtësi dhe nuk i trembej asgjëje. Për vetitë e tij të mira ai respektohej nga të gjithë.

Pas pak erdhi Neziri dhe të prirë prej tij, shkuam te File Musai, i cili banonte në një shtëpi dykatëshe së bashku me vëllanë e tij, Lime Musanë. Në katin e parë mbanin bagëtitë, në katin e dytë kishin nga një kuzhinë dhe nga një dhomë.

Dhomat e Files me ato të vëllait ndaheshin nga një mur i hollë dërr asash.

Sapo hyra br enda i dhashë dorën Files dhe kur u afrova të takohesha me të tjerët, pashë Kadrinë, djalin e tij.

- Të njoh, - i thashë Kadri Musait.

- Edhe unë, - tha ai dulce vënë buzën në gaz.

- Jemi takuar në Labinot, - i thashë.

- Po, - m'u përgjigj Kadriu, - unë isha rojë kur bëhej Konferenca.

Njerëzit e shtëpisë na rrethuan menjëherë me një dashuri prekëse. Për ta, ne, shokët e Shtabit, ishim bijtë e tyre, ishim si djali i tyre, partizani Kadri Musai. Këtë ngrohtësi ne e kishim ndier kudo, por gjithmonë ajo na dukej si diçka e re, si diçka që nuk shterte kurrë, sepse vërtet njerëzit e thjeshtë të popullit i donin partizanët, por ishte me interes të shihje me vëmendje si shprehej e si të rrethonte kjo dashuri.

Si u ulëm dhe filluam bisedën, vija re se Filja nuk m'i ndante sytë e tij të mprehtë.

- Kushedi sa vështirë e keni pasur për të ardhur nga Shpati këtu, në Vërçë, në mes gjermanëve dhe ballistëve që janë tërbuar fare këto ditë! - tha ai.

Unë nuk iu përgjigja menjëherë. Vështrova Filen, vështrova dhe tërë njerëzit e tjerë që rrinin pranë meje dhe thashë:

- Që të them se nuk e kishim vështirë nuk e them dot, por ama, kudo jemi rrethuar nga dashuria dhe nga mikpritja e shpatarakëve trima dhe patriotë, kudo kemi ndier ngrohtësinë e vatrës bujare të Vërçës, kudo kemi parë se ju lini kokën për Partinë dhe luftën që po bën tërë populli ynë. Prandaj, xha File, vështirësitë nuk na kanë hyrë fare në sy. Asnjëherë, - vazhdova, - nuk e ka vështirë ai njeri që _lufton për popullin dhe është gati të japë jetën për popullin. Vështirë në këto male e kanë pasur pushtuesit dhe ata që u janë lëpirë atyre. A do të trokiste i huaji apo tradhtari, si trokitëm ne në shtëpinë tënde, patriote dhe të ndershme, o File Musai?

- Kurrë, - tha Filja. - Dera e shtëpisë sime ka qenë gjithmonë e mbyllur për ta.

- Jo vetëm ti, o File Musai, - i thashë, - por sot gjithë njerëzit e ndershëm të Gramshit dhe të tërë Shqipërisë ua kanë vënë sinorin tek thana të huajit dhe tradhtarit. Ata me luftë po i dërrmojnë dhe nuk është e largët dita kur do të çlirohemi, kur në këto anë do të nisë një jetë tjetër që do të ndryshojë nga jeta që ka bërë deri më sot katundari i ndershëm dhe patr iot. Për këtë jetë djali yt doli malit, për këtë jetë ti ua ke hapur derën e shtëpisë Partisë dhe luftës së popullit.

- Ashtu është, o Komisar, ashtu është, - pohonte Filja me urtësi. Po ju shtr ihuni e flini, se jeni lodhur. Qejfi ma ka të bisedojmë gjatë e gjerë, por do të kemi kohë edhe për këto, tani çlodhuni se keni bërë tërë atë udhë.

- Mikpritja jote na e hoqi lodhjen, - i thashë.

Të nesërmen në mëngjes u ndava nga Neziri dhe Qamili, duke i falënderuar për gjithçka kishin bërë.

- E çfarë bëmë, o Komisar, - më thanë, - atë që ka bërë e po bën çdo shqiptar i ndershëm në këto raste. Krahina jonë nuk është turpëruar ndonjëherë që të turpërohet tani, kur tërë njerëzit e nder shëm luftojnë për liri.

U përqafova fort me këta malësorë trima dhe të thjeshtë dhe i ndoqa me sy gjersa ata humbën në shtigjet që të çonin nëpër fshatrat e tyr e. Binte shi dhe borë përzier. U ktheva në shtëpi dhe si u mblodhëm të gjithë tok, i them File Musait:

- Të faleminderit për gjithçka, por kemi edhe një kërkesë, ne nuk mund të qëndrojmë më gjatë këtu. prandaj, të lutemi të gjesh mundësinë për të na hedhur në Tomorricë apo Skrapar.

- Punë që bëhet, - tha Filja, - po më parë dua ta shoh me sy ku do ta kapërceni vaun e Devollit. Kam një mikun tim në Bërsnik dhe me të do të përpiqemi të gjejmë v aun. Derisa të kthehem ju çlodhuni dhe pushoni.

Filja u kthye vonë.

- Devolli ka ardhur shumë, o Komisar, po mos u mërzitni se do ta gjejmë rrugën.

Në kohën kur ne po diskutonim për rrugëkalimet më të mundshme, në fshat ia behën ballistët. Mund të ishin rreth 200. Ballistët filluan të shpërndahen nëpër shtëpitë e lagjeve të Kishtës. Ata po vinin edhe në shtëpinë e Files. Ne liruam menjëherë dhomën ku kishim qëndruar deri atëherë dhe shkuam e u futëm në një dhomë më të vogël, të vëllait të Files. Siç thashë edhe më sipër, dhomat ishin në të njëjtën ndërtesë dhe ndaheshin nga njëra-tjetra me një ndarje të hollë dërrasash dhe nga një korridor i ngushtë. Sapo hymë në dhomë, të gjithë sa ishim brenda zumë pozicione luftimi. Më kujtohet se për vete zara vend te dritarja, Kadriu te dera nga ngjiteshin edhe shkallët (gratë i çuam në katin poshtë, në haur, që sido të vinte situata, ato të ndodheshin larg çdo rreziku), Spiro Moisiu dhe Spiro Koleka zunë dy dritaret e tjera. Kur i pashë tërë shokët në pozicione luftimi, u buzëqesha, që të mbanin gjakftohtësinë. Në sytë e të gjithëve shkëlqenin besimi dhe ajo gatishmëri e përhershme e njerëzve të idealit tonë, që nuk kishin munguar as në situatat më kritike. Të gjithë e kishim marrë parasysh të luftonim deri në fishekun e fundit. Megjithatë, në qoftë se do të fillonte përleshja me armë, në asnjë mënyrë nuk duhej t'u linim përshtynje ballistëve se ishim pak dhe vetëm në shtëpinë e File Musait. Duke përgjuar afrimin e ballistëve, shikoj Qaniun. vëllanë e Kadriut. Ia bëra me shenjë të vinte tek unë.

- Del dot nga shtëpia pa të diktuar ballistët? - i thashë.

- Dal, - u përgjigj menjëherë Qaniu.

- Mos u ngut, - i thashë, - puna është tepër delikate dhe duhet bërë kujdes i madh. Shiko ku e kam mendimin! -' vazhdova. - Ti duhet të zësh ndonjë vend. nga mund . é qëllosh mbi ballistët, në qoftë se dëgjon se këtu në shtëpi krisi pushka, që ata të mos mendojnë se jemi vetëm. Në asnjë mënyrë nuk duhet të qëllosh ti i pari.

- Mos ki merak, Komisar, - m'u përgjigj Qaniu dhe si e furnizuam mirë me fishekë, ai arriti të dalë nga shtëpia pa u diktuar nga ballistët dhe të zërë pozicion në një çukë nga dukej shtëpia e File Musait.

Ballistët erdhën dhe u shtruan në dhomën ngjitur me tonën. Ata nuk dyshonin aspak se në atë shtëpi ishin strehuar partizanë. E vetmja gjë që mund të na tradhtonte ishte ndonjë zhurmë e shkaktuar nga pakujdesia. prandaj bënim kujdes të ishim sa më të qetë. Më kujtohe± që ato ditë isha ftohur dhe kisha pak kollë. Për të mbytur zhurmën e saj ngjishja gojën pas mëngës së kapotës. Me anë të njerëzve të shtëpisë i porosita fëmijët që të luanin e të zhur monin dulce u endur né korridor. Gjithashtu, me anë të dy fshatarëve besnikë, u siguruam se do të na nioftonin për gjithçka do të dëgjonin.

'Né këtë kohë u informova se batalioni i komanduar nga trimi Riza Kodheli kishte dalë né Shënepremte. Nuk e mbaj mend se kush na e solli këtë lajm. Ñdoshta frika e ballistëve ishte e tillë që e ndienin nga larg (Shënepr emtja nga Kishta né atë dimër të egër mbante, né mos gabohem, më shumë se 10 orë), afrimin e partizanëve, aq më shumë t° batalionit të Riza Kodhelit, që njihej per guximin dhe trimërinë né ato anë. Me ane të Files i nisa né çast një letër Rizait, për të ardhur sa më parë né Kishte. Filja u nis por ishte vonë, batalioni qe lar ; uar persëri për né zonat e Korçës. Situata sa vinte dhe po vështirësohej. Ballistët kis•, in vene roja nëpër rrugët e fshatit, kështu që lëvizja

nëpër fshat për të ndërruar bazë ishte krejt e pamundur. Rrinim në gatishmëri të plotë. E vetmja rrugë ishte largimi i ballistëve nga Kishta. Shfaqja e batalionit të Riza Kodhelit e kishte bërë njëfarë efekti të ballistët, por duhej që ky efekt të bëhej edhe më i madh dhe plotësisht real.

Në dhomën tonë hynin nganjëherë edhe fëmijët. Ata ia ngulnin sytë armëve tona dhe afroreshin tërë druajtje dhe i përkëdhelnin lehtë me duart e tyre të nroma dhe të skuqura nga të ftohtit. Ata sillnin në dhomën tonë një botë krejt tjetër, një botë të pastër dhe në të gjithë kishim rrokur armët dhe ishim gati të jepnim edhe jetën, pikërisht për të ardhmen e këtyre fëmijëve, që ajo të ndryshonte krejtësisht nga jeta e prindërve të tyre, që kishin hequr nën regjimet antipopullore. Sytë e fëmijëve ndritnin nga zgjuarsia dhe nga dëshira për të bërë diçka për ne. Duke njohur mirë psikologjinë e ballistëve dhe shkathtësinë e fëmijëve, i porosita që të përhapnin fjalë nëpër ballistë sikur nga çasti në çast mund të vinte në fshat Riza Kodheli dhe Brigada I. Pionierët e kryen më së miri këtë porosi dhe ballistët të tmerruar ua mbathën drejt Elbasanit. Tani rruga jonë drejt Korçes ishte e hapur. U përqaftuam me njerëzit e shtëpisë dhe, të udhëhequr nga File Musai e Kadri Musai, u nisëm drejt qafës së Shënepremtes.

MËSUESI PATRIOT «XHAFË REBELI»

Po rrija duke pirë kafe, me një kolegun tim, edhe ai mësues në gjimnaz, në një kafene të vogël afër Pazarit të Vjetër, kur na kalon pranë një burrë disi i kaluar nga moshja, i paktë nga trupi, me një kostum blu të vjetruar dhe me një borsalinë, së cilës i kishte dalë fare boia. Ai e përshëndeti kolegun tim, i cili u ngrit nga karrigia dhe ia ktheu përshëndetjen me shumë respekt; instinktivisht u ngrita dhe unë. Kur burri u largua, e pyeta kolegun:

- Kush ishte ai që përshëndete?

- Nuk e njeh? - më tha kolegu. - Është Xhafë Zelka, mësues patriot i shkollës shqipe këtu në Tiranë. Atë e kanë cilësuar «Xhafë Rebeli», sepse ka qenë «qatip» dhe luftëtar me Haxhi Qamilin*. *(Udhëheqës i Kryengritjes Fshatare të Shqipërisë së Mesme 1914-1915.)

M'u ngjall menjëherë kureshtja për Xhafë Zelkën apo «Xhafë Rebelin», sic e kishin cilësuar dhe i thashë kolegut:

- Qenka interesant, më fol c'di për të dhe po munde dua të më njohësh ndonjë ditë.

Kolegu dinte diçka mbi jetën e thjeshtë, luftarake dhe plot përpjekje të Xhafës. Më tregoi se që antifeudal, kishte luftuar kundër Toptanasve e kundër Vërlacit* *(Familje të mëdha feudale në Tiranë e Elbasan.) dhe, më vonë, si demokrat që ishte, mbështeti qeverinë e Nolit. Kur erdhi Zogu, Xhafës i nxorën një mijë belara, e pushonin nga puna, e emëronin, e pushonin prapë derisa e qitën në lirim.

- Duhet ta dëgjosh vetë kur tregon hiqajetet e babë Qamilit, - më tha shoku, - por njëherë po ta tregoj unë ashtu sic ma ka thënë Xhafa:

Babë Qamili dhe ushtarët e tij kishin dalë në breg të Shëngjinit. Aty ai ngriti dylbinë e gjatë që mbante me vete dhe filloi të shohë detin. Në horizont u duk një anije mjaft e madhe, që po afrohej. Ishte një nga ato anijet e mëdha tregtare që vozitnin në portet e Adriatikut.

- Xhafë, - i bërtiti babë Qamili Xhafë Zelkës, Ja i çik këtu, Xhafë, nxirr letrën dhe mereqepin e i shkruaj atij bir kurve që drejton anijen, të mos afrohet në brigjet e Shqipërisë, se, po u afrua, i rashë me top dhe do ta bëj përshesh që as peshqit të mos kenë c'të hanë.

Xhafa e kishte parë në sy babë Qamilin, por ai me një shikim të rreptë e kishte bërë të ulte kokën dhe të shkruante ato që dëgjoji. Babë Qamili pastaj u dha urdhër tre luftëtarëve të merrnin një varkë të vogël me rrema, që ndodhej atje, dhe të venin t'ia dorëzonin letrën në dorë kapëdanit. «Po ju mbajtën rob, - u tha babë Qamili, - përpiquni të vritni nja dy dhe bini në «shehadet», pse do t'ju grijë gjylja e babës, armiqitë dhe ju, shokë të mi. S'kam ç'baj, duhet mbrojtur ky millet, ju në xhenet do të shkoni». Por ata nuk shkuan në xhenet, se mbërritën përsëri shëndoshë e mirë në breg, kurse mauna një t'u kthyer e shkoi prapa diellit.

Ja këtë më ka treguar Xhafa, por ai duhet të dijë shumë nga këto histori, - e përfundoi «hiqajenë» kolegu im.

- Di ndonjë tjetër, - i thashë kolegut, kur ai heshti, - se më intereson shumë çështja e rebelizmit, sidomos Kryengritja e Fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme.

- Më gjatë, - tha ai, - pyete vetë Xhafën. Do të të njoh ndonjë ditë me të, por mos mendo se sa ta pjekësh ai do të fillojë dhe të të rrëfejë, duhet t'ia fitosh besimin pa të të flasë për këto gjëra, ndryshe ai hesht.

Kaluan kohë, Xhafë Zelkën kolegu nuk mundi të ma prezantonte, por unë, kur e shihja ndonjëherë në Rrugën e Dibrës, për t'i tërhequr vëmendjen i flisja me zë të lartë duke e përshëndetur me respekt.

Ai më shikonte me habi. pastaj më përshëndeste dhe vazhdonte rrugën. Me gjithë dëshirën e madhe për t'u njohur nga afër me Xhafën, nuk munda dot, sepse u transferova në Norçë. Vetëm pas pushtimit. kur fillova punën në dyqanin «Flora» arrita të njihem dhe të bisedoj me të. Gjatë kësaj kohe vazhdimisht rrëmoja për të mësuar sa më shumë rreth Kryengritjes Fshatare të Shqipërisë së Mesme, të udhëhequr nga Haxhi Qamili. Shoku ynë erudit, Selim Shpuza, m'i tregonte me hollësi fazat e asaj epoke që bejlerët, feudalët dhe borgjezia që po lindte e quanin «epoka e rebelëve».

Një ditë nga vitrina e dyqanit «Flora» shoh Xhafën që po vinte në dyqan. Ngrihem në këmbë dhe i them:

- Ç'urdhëroni, zoti Xhafë?

- Ku ma di emrin tim, mor djalë? - më thotë ai.

- Mësuesit ua dinë emrin dhe kanë respekt për mësuesit e vjetër e patriotë si ju.

- Pse, mësues je ti apo duhanshitës? - më tha Xhafa, i cili nuk e fshehu dot kënaqësinë që ndjeu kur dëgjoi se respektohej dhe cilësohej si mësues patriot.

- Mësues kam qenë, por pushtuesit më pushuan nga puna dhe tash shes cigare, - iu përgjigja.

Më pa në sy dhe tha:

- Mund të më japësh një paleo cigare?

- Dy, po të duash, - i them.

- Slam pare për dy, por për një.

- Të më falësh, zoti Xhafë, - i them, - por miqve u japim edhe me kredi. Kur t'i kesh, m'i sill paratë. Ke dyqan zotrote? - e pyeta.

- Jo, mor bir, por i shes në këmbë, si- dua të rr is fëmijët.

I vura përpara tri paleo cigare dhe i thashë t'i mente e paret t'i sillte mbasi të shiste cigaret.

Më shikoi përsëri në sy dhe më tha:

- A duhet ta pranoj këtë mirësi që më bën?

- Kur ia bën nxënësi mësuesit, kjo duket një gjë aq e vogël sa nuk pranoj të më falënderosh.

Xhafë Zelka vuri dorën në kapele, mori pakot, më tha «Mirupafshim, djalë» dhe doli.

Tani nuk kisha vetëm interes të mësoja nga Xhafë Zelka mbi kryengritjen fshatare të udhëhequr nga Haxhi Qamili, por edhe ta lidhja atë me luftën që kishim nisur. Një mësues e patriot i nderuar si Xhafa, do të bënte shumë punë në rrethet që njihje. Fjala e tij, e frymëzuar nga lufta jonë, do të bënte efektin e saj sidomos tek të rinjtë, kur këta të shihnin se edhe të moshuarve kjo luftë u kishte ripërtërirë energjitë. Fjala dhe shembulli i njerëzve të tillë si Xhafë Zelka, me atë bagazh të pasur jetësor e luftarak që kishin, me siguri do të shërbente edhe për të demaskuar ata «patriotë» që donin të jetonin me hijen «e lavdishme» të së kaluarës, pa pasur as edhe një të dhjetën e veprimtarisë së Xhafë Zelkës. Sigurisht nuk mund vi hapësia që ditën e parë. Do ta mbaja pranë, do ta prisja ashtu si e meritonte dhe më vonë njohja jonë do të merrte rrugën e saj të natyrshme.

Pas disa ditësh ai erdhi dhe më solli të hollat. Unë i nxora tri paleo të tjera.

- Prapë ti po këtë avaz, mor zotni? ! - më thotë Xhaf a.

- Jo, - i them, - nuk është më i njëjti avaz, ti këtë herë i pagove, ja, të hollat i vure mbi tryezë.

- Si të quajnë ty, mor djalë? - më pyeti Xhafa, dulce m'i ngulur svtë e tij të gjallë dhe të vëmendshëm.

- Më quajnë Enver Hoxha, - i them, - dhe jam nga Gjirokastra. Ja dhe babai im.

Plaku rrinte i heshtur në një karrige dhe dëgjonte. Xhafa u drejtua nga ana e tij dhe e përshëndeti. Plaku im që ishte i thjeshtë. u ngrit në këmbë dhe i bëri temena.

Të të rrojë djali, - i tha Xhafa.

- Ejvalla. - i tha plaku dhe, si kurioz që ishte, e pyeti: - Nga të kemi zotrote, a ke fëmijë?

Xhafa iu përgjigj se kishte vajza dhe djem dhe si mori pakot, iku dulce na përshëndetur e falënderuar.

Kur doli nga dera, xhaxhai më pyeti:

- Kush ishte ky? A ka dyqan?

- Çfarë dyqani, ai është kripë, i them. – Ky

plak ka qenë tok me Haxhi Qamilin kur u vunë zjarrin pallateve të Esat Toptanit.

- Jo more! - tha plaku. - E po jemi fit e fit, ky i vuri zjarrin pallatit të Esat Pashës, Avni Rustemi ia mbylli përgjithmonë derën Pashës së poshtër, - dhe xhaxhai ra në heshtje e në mendime.

- Po ku i gjen ky plaku paret, që blen nga tri paleo?

- Ia jap veresie, - i them.

- Mos e zgjat, - tha xhaxhai, - e kuptova.

Kur Xhafa erdhi herën tjetër, jo për të marrë pako me cigare, po thjesht se i kishte rënë rruga, nuk e lashë të largohej menjëherë, por e ftova të pinim një kafe. Xhafa nuk më refuzoi.

- Or zoti Enver, - më tha Xhafa, - vetëm pse kam qenë mësues dhe ke qenë dhe vetë mësues, më respekton dhe më nderon kështu?

- Edhe për këtë, zoti Xhafë, por sidomos për dashurinë që ke për atdheun dhe për luftën që ke bërë për të mirën e popullit fukara. Ju e keni ndier thellë pushtimin që na ka hedhur mbi shpinë Italia dhe me siguri keni menduar se populli nuk do ta durojë, por do të ngrihet e do ta flakë poshtë atë. Shpirti kryengritës i shqiptarëve nuk ka reshtur kurrë së qeni i tillë. Sigurisht kohët kanë ndryshuar, armiku është më i egër, më i armatosur. po mos do të tutemi nga kjo? Unë them jo, zoti Xhafë dhe nuk e di si mendoni ju, luftëtari i kryengritjes së Haxhi Qamilit?

Burri i urtë dhe i ndershëm, patrioti Xhafë Zelka u mendua pale e tha:

- Xhafë Zelka nuk është më i ri, zoti Enver, se po të ishte i ri, nuk do të sor ollatej kështu.

- Lufta për atdhe zoti Xhafë, nuk njeh moshë. Secili mund të kontribuojë, - dhe si e vështrova në sy i thashë duke i theksuar fjalët, - e duhet të kontribuojë për lirinë e atdheut. Prandaj më erdhi keq kur ju dëgjova që thatë se jeni plakur. Nuk plaket kollaj Xhafë Zelka dhe ai do të gjejë ilaçin me të cilin do të luftojë pleqërinë e moshës, por jo të shpirtit.

Xhafa piu kafen pa folur dhe bënte ç'bënte m'i hidh te sytë sikur më hetonte. Për atë ditë m'u duk e mjaftueshme biseda. Shpirti rebel i Xhafë Zelkës ishte i tillë, që donte vetëm një ngacmim për të shpërthver.

- Më bëre të mendohem me fjalët që më the, tha Xhafa dhe si uli kokën shtoi me një zë q~ mé bëri të dr idhem nga emocioni: - Mirë të gjetça, bir!

Mezi munda Via kthej përshëndetjen dhe për një kohë të gjatë e ndoqa me sy si ecte ashtu ngadalë.

Xhafë Zelka ishte një patriot i shquar, demokrat, atij i dukej se po «rëndohesha» me «ndihmën» që i jepja. Ai, i ndershmi plak Xhafë Zelka, kujtonte se unë bëj a ndonjë sakrif icë.

Një ditë erdhi në dyqan dhe unë i thashë:

- Sa pako do sot?

- Asnjë, zoti Enver, - më tha.

- Pse kështu, zoti Xhafë, - i thashë. - mos më kurse.

- Jo, bir, - më tha, - por jam lodh, tash më jep vetëm një kafe.

1 thirra të na bënte një kafe Mafit, kafeyhiut tiranasi, mikut tonë që na lajmëronte kur në kafenenë e tij të vogël vinin spiunët për të na përgjuar. Mali ishte burrë i shkuar, veshur tirançe dhe. kur solli kafen. Xhafa, që me siguri e njihte, i tha:

- Malo m'i ruaj me kujdes çunat.

- Mos ki merak babë Xhafë, - iu përgjigj Mali. Duke pirë kafen Xhafë Zelka më tundi kokën:

- Tash unë e di se ç'bluan ajo kaptina jote.

Me të qeshur i them:

- Pse unë nuk e di se ç'bluan jotja?

Qeshëm të dy.

- Dëgjo bir, - tha Xhafë Zelka, - tash nuk ju ndlhmoj dot sa duhet, se më janë pre kambët. por goja nuk më pushon dhe nuk do të më pushojë kurK~ kundër kët:y re qenve fashistë.

- Zoti Xhafë, - i thashë, - gjuha pret hekurin. ti ke qenë luftëtar i vecrjëlisë dhe vazhdon të jesh, ne ecim në rrugën tuaj për të shpëtuar atdheun.

- Ju dini më shumë nga ne si të luftoni. ju lumtë!

Dëgjo, avitu, - më tha Xhafa dhe më foli me zë të ulët: - Unë nuk bëhem dot komunist, por fëmijët e mi dua t'mi mësoni që ata medoemos të bëhen të Partisë.

- S'ka asnjë dyshim, - i thashë, - ata, si gjithë fëmijët e popullit, do të ndjekin rrugën dhe mësimet e babës së tyre, lufta do t'i mësojë dhe Partia do t'i mbajë kurdoherë pranë e do t'i edukojë të bëhen njerëz të vlefshëm.

Dhe me të vërtetë njëri nga djemtë e tij u bë një anëtar i vendosur partie dhe gazetar, kurse njëra nga vajzat, siç më ka thënë Nexhmija që e kishte shoqP klase në Institutin e atëhershëm Femëror të Tiranës, ishte mësuese aktive si gjatë viteve të luftës, ashtu edhe më vonë. Edhe tre fëmijët e tjerë të Xhafë Zelkës, siç kam dëgjuar, u bënë njerëz të thjeshtë dhe punëtorë të nderuar, ashtu si i deshte babai i tyre, patrioti Xhafë Zelka, që gjithë jetën luftoi për popullin fukara, për përparimin dhe_ lirinë e që pas Clirimit të atdheut për vite me radhë, derisa vdiq, kaloi një pleqëri të lumtur e të gëzuar.

V

MIQ DHE ARMIQ

NGA TAKIMET ME STALININ

E palzarruar do të nën mbetet dita e parë e takimit me Josif Visarionoviç Stalinin. Kjo ndodhi më 16 korrik 1947, ditën e tretë të qëndrimit tonë në Moskë. Ajo nisi si një ditë e jashtëzakonshme: Qysh në mëngjes shkuam në Mazoleun e Leninit të madh, ulëm kokën me nderim të thellë para rupit të udhëheqësit gjignial të revolucionit, para atij njeriu, emri dhe vepra kolosale e të cilit ishin gdhendur thellë në mendjet dhe në zemrat tona, na kishin ndriçuar e na ndriçonin rrugën e lavdishme të luftës për liri, të revolucionit e të socializmit. Me këtë rast në emër të popullit shqiptar, të Partisë sonë Komuniste dhe në emrin tim, vendosa para Mauzoleut të pavdekshmit Lenin një kurorë me lule slumëngjyreshe. Prej këtej, pasi vizituan, varret e luftëtarëve trima të Revolucionit Socialist të Tetorit, të militantëve të shquar Partisë Bolshevike dhe të shtetit sovjetik, të vendosura në muret e Kremlit, shkuam në Muzeun Qendror të Vladimir Iliç Leninit. Mbi dy orë e ca ne kaluam nga njëra salle në tjetren, duke u njohur nga afër me dokumente e ekspozate që pasqyronin me hollësi jetën dhe Veprën e shquar të Leninit të Madh. Para se të dilnim, në Librin e Vizitorëve të Muzeut, ndër të tjera shkrova edhe këto fjalë: «Kauza e Leninit do të rrojë e pavdekshme në brezat e ardhshën. Kujtimi i tij do të jetojë gjithnjë në zemrat e popullit shqiptar».

Tamam këtë ditë, të mbushur plot përshtypje e emocione të pashlyeshme, na priti e bisedoi gjatë me ne nxënësi dhe vazhduesi besnik i veprës së Leninit, Josif Visarionovic Stalini.

Ai që në fillim na krijoi një atmosferë të tillë shoqërore sa shumë shpejt u çlirua nga ai emocion i natyrshëm që ndjemë kur u futëm në zyrën e tij, një sallë e madhe, me një tryezë të gjatë për mbledhje, pranë tryezës së tij të punës. Pak minuta pas shkëmbimit të fjalëve të para ne e ndjemë veten jo sikur ishim duke biseduar me Stalinin e madh, por sikur po rrinim me një shok, që e kishim njohur më parë, me të cilin kishim biseduar shumë herë. Unë isha akoma i ri atëherë dhe

përfaqësues i një partie dhe i një vendi të vogël, prandaj, që të më krijonte një atmosferë sa më të ngrohtë e shoqërore, Stalini bënte shaka dhe filloi të fliste me dashuri dhe me respekt të madh për popullin tonë, për traditat e tij luftarake në të kaluarën dhe për heroizmin e tij në Luftën Nacionalçlirimtare. Fliste qetë, shtruar e me një ngrohtësi karakteristike që të bënte për vete.

Ndër të tjera shoku Stalin na tha se ndiente simpati të thellë për popullin tonë si një popull shumë i vjetër i zonës së Ballkanit dhe me një histori të gjatë trimërie.

- Jam njohur veçanërisht me heroizmin e treguar nga populli shqiptar gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, - vazhdoi ai, - por, kuptohet, këto njohuri të miat s'mund të jenë në gjerësinë dhe thellësinë e duhur, prandaj do të dëshiroja të na flisnit pak për vendin, për popullin tuaj si dhe për problemet që ju preokupojnë sot.

Pas kësaj fjalën e mora unë dhe i bëra shokut Stalin një përshkrim për rrugën e gjatë e të lavdishme historike të popullit tonë, për luftërat e tij të pareshtura për liri e pavarësi. Në mënyrë të veçantë u ndala në periudhën e viteve të Luftës sonë Nacionalçlirimtare, fola për themelimin e Partisë sonë Komuniste, si një parti e tipit leninist. për rolin vendimtar që luajti e luan ajo si forca e vetme udhëheqëse në luftën e në përpjekjet e popullit shqiptar për të fituar lirinë e pavarësinë e atdheut, për të përmbysur pushtetin e vjetër feudo-borgjez, për të ngritur pushtetin e ri popullor e për ta çuar vendin me sukses drejt shndërtimeve të thella socialiste.

Shoku Stalin shprehu gëzimin e tij për sukseset e popullit e të Partisë sonë në punën ndërtime dhe u interesua të dinte diçka më tepër për gjendjen e klasave në vendin tonë. Në mënyrë të veçantë u interesua për klasën punëtore dhe për fshatarësinë tonë. Për këto dy klasa të shoqërisë sonë ai bëri i një tog pyetjesh, rreth të cilave ne shkëmbyem shumë mendime që do të na shërbenin me vonë për ndërtimin e një punje të shëndoshë në gjirin e klasës punëtore dhe të fshatarësisë së varfër e të mesme, do të na shërbenin edhe në përcaktimin e qëndrimeve që duheshin mbajtur ndaj elementit të pasur të qytetit të kulakut të fshatit.

- Shumica dërrmuese e popullit tonë, - i thashë ndër të tjera shokut Stalin, në përgjigje të pyetjeve të tij, - përbëhet nga fshatarë të varfër, pastaj nga fshatarë të mesëm. Klasën punëtore e tremi të vogël në numër, tremi mandej një numër jo të vogël zanatçinjsh, qytetarë që merren me tregti të vogël dhe një pakicë intelektualësh. Gjithë këto masa punonjësish iu përgjigjën thirrjes së Partisë sonë Komuniste, u mobilizuan në luftën për çlirimin e atdheut dhe tanfi janë të lidhura ngushtë me Partinë e pushtetin popullor.

- A tra tradita në luftën klasore klasa punëtore e Shqipërisë? - më pyeti shoku Stalin.

- Para Çlirimit të vendit, kjo klasë, - i thashë, ishte shumë e vogël, e sapokrijuar dhe përbëhej nga një numër punëtorësh me mëditje, çir akësh ose zanatçinjsh të shpërndarë në ndërmarrje e në punishte të vogla. Në disa qytete të vendit në të kaluarën, punëtorët janë ngri-tur në greva, por edhe ato kanë qenë të vogla e të palidhura me njëri-tjetrën, si për arsye të numrit fit të paktë të punëtorëve, ashtu edhe të mungesës së organizimit në sindikata. Pavarësisht nga kjo, i thashë shokut Stalin, Partia jonë Komuniste u themelua si Parti e klasës punëtore që do të udhëhiqej nga ideologjia marksiste-leniniste dhe do të shprehte e do të mbronte interesat e proletariatit e të masave të gjera punonjëse, në radhë të parë, të fshatarësisë shqiptare, e cila përbënte edhe shumicën e popullsisë sonë.

Shoku Stalin na byeti me hollësi për gjendjen e fshatarëve të mesëm e të varfër në vendin tonë.

Në përgjigje të pyetjeve të tij, i fola shokut Stalin për politikën që kishte ndjekur dhe për punën e madhe e të sjthanshme që kishte bërë Partia jonë që në themelimin e saj për t'u mbështetur te fshatarësia e për ta bërë atë për vete.

Dulce marrë fjalën shoku Stalin tha se fshatarët, në përgjithësi, në fillim kanë frikë nga komunizmi, se ata kujtojnë që komunistët do t'u marrin tokën e gjithë ç'kanë.

Armiqtë vazhdoi ai, u flasin fshatarëve shumë në këtë drejtim, me qëllim që t'i shkëputin nga aleanca me klasën punëtore, t'i largojnë nga politika e Partisë dhe nga rruga socializimit. Prandaj, ka një rëndësi shumë të madhe puna e kujdesshme dhe largpamëse e Partisë Komuniste me qëllim që, sikundër thatë edhe ju, fshatarësia të lidhet në mënyrë të pazgjidhshme me Partinë dhe me klasën punëtore.

Dulce vlerësuar policikën e dl ejtë që kishte ndjeku Partia jonë me masat në përgjithësi e me fshatarësinë në veçantë. Shoku Stalin na dha një sërë këshillash të vlefshme shoqërore për punën tonë në të ardhmen.

Gjatë ditëve që qëndruam në Moskë, pas çdo takimi e bisede me shokun Stalin, akoma më shumë e me nga afër shihnim te ky revolucionar i shquar, te ky marksist i madh edhe njeriun e thjeshtë, të dashur, të urtë - njeriun e vërtetë. Ai e donte me gjithë zemër popullin sovjetik. Atij ia kishte kushtuar tërë forcat dhe energjitë, për te i punonte mendja e zemra. Dhe këto veti i dailoje në çdo bisedë me të, në çdo aktivitet që kryente që nga ato më të rëndësishmet e gjer te më të zakonshmet. Disa ditë pas mbërritjes sonë ne Moskë asistova, bashkë me shokun Stalin dhe udhëheqës të tjerë të Partisë e të shtetit sovjetik, në një manifestim fizkulturor për gjithë Bashkimin Sovjetik në Stadiumin Qendror të Moskës. Me ç'pasion e ndoqi Stalini këtë aktivitet! Mbi dy orë e ca qëndroi krejtësisht i përqendruar pas venrimeve të manifestuesve dhe, megjithëse nga funi i manifestimit nisi të binate shi e disa herë me radhë Molotovi iu lut ce të largohej, i vazhçonte të ndiqte gjer në fune me vën:e!djc ve;o.rimet.. të bënte shaka, të përshëndeste me dorë. Mbjaj mend. sc né abyllje të ushtrimeve u organizua né kros masiv. Vrapuesit i ranë disa herë rrotull stadiumit. Ndë-sa gara po mbaronte, para tribunës u duk një vrapues që kishte mbetur prapa, ishte shtatgjatë e tepër i hollë. Mezi i hidhte këmbët, duart i lëviznin para e mbrapa, e megjithatë përpiqej të vraponte. Ishte lagur e bërë quil nga shiu. Stalini po e shihtc që nga larg këtë vrapues me një buzëqeshje që shprehte kqardhje e ngrohtësi prej ati:

- *Millij moj**, *(I dashuri im, i shtrenjti im.) - iu drejtua si dulce folur me veti. shco në shtëpi, shko në shtëpi, çlodhu pakëz, ha bukë dhe eja prapë! Do të ketë përsëri vrapime...

Të pashlyeshme më kanë mbetur në kujtesë respekti dhe dashuria e madhe e Stalinit për popullin tonë, interesimi i tij për të mësuar sa më shumë rreth historisë e zakoneve të popullit shqiptar. Në një nga takimet qe patëm ato ditë, gjatë darkës që Stalini shtroi për delegacionin tonë në Kremlin, me të në zhvilluam një bisedë shumë interesante rreth origjinës çzhe gjuhës së popullit shqiptar.

- Cila është origjina dhe gjuha e popullit tuaj, - Më pyeti ndër të tjera, - dhe a mos është i afërt taopulli j uaj me baskët? Populli shqiptar, - vazhdoi pastaj Stalini, nuk besoj të ketë ardbur nga Azia e Largët, as me origjinë turke ai s'është, se shciiptarët janë më të vjetër nga turqit. Ndoshta populli juaj mund të ketë rrënjë të përbashkëta i-ne ata etruskë që kanë mbetur né malet tuaja, se të tjerët që shkuan né Itali një pjesë u asimiluan nga romakët dhe një pjesë kaluan né Gadishullin Iberik.

Unë iu përgjigja shokut Stalin se origjina e popullit tonë është shumë e lashtë. dhe giuha e tij është indoevropian:. Ka shumë teori për këtë çështje, por e vërteta është se origjina jone është ilire. Ne jemi një populi me prejardhjedire. Ka, gjithashtu, një teori që shtron tezën se popullit shqiptar është populli më i vjetër i Ballkanit dhe origjina e lashtë parahomerike e shqiptarëve janë pellazgët.

Teoria e pellazgëve, sqarova më tej, për një kohë është zhvilluar nga shumë shkencëtarë, vecanërisht nga shkencëtarë gjermanë. Ka, gjithashtu, edhe ndonjë shkencëtar shqiptar, i njohur si specialist i Homerit, që arrin në këtë konkluzion, dulce u mbështetur në disa fjalë të përdorura në Iliadën dhe në Odisenë dhe që fliten aktualisht nga populli shqiptar, si, për shembull, fjala gur, domethënë «kamjenj» r usisht. Homeri këtë fjalë e vë para fjalës greke e thotë «guri-petra». Pra, dulce u mbështetur në disa fjalë të tilla, dulce marrë parasysh Orakullin e Dodonës*, *(Fatthëna e Dodonës në Greqinë e lashtë tek e cila, sipas besimit të atëhershëm merreshin këshilla të ndryshme për të tashmen e të ardhmen) disa dokumentacione ose etimologji fjalësh, të cilat kanë pasur ndryshime sipas shumë shpjegimeve filologjike, shkencëtarët nxjerrin se paraardhësit tanë të lashtë kanë qenë pellazgët, të cilët kanë jetuar më përpara se grekët në Gadishullin Ballkanik.

Sidoqoftë unë nuk kam dëgjuar që shqiptarët të jenë të një origjine me baskët, i thashë shokut Stalin. Mundet të ekzistojë edhe një teori e tillë, ashtu sikurse teoria që thatë ju, se një pjesë e etruskëve ka mbetur në Saqipëri, pjesa tjetër është shkëputur dhe është vendosur në Itali, kurse një pjesë tjetër që andej ka shkuar në Gadishullin Iberik, në Spanjë. Ka mundësi që edhe kjo teori të ketë përkrahësit e saj, por unë nuk kam dijeni për të.

- Kemi në Kaukaz një vend që quhet Albani, - më tha në një rast Stalini, - të ketë lidhje me Shqipërinë?

- Nuk e di këtë gjë, - i thashë, - por fakt është se shumë shqiptarë gjatë shekujve, të detyruar nga pushtimi i egër otoman, nga luf tërat e nga kryqëzatat e egra të sulltanëve e të padishahëve osmanë, shpesh janë detyruar të lënë vendlindjen e tyre e të ngulen në dhera të huaja ku kanë formuar edhe fshatra të tëra. Kështu ka ndodhur me mijëra shqiptarë që u ngulën në Italinë e Jugut që në shekullin e 15-të, pas vdekjes së Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut, dhe tanfi atje janë zona të tëra ku banojnë arbëreshët e Italisë, të cilët, megjithëse kanë 4-5 shekuj në vend të huaj, akoma ruajnë gjuhën dhe zakonet e vjetra të atdheut të të parëve. Po kështu, - i thashë shokut Stalin, shumë shqiptarë u vendosën në Greqi, ku ka zona të tëra të banuara me arbëreshët e Greqisë, të tjerë u vendosën në Turqi, në Rumani, në Bullgari, në Amerikë e gjetkë... Por, për vendin tuaj që quhet «Albani», - i thashë, - nuk di asgjë konkrete.

Atëherë Stalini më pyeti për një varg fjalësh të gjuhës sonë. Deshi të dinte si i quanim ne veglat e punës, orenditë shtëpiake etj. Unë i përgjigjesha në shqip dhe ai, pasi i dëgjonte fjalët me kujdes, i përsëriste, bënte krahasimin midis emrit shqip të veglës së punës dhe ekuivalentit të saj në gjuhën e albancve të Kaukazit. Herë pas here u drejtohej Molotovit dhe Mikojanit se si mendonin ata. Doli se në rrënjën e fjalëve të krahasuara s'kishte ndonjë përngjasje.

Në këtë moment Stalini shtypi një buton e pas disa sekondash hyri gjenerali që shërbente pranë Stalinit, një ushtarak shtatlartë e shumë i kujdesshëm, i cili sillej me mjaft dashamirësi e simpati ndaj nesh.

- Me shokun Enver Hoxha po përpiqemi të zgjidhim një problem, por nuk mundemi, - i tha Stalini duke buzëqeshur gjeneralit. - Lidhu, të lutem me profesor (dhe përmendi një gjuhëtar e historian të shquar sovjetik, emri i të cilit nuk më kujtohet) dhe pyete nga ana ime nëse ka lidhje midis albancve të Kaukazit dhe Shqipërisë.

Pasi gjenerali doli, Stalini mori një kokërr portokall, e ngriti lart dhe më tha

- Në rusisht i thonë «apjelsin». Po shqip?

- Portokall, - u përgjigja unë.

Përsëri bëri krahasimin duke i shqiptuar fjalët e të dyja gjuhëve dhe mblodhi supet. S'kaluan as 10 minuta dhe hyri gjenerali.

- Mora përgjigjen e profesorit, - na tha. - Ai thotë se nuk ka asnjë të dhënë që të flasë për lidhje midis albancve të Kaukazit dhe Shqipërisë. Por, shtoi, se në Ukrainë, në zonën e Odesës janë disa fshatra (rreth 7) të populluara prej shqiptarëve. Për këtë profesori ka të dhëna të sakta.

Nga ana ime aty për aty porosita ambasadorin tonë në loskë të intereso hej që disa nga studentët tane që përgatiteshin për histori në Bashkimin Sovjetik do të qe mire ta bënin praktiken në këto fshatra e të studionin si e kur ishin agulu: në Odesë këta shqiptarë, a i ruajnë gjuhën e zakonet e të parëve etj.

Stalini, si gjimmonë, tepër i vëmendshëm, na dëgjoi dhe më tha:

- Shumë mire, shumë mire do të jetë. Atje le ta bëjnë praktikën studenti tuaj. bile bashkë me ta edhe disa nga tanët.

- Shkencat albanologjike, - i thashë né vazhdim të kësaj bisede të lire shokut Stalin, - né të kaluarën nuk

an ë qenë zh~,il'uar si duhej dhe mé tepër me to janë marre studiues të huaj. Kjo, veç te tjerash, ka bërë që të lindin edhe lloj-lloj teorish mbi origjinën e popullit, të gjuhës sonë etj. Sidoqoftë një gjë është e përbashkët thujse tek të gjitha - fakti që populli shqiptar dhe gjuha jonë janë me një origjinë shumë të lashtë. Por fjalën e saktë për këto probleme do ta thonë alba nologët tane, té cilët Partia dhe shteti ynë do t'i përgatitin me kujdes e do t'u krijojnë të gjitha kushtet e nevojshme për punë.

- Shqipëria, - më tha Stalini, - duhet të ecë me këmbët e veta, se i ka të gjitha mundësitë.

- Ne do të ecim patjetër përpara, - iu përgjigja unë.

- Nga ana jonë ne do ta ndihmojmë me gjithë zemër popullin shqiptar, - tha me dashamirësi shoku Stalin. se shqiptarët janë njerëz të mire.

U takuam përsëri pas disa ditësh né një darkë që u shtr ua né Kremlin për nder të delegacionit tonë. Shoku Stalin, une dhe të tjerët ishim ulur rreth tryezës. Edhe né këtë darkë, si né të gjitha takimet e tjera me të, na bënë përshtypje dhe na emocionuan dashuria e madhe e Stalinit për vendin e për

popullin tonë. interesimi i tij për të mësuar sa më shumë rreth historisë, kulturës, gjuhës, zakoneve të popullit tonë.

Ai e nisi bisedën duke më pyetur për disa fjalë të gjuhës shqipe:

- Dua të dëgjoj, - më tha, - si tingëllojnë shqip fjalët: popull, njeri, bukë, dhuratë, grua, burrë, tokë?! Unë nisa t'i shqipilloja në gjuhën shqipe këto fjalë dhe ai më dëgjonte krejtësisht i përqendruar. Mbaj mend. se për njërin nga fjalët u krijua një situatë humori. Më ishte pyetur se si i thonë shqip fjalës ruse «dar».

- Peshqesh! - i thashë - unë aty për aty.

- Jo, - tha, - jo! Peshqesh nuk është shqip, por turqisht, - dhe qeshi. Kishte një të qeshur shumë të çiltër, të singertë, e qeshur çë i dille nga zemra.

Duke dëgjuar shqiptimin e fjalëve të mia në gjuhën shqipe, shoku Stalin më tha:

- Gjuha juaj është mjaft e vjetër, ajo me anë të të folurit është trashëguar nga njëri brez te tjetri. Përndryshe ky është një fakt që tregon qëndrueshmërinë e popullit tuaj, forcën e tij të madhe për të mos u asimiluar me gjithë rrebeshtet që ka kaluar.

Lidhur me këto probleme, ai më pyeti:

- Cila është përbërja nacionale e popullit shqiptar? Ka pakica kombëtare serbe e kroate në Shqipëri?

- Shumica dërrmuese e popullit tonë, - i thashë, - përbëhet nga shqiptarët, por ka dhe një pakicë të kombësisë greke (afërsisht 28 mijë veta) dhe, fare pak maqedonas (gjithsej pesë fshatra të vogla), kurse serbë e kroatë nuk ka.

- Sa besime fetare ka në Shqipëri, - pyeti më tej shoku Stalin. - dhe e'gjuhë flitet?

- Në Shqipëri, - u përgjigja unë, - ka tri besime fetare: mysliman, ortodoks dhe katolik. Popullsia që kultivon këto tri besime është e të njëjtit komb, shqiptare.

prandaj edhe gjuha që përdoret është vetëm shqipja, me përjashtim të pakicës kombëtare greke që flet gjuhën e saj amtare.

Gjatë kohës që flisja, Stalini herë pas here nxirrte llullën e tij dhe e mbushte me duhan. Vura re se nuk përdorte ndonjë duhan të veçantë por merrte cigare «Kazbek», i shkoqte, e hiqte letrën, ndërsa duhanin e hidhte në llullë. Pasi dëgjoji përgjigjen time, më tha:

- Ju jeni një popull i veçantë, sikurse janë edhe persianët e arabët, që kanë të njëjtën fe me turqit. Paraardhësit tuaj kanë ekzistuar para romakëve dhe turqve. Çështja e fesë s'ka të bëjë me kombësinë dhe shtetësinë.

Dhe ndërsa vazhdonim të bisedonim, më pyeti:

- Ju, shoku Enver, e hani mishin e derrit?

- Po! - i thashë.

- Feja myslimane ua ndalon këtë gjë besimtarëve të saj, - tha ai. - zakoni i vjetër që i ka ikur koha. Sidoqoftë, - vazhdoi. - çështja e besimeve fetare duhet pasur mirë parasysh, duhet vepruar me shumë kujdes, se nuk mund të merren nëpër këmbë ndjenjat fetare të popullit. Këto ndjenja janë kultivuar prej shekujsh në njerëzit dhe duhet vepruar me shumë maturi se ky qëndrim ka vlerë për kompaktësinë dhe unitetin e popullit.

Gjithë darka kaloi në një atmosferë shumë të ngrohtë, shumë shoqërore. Shoku Stalin, pasi ngriti një doli për ushtrinë shqiptare dhe ushtrinë sovjetike, më hapi prapë prapë çështjen e luftës së popullit grek. Fliste me simpati të thellë për popullin trim e liridashës grek, për heroizmat, për sakrificat dhe për gjakun që derdhte në luftën e tij të drejtë.

- Edhe ne, edhe ju, gjithë revolucionarët dhe po. puajt jemi me luftën e drejtë të popullit grek. me kërkesat e tij për liri e demokraci. Mbështetja dhe përkrahja jontideologjike dhe politike atyre s'do t'u mungojnë kurrë, -tha, midis të tjerash, shoku Stalin. - Ju, - vazhdoi ai, - që jeni në kufi me Greqinë, në mënyrë të veçantë duhet të keni kujdes e të jeni vigjilentë për të përballuar çdo provokacion të monarko-fashistëve kundër vendit tuaj.

Gjatë darkës u ngritën doli për të gjithë shokët me radhë. U ngrit doli edhe për Omer Nishanin.

Molotovi, duke ngritur herë pas here gotën, më nxiste të pija më shumë dhe, kur pa se unë s'po ia plotësoja dëshirën, më pyeti:

- Pse kaq pak?! Ju mbrëmë pitë më shumë!

- Ah, mbrëmë ! Mbrëmë ishte ndryshe puna, -- i thashë, duke qeshur.

Molotovi atë çast iu drejtua shokut Stalin:

- Mbrëmë, - tha, - isha në darkë me shokun Enver te Vishinski. Na erdhi lajmi se dje më 31 mars Enver Hoxhës në Tiranë i lindi djalë. Nga gëzimi pimë diçka më tepër.

- Urime! - më tha atë çast Stalini dhe më drejtoi gotën. - Le të pimë një shëndet për djalin e vogël dhn shogon tuaj!

E falënderova shokun Stalin, duke i uruar shëndet e jetë të gjatë për të mirën e Partisë Bolshevike e të shtetit sovjetik, për të mirën e revolucionit e të marksizëm-leninizmit.

Kaluam disa orë në këtë ambient kaq të ngrohtë, të përzemërt familjar. Si mua ashtu edhe gjithë shokëve tanë na kanë mbetur të pashlyera në kujtesë sjelljet dhe tiparet e Stalinit të lavdishëm, e atij njeriu emri dhe vepra e të cilit u futnin dridhmën armiqve imperialistë, fashistë, trockistë, reaksionarëve të çdo ngjyre, kurse komunistëve, proletarëve, popujve u ngjallnin gëzim e entuziazëm, u shtonin besimin dhe forcat tek e ardhmja.

Qjatë gjithë darkës ai ishte me humor shumë të mirë, i gëzuar, i qeshur, tepër i vëmendshëm në bisedat e lira që bënim dhe përpiquej që gjithë të pranishmit ta ndienin veten sa më të lirshëm. Rreth orës 23 të darkës Stalini na propozoi:

- Shkojmë pimë nga një kafe?

U ngritëm të gjithë dhe shkuam në sallën ngjitur. Ndërsa po na servirej kafeja, në një tavolinë pranë dy shokë sovjetikë, duke qeshur, po mundoheshin ta bindnin Xhafer Spahiun të pinte edhe ca. Xhaferi i kundërshtonte e diçka u thoshte. Stalini, i vëmendshëm, i vuri re, e gjithë shaka iu drejtua shokëve sovjetikë:

- Aa, nuk është e drejtë! Ju nuk jeni në kushte të barabarta me mikun, jeni dy me një!

Të gjithë qeshëzn dhe vazhduam të bisedojmë e të bëjmë shaka si në një rreth të ngushtë familjar. Pastaj Stalini u grit përsëri:

- Shokë, - na tha, - tani ju ftoj të shkojmë në kinema.

U ngritëm të gjithë dhe Stalini na çoi në kinemanë e Kremlinit, ku zgjodhi vetë filmat që pa delegacioni ynë.

Ishin disc fi'ma dokumntarë me ngjyra, që paraqitnin pamje nga vende të ndryshme të Bashkimit Sovjetik si dhe filmin «Nusja e largët».

Këtu mbaron edhe vizita jonë e dvtë te Stalini.

DIMITROVI MADHËSHTOR

T ë nesërmen u nisëm për në Sofje. Në kufi na pritën shumë përzemërsisht Anton Jugovi dhe shumë shokë të tjerë të udhëheqjes bullgare. U përqaftuam. u puthëm si shokë e vëllezër nga me të ngushtë. Na dhanë të falat e Dimitrovit e na thanë se ai vetë dhe gjithë shokët e tji; rë të udhëheqjes së partisë e të qeverisë do të na pritnin në stacionin kryesor të Sofjes. Kontakti i parë me përfaqësuesit e popullit bullgar ishte i përzemërt. prekës. Njerëz te t,`htë na përqaftonin. na uronin mirëseardhjen. na uronin për suksese në vizitën tonë dhe për forcimin e marrëdhënieve reciproke midis dy vendeve e popujve tanë. I përshëndeta dhe unë me një deklaratë të shkurtër ku shprehja ndjenjat e dashurisë së madhe të popullit shqiptar për popullin vëlla bullgar. besimin se lidhjt tona miqësore do të ecin gjithnjë e më përpara dhe për»fundova d" ke thir rur:

- Rroftë udhëheqësi juaj i madh, Gjergj Dimitrovi?

Populli shpërtheu në ovacione të gjata. Sipas zakonisht nacional na dhuruan bukë e kripë. kurse një vajzë e re në dhuroi një kostum tradicional bullgar të qëndisur me mjeshtëri.

- Sa të shpuara gjilpëre ka në këtë kostum, aq shprehje dashurie ka për popullin shqiptar nga popull, bullgar, - më tha ajo e përbotur nga entuzazmi dhe më pëqafoi.

Në mes kësaj atmosfere u nisëm për Sofje.

Mbërritëm. Kishin dalë e na pritnin popull i macih, udhëheqja, në krye të tyre Dimitrovi madhështor, me fytyrë burrërore të skalitur si revolucionar i vërtetë, me leshra të gjata e të lëshuara, mbasi kishte hequr kokoren, megjithëse binte borë e bënte ftohtë. Ai më priste në peronin e trenit, më dha dorën, më rr oku në kr ahador e më puthi. Ishte një moment shumë emocionant për mua. E rroka për qafe dhe nuk e lëshoja. Lot më dilnin nga emocioni që arrita këtë ditë që Partia dhe populi' të më dërgenin këtu, të takohesha me këtë mësues të madh të proletariatit e gë, si nxënës besnik i tij, në shembullin e tij, nga mësimet dhe nga këshillat e tij, mësova si të qëndroja dhe të luftoja kundër pushtesve fashistë, kundër armiqve të popullit dhe të klasës për çlirimin e atdheut tim, për formimin dhe kalitjen e Partisë cime, për socializmin dhe komunizmin.

Pasi mbaruan ceremonitë në stacion, hipëm nëpër makina për të shkuar në selinë e qeverisë bullgare. Dimitrovi dhe unë hipëm në makinën e parë të hapur dhe kaluam në mes të një vargu të gjatë njerëzish që i kishin mbushur rrugët, trotualet, sheshet, penxheret, ballkonet plot. Kudo ishin vendosur flamuj shqiptarë dhe bullgarë, porti ete dhe parulla për miqësinë buligaro-shqiptare. Ç'dashuri e pafund e popullit për Dimitrovin; për Stalinin dhe për Shqipërinë! Sheshi përpara pallatit ishte plot me njerëz. Nga ballkoni i pallatit do të përshëndetnim popullin vëlla bullgar.

Para se të dilnim në ballkon, ndenjëm pranë e pranë me Dimitrovin. Ai ishte i madh n- thieshtësinë e tij shembullore. Më pyeti për popullin, për Partinë, për shokët. Fliste rusisht, kurse unë flisja shqip, se kuptoja shumë pak rusisht.

Kur dolëm në ballkon, në mes të ovacioneve të popullit, buçiti zëri i Dimitrovit. Kishte një zë të fortë, kurbues, me frymëmarrje të thellë që pengohet nga astma; ai fliste me entuziazëm, me zjarr, me dashuri të pakufishme për popullin tonë. Dhe unë, duke e dëgjuar, e kisha përqendruar vështrimin tek ai dhe mendja më punonte te luftërat e tij titanike, tek torturat, te vuajtjet e tij për kauzën e proletariatit botëror, te ky proletar që s'u thye kurrë, por u ngrit vazhdimisht si Anteu, përmes shtrëngatave, për triumfin e revolucionit.

Edhe fjalimi im u prit mirë nga populli i Sofjes, pse ai ishte i thjeshtë dhe shprehte dashurinë e zjarrtë dhe ndjenjat më të thella të popullit dhe të Partisë sonë për popullin bullgar, për Partinë Komuniste Bullgare dhe personalisht për Dimitrovin.

Pas meje u ngrit Dimitrovi, i cili mbajti një fjalë të zjarrtë për miqësinë dhe veçanërisht për popullin tonë, për luftërat e tij heroike.

Ne i dëgjonim me vëmendjen më të madhe fjalët e tij, mendimet e tij të thella.

Në një mbrëmje të madhe festive në Sofje më dhanë titullin «Qytetar Nderi i Sofjes» dhe mbaj mend se atë darkë kemi kënduar e kemi hedhur valle me qytetarë të thjeshtë e me udhëheqësit bullgarë, njëlloj sikur të ishim në Shqipëri.

Në një moment (s'më kujtohet në këtë mbrëmje apo në darkën e mirëseardhjes që na shtroi), Dimitrovi, midis të tjerash, më tha:

- Populli ynë ushqen nderim e respekt për popullin tuaj dhe për traditat e cilësitë tuaja të vyera. Qysh kur kam qenë fëmijë kam dëgjuar te ne të flitet «të jesh i papërkulur si arnautët, domethënë, si shqiptarët». Te ne vetia juaj për të mos ulur kryet para asnjë vështirësie e rreziku është shumë e njohur.

E pashë me kujdes drejt e në sy për të kuptuar nëse ma tha krejt rastësisht, apo kishte parasysh ndonjë gjë tjetër, por s'arrita të zbuloj gjë. Ai më shihte me buzëqeshje dhe ngriti gotën.

- Po, - i thashë. - Ky është një tipar shekullor i popullit tonë. I kanë rënë në qafë turli armiqsh, është përpjekur me ta, ka derdhur gjak, ka sakrifikuar shumë, por kurrë s'është përkulur . Tani që kemi Partinë ky tipar po forcohet më tepër. Kurrë s'do të përkulemi para asnjë vështirësie e pengese, shoku Dimitrov.

- Gëzuar! - tha e përplasi gotën. - Të rrojë populli juaj !

E paharruar do të mbetet darka zyrtarë që na dha Dimitrovi. Kishte veshur kostum të zi. Në krah të djathtë ai mori Nexhmijen, kurse unë, që qëndroja përballë tij, në krah të djathtë kisha të shoqen e

tij. Më kujto, het një hollësi e vogël, por shumë kuptimplote. Para se të fillonim fjalimet dhe të hanim. Dimitrovi një të grumbulluar numrin e madh të lugëve dhe të pirunëve të shumëllojtë që kishte përpara dhe i thotë garsonit:

- Merri këto. se nuk kam nevojë për 20 copë, më mjafton një thikë, një lugë dhe një pirun. - Deri këtu shkonte thjeshtësia e tij që nuk duronte dot luksin dhe zakonet borgjeze. Menjëherë dhe i entuziazmuar nga thjeshtësia e tij ia mbusha edhe unë duart garsonit me hekurat e nikeluar.

Pasi mbajti fjalimin Dimitrovi, iu përgjigja dhe unë me fjalë shumë të ngrohta, një pjesë të cilave ia kushtova figurës së madhe të Dimitrovit, rolin të tij të madh si udhëheqës jo vetëm për komunistët bullgarë, por për të gjithë komunistët e botës, e cilësova nxënësin dhe bashkëpunëtorin shumë të afërt të Stalinit të madh etj.

Darka kaloi në një atmosferë shumë të gëzuar. Dimitrovi ishte njeri i qeshur dhe shumë optimist. Kur mbaroi darka u kthyem gjithë qejf dhe me përshtypje të pashiyeshme në rezidencën ku rrinim, në pallatin e ish-mbretit Boris. Pasi u ulëm në sallën për të pirë nga një cigare e për të biseduar për përshtypjet që na kishte lënë darka, shkuam në dhomat e fjejes. Por gjumi nuk më zinte. Nuk më iknin nga sytë e nga mendja përshtypjet e takimeve dhe fjaliët e ngrohura të Dimitrovit, sillja ndër mend jetën e tij prej luftëtari të papërkullur, përpjekjet dhe sakrificat që kishte bërë për çështjen e popullit të tij dhe të proletarietit botëror. Duhej të kishte kaluar mesnata, kur dëgjoj të trokitura në dërë. Ngrihem, e hap. Në prag të derës qëndronin Koçi Xoxe dhe Shulja, të vrenjtur.

- Ç'ka ngjarë? Akoma nuk keni fjetur? - i pyeta.

- Nuk kemi fjetur, - tha Koçi. - pse duam të bisedojmë me ty.

- Kaq urgjente është? - i pyeta. - Nuk mund të pritnit mëngjesin?

- Unë dhe Shulja jemi aq të shqetësuar sa nuk na zë gjumi, - tha Koçi Xoxe, - prandaj duam të bisedojmë tani!

I pashë në moment ngultas, u thashë të më pritnin në sallën sa të hidhja diçka krahëve e, pas kësaj, dola. Trokitjet në dërë time dhe zërat pas mesnate i kishte dëgjuar dhe Hysniu e doli dhe ky te dera e dhomës së tij.

- Eja Hysni, - i thashë, - Koçi e Shulja se ç'kanë një gjë urgjente për të na thënë!

U ulëm në sallën dhe Koçi Xoxe filloi të thotë:

- Mua e Shules nuk na pëlqeu fjalimi yt dhe nuk jemi dakord me çka the për Dimitrovin!

Unë shqeva sytë nga habia dhe i hodha sytë Hysniut, i cili ishte po aq i habitur sa edhe unë.

Koçi vazhdoi:

- Ne nuk jemi dakord me të gjitha ato epitete që i vutë atij. Ne nuk themi se Dimitrovi nuk është njeri i shquar, por ti i dhe një rol të madh.

- Nuk kam folur gabim, nuk kam thënë asgjë të tepërt për Dimitrovin, - iu përgjigja, - duhej të thosha edhe me shumë, pse ai i meriton. Jeni ju që gaboni.

Erdhi edhe çasti kur do të shkonim në Kriçim, ku do të firmosnim marrëveshjet. Në rrugë e sipër vizitua vende historike, fabrika e kooperativa. Kudo u pritëm me gëzim dhe me entuziazëm të papërshtatshëm. Masat e popullit gjatë rrugës hekur udhore, në borë, brohoritnin me thirrjen: «Urra!». Treni ndalej, na dhuroheshin peshqeshe, niseshim përsëri e kështu arritëm deri në një vend, emri i të cilit nuk më kujtohet, ku do të linim trenin dhe me makina do të shkonim në Kriçim.

Kur ndaloi treni, populli (së bashku me kordonët dhe me brohoritje na zur i rrugën. Mezi dolëm të parët Dimitrovi dhe unë. Dimitrovi më thotë:

- Këta e kanë të gjatë punën, në rast se presim shokët, na mbërthen prapë turma, prandaj hipim unë e ti në makinë dhe «çajmë ferrën» (me një fjalë ai donte të thoshte si komitaxhi të vjetër). Dhe kështu bëmë. Dimitrovi, unë dhe roja ikëm përpara nëpër borë. Karvani mbeti shumë prapa.

- S'kemi rojat e sigurimit, brate, - i thoshte shoferi Dimitrovit.

- Ngaje se na ruan populli, - i përgjigjej Dimitrovit.

Afër Kriçimit populli na kishte zënë rrugën.

- Do t'u flasësh! - më thotë Dimitrovi. - Në rusisht?

- Si mund t'u flas, - i them, - unë e kuptoj disi rusishten, por nuk mund të flas me ato pak fjalë që di.

- Davaj, - tha Dimitrovi, - folu shqip se unë, edhe pa e ditur shqipen, do t'ua përkthej besnikërisht nga shqipja, sepse e di ç'do t'u thuash, se ndjenjat tona puqen, ne kemi një zemër. Dhe kështu bëmë. Dolëm përpara popullit, unë fola në shqip e me disa fjalë rasisht dhe plaku i shtrenjtë përkthente në bullgarisht.

Kur hymë në makinë Dimitrovi më tha:

- Nuk do të çuditen fshatarët ku e di unë shqipen, pse bullgarët dhe shqiptarët gjithmonë kanë qenë vëllezër e shokë armësh.

I dashur i e i shtr enjti Gjergj Dimitrov, mjaltë të lëshonte goja, siç thotë populli ynë!

Arritëm më së fundi në Kritçim. Ky është një fshat i madh, ku mbretërit e Bullgarisë kishin tokat më të mira dhe kishin ndërtuar një pallat të bukur gjahu për verë, por edhe për dimër. Në këtë pallat, që tash ishte pronë e republikës, ne ishim mysafirët e partisë dhe të qeverisë bullgare e personalisht të Dimitrovit. Në këtë vend të bukur ishte një park i mrekullueshëm me lule në natyrë e nëpër serra që gjelbëronin e lulëzonin dimër e verë. Atje kultivoheshin drurë të shumëllojtë, ndër të cilët edhe disa lloje pishash të gjata e të forta «sekuoja» të sjella që nga Kanadaja, siç na thanë. Në këtë park mbanin dhe ushqenin kafshë e zogj të zbutur dhe të aklimatizuar.

DASHURIA E BAJRONIT PËR SHQIPTARËT

Pak më vonë vjen Frederiku* *(Frederik Nosi - përkthyes, partizan i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë sonë) dhe më thotë se gjenerali* *(Gjenerali Deivis - kryetar i misionit ushtarak anglez në Shqipëri.) më kishte ftuar të shkoja për darkë në kuartierin e tij në Bizë tok me shokët që kisha me vete. E pranova ftesën dhe në pasdrekën e 11 nëntorit, i shoqëruar nga partizanët, duke marrë edhe Mustafa Gjinishin edhe si përkthyes dhe si anëtar të Shtabit, u nisa nga Orenja. Në Bizë arrita afër mbrëmjes. Aty, para çadrës kryesore më priste gjenerali buzëgaz, i shoqëruar nga adjutanti i tij, koloneli Nikols i «Coldstream Guards» në qoftë se s'gabohem. Shtrenguam duart dhe u futëm në çadër, pse bënte mjaft freskët. Në atë pllajë të hapur natën frynte erë.

Gjenerali e kishte rregulluar bukur e në mënyrë ko

mode çadrën fushore. Cdo gjë, që nga tryeza e mesit deri te stolat e veshur me mushama, mund të palosej. Mbi krevatin e tij ishte bërë kulaç bulldogu me kollanin e zbukuruar për gryke. Darka ishte me ushqim të thatë: konserva mishi, peshku, djathë të huaj dhe të vendit, disa

lloje frutash nga tonat, çokollata, cigare angleze, raki, uiski dhe verë. Gjenerali më ftoi të ulesha në krye dhe zumë vend me radhë. Na mbushi gotat me uiski.

I them: - Mua më hidh pak, se nuk e kam pirë kurrë, por do t'ju nderoj si zot shtëpie. Më mbush gotën me raki, se këtë ma kanë pirë stërgjyshërit, gjyshi dhe babai.

- Jeni konservator, zoti Hoxha, - më thotë.

- S'kam si t' mos jem për gjërat e mira të popullit tim. - ia prita. - Atdheun duhet ta duam më tepër se jetën tonë. Ja. ju. zoti gjeneral, që nga Anglia. e sillni me avion uiskin.

- Është pije shumë e mirë uiski, - tha Mustafa Gjinishi. - mua më pëlqen shumë.

- Pije, - i thashë, - por ruhu se mos të bie në kokë dhe s'kam si të të qoj deri në Orenjë.

Qeshëm dhe filluam muhabetë të lira, por gjuha, sig thotë populli, vete kurdoherë atje ku dhemb dhëmbi. Të tërë mendonim për politikë, të gjithëve si një çekan mbi kokë na rrihte ajo që ishte kryesore, por e evitonim se e dinim që do të grindeshim, sepse këtu interesat tanë ndr yshonin kryekëput. Folëm më parë për letërsinë, unë për tonën, ai për të tijën. Ai nuk dinte asgjë rreth letërsisë sonë. Kultura që kisha marrë në Francë dhe libi at e shumtë që kisha lexuar më kishin njohur edhe me një varg autorësh anglezë.

- Ne njohim mirë Shekspirin, - i thashë, - jo vetëm nëpërmjet shkollës po veçanërisht nga përkthimi i shquar që u tra bërë veprave të tij poeti, historiani dhe demokrati ynë revolucionar, Fan Noli.

Ashtu si Fitsxheraldi bëri që Khajami «të flasë» anglisht edhe Noli ynë bëri që Shekspiri i madh «të flasë» shqip.

Atë natë në Bizë, ku frynte murlani, folëm me gjeneralin edhe për netët e dimrit të «David Koperfildit», për humorin e Zherom Zheromit, për Suiftin dhe Bajronin, Shellin dhe Kiplingun.

- Kiplingu është i madh për ju, gjeneral, - i thashë, - por unë e urrej atë, sepse është një nga shkrimtarët tuaj. i cili në veprat e tij u thur himne pushtimeve koloniale të perandorisë britanike. Unë preferoj Bajronin tuaj të madh që brezi i ri anglez e tra lënë mënjane dhe të shtë lëshuar pas poetëve e shkrimtarëve pa ndonjë vlerë. Unë e dua Bajronin jo se jam romantik, por sepse ai e tra dashur sinqerisht popullin tim, i tra kënduar me ndjenja të pastra, bile, nga sa tram lexuar diku, dhe vajziës së tij i vuri emër in Alba. duke shprehur kështu simpatinë për popullin shqiptar. Siç e dini, në «Çajld Harold»-in e tij të famshëm. ai u tra kënduar edhe trimërisë. burërisë dhe pjekurisë së shqiptarëve:

«Të rreptë bijt' e Shqipes! Po vetitë Nuk u mungojnë, veç të ishin më të arrira; Armiku ua pa kurrizin ndonjëherë? Kush e duron si ala mundimin e luftës?»

Ç'armiq për vdekje, po sa miq .besnikë! . Kur besa a nderi i thërret të derdhin gjakun, Si trima turren ku t'i çojë i pari i tyre».

Këto karakteristika të të parëve tanë ne i tremi ruajtur të gjalla. Miqtë i duam dhe i presim me përzemërsi, armiqve u vëmë plumbin. Ju, zoti gjeneral Deivis, jeni miku dhe aleati ynë.

Gjenerali u përkul dhe, duke buzëqeshur, tha: Thank you.* *(faleminderit)

- Bajroni i donte popujt që luftonin për liri. Ai e çmonte këtë mbi qdo gjë tjetër dhe i këndonte:

«Liri! Thellë në qeli më tepër ti shkëlqen, Sepse zemrën tre ti për strehë, Zembrëra që përmban vetëm dashuri për ty; Dhe kur bijtë e tu në pranga t'i kanë hedhur, Në pranga, në errësirën e thellë të qelire me lagëht.i, Flijimi i tyre i s,jell atdheut fitore, Dhe fama e Lirisi» në krahë erërash fluturon».

A c dini. zoti gjener al, se cilët ishin njerëzit më besnikë që nuk iu ndanë Bajronit? Dy shqiptarë trima që ia kishte dhënë miku i tij. Ali pashë Tepelena. Ata e donin aq shumë Bajronin saqë, siç tram lexuar diku, në një moment, kur ai po përpëlitej nga ethet e forta, nga dhim bja e tliellë shpirtërore që ndienë për të, i thanë doktorit që kishin thirrur: O shëroje, o të vramë!

Neve na pëlqen Bajroni dhe duam që edhe populli anglez ta dojë popullin shqiptar si ai.

- Më bërë për vete, zoti Hoxha, - tha gjenerali. E dija që letërsinë franceze e njihnit, por ju qenkeni i njohur mirë edhe me tonën.

- Ne shqiptarët, zoti gjeneral, jemi të etur për liri dhe për dituri, për këto të dyja kemi luftuar në shekuj, po luftojmë tash, do të luftojmë edhe nesër, po ta dojë nevoja, - i thashë dhe ngrita gotën time me raki e ai të tij.ën me uiski, por dhe Gjinishi, që qe futur thellë në një bisedë të ëmbël me kolonelin Nikols, s'mbetej pas me të pirë.

- Keni bërë ndonjë shkollë ushtarake? - më pyeti gj enerali.

- Po, - i them, - kam bërë.

- Ku? - pyeti ai.

- Kam bërë shkollën luftarake të popullit tim, e cila është një shkollë me eksperiencë të madhe. Ju keni dëgjuar për Gjergj Kastriotin, Skënderbeun, - i thashë. - Ai u bë i njohur në të gjithë botën se luftoi kundër osmanllinjve, kundër dy sulltanëve nga më të mëdhenjtë, njëzet e dy beteja udhëhoqi,

asnjë nuk humbi. Sulltan Mehmet Fatiu e mposhti Bizantin, por Krujën sa qe gjallë Skënderbeu ynë nuk e mori dot.

- Ishte nga Veriu, - tha gjenerali me djallëzi.

- Ishte shqiptar, - i thashë prerë, dulce e kuptuar aluzionin që bënte fPër A. ~ógun dhe A. Kupinl dhe ishte princ që mbështetej në popull. Ai e donte popullin dhe ky e donte atë.

- Është i bukur vendi juaj. - tha gjenerali duke i ndër ruar drejtimin bisedës, - pr andaj e ka dashur Bajroni. Kemi një tablo me portretin e tij në Angli ku është paraqitur i veshur me kostum shqiptar. Kur të fitojmë luftën, besoj, zoti Hoxha, se do të më ftoni të vij ta vizitoj vendin tuaj, - tha gjenerali duke u munduar t'i jepte bisedës një ton gazmor dhe intim.

- Medoemos duhet të vini dhe ta njihni mirë se vendi dhe populli ynë janë të mrekullueshëm. Nuk duhet të mbeteni me përshtypjet e vjetruara që keni krijuar nga raportet tendencioze të konsujve anglezë, të cilët i shkruanin Forin Ofisit tuaj per gjëra që nuk ishin të vër_teta dhe që kishin qëllime të tjera, ose nga raportet e «koleksionistëve» të luleve e të fluturave që në realitet bënë punë tjetër. Natyrisht unë nuk e kam fjalën për studiues të tillë si Mis Durhami, e cila ka shëtitur nëpër Shqipëri e sidomos në Veri për të studiuar jetën e Malësitë e Veriut dhe nuk ka shkruar keq për të. Por kohët kanë ndryshuar, gjeneral. Perandoria angleze nuk e ka më atë forcë dhe fuqi të mëparshme, kurse te ne fuqia e bejlerëve dhe e bajraktarëve po perëndon, fundi i kësaj lufte do të vërë kap alcun mbi varrin e tyr e.

- Zoti Hoxha, - tha gjenerali, - është e vërtetë se perandoria jonë viktor Tane nuk është më ajo që ka qenë, por ne jemi një monarki demokratike, si të thuash, te ne nuk ka një parti por dy, njëra është e laburistëve, domethënë e punëtorëve, dhe tjetra e konservatorëve. Në vendin tonë zgjedhjet bëhen me vota të lira.

- E di, - i them, - sistemin e demokracisë suaj, por në këtë sistem punëtorët. siç thotë një shprehje jona, «mbajnë çelësat e kashtës». Te ju ka demokraci për kapitalistët, për lordët, por jo për punëtorët. Kur të fitojmë ne do të vendosim demokracinë. po jo si ajo juaja. Te ne do të ketë demokraci vetëm për popullin, kurse «çelësat e kashtës», - thashë dulce qeshur, - do t'i kenë në dorë bejlerët, agallarët e bajraktarët, që gjithnjë e kanë shtypur e tradhtuar popullin.

- Si, zoti Hoxha. - tha gjenerali, - do t'ua mer rni të gjithë pasurinë?

- Medoemos, gjeneral, të ligjtë, armiqtë, ata që kanë lyer duart me gjak do të shkojnë në gjvqet e popullit, të tjerët do t'i vëmë të punojnë, të dërsijnë që ta shikojnë sa e shijshm~ është buka kur fitohet me djersë.

- Prandaj, zoti Hoxha, ata nuk duan të bashkohen me ju, sepse kanë frikë nga ju, - tha gjenerali.

- Frikën është mirë të na e kenë. Ata e dinë se ç'i kanë bërë popullit tërë jetën, prandaj na e kanë frikën. Me gjithatë populli dhe ne u tremi bërë thirrje të braktisin rrugën e tradhtisë. Ata nuk dëgjuan, prandaj do ta pësojnë. Né Frontin Nacionalçlirimtar kemi njerëz edhe nga shtresa të pasura, që janë patriotë, e këta, populli dhe ne, i respektojmë për qëndrimet e tyre patriotike dhe antifashiste.

- Zoti Hoxha, - tha gjenerali, - unë pata një bisedë me zotin Lumo Skëndo e të tjerë dhe u folta drejt, i qortova, u thashë se «me sa di unë vetëm Nacionalçlir imtarja lufton kundër gjermanëve, kurse ju nuk luftoni». Ata më kundërshtuan dhe mend më akuzuan si komunist, por unë ngula këmbë në argumentet e mia dhe më në fund besoj se i binda e më dhanë fjalën se do të luftojnë.

- Do të luftojnë kundër nesh, - i thashë.

- Oh jo, zoti Hoxha, - tha gjenerali, - kundër gjermanëve.

- Atëherë, - më lejoni t'ju siguroj se ju kanë gënjyer, ata as kanë luftuar dhe as do të luftojnë kurrë kundër gjermanëve. Mbajeni mend këtë fjalë që po ju them. Ata do të vazhdojnë deri në fund tradhtinë kundrejt popullit të tyre me armë dhe me çdo mjet tjetër, në bashkëpunim të ngushtë me gjermanët.

LUFTË RËRRYLASH

Një ditë pas vdekjes së Stalinit, më 6 mars 1953, Komiteti Qendror i Partisë, Këshilli i Ministrave dhe Presidiumi i Sovjetit Suprem të BRSS u mbledhën shpejt e shpejt në një mbledhje të përbashkët. Në raste humbjesh të mëdha, si kjo e Stalinit, mbledhje të tilla urgjente janë një veprim i nevojshëm e i domosdoshëm. Por ndryshimet e shumta e të rëndësishme që u komunikuan në shtyp një ditë më pas, tregonin se kjo mbledhje urgjente ishte bërë jo për gjë tjetër, por për... ndarjen e posteve! Stalini sapo kishte vdekur, trupi i tij ende s'qaruar në sallën ku do të bëheshin homazhet e fundit, nuk qe përpiluar ende as programi i organizimit të homazheve e të ceremonisë së përmortshme, komunistët dhe populli sovjetik derdhnin lot për humbjen e madhe, kurse udhëheqja e lartë sovjetike gjeti ditën të ndante portofolet! Brenda kësaj dite u bënë ndryshime të rëndësishme në të gjitha organet e larta të partisë e të pushtetit.

Këto veprime nuk mund të mos na bënin përshtypje

të thellë dhe aspak të mirë. Vetvetiu lindnin pikëpyetje tronditëse. Si u bënë kaq papritur këto ndryshime të rëndësishme brenda një dite, dhe jo në ndonjë ditë çfarëdo, por në ditën e parë të zisë?! Çdo logjikë të shtyn të men

dosh e të besosh se gjithçka ishte përgatitur qysh më parë. Listat e këtyre ndryshimeve ishin hartuar me kohë, në heshtje e vjedhurazi, dhe pritej vetëm rasti që ato të shpalleheshin për të kënaqur edhe njërin, edhe tjetrin, edhe këtë, edhe atë...

Ne, dhe shumë si ne, mendonim se Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik do të zgjidhej Molotovi, bashkëpunëtori më i afërt i Stalinit, bolsheviku më i vjetër, më i pjekur, më 'me eksperiencë dhe më i njohur brenda dhe jashtë Bashkimit Sovjetik. Por nuk ndodhi kështu. Malenkovi u vu në krye, Beria iu ngjiti pas. Prapa tyre ato ditë, pak si më në hije, qëndronte një «panterë» që përgatitej të gëlltiste dhe të likuidonte dy të parët. Ky ishte Nikita Hrushovi.

\\Ënyra e ngjitjes së tij ishte me të vërtetë e çuditshme dhe e dyshimtë: u caktua vetëm kryetar i komisionit qendror për organizimin e ceremonisë së varrimit të Stalinit dhe më 7 mars_ kur u shpall në publik ndarja e posteve, atij nuk iu dha asnjë post i ri veçse u lirua nga detyra e sekretarit të parë të komitetit të partisë të Moskës meqë «do të për qendrohej me punë në Komitetin Qendror të partisë».

Por hipja kaq e papritur dhe e shpejtë e Hrushovit në fuqi neve nuk na la përshtypje të mirë. Jo se kishim ndonjë gjë kundër tij, por se mendonim që roli dhe figura e Hrushovit, qoftë brenda Bashkimit Sovjetik, qoftë në botë. nuk ishin aq të njohur sa ai kaq shpejt të zinte vendin e Stalinit të madh si Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të partisë. Në të gjitha takimet që kishim pasur për vite me radhë me Stalinin, Hrushovi asnjëherë nuk qe dukur, megjithëse në shumicën e atyre takimeve merrnin pjesë thujtë të gjithë udhëheqësit më të lartë të partisë e të shtetit sovjetik.

SHPIFJE KUNDËR STALINIT

Ndodhesha në Moskë, me rastin e një mbledhjeje të të gjitha partive të vendeve socialiste. Më duket se ishte janari i vitit 1956, kur u zhvillua një konsultë në probleme të zhvillimit ekonomik të vendeve pjesëtare të KNER*-it. *(Këshilli i Ndihmës Ekonomike Reciproke, një organizëm në shërbim të B.S. për skllavë-imin e vendeve satelite të Traktatit të Varshavës.) Ishte koha kur F-rushovi dhe hrushovianët po avanconin në veprimtarinë e tyre armiqësore. Me Hrushovin e Voroshilovin ishim në një vilë jashtë Moskës, ku do të hanim drekë të gjithë ne përfaqësuesit e partive motra. Të tjerët akoma nuk kishin ardhur. Asnjëherë nuk kisha dëgjuar nga goja e udhëheqësve sovjetikë të më flitnin hapur keq për Stalinin dhe unë nga ana ime vazhdoja si më parë të flisja me dashuri dhe me shumë respekt për çtalinin e madh. Si duket këto fjalë të miat nuk tingëllonin mirë në veshët e Hrushovit. Duke pritur sa të vinin edhe shokët e tjerë, Hrushovi dhe Voroshilovi më thanë:

- A marrim ca ajër në park?

Dolëm dhe u futëm në rrugicat e parkut. Hrushovi i thotë Klim Voroshilovit:

- I ? huaj. i thuaj ca Enverit për ga'oiimet e Stalinit.

Unë hapa veshët, sido që me kohe dyshoja për ligësitë e tyre. Dhe Voroshilovi filloi të më flasë se «Stalini ka gabuar në vijën e partisë, ka qenë brutal, i egër sa nuk round të diskutoje dot me të».

Si mbaroi Voroshilovi nga llomotitjet e shpifjet, unë i them

- Si është e mundur që Stalini të ketë bërë gabime të tilla?

Hrushovi, i skuqur, u kthye dhe m'u përgjigj

- Mundet, mundet, shoku Enver, Stalini i ka bërë këto.

- Ju i kishit vënë re këto që kur ishte gjallë Stalini. Po si nuk e ndihmuat të mos i bënte këto gabime që thoni se paska bërë? - e pyeta Hrusho_vin.

- Është e natyrshme, shoku Enver, të bësh këtë pyetje, por e shikon këtë «kapusta»? Stalini ta priste kokën me aq lehtësi sa ç'mund të këputë bahçevani këtë dhe Hrushovi i ra me shkop kokëlakrës.

- Çdo gjë është e qartë! - i thashë Hrushovit dhe s'foli më.

U futëm brenda. Shokët e tjerë kishin ardhur. Unë zieja nga zemërimi. Atë natë do të na serviroshin buzëqeshje e premtime për «një zhvillim më të madh» e «më të vrullshëm» të socializmit, për «më shumë ndihmë» dhe për «bashkëpunim më të gjerë» e «të gjithanshëm». Ishte koha kur po për gatitej Kongresi famëkeq i 20-të, koha kur Hrushovi po ecte me hapa më të shpejtë drejt marrjes së pushtetit.

Hrushovi, ky tartarec i neveritshëm i mbulonte hiletë dhe djallëzitë me llogje e pallavra. Megjithatë, në këtë mënyrë ai krijoi një situatë të favorshme për grupin e tij.

TEK TITOJA

Kërkesën për të dërguar në Jugosllavi një delegacion qeveritar të nivelit më të lartë, të kryesuar nga unë, ne ua kishim drejtuar shokëve jugosllavë shumë kohë më parë. Me vajtjen e këtij delegacioni zyrtar atje, ne synonim të hidhej një hap tjetër i rëndësishëm për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore reciproke midis vendeve, popujve dhe partive tona, për rritjen e prestigjit të vendeve tona në arenën ndërkombëtare, për shfrytëzimin e mundësive që do të na krijoheshin për të diskutuar në nivelin më të lartë probleme të ndryshme të karakterit politik, ekonomik etj., e që paraqitnin interes të përbashkët.

Illenduam t'i çonim edhe një peshqesh Titos. Vritnim mendjen çfarë t'i çonim, pse nuk donim të turpëroheshim, por asgjë të përshtatshme s'po gjenim. Më ra ndër mend dhe u thashë shokëve t'i çonim një pishqollë sermi shqiptare, nga të vjetrat. Kjo shkonte për bukuri. Shokët e miratuan. Thirrëm Sterjo Gjokorecin dhe e ngarkuam të na gjente një të tillë. Ai na tha se, gjatë konfiskimit të pasurisë së një kriminelit kuisling, kishin gjetur tri pishqolla të bukura, nga të cilat mund të zgjidhnim. I thamë të na i sillte dhe kur i sollti në zyrë ishte edhe përfaqësuesi i Jugosllavisë, Josip Gjergjia. Ishin me të vërtetë pishqolla të bukura. Zgjodha një dhe : thashë jugosllavit përse e desha. Ai e pa, e pëlqeu shumë dhe pa pikë turpi na tha

- Titoja do të kënaqet pa masë, dërgojani të tria!

Ç't'i thoshim këtij plaqkaxhiu?! E pranuan propozimin e tij. (Kështu që Titoja i mori të tria pishqollat prej serrai dhe i futi në arsenalin e tij të peshqesheve.)

Por ja dhe një vogëlsi që na kishte shpëtuar: Më mungonte uniforma e duhur e gjeneralit! Unë thosha të shkoja civil, por shokët ngulnin këmbë se duhej të kisha me vete edhe uniformën ushtarake të gjeneralit. si Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë. Uniformë të zakonshme kisha, por «grand uniformë» jo. Prandaj duhej të sajoni një, që nga këpucët lustrina deri te kapelja me lulka. Alire këpucët i bëmë, i bëmë dhe pantallonat blu me shirit të gjerë të kuq, por duhej gjetur xhaketa, kësaj si i bchej halli! Thirra Sokolovin në zyrë (ky ishte atashu ushtarak sovjetik në Tiranë) dhe i thashë:

Ke ndonjë xhakete të tepërt?

Pse? - më pyeti ai.

Mos pyet, - i thashë, - por pa zhvishe iljë hërë xhaketen tënde ta provoj !

Kur e veshja pamë se më rrinte e vogël. Atëherë i tregova hallin që më kishte zënë. Sokolovi më thotë

- Kam një copë të paprerë ushtarake, po jua Hhgoj, dhe, po ju pëlqeu, bëni me të një xhaketë e një kapeh~.

Kështu u rregullua edhe çështja e «grand Lini Inrri-vics». Pritnim datën që kishim caktuar për t'u nisur.

Avioni erdhi dhe delegacioni i parë i Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë u nis për në Beograd për vizitë miqësore*. *(Vizita e delegacionit qeveritar të RP të Shqipërisë, i kryesuar nga shoku Enver Hoxha, në RF të Jugosllavisë vazhdoi nga 23 qei,shori gjer më 2 korrik 1946.)

Duke shikuar nga dritarja e avionit tokat e Malit të Zi e të viseve të tjera të Jugosllavisë, mendoja me dhimbje të thellë e me respekt të madh për shokët e mi partizanë që u vranë në këto anë, me qindra, duke luftuar kundër nazistëve gjermanë. Dy divizione, me djem dhe vajza të Shqipërisë, me urdhrin që u dërgova nga Berati në pragun e çlirimit të plotë të Shqipërisë, kapërcyen kufirin dhe. Në përleshje të ashpra me pushtuesit, u shquan në këto anë për heroizmin, vetëmohimin, disiplinën, internacionalizmin dhe zotësinë e tyre në luftime. Nga bordi i avionit mendoja me dashur i për nënat shqiptare, të cilat. pa iu dridhur zemra, i çuan djemtë dhe vajzat e tyre në luftë për çlirimin e atdheut, por që koha u kërkoi këtyre djemve e vajzave, të edukuar nga Partia e komunistëve, të mendonin dhe të shkonin të derdhnin gjakun edhe për lirinë e popujve fqinj. Me mijëra u kthyen nga këto luftime heroike, me qindra ranë në fushën e nderit në territorin e Jugosllavisë, me qindra nëna shqiptare, mendoja ato çaste, presin nga ne t'u sjellim eshtrat e shenjta të bijve të tyre. Këtë, thashë me vete, do ta bëjmë, është detyra jonë, ata do të prehen në vendet më të bukura të atdheut, ku brezat në histori do të këndojnë pa pushim lavdinë dhe heroizmin e tyre*. *(Eshtrat e qindra dëshmorëve tanë tërë në Kosovë, në Mal të Zi etj., u sollën në Shqipëri dhe u vendosën në Var i-ezat e Dëshmorëve të Atdheut dhe në varrezat e dëshmorëve në rrethet përkatëse në vitin 1947 e në vitin 1975.)

Avioni mbërriti në Beograd dhe ne po e soditnim kryeqytetin nga lart. Jemi mbi aerodrom, ulemi në pistë, avioni rrëshiqet, ndalet dhe hapet porta. Shohim që na presin shumë njerëz, ushtarë, banda ushtarake. S'kishim kaluar kurrë nëpër ceremoni të tilla, këto ishin të panjohura për ne dhe do të na duhej të kishim kujdes të mos gabonim në të ashtuquajturat rregulla protokollare. Ne ecim përpara dhe drejt nësh vjen Titoja. Ai na jep dorën, na e shtrëngon fort. Kujtonim se sipas zakonisht tonë do të përqafoheshim. Por jo. Rregulla dhe zakone të tjera. As që vumë re për këto gjëra. Vargu i automobilave tanë. Dulce kaluar nëpër Beograd, arriti në Dedinjë, ku na ishte caktuar rezidenca.

- Nder i madh, i jashtëzakonshëm! - belbëzonte Gjergjia. - Kjo është Dedinja, këtu ka rezidencën kryesore vetë Titoja!

Siç na thanë, dhe siç e pamë më vonë, ai monte dhe punonte në pallatin kryesor të ish-kralëve të Serbisë. Ndërsa kortezhi i makinave ecte mengadalë nëpër rrugët e parkut, Gjergjia më tregoi me gisht një ndërtesë.

- Ja, - tha, - Pallati i Bardhë, pallati i ish-mbretërve. Tani e kemi ne, e ka Titoja!

Makinat tona ecën dhe pak nëpër park dhe ndalën.

- Pallati i ish-princit regjent! - më tha Gjergjia. - Tani aty do të rrini ju.

Rreth e rrotull pallatin e ruanin roja të veshura me uniformë «fringo», të armatosura me automatikë. Pse gjithë këto roja? - thosha me vete kur kujtoja se vetëm dy partizanë e ruanin shtëpinë time dhe në rrugën para saj, në atë kohë, kalonte edhe populli lirisht. Por ia gjeja shpejt «arsyen»: «Vend i madh, Titoja personalitet i madh, mirë bëjnë që e ruajnë kështu». Përpara pallatit bënin rojë nderi, në hollet e pallatit çdo gjë ishte parashikuar, që nga furça për të fshirë rrobat dhe deri te një njeri që na fshiu me leckë pluhurin që këpucët tona kishin marrë në park kur erdhëm. - Tek Titoja u dashkej shkuar «spic»! thoshim me vete. Dhe të mendosh se këta trima që fshijnë këpucët e vijnë rrotull me temena gjer një vit e ca më parë nën luftën dhe jetën partizane!

Hymë në sallonin e madh të pallatit. Luks. Në krye të sallonit rrinte në mes, nën një tablo, vetëm Titoja, në këmbë, i veshur me rrobat e bardha të mareshalit, me jakën dhe me mëngët e qëndisura me ar, me lule, me yje dhe në gjoks me një numër të konsiderueshëm shiritash që përfaqësonin dekoratat.

Që nga dera e sallorit dhe deri në kr ye, sa vajtëm e i dhamë dorën Titos, ai nuk luajti nga vendi. Gjatë fjalës sime Titoja mbante disa shënime në një bllok dhe vazhdimisht pinte cigare me një cigarishte të kthyer në forma llulle. Ai mbante syze, kurdoherë rrinte serioz, i vrenjtur, si i kredhur në mendime të thella. Na dukej se dëgjonte me vëmendje. Herë pas bere mbushte gotën që kishte përpara dhe pinte ujë mineral. Pasi mbarova una, bëmë pushim, na çoi në sallën e bufesë. Atje Titoja filloi të bisedonte, të bënte shaka, të qeshte me shokët e tij par gjëra pa rëndësi, par të shkuar kohën; përkthyesit na i përkthenin. Më vonë këto shaka e biseda të Titos me Moshe Pijaden i gjeta gati të njëllojta si ato të Hrushovit me Mikojanin, që orë e çast të tilla gjëra flitnin, kur mblidheshin. Titoja më pyeti ç'mendoja unë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi. Heshta një moment për t'i përmbledhur në mënyrë sa më koncize e të plotë pikëpamjet tona për këtë problem të rëndësishëm dhe i thashë:

- Ju i njihni padrejtësitë historike që i kanë bërë imper ialistët e ndryshëm e reaksioni serbomad Shqipërisë. Ju i njihni, gjithashtu, qëndrimet parimore të Partisë sonë gjatë Luftës Nacionalglirimtare dhe dëshirën e mirë të popullit tonë për miqësi me popujt e Jugosllavisë.

Në vazhdim unë i shpreha Titos mendimin e palës shqiptare se Kosova dhe viset e tjera në Jugosllavi të banuara nga shqiptarët i përkasin Shqipërisë dhe duhet t'i kthehen kësaj.

- Shqiptarët luftuan, - i thashë, - që të ketë një Shqipëri të lirë dhe sovraane, së cilës tani duhet t'i bashkohen edhe viset shqiptare të Jugosllavisë. Ka ardhur koha që ky problem nacional të zgjidhet drejt nga partita tona.

Presidenti Tito u përgjigj

- Jam dakord me pikëpamjen tuaj, por tash par tash nuk mund ta bëjmë dot këtë gjë, sepse serbët nuk do të na kuptojnë.

Por të gjitha fjalët e përбетimet e Titos ishin një bluf. Titoja, sig e vërtetuan faktet dhe koha, ishte një antimarksist i egër, një nacionalist, shovinist dhe agjent i borgjezisë dhe i imperializmit, ishte një «kalë Troje» në kampin e socializmit, në lëvizjen komuniste ndërkombëtare e ca më tepër në Ballkan.

Këtij Titoje, që u shpreh me kaq «zhdërvjelltësi» dakord me mua par problemin e Kosovës, as nuk i shkoi goja të thoshte: «Shoku Enver, una propozoj që ju, përveç vendeve të tjera të Jugosllavisë, duhet të shkoni të vizitoni edhe Kosovën. Ne duhet t'i tregojmë popullit shqiptar të Kosovës se erdhi koha e një miqësie të vërtetë me popujt e Jugosllavisë» etj. Titoja dhe shokët e tij patën frikë ta bënin një gjë të tillë. Koha nuk do të vononte të tregonte mashtrimet dhe egërsinë e madhe prej shovinisti serbokroat të Titos, jo vetëm kundër shqiptarëve që banonin në trojet e tyr e në Jugosllavi, por edhe kundër Republikës Popullore të Shqipërisë. Plani i fshehtë i Titos ishte që jo Kosova të lidhej me Shqipërinë, por Shqipëria të lidhej me Kosovën dhe, tok me të. të gllabërohej në Jugosllavinë titiste. Mirëpo titistët nuk ia ar ritën dot këtij qëllimi djallëzor.

Gjatë ditëve të vizitës as në Beograd, as gjetkë. në asnjë mbledhje ose pritje nuk pashë as takova ndonjë nga udhëheqësit komunistë shqiptarë të Kosovës. megjithëse disa i njihja dhe personalisht si: Fadil Hoxhën, Ymer Pulën. Nimanajt e të tjerë. Të vetmen «përfaqësuese» të Kosovës që takova ishte nëna e Miladin Popoviçit.

Ishim në një miting kur m'u afrua një plakë e thinjur, e cila, dulce më puthur e përqaftuar, më pëshpëriti: «Jam nëna e Miladinit dhe e Mihajllos, që luftuan tok me ty, djali im Enver Hoxha». Duke e shtrënguar fort në kraharor, më dukej se kisha pranë e përqafoja bashkë me nënën edhe shokun tim të dashur, Miladin Popoviçin. Nuk mund të duroja më dhe, në fjalën time atje, fola per Miladinin fjalët më të mira e më të ngrohta që meritonte.

Më vonë, jo në vizitë zyrtare, kam bërë edhe një takim rne Titon, më duket, kur u nisa për në Konferencën e Paqes në Paris. Biseduam në ver andë për mundësinë e zhvillimit të problemeve që do të diskutoheshin në Paris.

Pasi mbaruam bisedën, para se të hanim drekë, Titoja na propozoi të bënim një shëtitje në liqen. Nuk ia refuzova sido që nuk dija të bëja as not, në rast se kthehej varka.

U vu në lëvizje motori dhe varka rrëshqiti. I~le not na ndiqte edhe qeni i Titos. Buzë liqenit burra, gra, fëmijë bërtitnin

- *Heroi Tito, driizhe Tito, nash Tito!** *(Heroi Tito, shoku Tito, Tito ynë.)

Më bëri përshtypje se këto thirrje i kishim dëgjuar nga fashistët italianë, kur bërtitnin si «Duçe a noi». Unë çuditës! a si e lejonin. Kur po ktheheshim, Titoja tha:

- U lodh qeni, - dhe i thirri, - hip!

Ai u hodh në varkë dhe meqë ishte sa një vig, varka u lëkund, por s'pësuam gjë, e pësoi vetëm kostumi im i Konferencës së Paqes, pse qeni u shkund dhe unmora një dush në rroba.

- I thajmë kur të vemi në vilë, - tha Titoja.

- S'ka gjë, - i thashë unë, duke i hedhur sytë qenit.

Por e tëra kjo ishte një ndodhi e mëvonshme, nga e cila, përveç sa përmenda më sipër, nuk më ka mbetur asgjë në mendje, sepse, në fakt, nuk diskutoam për ndonë problem me peshë. Titoja, siç thashë, ishte me pushime dhe s'mund t'i shkëmbente kshehasjet me asgjë tjetër.

Erdhi dhe dita e largimit tonë për në atdhe. Në aer odrom na përcollën me atë ceremoni që na kishin I ritur, hipëm në avion dhe u kthyem në Tiranë.

Gëzimi im i vajtjes ishte shterur. Kthehesha me një ndjenjë të pashpjegueshme, edhe , besim kisha, edhe u deziluzionova nga fodullëku dhe luksi skandaloz i Titos, që dukej sheshit oysh atëherë. Me vete thosha: A do të puqen karakteret dhe punët tona me Titon?

MASHTRUESIT

- Shikoni se ç'ndodh, - ngriti zërin jugosllavi. Na vijmë nga pala juaj kërkesa të papërbalueshme. Marrim, për shembull, piskatoret. Na keni kërkuar 70 000 piskatore për një vit! Ky është kulmi! E zbrazët tregun jugosllav!

- Mund të ketë edhe kërkesa të padrejta! - iu drejtova jugosllavëve, - por për veglën në fjalë s'mund t'ju përgjigjem. Në ç'degë të ekonomisë përdoret?!

Papritur atmosfera e rëndë e takimit ra për një moment në qetësi. Përkthyesit nisën të flasin kokë më kokë me jugosllavët për t'u sqaruar për veglën në fjalë. Koçi Xoxe kishte mbështetur kokën mbi duar, kurse Zllatigi po bënte gjeste prej të marri: shkulte me majat e gishtave vetullat dhe diç donte të më tregonte. Më së fundi enigma u zgjidh:

- Fjala është, - nisi të më sqaronte përkthyesi, për një copë teneqe elastike, të kthyer më dysh që përdoret nga gratë për të hequr qimet e vetullave.* *(Në librin «Marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare» (1939-1948), botuar në Beograd në vitin 1949, edhe këtë fakt njerëzit e Titos s'kanë harruar la «vënë në dukje». Në faqen 205 (të botimit në gjuhën shqipe) ankohen se pala shqiptare «i tra dërgue Komisionit Federativ të Planit të RFPJ kërkesën për 70 000 pinceta për heqjen e qymave të ve tllave».)

Nuk ishte momenti për të qeshur, por për të bërtitur:

- Turp për ju që përmendni të tilla marrëzira! iu lëshova jugosllavëve. - Gratë e vajzat tona s'u dinë as emrin veglave që thoni ju e jo t'u shkojë ndër mend të heqin vetullat! Ato akoma s'kanë bukë të mjaftueshme, s'kanë rroba të vishen e këpucë të mbathin, kurse ju na ankoheni se ju paskemi zbratur tregun nga teneqeçkat e vetullaveX. Mbajini për vete, me përgjegjësinë time ju them té mos sillni në Shqipëri asnjë copë!

- Ju s'duhet të zemëroheni. Ne e sollëm si shembull të çrregullimeve që krijohen. Të tilla tra shumë, - vazhduan jugosllavët e nisën të numërojnë: treni kërkuar kaq tonë bojë këpuce, kaq mijë semenca këpucësh, kaq milionë (më duket rreth 7-8 milionë) maja penash (?!), kaq mijë kilogramë esenca pijesh etj., etj.

- E çuditshme! Tepër e çuditshme, - u thashi indinjuar e iu drejtova Pandi Kristos që rrinte më një cep si lepur i pëgërë: - Ju i keni kërkuar këto? Përse ju duhen?

- Shoku Komandant, ju treni të drejtë, por të drejtë kanë dhe shokët jugosllavë. Ato s'na duhen dhe aq neve, por, kur bëme kërkesa për ea motorë e ea pajisje të hekurudhës, shokët jugosllavë të planit

na i sugjer uan dhe këto se i kishin né treg me shumicë. Na thanë se «janë badihava, lirë fare, kërkujini né kuadrin e kredisë».

KY VEND KA ZOT

Nga fondi i prillit të vitit 1943 Komiteti Qarkor i Partisë per Gjirokastrën më lajmëroi se riga kufiri grek kishte hyrë në zonat tona të çliruara një grup ushtarakësh anglezë, të kryesuar riga njëfarë Bill Maklin, major, të pajisur me arme e me radio, që pretendonin se ishin mision ushtarak zyrtar, i dërguar pranë partizanëve shqiptarë riga Shtabi i Forcave Aleate të Mesdheut me qendër në Kajro. I porosita shokët e Partisë të Qarkorit të Gjirokastrës që anglezët e ardhur riga Greqia të bllokoheshin në Zagori dhe të pyeteshin me imtësi se cilët ishin, si quheshin (duke e vërtetuar me dokumente zyrtare identitetin e tyre), riga vinin, kush i udhëhiqte, cita ishte detyra e vërtetë që kishin etj.

- Ju, - i porosita shokët, - u beni një varg pyetjesh që ata të kuptojnë mire se të hysh në zonat partizane nuk është aq lehtë, se ato nuk janë han me dy porta, prandaj per të lëvizur në to duhet leje e veçantë riga Komanda e Përgjithshme Partizane. Të gjitha këto, u thashë shokëve, - t'i beni në atë mënyrë që anglezët të shikojnë qysh tash se te ne nuk do të lejohen të livadhisin si të duan. Silluni shumë kore ektë me ta dhe u jepni të hanë, në qoftë se nuk kanë me vete. Mos granoni të holla per ushqime, po të tentojnë t'ju japin.

Dhe shokët kështu bënë. Grupi i ushtarakëve britanikë, i bllokuar riga partizanët në një zone të Gjirokastrës, mbasi e pa se vendi kishte zot, u detyrua t'i drejtonte më 1 inaj 1943 autoritetit më të lartë të Luftës Nacionalçlirimtare në Shqipëri, Këshillit të Përgjithshëm, një letër të firmosur riga Bill Maklini, në të cilën, pasi thoshte se qe

dërguar riga Shtabi i Kajros me cilësinë e oficerit të lartë ndërlihdës per të vendosur lidhje me lëvizjen e rezistencës në Shqipëri, shkruante: «Kam dëshirë të madhe të tako hem me Këshillin tuaj sa më shpejt të jetë e mundur dhe të marr informata per t'ia transmetuar Kajros që prej a.ndeje t'ju dërgohen furnizime. Lëvizja juaj do të furni zohet me materiale riga Kajroja. Do të bisedoj çështje me rëndësi. Dëshira ime është të hyj në qendër të Shqipërisë». Siç dukej SOE-ja*, *(Drejtoria e veprimeve të posaçme që merrej me spiunaah në interes të Britanisë së Madhe.) me qendër në Kajro, e kishte gjetur

maskën per të hyrë në Shqipëri: Dërgimin e agjentëve të saj si përfaqësues të Shtabit të Forcave Aleate të Mesdheut, synimi i të cilëve ishte të hynin «në qendër të Shqipërisë», per t'u lidhur me agjentët e vet të vjetër, të zgjeronin radliët e tyre me të rinj, të merrnin informata prej tyre e t'u jepnin detyra të reja dhe, nën drejtimin e kontrollin e misioneve angleze, të organizohej në Shqipëri një lëvizje sipas interesave të politikës dhe të planeve strategjike të Britanisë së Madhe.

Në përgjigjen tonë i thoshim se ishim dakord të vinte pranë Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar një mision i tillë, por nuk mund ta prananim, aq më tepër në qendër të Shqipërisë, pa qenë i pajisur me dokumente të rregullta zyrtare riga Shtabi i Forcave Aleate të Mesdheut.

Anëtarët e misionit të Makliniit qëndruan atje derisa u pajisën riga Shtabi i tyre me dokumente përfaqësimi. Në qershor, shokët e Gjirokastrës, sipas porosisë sonë, i nisën per te ne në Labinot, të siguruar mire se mos u ngjante gjë rrugës. Erdhën të rraskapitur riga lodhja. I prita ditën e dytë të ardhjes. Maklini m'u paraqit si kryetar i misionit. Dukej djalë i ri, jo më shumë se 30 vjeç, i hollë jo i gjatë, por as i shkurtër, me një fytyrë shumë të rregullt, të rruar, të mprehtë e të flohtë. Ishte biond, me sy blu e të zgjuar, por që kishin pamjen e syve të një maceje të egër . Maklini, sic morëm vesh më vonë, ishte i «Scots Greys»* *(Organizatë agjenturore spiunazhi.) dhe qe stërvitur si agjent i regjur në luftërat koloniale në Palestinë e gjetkë.

E pyeta si kishte udhëtuar.

- Si partizan, - më tha, - por partizanët në Gjirokastër më vonuan shumë dhe më humbën një kohë të vlefshme. Shtabi ynë në Kajro është i shqetësuar.

- Ju jeni oficer dhe i njihni rregullat e kohës së luftës, - i thashë, - nuk është aq lehtë që një i panjohur të kalojë kufir in ku veprojnë forca ushtarake. Armiku kurdoherë bën përpjekje të futet, të informohet mbi gjendjen dhe të na sabotojë ose të na godasë në befasi, por ne, partizanët shqiptarë, nuk na zë gjumi. Ju e provuat vetë këtë me t'u futur në zonat tona. Natyrisht ju nuk ishit armiq, por, për sa kohë që nuk njiheshit, më parë duhej vërtetuar se cilët ishit. Ju nuk na lajmeruat se do të vinit, prandaj shokët tanë në Gjirokastrë bënë detyrën. Ju kërkojmë ndjesë për vonesën që ju shkaktuam. Qetësojeni Shtabin tuaj se jeni në duar të sigurta, në mes aleatëve tuaj, pranë Komandës së Përgjithshme Partizane. - Dhe me kaq kjo çështje u mbyll. Tashti duhej të më shpjegonte qëllimin e ardhjes: ç'kërkonte, ç'do të bënte etj.

E pyeta: - Cili është misioni juaj?

Në esencë majori Maklin (që më vonë u bë kolonel dhe pas luftës deputet i partisë konservatore), më tha:

- Ne jemi misioni i parë ushtarak anglez që dërgohemi pranë partizanëve shqiptarë. Qëllimi i qeverisë angleze, që na dërgon pranë jush, është t'i bëjmë të njohur asaj gjendjen e vendit, luftën e popullit tuaj kundër pushtuesit italian dhe, pasi të bëjmë këtë punë, t'i transmetojmë Shtabit tonë pikëpamjen tuaj për luftën dhe nevojat e kërkesat që do të më paraqitni për zhvillimin e kësaj lufte.

- Po ç'dini ju për luftën e popullit shqiptar kundër pushtuesve dhe kuislingëve në vendin tonë?

- Nuk dimë gjë fare, - tha ai duke buzëqeshur.

- Atëherë derisa nuk divi gjë, ju, për sa i përket Shqipërisë, paski ngelur në kohën e Çembërleut.

Sytë e Maklinut u egërsuan si të maces.

- E pra, - vazhdova unë, - që më 7 prill 1939, kur Çembërleu ishte në Week-end*, *(Pushim i fundit i javës.) për gjueti, e deri më sot, populli shqiptar po lufton pareshtur kundër fashistëve italianë, kuislingëve, tradhtarëve.

I foli me hollësi për luftën titanike të popullit tonë të vogël por trim. I tregova për heroizmat e popullit dhe të partizanëve, si dhe për barbarizmat, vrasjet, djegiet e kryera nga italianët dhe bashkëpunëtorët e tyre. I vura në dukje metodat e propagandës fashiste për të na përçarë, për të na demoralizuar, por që te ne nuk kanë pasur sukses, pse Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar dhe forcat partizane i kanë demaskuar duke i shkatërruar vazhdimisht planet e armiqve.

- Po ku i gjeni armët zoti Hoxha? - pyeti Maklini, - Rusia është larg dhe s'ju jep dot. Mos treni fabrikë këtu në male?

- Jo, s'kemi fabrika armësh në male, por i tremi në popull. Vërtet që satrapi Zog, 10 ditë pasi erdhi në fuqi më 1924, shpalli ligjin e çarmatimit të përgjithshëm, por, në fakt, ashtu si kurdoherë, shqiptarët i fshehën armët sepse kurrë dhe askush nuk i kishte çarmatosur ata. Kjo është një traditë që shqiptari e trashëguar brez pas brezi. Në lidhje me këtë, - vazhdova, - tregojnë se tra ndodhur një diçka interesante midis ish-ministrit tuaj të Jashtëm, Eduard Greit, dhe patriotit e luftëtarit tonë Isa Boletini. Ishte koha kur mbi qiellin shqiptar ishin grumbulluar përsëri re të zeza, kur Shqipëria ishte përfshirë në vorbullën e synimeve grabitqare të fqinjëve shovinistë dhe kur Konferenca e Ambasadorëve më 1913 padrejtësisht po linte jashtë kufijve të shtetit gjysmën e Shqipërisë, dhe cilën? Kosovën e vise të tjera, ku u la me gjak çdo pëllëmbë toke për t'u çliruar nga Turqia. Patriotët Ismail Qemali dhe Isa Boletini shkuan edhe në Londër për t'u takuar me Grein, në atë kohë kryetar i Konferencës së Ambasadorëve, për t'i shprehur atij protestën për padrejtësinë që po i bëhej vendit tonë, për t'i transmetuar betimin e pathyeshëm të shqiptarëve se do të luftonin deri në fund për bashkimin e të gjitha trojeve që u kishin lënë të parët. Para së të hynte në zyrën e sër Eduard Greit, i porositur nga rojat, Isa Boletini e la patllaken në gar dërobë. Pas bisedimeve, Greit, si më të qeshur, i tha Isait: «Më në fund, zoti Boletini, atë që s'e kanë bërë dot pashallarët turq, e bëmë ne, këtu në Londër». Isai e kuptoi se ai e kishte fjalën për çarmatosjen e tij, e shikoi drejt në sy ministrin tuaj dhe, duke qeshur edhe ky, iu përgjigj: «Jo besa, kurrë, as edhe në Londër» dhe nga gjiri nxori një nagant me fishek në gojë.

Ja, kjo traditë është një nga «fabrikat» e armëve tona, zoti major. «Fabrikat» e armëve tona, - vazhdova, janë edhe depot e italianëve në posta e në qytete, aksionet tona në rrugët nacionale dhe në fushat e betejave. Kur e nisëm luftën, nuk kishim armë të mjaftueshme, por populli këndon një

këngë: «Në mos keni armë, i gjeni, ia rrëmbeni atij geni». Dhe ne kështu bëmë e po bëjmë. Me luftë, me aksione, ua rrëmbejmë armët nga duart italianëve, i sulmojmë dhe ua marrim.

DREDHITË ANGLEZE

Anglezët, kur u haste shar ra në gozhdë, e linin rrugën e drejtpërdrejtë dhe bënë zanatin, mundoheshin me dredhi të përçanin e të mashtronin njerëzit tanë.

Maklini dhe shokët e tij përpiqeshin të tatonin terrenin, por nuk kolisnin asgjëkundi.

Një ditë tetori, tek po bisedonim me Babën, vjen një komandant batalioni me një qeskë të vogël në dorë që po e tundte.

- Ç'e ke atë, or babë? - e pyeti Myslimi.

- Sterlina të verdha, - u përgjigj ai.

- Ku i gjete? - e pyeta unë.

- Në një qoshe të çadrës sime. Binte shi, majori anglez, që kalonte andej, u fut që të mos qullej dhe, kur pushoi shiu, iku, po gjeta këto që i kishte lënë në çadër.

- Shiko, - i thashë, - merr përkthyesin dhe shko në banesën e tij, ia jep të hollat dhe i thuaj : «Herë tjetër zoti major mos «harroni» sterlina në çadrën e partizanëve, se mund t'ju ngjasin gjëra të papritura».

- Të poshtrit! - shfreu Baba. - Edhe një herë tjetër e kanë bërë këtë gjë.

- Po, - i thashë, - e mbaj mend.

Ishim në një fshat të Pezës. Ndërsa Myslimi, unë dhe disa shokë të tjerë ishim ulur rreth vatrës në odën e zjarrit të një pezaku të varfër, ia behu një partizan që mezi merrte frymë nga nxitimi:

- Oficeri anglez, Babë, që sapo u nis për në Greca ka lënë në vendin e çadrës së tij këtë qese, - iu drejtua ai Myslimit.

- Ç'ka brenda, or babë, pa ma jep ta shoh. Myslimi e mori qeskën, e hapi dhe derdhi mbi një postiqe të dhirtë disa lira sterlina.

Myslimi u vrenjt në fytyrë, u ngrit në këmbë dhe prerë i tha partizanit:

- Merri, babë, nisu shpejt, arrije atë qen dhe thuaji: -Mos i mbill paret rrugëve. S'i hamë ne këto. Shpirti i shqiptarit nuk blihet me pare».

- Ashtu është, o Babë, - i thashë. - Ta dijë mirë anglezi se verdhushkat nuk shkojnë te shqiptarët e vërtetë.

Nuk ishte hera e parë që Myslim Peza mbante qëndrim të tillë, të vendosur, të prerë e të zgjuar.

Një herë, majori anglez Seimor i dërgonte, nga fshati Grecë, një letër shokut Myslim Peza, të cilit i ankohej se nuk i jepte njeri informata, se nuk i dëgjonte njeri porosinë e tij, se nuk i trëgonin planet e goditjes së gjermanëve etj., dhe, dulce ia kërkuar këtij këto plane, me dhëlpëri i shkruan: «Unë ta kam adresuar ty këtë letër se ti je ushtarak sikurse unë dhe shpresoj se këtë pozitë të vështirë ti e kupton më shumë se të tjerët, që s'kanë atë eksperiencë në luftë dhe në të tjera». Gjete kishë ku të falej majori anglez! Dhe te kush? Te babë Myslimi, patrioti, trimi e luftëtari i shquar i popullit tonë. Myslimi i dha një përgjigje të tillë që dhelpëra e Intelixhens Servisit të mos guxonte të kthehej më në këtë rrugë.

Ngado që shkonin, sidomos kur bënë «aksione», prishnin ura apo rrugë, linin dhe hidhnin si pa të keq sende të ndryshme, paketa, kuti mishi e të tjera me etiketën Made in England me qëllim që të kuptonin pushtuesit se autorët ishin anglezë, t'i ndiqnin këta, pa u qederosur se bëheshin djegie e raprezalje kundër popullatës në zonat ku vepronin. Kulmi i «aksioneve» të tyre ishte bombardimi që bënë, nga mesi i tetorit 1943, avionët anglezë dhe ata amerikanë mbi «aerodromin e Tiranës». Siç na njoftuan shokët nga Tirana, ata kishin bombarduar një lagje të tërë të qytetit duke vrarë e dulce plagosur me qindra banorë dhe dulce shkaktuar dëme materiale të pallogaritshme. Menjëherë mbasi e morëm vesh këtë. i dërguam një protestë misionit ushtarak anglez, të cilën e përfundonim: «Njoftoni Kajron mbi këtë ngjarje që vërejtja jonë t'i bëhet e njohur atij që i takon, me qëllim që

këto akte të papëlqyera të rnos përsëriten më mbi popullsinë civile, por të përsëriten me një ashpërsi akoma edhe më të madhe kundër objekteve ushtarake armike». Né përgjigje të kësaj, misioni anglez i dërgoi mikut të tyre, Mustafa Gjinishit, një fletushkë né anglisht që ta përkthente, për t'u shumëfishuar e për t'u shpërndarë né Tiranë. Midis të tjerave, né të thuhej: «Pilotët tanë do të kenë gjithë kujdesin e mundshëm për të mos ju shkaktuar juve aksidente, por ju nga ana juaj duhet t'i ndihmoni ata dulce mos qëndruar afër objekteve ushtarake». Ç'logjikë!

Ja ç'kontribut jepnin «aksionet» e anglezëve né Shqipëri!

BUJARIA SHQIPTARE

U nisëm përsëri për rr ugë drejt Fushës Studës, në mes dëborës e të ftohtit. Kujtonim me ëndje natën e këndshme që kaluam në atë shtëpi të ngrohtë në Okshtun. Çaste si ato që kaluam asaj nate ishin të rralla për ne. Por ishim në luftë dhe për luftëtarët nuk tra çlodhje të gjatë. Pra, le ta shihte një herë anglezi se ç'forcë të madhe morale e fizike, ç'durim të hekurt kishin partizanët, le ta njihte mirë nga afër forcën e komunistëve që u kishin bërë e po u bënin ballë me vetëmohim edhe italianëve, edhe gjermanëve, edhe të ftohtit, edhe urisë.

Kapërcyem rrugën Librazhd-Dibër në Fushë Studë dhe morëm përpjetë malin e Letmit. Na zuri nata në pyjet e malit të Letmit, ku fjetëm të mbështetur njëri pas tjetrit. Anglezët dhe ne kishim nga një çadër. Ata hanin çokollata e biskota, kurse ne kulaç të misërt e pak djathë dhe nga një qepë të thatë, por edhe këto ushqime që kishim po na mbaroheshin. Ata pinin uiski për t'u nxehur, ne shkrinim dëborën dhe pinim ujë për të shuar etjen. Të nesërmen lëv izëm drejt Qarrishtës. Prapë rrugë e prapë borë e murlan.

Shpesh, gjatë rrugës, i jepja kurajë gjeneralit, i cili ishte skuqur dhe hera-herës nxirrte një pagur të vogël e pinte uiski. Asnjëherë s'i bëri zemra të thoshte: «Kthejeni dhe ju një gllënjë për t'u nxehur, zoti Hoxha!». Herë pas bere ai dhe koloneli i tij përtyreshin, hanin ndonjë çokollatë. Për të L;ërë shaka, i thashë:

- Gjeneral, mos i hani menjëherë të gjitha, se nuk dihet rruga e partizanëve, ajo mund të jetë e gjatë. Shikonani ne që nuk hamë kur ecim. - Në fakt ne s'kishim ç'të hanim.

Kur mbërritëm në pyjet e Qarrishtës, pararoja na lajmër oi se nuk mund të vazhdonim më tej, nga Çermenika e Vogël për në Mokër ose në Bërzeshtë, pasi reaksioni atje ishte në kulm. Çetat balliste të Aziz Biçakut e të tjerë ishin në këmbë dhe kishin zënë gjithë udhëkalimet, qafat e shtigjet. Duhej të ktheheshim medoemos përsëri drejt Okshtunit.

Lajmërova gjeneralin që kishte mbetur mbrapa, se nuk mund të kalohej për shkak të reaksionit të armatosur ballisto-gjerman e se duhej të ndërronim drejtim. Gjenerali anglez, s'ç dukej, e kishte humbur durimin e gjakftohtësinë dhe i kishte hyrë lepuri në bark. Ai më dër goi ordinancën e tij, i cili më tha se gjenerali dëshironte ta prisja se donte të bisedonte me mua.

- E pres, le të urdhërojë, - i thashë.

Ndaluam dhe ngritëm çadrën. Erdhi dhe gjenerali me gjithë Frederikun.

- Po vde - rga frika dhe është me inat, - më tha Frederiku.

- I japim uth zll të pijë, - i thashë.

Sa erdhi, i shpjegova qetësisht se nuk mund të çanim dot nga ky drejtim.

- Do të kthehemi përsëri nga erdhëm e do të dalim nga drejtime të tjera, - i shpjegova. - Do të marrim masa, do të lajmërojmë edhe Baba Fajën.

- Po humbas durimin, zoti Hoxha, - tha gjenerali i skuqur.

- Duket se i tre har ruar këshillat që Kiplingu i jep djalit të vet kur i thotë në një nga vjershat e tij: «Do të bëhesh burrë, djali im, të ruash gjakftohtësinë, të mos humbasësh durimin dhe toruan kur të gjithë rreth teje i kanë humbur këto». Pse e treni humbur durimin? - e pyeta.

- Kemi kaq ditë e kaq netë të errëta e me borë, që më kujtojnë netët nëpër malet e Skocisë, dhe po vijmë vërdallë nëpër pyje e male e nuk po çajmë dot.
- Luftë është kjo, zoti gjeneral, - vazhdova. - Rrugën nuk e kemi të shtruar me lule.
- Por unë dua të çaj, të dal, - nguli këmbë ai.
- Ku të shkoni? - i thashë. - Vetëm do të shkoni? Ç'ju shtyn të shkoni?

Gjenerali i zemëruar më tha:

- Unë, përveç eprorëve të mi, nuk i jap llogari njeriu se ç'do të bëj.

Me gjakftohtësi i thashë:

- Unë nuk dua të më jepni llogari, por ju duhet të dini se jemi aleatë, jeni dërguar pranë Shtabit tonë dhe ne tremi përgjegjësi për jetën tuaj. Ç'të na ngjasë duhet të na ngjasë sé toku, por unë ju siguroj se nuk do të na ngjasë gjë.
- Jo, - tha gjenerali kryeneg, - unë do të shkoj në Korçë pa ju.
- Ju mund të doni, por nuk ju lejoj unë, - i thashë.
- Pse, rob juaj jam unë? - ngriti zërin gjenerali.
- Jo, rob ynë nuk jeni, por jeni aiati dhe miku ynë e nuk mund të lejojmë t'ju vrasin gjermanët.
- Derisa nuk jam rob juaj dhe jam përfaqësues i Britanisë sé Madhe, unë do të shkoj edhe pa lejen tuaj, ma ktheu gjenerali.

- Me gjakftohtësi, zoti gjeneral, - i thashë atij përsëri. - Né qoftë se ju e shtroni gështjen kështu, atëherë unë nuk ju ndaloj të shkoni, por vetëm me disa kushte: Ju duhet të më firmosni një dokument ku të thuhet se ju morët vetë përgjegjësinë dhe u larguat nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare kundër pëlqimit e dëshirës sime dhe Shtabit tonë. Unë jam i sigurt se ju shkoni drejt vdekjes ose robërisë, prandaj nuk mund t'ju jap me vete as Frederikun dhe asnjë partizan, se jam përgjegjës përpara popullit për bijtë e tij.

Gjenerali u shtang dhe, duke e parë pisk, shfryu si i marrë

- Zoti Hoxha, unë nuk lëshoj dokument të tillë. Siç shihet, puna juaj mori fund. Jeni të humbur. Gjermanët kanë bërë një ofensivë të madhe e të koordinuar dhe forcat tuaja janë shkatërruar. Tani s'ka mbetur tjetër veçse ne të ikim dhe ju të dorëzoheni. Por juve ju janë errur sytë dhe nuk shikoni asgjë. Ju e treni kot, ju e humbët luftën, ju jeni të rrethuar, dy rrugë ju mbeten: Ose të vriteni, ose të dorëzoheni.

Këtë herë mbaroi gjakftohtësia ime. U ngrita brof në këmbë (u ngrit edhe Frederiku) dhe i thashë:

- Dëgjoni, zoti gjeneral! Kjo që guxuat të thoni është kulmi i tradhtisë dhe i poshtërsisë suaj. Por ta dini se ne nuk do të dorëzohemi dhe as mos kujtoni se lufta jonë e humbi davanë. Ne ju tremi trajtuar si aleatë, por ju, siç duket, nuk doni të treni aleatë ata që luftojnë kundër fashizmit. Ne do të vazhdojmë luftën tonë deri në fitoren e plotë. Ju duhet të përgjigjeni për tradhtinë që i bëni luftës së popullit tonë. Ju po dezertoni nga lufta dhe ju e dini se çfarë i pret dezertorët në ushtri. Veç të tjerave, ata quhen tradhtarë. Puna juaj, pra, është dezertim nga lufta, është tradhti.

Kush e humbi luftën? Kush të dorëzohet, ne? Kurrën e kurrës! Ju, zoti gjeneral, jeni një disfatist, një kapitullant. Partizanët shqiptarë nuk kanë humbur dhe nuk do humbasin asnjë luftë. Italianët i dërrmuam dhe i gjunjëzuam pa ndihmën e kurrkujt. Gjermanët po ashtu i godasim pa pushim dhe do Vi dërrmojmë e do Vi gjunjëzojmë edhe ata po ashtu pa ndihmën e kurrkujt. Shqiptari Vi dorëzohet armikut? Kjo s'ka ngjarë dhe s'do të ngjasë kurrë. Të gjitha ofensivat e armikut i kemi thyer. Sulmet kundër nesh kanë përfunduar me humbje për armiqtë dhe me fitore për ne. Ç'kujtoni ju, zoti gjeneral, se partizanët dëshpërohe n pse rrinë nëpër pyje. E keni gabim. Tërë jeta jonë traqenë luftë pa pushim mbi armikun, ne sulmojmë qytete, rrugë, hedhim në erë ura e depo, vrasim ushtarët e pushtuesit dhe agjentët e tij. Ne jemi zotër të këtyre maleve, të këtyre pyjeve, por edhe të shtëpive brenda në qytete. Dhe ju na këshilloni të dorëzohemi se e paskemi «humbur luftën?!». Dorëzimi është veprim jo i denjë për një ushtri që nuk u dorëzua kurrë përpara gjermanëve. Zoti gjeneral, kjo është një fyerje që po na bëhet. Fyerjen nuk e mban në kurriz kurrë shqiptari. Më falni, por më duket se ju treni humbur logjikën.

Gjeneralit i ranë pendët. U ngrit në këmbë, i tha Frederikut të më thoshte se më kërkonte ndjesë dhe se nuk kishte pasur qëllim të na fyente dhe iku për te grupi i tij duke më përshëndetur me kokë. Edhe unë e përshëndeta prerë, ftohtë me kokë.

Mblodha shokët dhe u tregova ngjarjen. «Ja bëre paq», më thanë ata njëzëri.

U nisëm. Pas pak na ndoqi dhe gjenerali me suitën e tij.

Vazhdonte të binte borë e madhe. Ftohtë, acar. Muriani që frynte na i goditi fytyrat si me kamxhik. Ecnim e ndaleshim. Në mes të pyllit, nën strehën e një peme, bëmë një ndalesë më të gjatë. Koleka, siç e kishte zakon, ndau rriska-r ris-ka një kulaç dhe na dha secilit nga një rriskë e nga një qepë. Pasi i hëngrëm ato u nisëm. Bora binte dendur sa nuk po e gjenim dot rrugën për në Fushë Studë. U sollëm kot me orë të tëra nëpër pyll dhe, papritur, u gjendëm përsëri te vendi ku hëngrëm bukë, sepse pamë lëvoret e qepëve. «Udhëheqësi» ynë, që na kishte rrahur gjoksin se e njihte «pëllëmbë për pëllëmbë» terrenin, e humbi toruan por, siç e kishte zakon, mundohej të mos e jepte veten. Atëherë e morëm vetë situatën në dorë duke përdorur hartën e busullën. Pas shumë përpjekjesh të lodhshme, mezi u orientuam. Më në fund ramë në rrugën tonë, po bora vazhdonte të binte e të binte. Nata na zuri para se të zbritnim në Fushë Studë. Kishim më tepër se 10 orë që po ecnim. Pasi kapërcyem këtë, u ngjitëm malit përjetë. Ishte një udhëtim i rëndë e i vështirë. Ndalua.

Na kishte ngelur vetëm një kulaç misri për të gjithë dhe dy kuti qumështi «Nestle». Partizanët, me shumë mundim, ndezën një zjarr, i cili qe shpëtimtar për ne, vunë kusinë, shkrinë borë në të dhe hodhën qumështin. Kur po e përziemin, ia mbërriti ordianca e gjeneralit që qe mësuar të hante çokollata e biskota, por që tani s'i kishte mbetur asgjë, dhe thotë:

- Ju lutem, mund të më jepni një porcion për gjeneralin?

- Patjetër, - i tha një nga shokët dhe i mbushi një pagure me qumësht e dy thela të mira kulaç të misërt e ia dërgoi gjeneralit.

Natën e kaluam në mal. Kur zbardhi dita, larg përballë nesh, u duk Okshtuni. Atëherë e morëm vesh se ishim në malin e Okshtunit.

Në mëngjes gjenerali erdhi, i dhamë dorën njëri-tjetrit, unë i buzëqesha gjoja sikur e kisha harruar grindjen e djeshme. U nisëm për në Okshtun. Zbritjet dhe ngjitjet qenë të vështira. Bora kishte ngrirë kallkan. Murlani vazhdonte.

- Arritëm, zoti gjeneral, - i thosha, duke i dhënëkurajë. - Arritëm, durim edhe pak, mos e prishni humorin e mirë.

Në Okshtun ishin lajmëruar bazat tona e po na pritnin, bile duke parë se ne u vonuam, dërguan njerëzit e tyre, të cilët u takuan me pararojën tonë par tizane.

Në bazën ku do të qëndronim arritëm në mbrëmje. Te dera e banesës, në errësirën e natës e në borë, kishin dalë të zotët e saj. Na përqafulan, na futën brenda, hoqëm palltot e qullura, i dorëzuam pushkët të parit të shtëpisë, i cili i vari në mur njëren pas tjetrës. Në paradhomë ishte nxehtë. Na pushtoi një kënaqësi e madhe. Gjenerali shihte edhe i kënaqur, edhe me kureshtje se si përqafoheshim me njerëzit e shtëpisë, si dorëzonim pushkët, si hiqim çizmet dhe këpucët në fund të dhomës e përpiquej edhe ai të bënte si ne.

I zoti i shtëpisë hapi derën e odës së mirë, odës së zjarrit, dhe na ftoi:

- Urdhnoni, shpia teme asht jueja.

- Urdhëroni, hyni i pari, - i bëra nder gjeneralit. Dhe hymë në odë. Me të vërtetë ishte një mrekulli jo vetëm për gjeneralin anglez por edhe për ne që ishim djemtë e këtij vendi e të këtij populli. Pas një udhëtimi aq të lodhshëm në mes pyjeve, rrugë e pa rrugë, në borë e në tufan, futeshim në një dhomë fshati që e bëri anglezin të thoshte: «Ç'është kjo mrekulli, a mos vallë ëndërroj?».

I zoti i shtëpisë më pyeti nga ishte zotnia dhe ç'gjuhë fliste. Ia prezantova gjeneralin.

Në krye të dhomës në një oxhak të madh qe ndezur një zjarr bubulak që e kishte ngrohur dhe e ndriste anekënd dhomën. Dy-tri llamba me vajguri ishin ndezur për ndriçim, në krye të dhomës qenë shtruar postiqe të bardha si bora, jastëkë me këllëfë të pastër për t'u mbështetur. Në mes të dhomës një qilim i madh dibre, kurse mbi trarët e tavanit ishin rreshtuar si ushtarë vargje me kallinj misri të varur njëri pas tjetrit. Nuk shihje as trarë, as çati, vetëm kallinj misri që drita e zjarrit u jepte ngjyrën e ndritshme të floririt.

«Kjo është e mrekullueshme! Kjo është parajsë!» mermëriste gjenerali, - «as në ëndërr nuk mund ta imagjinoja një natë të tillë krishtlindjesh».

- Ja, të tilla janë vatrat dhe zemrat e shqiptarëve të thjeshtë, zoti gjeneral, - i thashë, - ato janë parajsë e vërtetë, - pa Djall e Zot si te «Parajsa e humbur» e Miltonit tuaj. Juve mund t'ju kujtohen vargjet e bukura e plot ndjenja të lord Bajronit. Në «Çajld Harold»-in e tij, ai vinte në dukje virtytet e pastra të shqiptarit e shkruante: E pritën në shtëpi me gjithë të mirat. Ndezën zjarr, u thanë rrobat. Dhe shtruan sof rën me atë që patën. Kësaj i thonë dashuri njerëzore.

- Po, zoti Hoxha, - tha gjenerali, - ato që Bajroni ka shkruar për ju shqiptarët, unë po i shoh në realitet, dhe në kohëra të vështira që po kalon bota.

- Zoti gjeneral, - i thashë, - ambienti kaq bujar i të zotit të shtëpisë më kujtoca leximet e mia mbi jetën e Bajronit. Në një ambient të tillë lëngonte në shtratin e vdekjes poeti i madh anglez që kishte vajtur në Greqi të luftonte për lirinë e popullit grek. Kur rreth e rrotull Mesollongjit luftonin arvanitasit e kapedanëve trima shqiptarë, Marko Boçarit, Kollokotronit e të tjerë*, *(Komandantë arvanitas, të shquar në luftën e popullit grek për pavarësi 1821-1827.) në dhomën ku dergjej poeti, i shërbenin dhe i bënin rojë shqiptarë, suljotë.

- Më prekën fjalët tuaja, zoti Hoxha, - u përgjigj gjenerali anglez.

- Në shkrimet e tij Bajroni ka pasqyruar edhe bujarinë e popullit tonë, - i thashë. - Diku ai tregon se kur ishte duke udhëtuar në Shqipëri e zuri nata në një fshat dhe qe detyruar të kthehej në një shtëpi, ku u prit me shumë përziemërsi. Të nesërmen, para se të largohej, Bajroni nxori paratë të paguante. I zoti i shtëpisë, i indinjuar i tha: «Jo, shqiptari s'do para, por miq». Dhe Bajroni mbeti me të vërtetë mik i shqiptarëve.

I zoti i shtëpisë na shtroi sofrën siç e kanë zakon dibranët. Gjenerali ngrihej në gjunjë, vinte dorën në zemër për të falënderuar sa herë që mikpritësi i jepte cigare, ose i çokte gotën. Lodhja na u zhduk përnjëherë. Anglezi hapte sytë me habi.

- S'po e marr vesh ku jemi këtu, në qytet apo në fshat? ! - tha ai.

- Jemi në një fshat, banorët e të cilit denbabaden kanë luftuar për lirinë. Këta janë të varfër, por, kur u vijnë miq e shokë, bëjnë ç'është e mundur të mos turpërohen. Kështu i ruan traditat e të parëve gjithë populli ynë, zoti gjeneral, - i thashë.

- Ç'kulturë e çuditshme kjo juaja, - tha gjenerali, - c'xhentesë!

Duke dëgjuar këto fjalë të gjeneralit, m'u kujtua një ngjarje tjetër që kishte ndodhur ato ditë të vështira, të cilën ma kishin treguar f'ill e për pe shokët. Në pyllin e Okshtunit, siç e kam përmendur, ne qemë të detyruar të kalonim natën. Rreth e përqark borë. Megjithëse në pyll, dru të thata s'gjendeshin. Mezi mundëm të ndiznin zjarrin duke grisur ndonjë copë nga këmishët tona. Pak më tej, ndezi një zjarr edhe grupi i gjeneralit. Po ç'kishte ndodhur? Pranë zjarrit të anglezëve ishte afruar të ngrohej edhe një nga udhërrëfyesit tanë. Koloneli Nikols, duke manifestuar botën e tij të ngushtë, s'e kishte pranuar dhe me fjalët më ofenduese e kishte sikterrisur.

Kështu, në atë natë dimri të ftohtë, në atë shtëpi dibrane, ne harruam për disa çaste vështirësitë e mëdha të luftës, dulce biseduar për letërsinë, për poezi e poetë, për mësimet e historisë.

VI

SHOKËT EMI PIONIERË

NJË NXËNËSI IM I VOGËL

Më kujtohet gjatë kohës së luftës në një pyll në malet e Mokrës, pas një udhëtimit të lodhshëm, një ish-nxënësi im i vogël* *(Shoku Enver ka punuar për një kohë para Çlirimit si profesor në Gjinnazin e Tiranës dhe në Liceun e Korçës. Mjaft nga nxënësit e tij morën pjesë aktive në Luftën Nacionalçlirimtare.) që kishte

braktisur shkollën dhe kishte rrokur armët, më thotë: «Shoku Enver, kur mësoja gjeografinë e Shqipërisë në shkollë sa e mërzitshme më dukej, por, po të dal i gjallë nga kjo luftë, sa me zell do ta mësoj dhe do t'ua mësoj dhe të tjerëve, pse një metamorfozë e çuditshme ka ngjarë tek unë. Ato që më dukeshin të thata në bankat e shkollës, për mua tash kanë marrë jetë. Njoh malet dhe fushat tona me pëllëmbë, lumenjtë e përrenjtë i kam kapërcyer dimër e verë, i ngarkuar rëndë me armët e partizanit dhe me detyrat e rënda që na ka ngarkuar populli; kam njohur fshatrat tona dhe kam luftuar për t'i mbrojtur; një pjesë e trupit tim digjej kur shihja të digjej kasollja e katundarit, ku gjeja një zemër vëllai e motre në kohët më kritike; tani njoh fare mirë katundarin tonë, të cilin e dua si vëlla, si shok, si shpirt, pse e pashë sa i mjeruar ishte, sa bujar me gjithë fukarallëkun e tij, sa i lartë, sa i guximshëm. Ai më dëgjoi me vërejtje në fillim për çka i thoja unë, djali i vogël i qytetit, që mbaja një distancë me të dhe e shikoja nga lart kur ai vinte në qytet, po kur më pa si luftoja, se përse luftoja, kur pa se shokët e mi po binin për një ideal që ishte i tij, ai më priti me krahë hapur, më pushtoi dhe të pandarë shkojmë në luftë për një të ardhme të lumtur. Kurrë nuk do t'i lëshoj armët derisa Via arrijmë këtë qëllim».

Këto më thoshte në pyllin e Mokrës një ish-nxënësi im i vogël, i cili më vonë ra duke luftuar me trimëri tek ura e Shëmbërdhenjtit, ra si hero për detyrën, që i kishte ngarkuar populli, ra dëshmor i idealeve të tij të larta.

5 maj 1945

RROFSHI TR GËZUAR TË GJITHË JU, TË GJITHË PIONIERËT E SHQIPËRISË !

*(Nga takimi
me një grup pionierësh të dalluar
më 4 korrik 1947)*

Unë dhe shokët e mi të Qeverisë jemi shumë të gëzuar që ju presim ju, pionierët që keni ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, t'ju shohim dhe të gëzohemi së bashku sonte. Sigurisht, ju jeni pak të lodhur nga rruga, por gëzimi që ndiejmë do t'ju heqë pak lodhjen dhe ju ftoj, gjithashtu, të rrini disa ditë këtu në Tiranë, të vizitoni dhe të shihni shumë gjëra që do t'ju kënaqin.

Unë jam shumë i gëzuar dhe për një gjë tjetër, që kam përpara pionierët më të mirë të Shqipërisë, ata q-3 kanë dalë të parët në shkollë. Unë ju them ju lumtë, se keni bërë detyrën si duhet, keni gëzuar prindërit edhe mua. Ne ju urojmë dhe ju këshillojmë që të punoni edhe më shumë që vitin tjetër të dilni edhe më të shkëlqyer, pse kjo është detyra juaj nga më kryesoret dhe se kështu do të bëheni edhe më të vlefshëm për atdheun.

Qeveria me gjithë organet lokale të pushtetit dhe prindërit tuaj do t'ju ndihmojnë dhe do të punojnë me gjithë forcat, që juve, dua të them gjithë pionierëve të Shqipërisë, të mos ju mungojë asgjë dhe jeta juaj të bëhet dita me ditë më e gëzuar. Shkollat vitin që vjen do të jenë më të shumta e më të bukura, fletoret dhe librat tuaj do të jenë më të bukur dhe me këto shkolla dhe me këta libra do të mësoni ju e mijëra e mijëra pionierë të tjerë. Në çdo vend të Shqipërisë, nxënësit sivjet kanë dalë mirë në mësim. Kjo na jep shpresa të mëdha për të ardhmen e vendit tonë; kështu do të përparojë Shqipëria; kjo është rruga jonë. Pushimet ju i treni merituar plotësisht, prandaj ju uroj t'i shkoni gëzuar. Një pjesë e pionierëve, nga ata që kanë mësuar më mirë, nga ata që prindërit e tyre janë vrarë për atdheun, do të shkojnë në kampet verore të pionierëve, të organizuara nga Qeveria, të tjerë do të shkojnë në kampet e organizuara nga organet lokale të pushtetit, kurse për ata që s'do të kenë fatin e mirë të venë dot në këto kampe, organet lokale të pushtetit dhe organizata e rinisë do të

organizojnë lodra dhe piknikë, që kështu të gjithë pionierët t'i shkojnë mirë pushimet. Ju e dini sa e madhe është dëshira jonë që të organizojmë kampe verore për të gjithë pionierët e Shqipërisë. Por ju e kuptoni. gjithashtu, se vendi ynë është ende i varfër. Ne punojmë që vendi të pasurohet dhe do Via arrijmë shpejt asaj dite që pionierëve të mos u mungojë asgjë.

Shumë nga ju vijnë për herë të parë në Tiranë. Ju keni parë në Tiranë shtëpi të mëdha, rrugë të gjera, por unë do t'ju këshilloj që vendet tona, malet, qytetet tona, Tiranën tonë, t'i shihni me një sy tjetër dhe t'i ndieni me zemër ato që shikoni. Për shembull, Tirana nuk është vetëm kryeqyteti ku rri Qeveria, por Tirana është diçka tjetër dhe sidomos pse 6 vjet më parë në qytetin e Tiranës, në kohët më të errëta të historisë së Shqipërisë, u formua Partia jonë, Partia heroike Komuniste e Shqipërisë. U formua Partia jonë, e cila na mësoi të luftojmë deri në vdekje për çlirimin e atdheut dhe të popullit. Partia organizoi kryengritjen e madhe, organizoi dhe udhëhoqi luftën. çliroi Shqipërinë dhe sot ndërton Shqipërinë e re. Partia e mësoi gjithë popullin si të luftonte me heroizëm për çlirimin e vendit, prandaj populli ynë dhe pionierët tanë Partinë e duan si shpirtin e tyre dhe e mbrojnë si sytë e ballit.

Në çdo rrugicë të Tiranës që do të shkoni, çdo mur dhe çdo penxhere që do të shihni, ato ishin kala dhe fusha lufte, ku njerëzit e Partisë luftonin fashistët dhe tradhtarët. Në rrugët e Tiranës dhe në gjithë Shqipërinë janë bërë nga populli ynë heroizma kaq të mëdhenj, që mendjet tuaja akoma të njoma nuk mund t'i imagjinojnë, por zemrat tuaja të pastra i ndiejnë thellësisht. Në kopshtet e Pallatit të Brigadave, ku ne jemi mbledhur sonte, janë treguar heroizma të pashoq nga partizanët tanë. Sigurisht, shumë nga ju që tram këtu pranë kanë humbur të dashurit e tyre në luftë. Shumë nga baballarët ose vëllezërit tuaj janë vrarë në këto kopshte, duke sulmuar me bomba përmbi tela fashistët gjermanë. Por ata luftuan dhe u vranë që Shqipëria të rrojë dhe ju, bijtë e bijat e tyre, dhe ne, shokët e tyre dhe gjithë Shqipëria mburremi me ta dhe i adhurojmë.

Shokët e rinisë duhet t'ju shpien të nderoni dhe t'i vini lule udhëheqësit tuaj të madh, Qemal Stafës. Armiku vetëm gjoksin i kishte parë Qemalit dhe ai me gjoks përpara sulmoi në ballë deri në kohën e vdekjes dhe koburen ai nuk e lëshoi nga dora, as kur trupi i tij i shenjtë, i copëtuat nga plumbat e fashistëve, u shtri pa shpirt në zallin e lumit jashtë Tiranës. Ai luftoi dhe u vra për popullin, për atdheun, për ju.

Shokët e rinisë duhet t'ju çojnë të shihni dhe shtëpinë ku tra luftuar Vojo Kushi. Trim ishte Vojo Kushi, trim i madh dhe rrallë lindin të tillë burra. Vetëm tre ishin ata dhe nga këta vetëm Vojo Kushi ishte i shëndoshë. Shoku i tij Sadik Stavaleci ishte tuberkuloz. Xhoxhi Martini e kishte trupin me plagë, por që të tre zemrat i kishin si çelik. Këta heronj luftuan 6 orë kundër qindra armiqve, kundër tankeve dhe mitralozave. A e dini se ç'bëri Vojava, kur iu mbaruan fishekët dhe bombat? Ai me gjoks përpara sulmoi mbi tankun. Ai luftoi dhe u vra për popullin, për atdheun, për ju.

Në çdo rrugë të Tiranës që do të shkoni, ju do të shihni veprat e atyre që organizuan luftën kundër fashizmit, ju do të shihni dhe të ndiqni gjurmët e trimit punëtor Misto Mames, e trimit punëtor Vasil Shantos, e trimit punëtor Mihal Durit, të Heroit të Popullit Kajo Karafilit e qindra e qindra të tjerëve dhe emrat e tyre t'i huani shtrenjtë në mendjet tuaja dhe kujtimin e paharruar të tyre në zemrat tuaja te pastra. pse këta njerez kaq tt' medhenj, vetëm në zemi a të pastra e kanë vendin. Shoket e rinisë t'ju çojne të shihni jashtë dhe brenda qytetit të Tiranës dhe t'ju tregojnë vendet ku partizanët heroikë të Divizionit I sulmonin ditë e natë gjermanët dhe ku në këto sulme merrnin pjesë edhe pionierët.

Por pse valle partizanët ishin kaq trima? Mund t'ju them: Se ashtu i mësoi Partia. e cila u tha: «Të luftoni deri në vdekje për lirinë e Shqipërisë. për lirinë e popullit dhe për demokracinë e vërtetë». Dhe pse këto që u tha Partia ishin dëshirat e popullit, partizanët e kryen deri në fund detyrën e tyre. Po pse partizantë luftonin dhe vriteshin me kënge në gojë. jo sikur shkonin drejt vdekjes, por sikur venin në dasmë? Ata luftonin dulce kënduar, pse ata ishin te bindur se me luftën e tyre dhe me sakrificat e tyre do t'ju siguronin juve një jetë të gëzuar. Dhe ata jua siguruan. Ata e kryen detyrën e tyre. Tani ria mbetet neve. gjithë popullit shqiptar. që riga unë e deri te ju të vegjlit ta vazhdojmë veprën e madhe. Dëshmorët tanë ria porositën: «Ta dori me gjithë shpirt atdheun. ta mbron

atdheun, ta ndërtoni atdheun, pa marrë parasysh as edhe sakrificën e fundit». Ashtu sikundër heronjte tanë dhanë çdo gjë për Shqipërinë dhe për popullin, ashtu duhet të bëjmë edhe ne.

Ky është amaneti i tyre dhe këtë ne do ta plotësojmë. Sakrificat e dëshmorëve tanë duhet të jenë shembull për ne dhe me këtë shembull e me kujtimin e heronjve të luftës sonë në zemër ne të ecim përpara dhe ju të mësoni ditë më ditë se mësoni sa më shumë.

Një ditë Qemal Stafa më pati thënë: «A do të jetë vallë larg ajo dite kur ne t'i shohim pionierët tanë të gëzuar. të kënaqur shkollat e tyre. vendet e defrimeve, t'i shohim të rriten të shëndoshë dhe të zhduket riga zemra e tyre trishtimi?». Kjo dite është këtu. këtu jetë të gezuar për ju po e ndërtojme. Mjerisht, shoku ynë i dashur Qemal Stafa, nuk e pa, por ai u vra shumë luftuar me bindjen e plotë se kjo ditë do të arrihej, pse ashtu kishte vendosur Partia.

Në Tiranë do të shihni ditë më ditë gjëra të tjera të bukura: teatro. kinema. do të shihni si janë organizuar shkollat: shkoni vizitoni fabrikat. ku puntorët. vëllezërit tua punojnë me hëvesh ditë e natë. shkoni shihni hekurudhën e rinisë. vendlindjen, vëllezërit tuaj më të mëdhenj. Pas ditësh do të shihni manifestimin e shokëve tuaj pionierë të Tiranës. Por ju do të shihni dhe një tjetër, ju jeni mysafirët e mi deri në 10 korrik dhe atë ditë ju do të shihni një riga veprat më të shkëlqyera të Partisë sonë dhe të popullit shqiptar, do të shihni ushtrinë tonë heroike që do të parakalojë në Tiranë (*Pionierët brohorasin: «Rroftë Ushtria jonë!»*...). Ju, të dashur të vegjel. keni plotësisht të drejtë që thërritni: «Rroftë Ushtria jonë Popullore!». Ushtria është ajo që mbron të drejtat e popullit tonë. ajo që mbron atdheun riga çdo rrezik, ajo që mbron jetën tuaj të gëzuar. prandaj lëni plotësisht të drejtë dhe duhet ta doni me gjithë shpirt atë.

Sonte do të shohim të luajnë pionierët e Tiranës; ata kanë përgatitur një shfaqje të bukur. Ju lumtë pionierëve të Tiranës! Por unë jam i bindur se edhe ju të qyteteve të tjera s'mbeteni aspak pas këtyre. Sa keq më vjen që s'ju kam parë ju të luani, pse unë s'kam ardhur në qytetet tuaja, por ja ku jua jap fjalën se unë për së shpejti do të vij në të gjitha qytetet dhe do të shoh se kush i bën shfaqjet më të mira. Mos t'ju mbetet hatëri që sonte lavdërova ata të Tiranës, lavdërimet janë për sonte. pse duhet t'i inkurajojmë ata që të luajnë më mirë. por mendimin e prere për këtë gjë do ta them kur t'ju shoh dhe ju.

Kur të shkoni në shtëpitë tuaja. u thoni prindërve tuaj dhe gjithë shokëve tuaj pionierë shumë e shumë të fala riga une.

Rrofshi te gezuat të gjithë ju. te gjithë pionierët e Shqipërisë. i gjithë brezi i ri i vendit tanë!

Rroftë populli shqiptar!

TRASHËGIMTARË TË DENJË TË TRADITAVE HEROIKE TË TË PARËVE TANË

(Letër drejtuar pionierëve të qytetit të Krujës)

Të dashur pionierë të qytetit të Krujës,

Ju falënderoj nga zemra për urimet që më dërguat me rastin e ditëlindjes sime dhe ju uroj të gjithëve shëndet të mirë, jetë të gëzuar dhe suksese në mësimet që të bëheni bij të denjë të atdheut tonë të dashur.

Ju, pionierët e qytetit heroik, ku Skënderbeu ynë i lavdishëm ka zhvilluar betejat legjendare dhe fitimtare kundër hordhive turke, të bëheni trashëgimtarë të denjë të traditave heroike të të parëve tanë. Sikundër i gjithë brezi i ri i vendit tonë që edukohet nga Partia jonë e dashur dhe nga organizata e Bashkimit të Rinisë së Punës, duhet të bëheni shembull në përvetësimin e mësimet, në sjellje, në familje, në shkollë e kudo, të nderoni e të dëgjoni me kujdes këshillat e prindërve e të mësuesve tuaj, të kryeni plotësisht detyrat që ju ngarkon organizata juaj e pionierëve. që të bëheni kështu patriotë të mirë, ndërtesues aktivë të shoqërisë socialiste dhe mbrojtës të flaktë të fitoreve historike të popullit tonë.

Juaji
ENVER HOXHA

20 tetor 1956

**MBAJENI LART
EMRIN E HEROIT
TË SHKOLLËS SUAJ**

*(Letër drejtuar
pionierëve të çetës së shkollës 7-vjeçare
«Naim Gjylbegu»)*

SHËNPAL-RRËSHEN

Të dashur shokë pionierë,

Ju falënderoj me gjithë zemër për urimet që më dërguat me rastin e ditëlindjes sime.

Jam shumë i gëzuar që me këtë rast t'ju uroj edhe juve shëndet, lumturi dhe suksese në mësim, për t'u bërë të vlefshëm për atdheun dhe Partinë tonë të dashur.

Shkolla juaj mban emrin e njërit prej heronjve të Vigut, Naim Gjylbegut, i cili, së bashku me shokët e tij, dha jetën duke luftuar kundër okupatorit nazist dhe tradhtarëve të vendit, për Shqipërinë e lirë dhe socialiste. Mbajeni lart emrin e këtij heroi, mësoni dhe gjithnjë mësoni, dëgjoni me kujdes dhe zbatoni këshillat e prindërve, të mësuesve dhe të edukatorëve tuaj, për t'u bërë të vlefshëm për veten, prindërit, atdheun dhe Partinë tonë të dashur, e cila ka punuar dhe punon për të ardhmen më të lumtur të brezit tuaj të ri.

Edhe njëherë ju uroj me gjithë zemër shëndet, lumturi dhe suksese kurdoherë më të mira në punët shkollore, për t'u bërë bij të denjë të atdheut tonë të bukur socialist dhe të Partisë sonë të dashur!

*Juaji
ENVER HOXHA*

Tiranë, 19 tetor 1957

PRANË KAZMËS DHE PUSHKËS TË MBAJMË KURDOHERË EDHE LIBRIN*

*(Përsëritja që shoku Enver Hoxha i drejtoi më 3 qershor 1963 Konferencës së Parë Kombëtare për përhapjen e leximit të librit.)

Të dashur miq të librit,

Jam edhe unë një mik i librit, prandaj më lejoni t'ju përsërit nga zemra e t'ju përgëzoj për iniciativën që keni marrë e jeni mbledhur për të diskutuar se si të organizohet më mirë puna për botimin, përhapjen e për leximin e librit!

Libri është një nga thesaret më të çmuara për njeriun. Ai është mësuesi, edukuesi, këshilluesi dhe frymëzuesi i tij. Në librat pasqyrohet zhvillimi i shumanshëm i botës ashtu siç ishte, siç është dhe siç do të jetë. Libri është prej letre të lehtë, por ka të tillë peshë dhe forcë sa ta fisnikërojë e ta ngrejë njeriun në majat më të larta të diturisë e të shkencës, sa t'i zbulojë çdo sekret të universit dhe të jetës, sa ta bëjë atë zot të forcës bërthamore dhe të kozmosit.

Që kur u shpik shkrimi e filluan të shkruhen librat në gur, në pergamen e në letër, bashkë me përparimin e shoqërisë nga një fazë në tjetrën, ka përparuar edhe libri. Ai nuk mbeti si i ngurosur brenda mureve të piramidave e të tempujve, as në raftet e nxira të kishave mesjetare, as si një unazë e rrallë xhevahiri në dorën e aristokratit, por si një «rebel» i vërtetë çau rrugën për te masat dhe u ngrit në lartësi të pashoqe. Librat kanë pasur dhe kanë partizanë të tyre të flaktë, që i kanë shkruar

ata ose i kanë mbrojtur nga obskurantizmi mesjetar, nga barbaria fashiste, e sot akoma nga dekadentizmi borgjez kapitalist, me zjarrin e zemrave të tyre fisnike, me vullnetin e hekurt e mendjet e tyre të ndritura. Në vendin tonë bashkë me masat punonjëse fituan lirinë e plotë e të vërtetë edhe libri e dituria: ata fituan të drejtën të futen kudo, gjer ne kasollen më të humbur, ku gjetën miq, mbrojtës, propagandistë të flaktë e të panumërt.

Libri sot, veçanërisht në kushtet e shoqërisë socialiste, është një armë e fuqishme njohjeje, pune, lufte, që i armatos njerëzit me eksperiencën shekullore të jetës e të luftës së mbarë njerëzimit, me trashëgimin më të mirë të diturisë botërore dhe i ndihmon të transformojnë natyrën dhe shoqërinë, ta bëjnë jetën më të lehtë dhe më të bukur.

Në libra njerëzit shprehin ditur itë e tyre, ndjenjat e tyre më të mira, nëpërmjet librave njerëzit njohin mendimet, vuajtjet, aspiratat e njëri-tjetrit, prandaj libri është një trumbetar që ndihmon në zgjimin e në çlirimin e popujve, një fener që u ndrit mendjen e rrugën, që u kalit ndërgegjen, që i shërben miqësimin të tyre, paqes e progresit shoqëror. Prandaj libri është një nga shpikjet dhe thesaret më të mrekullueshme të njeriut.

Në botë janë botuar dire botohen aq shumë libra, sa nuk besoj të arrijë t'i regjistrojë edhe shërbimi më i përsosur statistikor e janë aq sa nuk mjaftojnë shumë jetë të njeriut për t'i lexuar. Dihet se shumë nga ata që janë botuar e që botohen janë jo për të ndriçuar mendjet e njerëzve, por për t'i helmuar e për t'i shushatur ato. Veçse librat e artë, nuk i shlyejnë as stuhitë e rrebeshet e shekujve, kurse të këqijtë i merr rrëkeja.

Libri është e duhet të ietë për njeriun shok besnik e i pandarë, shok pune, bashkëpunëtor, shok që të mëson, që të udhëheq në jetë, është shok e mik që të çlodh, që të bën ta kalosh kohën e lirë në mënyrë të këndshme e të frytshme. Këto funksione të librave janë të dobishme dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Prandaj ato duhen kombinuar në jetë. Por gjithë kjo varet nga lloji i librit dhe qëllimi që njeriu i vë vetes para leximit të tij.

Që libri të jetë sa më i dobishëm, ai duhet trajtuar me seriozitetin më të madh: librat duhen lexuar me sy kritik, duhen studiuar, duhen nxjerë në mësim prej tyre. Ndryshe truri i lexuesit do t'i përngjante një magazine pa inventar, ku do të depozitoheshin së bashku mallra të vlefshme e plehra, gjë që, natyr isht, do ta bënte atë jo vetëm 'të padobishëm, por edhe një vatër me lloj-lloj sëmundjesh.

Partia jonë gjithmonë e ka vlerësuar lart librin, si ndihmës dhe armë të fuqishme revolucionare, armë në luftë dhe në punë. Dje, në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare, ajo i këshillonte partizanët që pranë pushkës të mbanin edhe librin. Atëherë gërmat e abetares, fjala e shkruar në libra, gjenialiteti shekullor i mendimit njerëzor, mësimet jetëdhënëse të Marksit, Engelsit, Leninit e të Stalinit, mësimet e Partisë u shndërruan në ,forcë kolosale, që e bënë edhe pushkën të gjëmojë më fort, që i bënë partizanët të pathyeshëm. Pastaj më vonë, njerëzit tanë, duke ndjekur përsëri këshillat e Partisë, s'i ndanë abetaret dhe libra të tjerë as kur ndërtnuan urat, rrugët, hekurudhat, fabrikat e hidrocentralet e para.

Sot Partia porosit që pranë kazmës dhe pushkës, pranë makinës dhe traktorit të mbajmë kurdoherë edhe librin, këtë armë të pazëvendësueshme për ndërtimin e socializmit. Me ndihmën e libra ve do të krijohet armata e pafund e qindra mijëra punonjësve tanë të ditur dhe të kalitur nga pikëpamja politike, ideologjike e profesionale, që do ta bëjnë gjithnjë e më të bukur e më të lumtur atdheun tonë dhe që do ta ngrenë lart e më lart lavdinë e Shqipërisë së re socialiste.

Të jesh mik i librit, ky është një titull nderi. Kam dëgjuar që këtë titull e marrin ata që lexojnë e kanë në bibliotekën e tyre një numër të caktuar librash. Kjo është një gjë e mirë. Por ndoshta do të jetë akoma më mirë në qoftë se mik i librit do të konsiderohet jo vetëm lexuesi i thjeshtë, ai që lexon për vete, por, në radhë të parë, ai që është njëkohësisht dhe aktivist, përhapës e propagandist i flaktë i librit.

Në shtyp kam lexuar se shpesh bëhen takime të shkrimtarëve me punonjës, ku poetët e prozatorët lexojnë pjesë nga krijimtaria e tyre, dëgjojnë vërejtjet dhe sugjerimet e masave. Kjo është një iniciativë shumë e mirë, që duhet vazhduar dhe duhet zgjeruar. Por nga ana tjetër, ndoshta nuk jam informuar sa duhet, më duket sikur nuk bëhet një punë e tillë edhe nga specialistët e çdo dege. Dhe

këtu e kam fjalën jo vetëm, për shembull, për historianët e mësuesit e historisë, gjeografisë, gjuhës, që mund të bëjnë dhe duhet të bëjnë një punë kolosale për përhapjen e propagandimit e gjithë atyre librave aq të vlefshëm që janë botuar mbi luftën e jetën e popullit tonë, por edhe për inxhinierët, agronomët, mjekët, ekonomistët, fizikanët e të tjerë, që të shkruajnë e të lexojnë në masa për ato që bëhen e na duhen sot.

Natyrisht literatura artistike i tërheq më shumë masat e gjera. Por kjo nuk do të thotë se tek ato nuk mund të ngjallet po aq interesimi dhe për librat tekniko-shkencorë, ose librat që, përgjithësisht, japin njohuri mbi jetën e vendit e botën, mbi të fshehtat e natyrës, mbi jetën e zakonit e popujve, mbi eksperiencën e tyre shekullore. Libra të tillë për masat, veçanërisht për rininë ka pak, ose shpeshherë janë të thatë e të papërshtatshëm. Specialistët, me të tilla botime, natyrisht, s'mund të kenë suksesin e shkrimtarëve me lexuesit e tyre. Prandaj më duket se entet botuese, në bashkëpunim të ngushtë me institutet e larta dhe me specialistët e ndryshëm, duhet ta gjejnë, ta zgjedhin, ta përpunojnë, ta botojnë e ta përhapin më shumë këtë lloj literature. Të botohen më shumë dhe më me kujdes libra për fëmijët e moshave të ndryshme dhe për të rinjtë, libra artistikë ose tekniko-shkencorë popullorë që të nxitin fantazinë, të ndezin guximin, të kalitin si çeliku mendjen e shpirtin e brezit tonë të ri.

Më lart theksova se lexuesi duhet të qëndrojë seriozisht përpara librit, por këtë çështje dua ta theksoj akoma më me forcë përpara atyre që shkruajnë librat, që i përkthejnë e që i shtypin. Shkrimtarët, përkthyesit dhe tipografët duhet të kenë parasysh vazhdimisht, orë e gast, se puna e tyre e nuk është një punë si të thuash tregue, aja është, në radhë të parë, një punë fisnike edukuese. Veçanërisht botimi i librave nga gjuhët e huaja duhet të bëhet objekt i një studimi të vazhdueshëm, jo vetëm për sa i përket zgjedhjes së veprave, por edhe cilësisë së përkthimit. Shumë përkthime masakrohen me tërë kuptimin e fjalës. Nuk duhet lejuar më, që disa përkthyes ta shikojnë këtë çështje vetëm në rrugën e përfitimit të tyre personal. Të tillë përkthyes s'kanë respekt as për autorin, as për lexuesin. Tipografitë tona po bëjnë një punë të madhe e të lavdërueshme, por do të dëshiroja të theksoj për to, se një kujdes akoma më i madh në të gjithë procesin e punës së tyre, do të lehtësojë leximin nga kushdo, do të ngjallë një dashuri e respekt më të madh për një libër, të shtypur pastër, bukur dhe të lidhur mirë.

Duke ju uruar punë të mbarë dhe suksese të mëtejshme, më lejoni që, në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe timin personal, të shpreh bindjen se edhe në të ardhmen ju do të vini të gjitha fuqitë tuaja shpirtërore e mendore që të përhapet sa më gjere libri në masat, të lexohet sa më shumë nga punëtorët dhe fshatarët, burra dhe gra, të rinj, të reja e fëmijë, si nga ata që dinë pak, ashtu dhe nga ata që dinë më shumë.

Le të bëhet libri mik i ngushtë e shok i pandarë, bashkudhëtar i përjetshëm i çdo njeriu. Mbani mend gjithmonë fjalët e arta të Leninit të madh se, pa ditur të përdorësh librin, nuk mund të ndërtoësh socializmin, pa libra s'ka dijeni, pa dijeni s'ka komunizëm.

Le të ndihmojë mbledhja juaj që nga lëvizja e thjeshtë e sotme e miqve të librit, të shpërthejë një lëvizje e fuqishme për propagandimin e leximin në masë të librit, që drita e tij të përhapet në të gjitha skajet e atdheut dhe që ai t'i mësojë njerëzit tanë të punojnë e të rrojnë më -mirë, të ndërtojnë si duhet jetën e lumtur socialiste, të mbrojnë dhe të çojnë më tej frytet e shkëlqyera të revolucionit tonë fitimtar!

GURSKALITËSIT E VEGJËL

(Letër pionierëve të qytetit të Beratit)

Të dashur pionierë,

U gëzova pa masë sot kur mora vesh se ju, të dashur djem dhe vajza të shkollavP 8-vjeçare të qytetit, u organizuat, u armatosët me çekiçë e me dalta dhe, nën drejtimin e mësuesve e gurgdhendësve pensionistë, filluat të ndërtoni në kohën tuaj të lirë kalldrëmet e qytetit*. *(Në vitin 1967 pionierët e Beratit morën nismën për të shtruar me gurë rrugët e qytetit të tyre muze. Shoku Enver me këtë rast u dërgon në 27 janar 1967 këtë letër përgëzuese.)

Ju lumtë! Ju mësoheni që të vegjëll të ecni në rrugën e muratorëve e gurgdhendësve të lavdishëm të vendit tonë, që shekuj me radhë e deri më sot kanë ushtruar një nga mjeshtëritë, një nga artet më të mrekullueshme të njerëzimit. Veprat e këtyre baballarëve, gjyshërve e stërgjyshërve tanë janë të pavdekshme, ne i shohim ato kudo në vendin tonë dhe i admirojmë, sidomos në qytetin tuaj muze. Ju e filloni me gurët e kalldrëmeve dhe me këtë do t'ju ngjallet një dashuri e madhe për gurin, me të cilin do të bëni vepra të mëdha e të mrekullueshme për vendin. Në gur, si gjatë historisë së njerëzimit, ju do të fiksoni përjetë veprën madhështore të Partisë dhe të popullit tonë.

Unë i kam dashur, i dua dhe i respektoj shumë muratorët dhe punonjësit e gurit, prandaj vij sot te ju, të dashur të vegjël dhe vogëlushe, t'ju përqafoj dhe t'ju puth me dashuri që morët këtë iniciativë kaq të mirë. Ju siguroj se, kur të vij në Berat, gjëja e parë që do të bëj, është të piqem me ju dhe të shoh punën tuaj.

*Ju puth me mall të gjithë
ENVER HOXHA*

**BREZI YNË I RI
EDUKOHET E PUNON
NË MËNYRË REVOLUCIONARE**

*(Nga biseda me një grup të rinjsh,
pionierësh e fatosash të Tiranës
më 16 tetor 1968 j*

Kur shoku Enver hyn në sallën e pritjes të Komitetit Qendror të Partisë, të rinjtë, pionierët dhe fatosat shpërthejnë në duartrokitje dhe në brohoritje të vazhdueshme për Partinë dhe për shokun Enver. Shoku Enver përshëndetet me ta ngrohtësisht, shuntë nga ata i përqafoi e i puth. Pasi zënë vendet, disa nga fatosat i drejtohen xhaxhit Enver me vjersha kushtuar 60-vjetorit të lindjes së tij, me vjersha për Partinë etj. Në fundin e tij shoku Enver Hoxha tha:

Në emër të shokëve të mi të Partisë dhe në emrin tim ju falënderoj të gjithë nga zemra e nxehtësisht, ju përfaqësues të rinisë, të pionierëve dhe të fatosave të Tiranës, për këtë dashuri të zjarrtë, që ju, brezi i ri i Shqipërisë, keni për mëmën tonë të dashur, Partinë ! Sa forcë të madhe, sa shpresa të mëdha, ç'siguri në të ardhmen ndien populli, kur shikon të rinjtë dhe të rejtat, pionierët e fatosat tanë, që e kanë në zemër, e duan dhe e mbrojnë me zjarr Partinë, që mësojnë e kaliten në rrugën e saj! Ky është një gëzim i papërshkrueshëm për popullin, sepse populli te Partia gjeti shpëtimin. Pa Partinë populli do të vuante në robëri të shumëllojta, kurse Partia e çliroi atë përgjithmonë dhe i hapi rrugë të ndritura. Është për këtë që jeta e popullit tonë është pleksur në mënyrë të pazgjidhshme me Partinë e tij të lavdishme dhe çdo gjë të tij, çdo mendim të tij, ndjenjat e tij më të pastra e të sinqerta, ai ia drejton Partisë, ato janë të lidhura ngushtë me Partinë. Kur populli shikon djemtë dhe vajzat e tij që e duan me kaq zjarr Partinë, kjo e ndien veten jo sikur ka dy krahë si shqiponja, por sikur ka dhjetë palë krahë.

Partia për ju të rinjtë dhe të rejtat tregon kujdesin më të madh. Qëllimi i saj më i lartë është që ju të rriteni, të edukoheni e të punoni si revolucionarë, sepse vetëm me një kuptim e qëndrim të tillë në shoqërinë tonë të re, jeta bëhet më e bukur. Prandaj Partia ka vënë të gjitha forcat dhe interesohet që rinia jonë të edukohet e të punojë në mënyrë revolucionare.

Më përpara thuhej se në shkollë vetëm mësohet, kurse tani Partia thotë që njerëzit në shkolla duhet edhe të mësojnë, edhe të punojnë e të stërviten. Dhe kur të rejtat e të rinjtë të dalin në jetë edhe të punojnë, edhe të mësojnë, demethënë të mësojnë në shkollë dhe jashtë saj. Prandaj krahas mësimet, në shkollë, brezi i ri do të fitojë shprehitë e punës, duke gërshetuar mirë punën mendore me punën fizike dhe këtë proces do ta vazhdojë edhe më pas, gjithë jetën. Derisa të ketë jetën, njeriu ynë, i brumosur me mësimet e Partisë, duhet të jetë kurdoherë zjarr e revolucionar, ta mbajë gjallë e të pashuar, vazhdimisht, pishtarin e revolucionit.

Të rinjtë e të rejtat tona kanë detyra jo vetëm ndaj atdheut, por, si komunistë internacionalistë e si revolucionarë, ata duhet të mendojnë kurdoherë edhe për çlirimin e popujve të tjerë të botës. Këtë të drejtë nuk e kanë vetëm rinia dhe popujt e mëdhenj të botës, këtë detyrë e të drejtë, e ka çdo njeri revolucionar, çdo marksist-leninist, i organizuar ose jo në parti, e ka çdo popull, i vogël ose i madh qoftë. Prandaj kur ne luftojmë, punojmë e realizojmë detyrat sipas r rugës marksiste-leniniste të Partisë, në çdo punë që na ngarkohet, qoftë si punëtorë në fabrika e në uzina, qoftë si kooperativistë në ara, apo si mësues, si inxhinierë e të tjerë, ne kryejmë jo vetëm detyrën tonë kombëtare, por njëkohësisht dhe atë ndërkombëtare.

Ne luftojmë për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste në vendin tonë, luftojmë që ta bëjmë Shqipërinë një vend të bukur, por ne mendojmë njëkohësisht që populli ynë të bëhet shembull edhe për popujt e tjerë. Dhe sa më të fortë ta kemi situatën në vendin tonë, aq më tepër do të ndihmojmë e do të frymëzojmë me shembullin tonë edhe popujt e tjerë. Ju duhet ta kuptoni mirë këtë rol të madh të Partisë sonë, të të gjithë popullit dhe tuajin si brez i ri e kur them brezi i ri, kam parasysh jo vetëm ju më të rriturit, studentët, por edhe këta, të vegjlit, sepse edhe këta kanë ndërgjegjen e tyre që, çdo ditë rritet e kristalizohet, në fillim në forma të thjeshta, pastaj më thellë, për çështjen e ndërtimit të socializmit, që përbën një faktor të madh nxitës e frymëzues edhe për revolucionin botëror.

Prandaj, të dashur shoqe dhe shokë të rinj, nxënës, pionierë e studentë, të keni gjithmonë parasysh mësimet e Partisë dhe të jeni kurdoherë revolucionarë. Të mësoni me zell në shkollat që ndiqni, të qëndroni gjithnjë lart si militantë të organizatës suaj të rinisë e të pionierit, të cilat janë ndihmëse të fuqishme të Partisë. Të mendoni se mësimi në shkolla dhe puna jashtë shkollës, që do të bëhen njëkohësisht e të koordinuara, do të ndihmojnë që te ne të përgatitet një brez i shëndoshë, i kalitur fort për jetën, që nesër do të marrë në duar të sigurta frenat e shoqërisë.

Ju tani po përgatiteni të krijoni personalitetin tuaj si revolucionarë, ta çoni përpara socializmin, të krijoni jetën e re të gëzuar, të krijoni familjet tuaja të reja socialiste. Varet nga ju, shokë të rinj e të reja, se si do të jetë Shqipëria nesër dhe me ju, që udhëhiqeni nga mësimet e Partisë, ajo do të qëndrojë kurdoherë komuniste, bolshevike. Në këtë rrugë ecin e do të ecin populli dhe Partia jonë në shekuj, në këtë rrugë do të ecë edhe brezi i ri i rritur dhe i edukuar nga Partia. Partia do të shtojë radhët e saj me bij e bija nga ju brezi i ardhshëm, që të mbetet gjithnjë e re, revolucionare, e kuqe, pararojë, e shkathët e të mos myket. E theksoj këtë se në jetë ne kemi edhe shembuj se si parti të tjera, si Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, pas vdekjes së Stalinit degjeneroi, u myk, se, për mungesë vigjilence, armiqtë ia rrëmbyen fitoret nga duart dhe shke lën mësimet e ndritura të Leninit e të Stalinit të madh! Po ne a do të lejojmë vallë që armiqtë të na i rrëmbejnë fitoret tona? Në asnjë mënyrë! Ne do ta ndjekim me konsekuencë, pa shmangie, vijën e Partisë, do të ecim në rrugën e klasës punëtore, do të punojmë, do të mendojmë më e do të luftojmë si klasa punëtore, si revolucionarë. Dh që ta bëjmë këtë, duhet që intelektualët, mësimin dhe edukimin të mos i konsiderojnë si konsideroheshin në të kaluar, një stoli për karrierë e për përfitime personale, por si miete për t'i shërbyer çështjes së madhe të Partisë dhe të, mbarë popullit.

Tani për ju janë hapur dyert nga të katër anët. Shqi përja, e ardhmja e saj dhe Partia janë tuajat. Rinia ka tre guar me vepra sa mirë i kupton dhe i zbaton direktivat e Partisë. Populli dhe Partia për

këtë, që nga baza e deri n, krye, i janë mirënjohëse dhe vlerësojnë lart punën heroik të rinisë sonë. Rinia ka qenë në ballë të luftës për çlirimii e atdheut dhe për ndërtimin e vendit. Kjo rini e zjarrtë mund të themi, se në fillim me vrullin dhe me punën e sa plotësoi mungesën e një klase punëtore të madhe. Rini; vuri në balancë gjithë hovin e saj, u kalit në shkollën e madhe të luftërave dhe ishte gjithnjë e zjarrtë. Prej hovi e prej zjarrit të saj morën edhe të tjerët e duhet të merrn edhe ju. Tani në vendin tonë është krijuar e është forcua klasa punëtore e kalitur me idetë r evolucionare të Partisë Ajo është zgjuar e edukuar dhe është në gjendje të ndi kojë në gjithë jetën e vendit, të vërë kudo ligjin e saj, t' japë tonin gjithë veprimtar isë së jetës e të ndër timit ti socializmit në Shqipëri.

Ne shikojmë se hovi i rinisë, nuk është ndalur për as një çast. Edhe në momentet shumë të vështira, kur asaj kanë munguar veshja e mbathja. kur ka qenë pa buki dhe ishim të rrethuar nga armiqtë. ajo ka qenë në ballë ti punës. Rinia çante përpara, duke luftuar me vendosmër kundër të gjithë armiqve të Partisë, kundër titistëve, ku ndër revizionistëve sovjetikë e çdo komploti imperialisto -revizionist, ajo i ka qëndruar kurdoherë besnike vijës si Partisë. Rinia jonë, e edukuar nga Partia, qëndron e pastër si qelibari, kujdesin e Partisë e të popullit ajo e justifikon me përvetësimin me zell të mësimëve të Partisë dhe me veprat e reja që ndërton, si: hekurudhat, rrugët, hidrocentralet e shumë e shumë të tjera që ka kryer me duart e saj të arta.

Para disa ditësh u inaugurua Hekurudha Rrogozhinë-Fier, një vepër me rëndësi shumë të madhe politike, ideologjike dhe ekonomike për vendin tonë. Kjo është vepra e të gjithëve ju, shoqe dhe shokë të rinj, e punëtorëve nga më të thjeshtët e deri tek inxhinierët. Në këtë objekt rinia jonë ka derdhur djersën, dituritë dhe gjithë zotësitë e saj. Ajo e ndërtoi atë në një kohë rekord. Vetëm ju mund ta bënit këtë punë në një afat të tillë; po ta bënim me pagesë, do të donim jo më pak se katër vjet, ndërsa rinia e bëri për dy vjet.

Edhe rruga e Malësisë së Madhe është një tjetër vepër me shumë rëndësi politike dhe ekonomike. Sa do të gëzohen malësorët, sa do t'ju urojnë ata ju për këtë vepër! Ju çatë gjithë ato male dhe çfarë malesh! Ju i dhatë asaj zone dritën, zbatuat vijën e Partisë dhe tanfi ju presin të tjera vepra të mëdha. Si kurdoherë juve ju ndritin sytë kur thoni: «Ku do të shkojmë?». Do të vendosë Partia se ku do të shkoni e ç'vepra të tjera do të kryeni. Prandaj ta doni kurdoherë Partinë tuaj të dashur, se edhe ajo, si mëma juaj ju do me gjithë shpirt! Ajo ushqen për ju dashuri të pakufishme.

Prandaj të brohorasim për Partinë

Të rrojë Partia!

Të rrojë rinia!

KUR TË Rritesi TË BËHESH REVOLUCIONARE DHE KOMUNISTE E MIRI

*(Letër drejtuar Lindita Seseri
Lagjja nr. 3 Tiranë*

E dashura Lindita e vogël,

Urimet që më bëje për Vitin e Ri dhe dhurata që mi

dërgove më gëzon shumë. Ti qysh tani që je 5 vjeçe dhi sa bukur e kishe qëndisur lulen në copën që më dërgove me të cilën unë do të mbuloj gotën time. Pa le pastaj kui të rritesh, sa gjëra të bukura do të bësh. Atëherë kushedi do të prodhosh basma e stofra të bukura, ose do të ndër. tosh shtëpi e pallate, do të prodhosh a montosh radio, makina e të tjera gjëra që e bëjnë më të bukur e më të lehti punën e njerëzve. Apo ke qejf të bëhesh mësuese, agronome, doktoreshë? Të gjitha punët janë të mira, dhe kur té rritesh, ti do të zgjedhësh një nga ato që do të të pëlqejë më shumë.

Tani që je akoma e vogël, po të dërgoj një top e një lodër që të lozësh. Besoj se je vajzë e urtë, nuk mërzit babagjyshin e mamanë, por i ndihmon me sa mundesh që tani. Jam i bindur gjithashtu se, edhe kur të vesh në shkollë, do të mësosh mirë.

Unë dëshiroj që, kur të rritesh, të bëhesh revolucionare e komuniste e mirë, ashtu si gjyshi yt, Meti, që është shoku im i vietër, partizan e komunist, që luftoi për çlirimin e Shqipërisë, ashtu si babai tënd që është oficer dhe punon për mbrojtjen e atdheut tonë të dashur socialist.

Shumë të fala nga unë dhe shoqja ime Nexhmije për babagjyshin, mamanë dhe babanë.

Ju përqafojmë, e dashur Lindita e vogël, ty dhe vëllanë tënd.

ENVER

Tiranë, më 13 shkurt 1969.

TË GDHENDURIT E GURIT ËSHTË NJË NGA MJESHTËRITË MË TË BUKURA

*(Bisedë me pionierët e shkollës «7 Nëntori»
të qytetit të Beratit, më 26 shkurt 1969)*

Të dashur pionierë,

Jam shumë i gëzuar që po takohem sot me ju, se jeni pionierët e parë të vendit tonë që morët iniciativën për të ndërtuar sërishmi kalldrëmet e qytetit të lashtë e të bukur të Beratit. Në shembullin tuaj kanë filluar tani të bëjnë kalldrëme edhe shumë pionierë të tjerë në vendin tonë.

Punimi i gurit, siç ju kam shkruar në letrën që ju kam dërguar, ka rëndësi të madhe, se me gurë bëhen shtëpi banimi, ngrihen institucione shoqërore, kulturore dhe ekonomike, ndërtohen rrugë e ura, bëhen statuja të mëdha e sa e sa vepra të tjera që jetojnë për qindra e mijëra vjet dhe që janë të vlefshme për njerëzimin. Edhe në gur mund të pasqyrohen mendimet më përparimtare dhe shijet estetike të popullit, të shprehen frymëzimi më i pastër dhe dëshirat më të zjarra të atyre që dinë të punojnë me të. Të gdhendurit e gurit është një nga mjeshtëritë më të vjetra e më të bukura.

Ju jeni të rinj e do të keni rastin të shikoni ndërtimin e veprave shumë më të bukura e më madhështore jo vetëm nga ato që kanë parë e ndërtuar këta që ju mësuan, por edhe nga ato që po ndërtohen sot. Tani është koha e Partisë, e cila udhëheq ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Te ne ngrihen uzina e fabrika, ndërtohen vepra ujitëse e kulluese që i bëjnë gjithnjë e më pjellore dhe i lulëzojnë fushat tona, ndërtohen pallate, shkolla e spitale, shtëpi kulture, kinema etj., etj. Të gjitha këto ngrihen me sukses çdo vit e më mirë nën udhëheqjen e Partisë, që tra në dorën e saj një armë shumë të fortë, teorinë e klasës punëtore, teorinë e Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit, me të cilën udhëheq klasën punëtore, fshatarësinë, inteligjencien tonë, ku bëjnë pjesë edhe mësueset e mësuesit, të cilët ju mësojnë dhe ju edukojnë ju që të bëheni njerëz shumë më të mirë nga ne, kur ishim të vegjël si ju. Në të kaluarën, ne nuk na mësonte njeri gjithë këto gjëra kaq të dobishme për popullin dhe për atdheun, siç ju mësojnë ju sot. Ne u rritëm në kushte të tjera, më të vështira, sidoqoftë, punuam me ndërgjegje e ndershmëri, luftuam, sakrifikuam dhe vuajtëm shumë, pikërisht që populli ynë të dilte në dritë dhe të arrinte në këto ditë kaq të bukura e revolucionare që po jetojmë.

Muratorët e vjetër, të cilët po ju mësojnë ju të gdhendni gurë e të bëni kalldrëme, janë nga ata proletarë të vërtetë, për të cilët ju kanë folur shpesh mësuesit në orët e mësimit. Proletarët, si këta, në të kaluarën s'kishin gjë tjetër veç mistrisë dhe rrobave të grisura në trup. Ata ishin të paushqyer mirë dhe jetonin në mëshirën e beut, të agait, të tregtarit apo të fajdexhiut të pamëshirshëm. Punonin e robtoheshin dhe, kur mbaronin së ndërtuari shtëpitë e zotërinjve, merrnin si shpërblim vetëm një krodhë bukë dhe disa lekë, që nuk u mjaftonin as për t'e ushqyer veten, pa lëre për

fëmijët që vuanin për bukën e gojës, se për t'i dërguar ata në shkollë, në ato kohë të vështira as që mendohej fare. Përveç kësaj, punëtorët muratorë atëherë i përbuznin dhe i shanin, megjithëse ishin pikërisht këta që ndërtonin me duart e tyre të shkathëta pallatet e pasanikëve e të bejlerëve, të Vrionasve me shokë. Shumë herë këta punëtorë nuk paguheshin për punën e madhe që bënin dhe, në vend të shpërblimit, bejlerët u jepnin dru kokës, ua hanin të drejtën, se atëherë nuk kishte drejtësi për popullin, kurse klasat e pasura i mbronin ligji. Kur erdhi Partia në udhëheqje dhe populli e mori fuqinë në dorë, bejlerët morën dënimin e merituar. Ne u shkatërruam atyre dhe gjithë armiqtë të tjerë të popullit, pushtetin e tyre shtypës e mizor dhe populli i udhëhequr nga Partia erdhi në fuqi dhe vendosi pushtetin e vet.

Në sajë të luftës së popullit, të klasës punëtore, të fshatarësisë e të inteligjencies, të udhëhequra nga Partia, lindi Shqipëria e re socialiste, ku janë ndërtuar dhe ndërtohen tani vepra kaq të bukura. Për ngritjen e tyre po kontribuoni edhe ju, djem e vajza kaq të reja e të gjalla, me ndjenja kaq të pastra. Ju ndiqni si duhet rrugën që ju tregon Partia dhe mësoni si ju porosit ajo. Mësimi tra rëndësi të madhe për ju dhe për shoqërinë tonë, pionierë të dashur. Këtë ju e kuptoni mirë, prandaj duhet të mësoni sa më shumë dhe njëkohësisht edhe të punoni mirë. Kur mësuesja ose mësuesi ju porositin t'i përgatitni vazhdimisht mirë mësimet, të mos bëni gabime në hartime, t'i zgjidhni drejt dhe shpejt problemet e aritmetikës apo ushtrimet e gjuhës, të mbani mend këto ose ato gjëra, duhet t'i kuptoni drejt se sa punë të madhe bëjnë ata dhe sa shumë jua duan të mirën. Prandaj i doni dhe i dëgjoni me respekt duke u përpjekur të përfitonit sa më shumë prej tyre, se janë më të rritur dhe e njohin jetën më mirë, kanë përvojë të madhe në jetë dhe në punë, kanë dituri më shumë dhe dinë ç'nevoja treni ju. Të gjitha këto ata i kanë mësuar në procesin e madh të jetës, pra, që kur kanë qenë të vegjël, kështu si ju, e gjer tani. Partia sot dhe njerëzit përparimtarë e patriotë të së kaluarës i kanë mësuar ata vazhdimisht, ndaj dhe e kuptojnë se pa dituri s'ka jetë, po errësi, siç ndodhte në regjimet e kaluara.

Kur mësuesit dhe edukatorët tuaj ju shpjegojnë mësimin, ju duhet të jeni të vëmendshëm dhe t'i thithni mirë të gjitha dijet që ju japin ata. Shokët më kanë thënë se ju kështu keni bërë dhe kështu po vazhdoni të bëni. Mësimet e Partisë. që jua zëbërthejnë mësuesit, i keni kuptuar dhe i kuptoni mirë. Këtë e provon edhe fakti se ju, tok me rëndësinë që i jepni mësimin, ishit të parët që vlerësuat lart rëndësinë e punës dhe dolët me iniciativë për të ndërtuar kalldrëmet e prishura të rrugëve, për të ndërtuar kalldrëme të reja atje ku ndihet nevoja e tyre.

Rruga ka rëndësi të madhe për të gjithë. Në rrugë ju luani me top, me pingël e lojëra të tjera të reja që ne, kur ishim të rinj si ju, nuk i kishim. Rruga është shumë e dashur për cilindo, sepse atje kalon përditë, sepse ajo të lidh me njerëzit, me jetën. Në rrugë kalojnë njerëzit kur vene e vijnë nga puna, në rrugë kalojnë edhe fëmijët kur venë e kthehen nga shkolla. 'Në rrugë njeriu duke ecur edhe _mendon, edhe ëndërron për të ardhmen, domethënë, bën plane me bukë e jo ëndrra të kota. Prandaj rrugët duhet t'i mbajmë kurdoherë të pastra, që të mos kenë gurë të hedhur andej-këtej, as pellgje me ujë që njerëzit të pengohen e të ndoten. Po të ketë gurë, ai që kalon bie e vritet, po të ketë pellgje me ujë, bëhet helaq. Po të ngjasë kështu edhe me ju, kur të veni në shtëpi me siguri nëna do t'ju qortojë e do të thotë: «Po ku u bërë kështu more ditëshkurtër?». Akoma më keq është kur ndonjë i kaluar nga mosha pengohet, nga këto gjëra në rrugë, bie dhe thyen dorën ose këmbën. E shihni, pra, ç'rëndësi të madhe ka rruga? Pastaj, pas punës, në rrugët e mira njerëzit bëjnë edhe shëtitje, se të ecurit forcon shëndetin e njeriut, njëkohësisht edhe e qetëson shumë atë, prandaj mësuesit e mësueset ju këshillojnë që, pasi të mbaroni mësimin në klasë dhe të bëni detyrat në shtëpi, të dilni edhe jashtë për të luajtur e për të shëtitur me njëri-tjetrin. Shëtitja, si çdo lëvizje tjetër, është me të vërtetë një nevojë e domosdoshme për trupin e njeriut, është një gjë shumë e mirë, por, natyrisht, duhet bërë vetëm pasi të keni kryer detyrën. E them këtë se ka edhe ndonjë pionier jo të rregullt dhe ndonjë të kaluar në moshë, që nuk i kryejnë mirë detyrat, por sillen lart e poshtë gjithë ditën. Kjo do të thotë ta kalosh kohën kot, pa i sjellë dobi si shoqërisë, edhe vetes tënde.

Kur morëm vesh se ju filluat të bënit kalldrëmet, këtë e vlerësuam si një iniciativë shumë të mirë. Unë dhe shokët të tjerë udhëheqës thamë atëherë për ju: «Këto vajzat e djemtë e Beratit qenkan jo vetëm shumë të zgjuar, por edhe shumë të lidhur me popullin, me shkollën, me mësuesit dhe me

punën. Kjo do të thotë se ata e kanë kuptuar mirë orientimin e Partisë se njerëzit duhet të mësohen me punë që në vegjëli». Për këtë ju bëni shumë mirë dhe veproni shumë drejt, sipas mësimëve të Partisë. Ju lumtë!

Gjithashtu, unë jam i bindur që ju nuk ia bëni kurrë fjalën dy as mamasë e as babait, se ata për lumturinë tuaj punojnë në fabrikë dhe në arë, ju ushqejnë, ju lajnë kokën e trupin, ju lajnë e ju hekurosini teshat. Por edhe ju nuk mungoni t'i ndihmoni ata për të mbushur ujë e për punë të tjera. Edhe unë kur isha i vogël bëja ca punë në shtëpi. Mëma më kishte bërë atëherë një kokore me lecka dhe, para se të veja në shkollë e vija atë në kokë, mbi të vija tepsinë me bukë për ta çuar në furrë. Kokoren e lija te furrxhiu se kur kthehesha nga shkolla duhet ta merrja medoemos tepsinë prapë në kokë.

Mbaj mend, gjithashtu, se kur isha i vogël, në Gjirokastrë nuk kishte ujë të mjaftueshëm për të pirë, siç ka kudo tanfi në kohën e Partisë, prandaj detyroheshim të pinim ujët e ndenjtur të sterave e të muslluqeve. Stera nganjëherë zinte papastërtira, prandaj para se të mbushnim ujë në muslluk në grykën e gjymit vinim nje copë të hollë për ta kulluar ujët që do të pinim. Atëherë nëna ime ishte e re, por edhe sot që kanë kaluar shumë vite i n:ban mend mirë ç'hiqim, prandaj nganjëherë më flet për ato kohë dhe më thotë: «E djalo i mban mend këto gjëra?». «I mbaj mend, si jo» i them unë. Po fjalën e kam këtu që shpesh ajo më porosiste të mbushja gjymat, mirëpo unë në atë kohë nuk e kuptoja se e kisha detyrë ta bëja këtë punë dhe nganjëherë nuk e zbatoja porosinë e saj. Vetëm dëgjoni, këtë e themi në mes nesh, se unë atëherë nuk mendoja si tanfi, ose, më mirë të themi, siç mendoni ju, që jetoni sot në një kohë tjetër, në kohën e Partisë, dhe jeni të zhvilluar nga çdo pikëpamje.

Kur ju filluat të ndërtoni kalldrëmet, ishte një gëzim i madh për ne në Tiranë. Juve nuk ju shkon në mendje e nuk e përfytyroni dot që me shembullin tuaj të bukur ndihmuat për të forcuar idenë që në shkollat tona, krahas mësimit edhe të punohet. Kështu ju kontribuuat shumë për revolucionarizimin e shkollës. Shembulli juaj është një gur i rëndësishëm në themelin e shkollës sonë të re.

Pastaj shoku Enver Hoxha i drejtohet një gurgdhendësi të vjetër.

Edhe ti që i ke mësuar këta pionierë të gdhendin gurë e të bëjnë kalldrëme, je mësuesi i gjithë këtyre, je njeri i dalë nga klasa jonë punëtore, pa të cilën s'bëheshin dot gjithë këto mrekulli e të arriheshin gjithë këto suksese në vendin tonë. Prandaj, të dashur pionierë, duhet të keni respekt të madh për këtë xhaxhon këtu dhe për të gjithë punëtorët. Si gjithë punëtorët, edhe shokët muratorë janë njerëzit më të nderuar në shoqërinë tonë socialiste, dhe këta, që ju kanë mësuar ju, kanë bërë një punë shumë të dobishme.

Duke biseduar me ju, mund të rrimë këtu me orë të tëra, se s'ka minutë, orë dhe ditë më të bukura për njerëzit e moshës sonë sesa kur rrimë e bisedojmë me fëmijët. Në raste të tilla kujt do i kujtohen shumë gjëra të bukura nga jeta e rinisë, prandaj më të lumturit në botë janë mësueset e mësuesit, që merren vazhdimisht, gjatë gjithë jetës me edukimin e brezit të ri.

Edhe një herë dëshiroj t'ju këshilloj që t'i doni e t'i respektoni shumë mësueset dhe mësuesit tuaj, të dëgjoni me vëmendje këshillat dhe mësimet e tyre, se ata punojnë sipas mësimëve të Partisë.

Tani të vemi t'i shohim konkretisht rrugët që ju i keni shtruar me kalldrëm dhe ju siguroj se, kur të kthehem në Tiranë, do t'u tregoj të gjithë shokëve të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë, për takimin që pata sot këtu me ju. Sa e për zemërt dhe e paharrueshme është për mua kjo pritje që m'u bë këtu në Berat. Ku kemi pionierë të zgjuar, të zjarr të patriotë dhe trima. Të cilët mësojnë dhe punojnë mirë. bëjnë edhe kalldrëme të mira. Jam i bindur se tani që do të vete t'i shoh. do t'i gjej të forta dhe të bukura dhe. po të jetë vërtet kështu, atëherë do t'ju vë një notë të mirë.

Rroftë Partia që na selli këto ditë dhe na edl.ikon!

Rroftë rinia!

Rroftëshin pionierët!

JU I MBANI GJITHNJË NË ZEMËR DËSHMORËT E LUFTËS

(Letër drejtuar nxënësve të shkollës «Hasan Koçi»)

SHKOZET-DURRËS

Shuinë të dashur miq të vegjël,

U gëzova dhe njëkohësisht u preka shumë nga letra që më dërguan dy shoqet tuaja të klasës së tretë, Eleni Duro e Dhurata Bilali. Ato më shkruanin se në ekskursionin që kishte organizuar shkolla, pasi mblodhën me kujdes lule të freskëta i vendosën ato plot dashuri e respekt mbi varrin e dëshmorit Hasan Koçi. emrin e të cilit mban shkolla juaj. Kjo tregon se të edukuar me mësimet marksiste-leniniste të Partisë sonë, ju i mbani gjithnjë në zemër dëshmorët e Luftës Nacionalçlirimtare. të cilët nuk kursyen as jetën e tyre për çlirimin e atdheut nga pushtuesit fashistë e tradhtarët e vendit dhe që populli yni të shpëtonte një herë e përgjithmonë nga shtypja e shfrytëzimi i feudalëve. bejlerëve. borgjezëve dhe të bëhej zot i fateve të veta.

Brezi që kreu revolucionin dhe ai qi do ta marrë e do ta çojë inë tutjn stafetin e tij,që do të ndirtoji shoqirini e plot, socialistia dhe komunizmin nti vondin toni, kurrë nuk duhet të harrojnë gjakun e atyre që dhanë jetën për ditët e bukura të pranverës socialiste që ne gëzojmë sot.

Për ju, të dashur fatosa e pionierë, është nder i madh që shkolla juaj mban emrin e një dëshmori, prandaj përpiquni të mësoni, të punoni e të silleni sa më mirë, të rriteni dhe të bëheni sa më të vlefshëm për Partinë dhe popullin.

Ju përqafoj me dashuri

Juaji
ENVER HOXHA

'Tiranë, më 9 maj 1969

**ZEMRA E PARTISË
ËSHTË SHUMË MË E MADHE
SE ZEMRA E NJË NËNE**

*(Nga fjala në takimin me fëmijët
dhe me personelin e shtëpisë së
fëmijës «8 Nëntor» të kryeqytetit,
më 23 nëntor 1969)*

E dashura shoqja drejtoreshë,

Të dashur fëmijë,

Të dashur shokë dhe shoqe,

Sa shumë jam i gëzuar sonte që ndodhem këtu në mes jush për t'ju sjellë përshëndetjet më të zjarrra të Komitetit Qendror dhe të të gjithë Partisë ju, bijave e bijve nga më të mirët e popullit tonë, që diçka shumë e madhe dhe e dhembshur për njeriun, siç janë prindërit, ju ka munguar. Por ajo diçka

e madhe dhe e dhembshur, mungesa e prindërve, ju është zëvendësuar juve me diçka tjetër shumë më të madhe, me kujdesin dhe me dashurinë e nënës Parti, me kujdesin dhe me dashurinë e zjarrtë të mbarë popullit.

Qysh në fillim të vendosjes së pushtetit popullor, Partia dhe populli, me gjithë mundësitë e pakta që kishin në ato kohë të vështira pas Çlirimit (mbasi siç ju kanë treguar mësuesit tuaj, dëme të jashtëzakonshme në njerëz dhe në pasuri pësuar nga lufta), ju rrethuan ju me dashurinë dhe me kujdesin më të madh. Në ato kushte të mjeruara që trashëguam, populli dhe Partia iu përveshën me të gjitha forcat punës së madhe për rindërtimin e atdheut të rrënuar, por njëkohësisht ata menduan edhe për bijtë e bijat jetime si ju, pa asnjë dallim, cilëndo që ishin, mjaft që ishin djemtë e vajzat e popullit punonjës, të shtypur e të shfrytëzuar deri në palcë në të kaluarën. Mbështetur në vijën e saj të drejtë, Partia nuk pa nëse ky ose kjo ishin djalë apo vajzë e dëshmorit partizan, e fshatarit osti e punëtorit apo e qytetarit, që kishte vdekur normalisht jo në luftë, ose bir apo bijë e një vajze nga të popullit të mjeruar, së cilës i kishte ndodhur një aksident në jetë. Të gjithë këta Partia i mbledhi pa dallim dhe vendosi t'i rritë e t'i edukojë si bijtë dhe bijat e saj, t'i rritë e t'i edukojë me idealet marksiste-leniniste, t'i bëjë luftëtarë të cështjes së saj të madhe, sic. i bëri e sic. do t'i bëjë edhe në të ardhmen, ashtu si gjithë të tjerët, edhe ata që do të kalojnë në institucione si ky, njerëz të vlefshëm, shtylla të atdheut tonë socialist.

Në sajë të këtij kujdesi prindëror, nga ky institucion kanë dalë në jetë sa e sa shoqe dhe shokë të shquar, shumë prej të cilëve ndjekin ende shkollat. Djem e vajza të tjera akoma më të vogla vazhdojnë të rriten e të edukohen nëpër befotrofe e shtëpi fëmijësh si kjo juaja, kurdoherë me të njëjtin synim, të përgatiten që nesër edhe ata të japin si të gjitha bijat e bijtë e tjerë të këtij populli heroik, nën udhëheqjen e Partisë, kontributin e tyre të gmueshëm në ndërtimin e shoqërisë sonë socialiste.

Shoh se ju po brohoritni me gjithë shpirt për Partinë tonë të Punës. Është plotësisht e kuptueshme për të gjithë ne kjo dashuri e madhe që shprehni ju për nënën tonë të madhe. Nënës që më lindi mua asnjë nga ju nuk ia di emrin, kurse emrin e nënës suaj, emrin e nënës së madhe të të gjithë neve, emrin e Partisë së lavdishme të Punës të Shqipërisë, e di e gjithë bota. Nëna që më lindi mua më donte shumë, ajo donte shumë edhe popullin, por zemra e Partisë është një zemër shumë më e madhe se zemra e një nëne të vetme, ajo është një zemër bujare që kujdeset për të gjithë popullin. Nëna ime vdiq, po Partia nuk vdes, pse ajo mishëron idetë e mëdha të materializmit historik, prandaj s'ka e s'do të ketë mortje kurrë. Vepra e Partisë do ti rrojë në shekuj, pse c.do furtunë apo stuhi që do t'i dali Partisë përpara në rrugën e saj, Bado e tmerrshme që ti jetë, do të mposhtet, do të thyhet e do të bëhet copë i thërrime përpara forcës së madhe të popullit dhe ti Partisë.

Të gjitha sukseset e mëdha të arritura deri sot, që i, kanë ndryshuar faqen Shqipërisë, janë realizuar në sajë të vijës së drejtë të Partisë, që është dic.ka materiale, e prek. shme, konkrete, e lidhur ngushtë me dëshirat e zjarra të popullit, me mundësitë, me aftësitë krijuese të njerëzvi tanë, që ajo di t'i vërë në lëvizje jo jashtë kohës, po brend, saj dhe mbi këtë tokë. Partia di t'i organizojë, t'i kombi nojë, t'i drejtojë e t'i sqarojë njerëzit. Me rrezet e zjarrit,, të dritës së saj, ajo u tregon atyre drejtimin nga duhet ti ecin. Varet vetëm nga ne dhe nga askush tjetër që këti që themi të bëhen realitet.

Po të mos ishte e tillë vija e Partisë, masat tona puno njëse nuk do ta ndiqnin dhe nuk do ta zbatonin atë, do ti linin Partinë në rrugë. Por përkundrazi, njerëzit tanë

ndoqën dhe e ndjekin atë me vendosmëri e me besnikëri ti madhe, ata lënë kokën për Partinë, sepse ajo është jeta i tyre, jeta e kalamanëve dhe e së ardhmes së atdheut. Pra ndaj populli shqiptar i thotë Partisë së vet: «Hapna sytë tregona shtigjet nga duhet të ecim, c.r rugë të ndjekim, n~ trego të këqijat që duhet të spastrojmë dhe na sqar o pë c.do c.ështëje që s'e kuptojmë. Ka raste, mëma jonë Parti që ne bijtë e tu bëjmë edlie gabime, po e dimë sa e gjerë sa e madhe është zemra jote, ajo na i fal gabimet dhe n, ecim drejt përpara, prandaj na trego c.'duhet të bëjmë dh ne do ta kryejmë gjer në fund c.do porosi tënden, do t~ ecim kurdoherë në rrugën ku na udhëheq ti!». Dhe Parti, na e ka treguar dhe vazhdimisht na e tregon rrugën nëpë të cilën duhet të kalojmë, prandaj ne po jetojmë në kohë e një transformimi të paparë të atdheut, transformim ko losal material, ekonomik, në drejtim

të mirëqenies së nje rëzve, njëkohësisht edhe një transformim i gjithanshën shpirtëror në drejtim të zbulurimit dhe të rritjes së pandër prerë të ndërgjegjes së njeriut tonë të ri.

Për transformimin e pandërprerë të ndërgjegjes së njeriut tregon kujdes të vazhdueshëm Partia, pse ajo e di që, po të arrijë ta pajisë, ta zbulojë, ta kalitë çdo orë, çdo ditë, çdo muaj e çdo vit njeriun tonë nga pikëpamja e ndërgjegjes me mësimet e marksizëm-leninizmit, domethënë ta bëjë atë që të ushqejë për shokun, për vëllanë, për të afërmin e tij ndjenjat më të pastra, një dashuri të pafund, po të arrijë që ta bëjë atë të jetë kurdoherë i dr ejtë, i ndershëm, punëtor, i sakrificës dhe i vendosur për të zhdulkur në veten e tij çdo njollë të së kaluarës, atëlierë çdo detyrë, qoftë kjo edhe jashtëzakonisht e vështirë dhe e ndërlikuar, do të realizohet me sukses të plotë dhe brenda një kohe rekord. Një njeri që brumset çdo ditë me mësimet e Partisë, me ideologjinë marksiste-leniniste, me ndjenja të pastra, përvetëson me shpejtësi gjithçka të mirë e pozitive, çdo njohuri shkencore apo normë të moralit tonë të lartë komunist, për t'i vënë ato në shërbim të atdheut tonë socialist dhe të mbarë njerëzimit. Kur të arrijmë ta përgatitim plotësisht njeriun tonë me të tilla virtyte të larta, atëherë do të shohim ç'forcë e madhe do të krijohet në këtë vend, ç'male do të rrëzohen e ç'hydrocentrale të fuqishme e fabrika moderne do të ndërtohen me shpejtësi, sa shumë pjellore do të bëhen fushat tona, gjëra këto që tani njeriu as që mund t'i marrë dot me mend.

Po kush do t'i realizojë gjithë këto detyra të mëdha? Njerëzit e Shqipërisë, burrat e gratë, vajzat e djemtë, të rinjtë e të rejtat si ju që edukon, kalit e frymëzon Parfja me vijën e saj të drejtë, me luftën e saj të paepur. Prandaj t'i ndjekim me vëmendje të madhe mësimet e Partisë, fëmijë të dashur, të punojmë me zell çdo ditë, çdo orë dhe minutë, kudo që jemi, të punojmë me zell e me këmbëngulje sidomos për të spastruar nga ndërgjegjja jonë mbeturinat, pse ato na qepen si fer rat që na grisnin trupin. Ato na shfaqen neve në një mijë mënyra e në forma nga më të ndryshmet. Bile, edhe kur mendojmë se i kemi zhdukur, disa prej tyre na dalin përsëri në forma që as i parashikojmë dot. Prandaj, që t'i luftojmë ato me sukses, në çfarëdo forme e mënyre dhe në çdo kohë që të paraqiten, duhet t'i kemi sytë vazhdimisht hapur dhe mendjen kurdoherë te Partia dhe tek ideologjia e saj marksiste-leniniste.

Shumë nga ju që keni kaluar nga ky institucion, jeni të rritur tashmë dhe e kuptoni jetën më mirë nga të tjerët. Ju jeni militantë të shquar të Partisë, që punoni me zell, trimëri e heroizëm në fabrika, në ushtri, në kantiere, në opera, në ara, nëpër zyra e kudo, që jeta e popullit të bëhet gjithnjë më e bukur, më e lumtur. Por të gjithë e kemi për detyrë dhe duhet të përpiqemi që edhe këtyre pëllumbave e pëllumbeshave të vogla që jetojnë këtu, t'ua bëjmë jetën të lumtur e të gëzuar dhe t'i edukojmë e t'i mësojmë si duhet. Kjo varet shumë nga mësuesit e mësueset dhe nga gjithë personeli tjetër që punon në këtë institucion, tek të cilët këta fëmijë të vegjël, përveç kujdesit të ngrohtë të mëmës së madhe Parti, duhet të shohin prindërit e tyre. Partia është ajo nënë e madhe që nuk e zëvendëson dot askush, por te mësuesit, mësueset, te kujdestarët e gjithë të tjerët ju fëmijë të dashur duhet të gjeni mëmat e baballarët që disa nga ju s'i kanë njohur. Prandaj është detyrë sa humanitare, aq edhe e domosdoshme që personeli i këtushëm të punojë shumë më mirë se në të gjitha institucionet dhe qendrat e tjera të punës, të kujdeset shumë më mirë se p-sr fëmijët e vet.

Kur në dimër gjyshes i kthehen fëmija nga shkolla në shtëpi, ajo i pret ata me buzë në gaz, i afron për t'u ngrohur e për t'u çlodhur ndanë zjarrit në oxhak mbi poste, hedh në bragaç misra apo gështenja dhe, në pritje derisa ato të valojnë e të ziejnë për t'ua dhënë t'i hanë, u tregon, sipas moshës, ngjarje nga jeta dhe nga historia e popullit, ndonjë përrallë etj., e, kur çlodhen, i vë të përgatitin mësimet. Prandaj, fëmijët i duan jashtëzakonisht shumë gjyshet e tyre në shtëpi, bisedojnë ngrohtë me to, u hapin zemrën për çështjet e tyre më intime, sepse shohin me prova se ato i duan me gjithë shpirt fëmijët.

Veç kësaj, vajzat dhe djemtë, shoqja drejtoreshë, kur të venë në shkollë, duhet të jenë të veshur më mirë e më pastër nga gjithë fëmijët e tjerë. Këtë nuk e them që fëmijëve tani t'u ngrihet mendja, por e kam çështjen se ndërmjet të rejave dhe të rinjve që ndjekin shkollat, pavarësisht se në shumicën e tyre dërrmuese shpirtin e kanë të bardhë si karta, ka edhe nga ata që i ngacmojnë fëmijët pa prindër, prandaj mos lini shteg që ndonjë i edukuar keq t'u thotë atyre me përçmim: «Hë mo ti, se i shtëpisë së fëmijës je!». Të shtëpisë së fëmijës janë këta, po janë djemtë dhe çupat e Partisë dhe të

popullit. Për gjithë të tjerët punojnë një baba dhe një mëmë, kurse për këta punojnë një Parti dhe një popull i tërë.

Morët vesh tani, të dashur fëmijë? Prandaj kam bindjen se do t'i vihëni me vullnet të madh mësimin, do të tregoheni kurdoherë të sjellshëm e do të ushqeni vazhdimisht dashuri të zjarrtë për Partinë, për mësuesit, për personelin tjetër që shërben këtu, për shoqet e shokët tuaj dhe, me punë të palodhur e sjellje shembullore, do ta meritoni plotësisht kujdesin e madh që tregojnë Partia dhe populli për ju.

Rroftë Partia!

Rroftë rinia!

Gëzuar festat!

TË MËSONI MIRË NË SHKOLLI

*(Nga biseda me një grup fatosash, pionierësh dhe të rinjs
të Tiranës dhe të Durrësit, më 16 tetor 1971)*

*Në fillim një pioniere, në emër të të gjithë pionierëz;
e të të rinjve, e uroi shokun Enver Hoxha dhe i solli përshi
ndetjet më të zjarrta dhe urimet më të mira të brezit të r
Pastaj u zhvillua një bisedë e përzemërt:*

SHOKU ENVER HOXHA: Faleminderit shumë!

Si jeni? Si ia çoni ju djemtë me top? Me futbollin besc se jeni mirë. Edhe vajzat luajnë me top, volejboll e basket boll, por, kur vjen çështja për të mësuar ne shkollë, ato mësojnë më mirë nga djemtë marksizëm-leninizmin, më du ket mua.

Shoku Enver Hoxha njihet me vajzën e Heroit të Puni

Socialiste Adem Reka dhe i thotë:

Ke bërë shumë mirë që ke ardhur. Nëna si është? 7 ku mëson, né çshkollë je?

TATJANA REKA: Nëna mirë është, unë jam këtu n Tir anë, né Shkollën e Mesme të Gjuhëve të Huaja.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë.

Po ju kolopuçët çfarë pritni? Sulmoni, hani nga kët çokollatat.

Me atë atje (Shoku Enver Hoxha tregon të riun Spartak Kote) jemi njohur 16 vjet më parë. Që atëherë nuk ishim takuar . Dhe ja, u takuam sot. Atëherë ai ishte i vogël, nuk kishte hyrë akoma në shkollë. Ishim në Voskopojë, rrinim nën hijen e pishave dhe bënim muhabet, luanim me gur içka.

Unë i thosha të shkonte të merrte gurë e ndonjë shkop: dhe bënim pushkë.

Në çfarë klase je tani?

SPARTAK KOTE: Në vitin e katërt, studioj për inxhinieri mekanike.

NJË PIONIERE: Edhe unë, xhaxhi Enver, e kam herën e dytë që takohem me Ju.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu?! Shumë mirë, po ku jemi takuar bashkë?

PIONIERJA: Jemi takuar në festën e Vodicsës. Ju më morët në krah dhe më puthët.

SHOKU ENVER HOXHA: Të kujtohet sa bukur ishte atë ditë, si ishte zbukuruar Vodica për festë?!

Atje ishte edhe një plak nga një fshat i Kolonjës, i cili më mori nga krahu dhe më tha: «Shoku Enver, unë dëshiroj një gjë nga Ju, do të ma jepni?». «Çfarë është ajo, thuama, ba, po të jetë për të ta dhënë, do të ta jap», - iu përgjigja. «Dua një top», më tha ai. Ky ishte një nga ata luftëtarët që nuk donte pushkë, po top për të mbrojtur kufirin. Kurse ju të mësoni mirë në shkollë dhe, kur të rriteni, të mësoni edhe armët e ndryshme, pushkën, mitralozin etj.

Tani të bëjmë një fotografi së bashku.
Fatosat, pionierët e të rinjtë e rrethuan shokun Enver
Hoxha dhe dolën në fotografi.
Faleminderit shumë, t'u bëni të fala gjysheve, nënave e baballarëve !

**EDHE NË MERTURIN KRENAN
KA PERËNDUAR E KALUARA E HIDHUE
DHE PO LULËZON PRANVERA SOCIALISTE**

*(Letër drejtuar nxënësve dhe mësuesve
të shkollës së fshatit Mertur)*

PUKË

Të dashur nxënës dhe mësues,
E ndiej veten të lumtur që po ju çoj sot përshëndetjet e zemrës juve, nxënësve dhe mësuesve të fshatit Mertur dhe t'ju falënderoj për letrën që më dërguat. .
Ashtu si ju, edhe unë ruaj kujtime të paharruara nga vizita që bër a vjet në rr ethin tuaj. Duke lexuar letrën, solla edhe një herë ndër mend me përmallim ato ditë kur u poqa e kuvendova me pukjanet e pukjanët trima të shquar e punëtorë të palodhur dhe kuptojeni, miqtë e mi, sa shumë u gëzova që edhe në Mertur, si në gjithë rrethin tuaj, po arrihen suksese në zbatimin e detyrave që ju dhe fshatarësia patriote e asaj kooperative i keni caktuar vetes.
Nuk kam qenë ndonjëherë në Mertur, por më kanë thënë se ai ndodhet në një terren të thyer, mbi të cilin duket madhështor shkëmbi i Çllumit, dëshmitar i heshtur i shtypjes dhe i shfrytëzimit të atij populli, por edhe i luftërave të tij të paprera për lini e dr ejtësi, për një jetë më të mirë.
Në atë fshat të thellë e shkëmbor, ku njerëzit vuanin përpara nga uria dhe mjerimi, tani u arrit që bukën ta prodhoni vetë në vend, pasi me punë të palodhur, të gjithë, të mëdhenj e të vegjël, keni çelur tokë të re edhe në shkëmb, duke dyfishuar sipërfaqen arë të mbjellë sidomos me misër, rendimentin mesatar të të cilit e keni ngritur në 33 kuintalë për hektar, ndërsa në parcelën eksperimentale deri në 72 kuintalë për hektar. Sot edhe në Merturin krenar, por të varfër në të kaluarën, ka perënduar e s'kthehet më ajo kohë kur Migjeni zemërzjarrtë me gjithë dufin e shpirtit të tij të revoltuar ligjëronte:

*«Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi,
kâfshatë që të mbetë në fyt dhe të zë trishtimi».*

Tani kanë ardhur kohë të reja, jetojmë në epokën e Partisë, kur në atdheun tonë të lirë lulëzon pranvera socialiste dhe jeta e njerëzve tanë bëhet çdo vit e më e mirë.
Prindërit tuaj, të dashur fatosa e pionierë, kanë qenë analfabetë, kurse për ju Partia dhe pushteti popullor karië ndërtuar shkollë të re 8-vjeçare, ku në mbrëmje mësojnë edhe shumë vajza e djem të rritur; për ju janë ndërtuar shtëpia e kulturës, çerdhja, kopshti, furra, ambulanca, infermiera. etj. Ditë të reja, më të bukura, e presin popullin tonë, pasi Partia mendon dhe punon për një të ardhme akoma më të bukur. Prandaj ju keni të drejtë të shprehni për të fjalët më të mira të zemrave tuaja dhe të luftoni që të zbatoni në jetë porositë e saj duke mbajtur në një dorë kazmën, në tjetrën pushkën dhe me librat e Partisë në gji mësoni, punoni e vigjiloni aty në atë skaj verior të atdheut, ku jeton një popull trim, i zgjuar, punëtor e i talentuar, nga gjiri i të cilit kanë dalë punëtorë të shquar sharrëxhinj, muratorë dhe gurskalitës duarartë, gjeologë e të tjerë.

I uroj kolektivit tuaj shëndet e suksese në mësim dhe ju lutem t'u jepni të falat e mia të përzemërta prindërve e të afërmeve tuaj, gjithë malësoreve e malësorëve trima të Merturit, që punojnë pa u lodhur për ta bërë kooperativën më të begatshme, më të bukur, më të lulëzuar e më të fortë, ashtu siç po bëhet gjithë atdheu ynë socialist, i cil: po i pret ballëllart e duarplot 30-vjetorin e Themelimit të Partisë dhe Kongresin e 6-të të saj.

Ju përqafoj me mall
Juaji
ENVER HÖXHA

Tiranë, 19 qershor 1971.

JU JENI E ARDHMJA E LUMTUR E ATDHEUT*

*(Më 30 dhjetor 1977 u mbledhën në Pallatin e Brigadave 500 pionierë të dalluar të ardhur riga gjithë vendi. Shoku Enver iu drejtua brezit të ri me këtë përshëndetje.)

Të dashur pionierë dhe pioniere,

Këngët tuaja të bukura ria gëzojnë pa masë. Këto i këndojnë atdheut të dashur, Partisë sonë të shtrenjtë, popullit tonë heroik. Partia jonë kur luftoi dhe lufton ka pasur e ka kurdoherë parasysh mirëqenien dhe lumturinë e popullit dhe, në radhë të pare, lumturinë e kalamanëve dhe të rinisë sonë të mrekullueshme. E ja, edhe sonte në këtë pallat të popullit, që është edhe juaji, jemi mbledhur të festojmë së toku Vitin e Ri. Viti i Ri, siç e dini, festohet nesër, por ne e festojmë që sonte, se pionierët janë në pararojë. Pionierët këtë vit do ta festojnë Vitin e Ri dy herë, një herë këtu, me ne, pastaj me prindërit e tyre të dashur, me gjyshërit e gjyshet, me vëllezërit dhe me motrat e tyre.

Është kënaqësi e madhe që anekënd Shqipërisë një gëzim i madh ka pushtuar gjithë njerëzit tanë. Ky është një gëzim për cilindo, për arsye se sheh atdheun kudo të lulëzuar, sheh popullin të lumtur, sheh rininë të shkollohet. Kështu gjithë populli ynë, me besim të madh te Partia punon, ndërton e gëzon për të tashmen dhe për të ardhmen edhe më të mirë. Gjithë këto vite që kemi kaluar i kanë sjellë Shqipërisë dhe mbarë popullit shumë të mira, që v ju të tërë i keni pare dhe po i gëzoni. Gjithë këto të mi të dashur pioniere, u arritën në sajë të udhëheqjes së dre të Partisë sonë heroike. Politika e Partisë është një politike e drejtë, një politikë marksiste-leniniste, një politikë që për qëllim të vetëm mirëqenien e popullit, edukimin e me dashuri për njëri-tjetrin, forcimin e atdheut social dhe mbrojtjen e tij riga gdo rrezik. Çdo gjë që është ridi tuar në Shqipëri është arritur nën udhëheqjen e drejtë të Partisë, riga populli, riga gjyshërit, riga baballarët, riga rr mat, motrat dhe vëllezërit tuaj. Po edhe ju, pioniere, mesoni mirë dhe edukoheni me moralin e shëndoshë të Partisë, keni kontribuar shumë në këtë çështje. Kjo rëndësi të jashtëzakonshme për fatet e ardhshme të dheut, për arsye se sa më të edukuar me një frymë ,lartë patriotike të jeni ju, sa më të sjellshëm, sa më mësuar e të kulturuar të bëheni, aq më i bukur do të je atdheu, aq më i lumtur do të jetë populli ynë. Këtë bind Partia e ka të plotë, sepse ju sheh ju, pionierët. ju të rir të, e të rejtat, klasën punëtore, fshatarësinë dhe intelektu lët tane popullorë, që nuk kursejnë asgjë, po i janë pë veshur punës kudo për të ndërtuar kurdoherë vepra të b kura e të dobishme për atdheun, në radhë të pare, për 1 ninë, për ju, pioniere e pioniere.

Prandaj Partia e meriton dashurinë e pafund që ushqë për atë gj ithë populli shqiptar, klasa punëtore, rinia, fsh tarësia. Për këtë arsye ju e ngrini zërin në qiell duke k nduar për Partinë. Ta doni Partinë me gjithë shpirt,

ajo është nëna jonë e madhe me zemër të gjerë, me mend kurdoherë të freskët, me qëllime kurdoherë të larta pi popullin tonë dhe jo vetëm për popullin tonë.

Këtu jeni grumbulluar sot të festoni Vitin e Ri riga katër anët e Shqipërisë dhe kjo është një gjë e bukur. Ashtu siç është gjithë populli ynë i bashkuar si një tërësi; rreth Partisë, edhe në këtu jemi shtet si një familje madhe. Ne, përfaqësuesit e Partisë, jemi të lumtur që si kemi pranë qindra pioniere dhe pioniere. Shokët e mi ditë, duke ju përshëndetur ju, përshëndetim gjithë pionierët e Shqipërisë, përshëndetim gjithë rininë dhe popullin shqiptar brenda dhe jashtë atdheut, kudo që rrojnë dhe të gjithëve u urojmë me këtë rast një vit të gëzuar e të lumtur dhe u shtoftë në zemrat e tyre, në zemrat e çdo shqiptari dashuria për atdheun tonë të shtrenjtë socialist!

Ne përshëndetim të gjithë pionierët e botës, si dhe gjithë shokët tanë komunistë që luftojnë kudo në botë për një jetë të gëzuar edhe në vendet e tyre, sepse jeta e tyre atje është e mjeruar, nuk ka dhe nuk mund të bëhet asnjë barazim me jetën e lumtur që gëzojnë populli ynë, pionierët tanë. Zemrat tona janë të bashkuara me zemrat e gjithë revolucionarëve e pionierëve të kontinenteve të botës, që shpresojnë e luftojnë të dalin edhe ata në ditë, siç doli populli ynë, siç dolën rinia dhe pionierët tanë.

Nuk po zgjatëm më shumë se dëshirojmë t'ju dëgjojmë ju të këndonit e të vallëzoni. Prandaj, duke ju uruar të gjithëve një vit të ri të gëzuar e të lumtur, le të fillojmë nga festa me këngë, me gëzim e hare dhe të brohorasim:

Rroftë Partia jonë e lavdishme!

Rroftë populli ynë!